**Republika e Kosovës**

Republika Kosova - Republic of Kosovo

***Ministria e Punëve të Brendshme***

*Ministarstvo Unutrasnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs*

**Akademia e Kosovës për Siguri Publike**
Kosovska Akademija za Javnu
Kosovo Academy for Public Safety

# *FAKULTETI PËR SIGURI PUBLIKE*

# *PROGRAMI BACHELOR NË SIGURI PUBLIKE*

# *RI/AKREDITIMI I PROGRAMIT STUDIMOR*

# RAPORT VETËVLERËSIMI

*24/12/2020, VUSHTRRI*

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbajtja

1. HYRJE ....4
1.1. Një vështrim i shkurtër i institucionit dhe programit në vlerësim....4
1.2. Programi Bachelor i Fakultetit të Sigurisë Publike....7
1.3. Udhëheqja institucionale, strukturat, administratës dhe personelit....8
1.3.1. Udhëheqja institucionale ....8
1.3.2. Strukturat e menaxhimit dhe marrëveshjet e administratës dhe personelit....10
1.3.3. Studentët e tij ....13
1.3.4. Mësimdhënia, mësimi dhe kurrikula ....14

2. VLERËSIMI I PROGRAMIT ....17
2.1. Misioni, objektivat dhe administrimi ....17
Analiza SWOT për misionin, objektivat dhe administrimin: ....19
2.2. Menaxhimi i cilësisë ....20
2.2.1. Përshkrimi i sistemit për sigurimin e cilësisë së brendshme....20
2.2.2. Rregulloret e Institucionit për procedurat e sigurimit të cilësisë....21
2.2.3. Procedurat për rishikimin e programeve të studimit ....22
2.2.4. Instrumentet për vlerësimin e cilësisë së programit ....22
2.2.5. Mekanizmat për zbatimin e masave për sigurimin e cilësisë....22
Analiza SWOT për menaxhimin e cilësisë:....23

2.3. Stafi akademik ....24
2.3.1. Stafi, proceset e punësimit dhe zhvillimi profesional....25
2.3.2. Stafi akademik i rregulltë....28
2.3.3. Stafi akademik i angazhuar....29
2.3.4. Stafi akademik vizitor....31
2.3.5. Plani për zhvillimin e stafit akademik ....31
2.3.6. Dosja e stafit akademik....32
Analiza SWOT për stafin akademik: ....32

2.4. Përmbajtja e procesit arsimor ....33
2.4.1. Pasqyra e programit.... 36
2.4.2. Lëndët e përshkruara mësimore .... 40

I. Programi i përgjithshëm ....44
II. Drejtimi Policor - Studimet e specializuara....67
III. Drejtimi Korrektues dhe Sprovues – Studimet e specializuara....98
IV. Drejtimi Doganor – Studimet e Specializuara ....128
V. Drejtimi Emergjent – Studimet e specializuara ....159

Analiza SWOT për përmbajtjen e procesit arsimor: 191

2.5. Studentët 192
2.5.1. Numri aktual i studentëve 193
2.5.2. Punësueshmëria e të diplomuarve në tri vitet e fundit 194
2.5.3. Raporti personel akademik i rregullt / student për njësi dhe institucion në përgjithësi 195
2.5.4. Ndarja përkatësisht ndërmjetësimi i bursave nga institucioni arsimor 195
2.5.5. Organizimi i studentëve brenda institucionit/njësisë 195
2.5.6. Shërbimi Studentor 196
2.5.7. Shërbimi për udhëzim në karrierë dhe kryerjen e praktikës (internship) për student 197
2.5.8. Oferta tjera arsimimi të institucionit (nëse ekzistojnë) 197
2.5.9. Shërbimi për studentët e diplomuar e të punësuar (Alumni) 198
Analiza SWOT për studentët: 199

2.6. Hulumtimi 200
2.6.1. Listimi i publikimeve nga stafi akademik dhe i studentëve 202
2.6.2. Projektet për bashkëpunim ndërkombetar në hulumtim dhe mësimdhënie 202
2.6.3. Ndërlidhja e hulumtimit me mësimdhënien në nivel të institucionit dhe të programit 203
Analiza SWOT për hulumtim: 203

2.7. Infrastruktura dhe burimet 204
2.7.1. Infrastruktura fizike, teknologjisë informative dhe logjistike 204
2.7.2. Burimet njerëzore dhe financiare 207
Analiza SWOT për infrastrukturën dhe burimet: 208

3. EVOLUCIONI DHE ZHVILLIMI I KOHËVE TË FUNDIT I REGJISTRUAR QË NGA VLERËSIMI I MËPARSHËM 209

4. SHTOJCAT (nëse ka) 212

# 1. HYRJE

## 1.1. Një vështrim i shkurtër i institucionit dhe programit në vlerësim

AKSP është institucion i formuar me Ligjin nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, përgjegjës për ofrimin e trajnimeve dhe arsimit të lartë, zbatimin e politikave dhe strategjive të trajnimit, arsimimit të lartë si dhe zhvillimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë publike. Në kuadër të strukturës organizative të Akademisë funksionon Fakulteti i Sigurisë Publike (në tekstin e mëtejmë: Fakulteti), i cili zhvillon programe të arsimit të lartë, hulumtimit dhe zhvillimit në fushën e sigurisë publike. Detyrat dhe përgjegjësit e Fakultetit janë të përcaktuara me Rregulloren (QRK)  nr. 05/2019 për arsimin e lartë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (Miratuar nga Qeveria). Fakulteti ofron programe studimi për të gjitha institucionet e sigurisë publike, përkatësisht:

- *Policinë e Kosovës;*
- *Inspektoratin Policor të Kosovës;*
- *Shërbimin Korrektues;*
- *Shërbimin Sprovues;*
- *Doganën e Kosovës;*
- *Agjencinë e Menaxhimit Emergjent;*

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 04/L-054 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, AKSP i është nënshtruar një transformimi, si në aspektin funksional, po ashtu edhe në atë organizativ. Aspekti funksional lidhet me atë se tani në kuadër të funksioneve të AKSP-së përveç funksionit mbështetës, teknik dhe administrativ, kemi një fuqizim të kompetencave në fushën e ofrimit të trajnimeve si dhe arsimit të lartë.

**Arsimi i lartë në AKSP** - Krahas aprovimit të Ligjit të AKSP-së në dhjetor të vitit 2011, Komisioni Evropian ka aprovuar dhe financuar Projektin e Binjakëzimit me titull: "Përmirësimi i arsimit në sektorët e sigurisë dhe rendit publik" implementuar gjatë periudhës 2012 – 2014 nga Finlanda dhe Estonia. Përmes projektit të binjakëzimi u bë e mundur themelimi i Fakulteti i Sigurisë Publike gjegjësisht Arsimit të Lartë në fushën e sigurisë publike për të gjithë zbatuesit e ligjit, në përputhje me procesin e Bolonjes, përkatësisht me standardet evropiane, diçka që më parë nuk kishte ekzistuar jo vetëm në Akademi, por as në Kosovë dhe në Regjion. Detyrat dhe përgjegjësit e Fakultetit u përcaktuan me Rregulloren  (QRK) -nr. 26/2013 për arsimin e lartë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (miratuar nga Qeveria).

Në projektin e themelimit të Fakultetit të Sigurisë Publike, kontribuan më se 170 zyrtarëve nga Institucionet e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Bashkëpunimi i ngushtë i të gjithë akterëve të përfshirë në projekt, i personelit të Akademisë, zyrtarëve të lartë të Qeverisë së Kosovës, ekspertëve të Institucioneve të Sigurisë Publike si dhe më se 26 Ekspertëve nga Finlanda dhe Estonia. Gjatë periudhës 2012 – 2014, në kuadër të projektit të binjakëzimit në Akademi u realizuan një mori procesesh të rëndësishme: Kompletohet korniza ligjore; hartohet raporti i vetëvlerësimit, dizajnohet kurrikula për Bachelor në sigurinë publike, dizajnohet struktura e programit studimor katër vjeçar (240 ECTS), niveli Bachelor(BA), hartohet "Doracaku i Cilësisë" dhe Sistemi i Sigurimit të Cilësisë, hartohet "Strategjia Zhvillimore e Akademisë dhe Plani i Veprimit'', për vitet 2014 – 2018, rekrutohet stafi i përhershëm akademik në (mars 2014). Në vitin

2014, AKSP iu nënshtrua akreditimit institucional dhe programor, dhe arrihet vendimi i akreditimit të programit studimor katër vjeçar (240 ECTS) për Akademinë në fushën e sigurisë publike për periudhën trevjeçare, përkatësisht 01 tetor 2014-31 Shtator 2017.

Realizimi i të gjitha këtyre proceseve, bënë të mundshme që në në vitin e parë akademik 2014/2015 në Fakultetin e Sigurisë Publike, i cili filloj me 15 tetor 2014, u regjistruan 69 studentë nga Institucionet e Sigurisë Publike, përkatësisht nga: Policia e Kosovës, Shërbimi Korrektues i Kosovës, Shërbimi Sprovues i Kosovës, Agjencia e Menaxhimit Emergjent, Dogana e Kosovës dhe Inspektorati Policor i Kosovës.

AKSP, iu nënshtrua procesit të dytë të riakredimit institucional dhe programor në vitin 2017. Në nivelin instutucional AKSP u akreditua për periudhën pesë vjeçare, përkatësisht 01 tetor 2017-30 shtator 2022, ndërsa atë programor u riakreditua për periudhën trevjeçare, përkatësisht 01 tetor 2017-30 shtator 2020. Këshilli i Cilësisë, në mbledhjen e mbajtur më datë 10 Maj 2018, mori vendim të zgjatet akreditimi institucional për periudhën njëvjeçare, 1 tetor 2022- 30 shtator 2023, ndërsa periudhën e akreditimit të programit studimor për periudhën njëvjeçare, 1 tetor 2020-30 shtator 2021.

AKSP ka hartuar dhe miratuar Strategjinë Zhvillimore dhe planin e veprimit 2019-2022. AKSP, përmes kësaj strategjie, dëshiron të hap rrugë drejt një Akademie moderne e cila synon që duke u mbështetur në përmirësimet e vazhdueshme dhe cilësi të lartë të trajnimeve dhe arsimit të lartë të ofroj nivel të lartë të kompetencave për autoritetet e zbatimit të ligjit për të ju përgjigjur ndryshimit të vazhdueshëm të sfidave.

Misioni dhe vizioni i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike janë formuluar nëpërmjet rolit të saj dhe janë në pajtim me pritshmëritë e të gjitha grupeve të interest,

***Misioni i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike*** *është të* ***ofrojë shërbime me cilësi të lartë të trajnimit, arsimit, kërkimit dhe zhvillimit në fushën e sigurisë publike.***

***Vizioni i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike është që: Në vitin 2022 AKSP-ja do të jetë Qendër e Ekselencës për Siguri Publike në Kosovë.***

Vlerat themelore të AKSP-së përshkruajnë bindjet të cilat janë ndarë me të gjitha palët e interesit. Ato sigurojnë kornizën në të cilën janë marrë vendimet dhe i vendosin parimet udhëheqëse të cilat i përcaktojnë normat e zbatueshme të sjelljes dhe veprimit. AKSP-ja ka përcaktuar këto vlera themelore:

- ***ndershmëria,***
- ***transparenca,***
- ***përgjegjësia,***
- ***etika profesionale*** *dhe*
- ***diversiteti.***

Me qëllim të përcjelljes, së trendëve bashkëkohore në arsimimin e zyrtarëve të sigurisë konformë nevojave të Institucioneve të Sigurisë, Fakulteti i Sigurisë Publike ka krijuar programe studimore të cilat ndihmojnë ngritjen e kapaciteteve dhe sigurisë publike në vend. **Fakulteti** menaxhohet nga dekani i cili është drejtuesi kryesor i njësisë akademik (autoriteti kryesor menaxhues), i ndihmuar nga një prodekan për çështje mësimore. Gjithashtu fakulteti ka edhe koordinatorin e programit studimor bachelor që koordinon aktivitetet akademike ndërmjet palëve të interesit për zbatimin e

programit studimor, si dhe për secilin profil studimor që ofrohet në kuadër të programit studimor, janë të caktuar bartësit e tyre sipas kualifikimeve relevante profesionale, përkatësisht nga radhët e personelit akademik janë caktuar bartës të specializimeve për drejtimet: policor, korrektues dhe sprovues, doganor dhe menaxhimi emergjent. Në kuadër të strukturës organizative është paraparë të funksionojë edhe Instituti për Hulumtim dhe Zhvillim.

Secila prej këtyre funksioneve është i paraparë dhe rregulluar me aktet e nxjerra nga autoritetet relevante, përkatësisht me rregulloret e nxjerra nga Qeveria dhe AKSP-ja, (Drejtori i Përgjithshëm, si dhe nga Këshilli i FSP-së).

**Vështrim i shkurtër i programit studimor në vlerësim** - Programi studimor është program studimi katër (4) vjeçar dhe përfshin 8 semestra, me gjithsej 240 ECTS. Ky program u mundëson studentëve të arrijnë një nivel të mirë të njohurive, shkathtësive dhe kompetencës profesionale. Programi është i dizajnuar në mënyrë të balancuar ndërmjet studimeve teorike dhe vijimit të praktikës profesionale. Nga 240 ECTS kreditë e gjithmbarshme, 160 ECTS kredi i dedikohen pjesës teorike, ndërsa 80 ECTS kredi i dedikohen pjesës praktike. Programi studimor është hartuar për nevojat e agjencive të sigurisë publike. Në tre semestrat e parë të programit, studentët e të gjitha drejtimeve ndjekin lëndët e përbashkëta që kanë synim zhvillimin e shkathtësive dhe kompetencave në fushën e shkathtësive të komunikimit; ligjit dhe etikës; menaxhmentit dhe sigurisë publike; dhe raportet njerëzore dhe sjellja shoqërore, nga të cilat akumulojnë 65 ECTS.

Në semestrin e katërt, studentët profilizohen në drejtimet e caktuara, bazuar në marrëdhënien e punës që kanë me një nga agjencitë e sigurisë publike. Përgjatë studimeve të specializuara në këto drejtime, studentët ndjekin lëndët mësimore obligative dhe zgjedhore, nga të cilat akumulojnë 80 ECTS, si dhe vijojnë praktikën profesionale bazuar në Manualin e Intershipit për studentë. Në semestrin e fundit të studimeve, studentët hartojnë temën e diplomës në përputhje me rregulloret përkatëse të fakultetit nga ku akumulojnë 15 ECTS.

I diplomuari në programin studimor bachelor “Siguri Publike” arrin gradën shkencore “Bachelor i Sigurisë Publike” në njërin nga drejtimet: Policor, Korrektues dhe Sprovues, Doganor dhe Menaxhimi Emergjent. Programi studimor parasheh objektivat e përgjithshme dhe objektivat specifikë për secilin drejtim. Objektivat specifikë janë të përshkruara në trajtimin e profileve sipas drejtimeve dhe ato mund të gjinden në pjesën pasuese të këtij dokumenti, sikurse edhe përshkrimi i objektivave të përgjithshëm të programit studimor.

## 1.2. Programi Bachelor i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike / Fakulteti i Sigurisë Publike

| Emri i Programit të Studimit | Siguri Publike |
|---|---|
| Niveli i Kualifikimit sipas KKK (me shkurtesat, BA, MA , PhD , Program Doktorate , Kurs universitar , Certifikatë apo diplomë profesionale) | Niveli i VI / BA |
| Grada Akademike dhe emërtimi i diplomës në formë të plotë dhe të shkurtuar | **"Bachelor i Sigurisë Publike"**<br>*me specializimet / drejtimet:*<br>- Policor;<br>- Korrektues dhe Sprovues;<br>- Doganor;<br>- Menaxhimi Emergjent. |
| Fusha e Studimit sipas Erasmus Subject Area Codes(ESAC) | 16.0 Fusha tjera të studimit |
| Profili i Programit Akademik ( specilaizimi) | |
| Kohëzgjatja minimale e studimit | Katër(4) vite |
| Forma E Studimit ( e rregullt , pa shkëputje nga puna , studim në distancë , etj.) | Studime të rregullta |
| Numri i ECTS kredive ( total dhe për vit) | 240 |
| Modulet /Lëndët ( titujt) | I diplomuar i aftë të bëhet specialist, profesionist apo menaxher në Siguri Publike . Nga semestri I katërt , studentët do të zgjedhin njërin nga drejtimet si vijon në fushën:<br>- Policor ,<br>- Korrektues dhe Sprovues,<br>- Doganor,<br>- Menaxhimi Emergjent |
| Numri i vendeve të studimit | 65 |
| Udhëheqës i Drejtimit / Programi të Studimit | Prof.Asoc.Dr. Bejtush Gashi, Dekan |
| Personeli i përhershëm shkencor / artistik ( numri sipas kategorive të personelit ) | 1. Prof.Ass.Dr. Vilard Bytyqi – përgjegjës i drejtimit policor;<br>2. Prof.Ass.Dr. Besnik Fetahu - përgjegjës i drejtimit korrektues dhe sprovues;<br>3. Prof.Ass.Dr. Nexhat Jashari - përgjegjës i drejtimit doganor;<br>4. Prof.Asoc.Dr. Bejtush Gashi - përgjegjës i drejtimit menaxhimi emergjent;<br>5. Prof.Ass.Dr. Ferid Azemi;<br>6. Anita Zenuni, MA, Ligjërues;<br>7. Florentina Shala, MA, Ligjërues;<br>8. Halil Asllani, MA, Ligjërues. |
| Taksat e studimit | Pa pagesë |

## 1.3. Udhëheqja institucionale, strukturat, administratës dhe personelit

### 1.3.1. Udhëheqja institucionale

AKSP emërtohet sipas Ligjit Nr.04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike e cila është agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme. AKSP ka subjektivitet juridik që menaxhohet nga Drejtori i Përgjithshëm i cili është përgjegjes për administrimin dhe menaxhimin e përgjithshem te AKSP-së. Funksionet e AKSP-së, d.m.th. mandati, detyrat dhe përgjegjësitë e saj janë përshkruar më tutje në Ligjin për AKSP-në (SHM 7.1). Pjesa tjetër e përgjegjësive si dhe koordinimi me agjencitë e sigurisë publike, duke përfshirë edhe rolin e Bordit të AKSP-së si dhe të KPF së, janë çështje të akteve nënligjore. Me miratimin e Ligjit Nr. 04/L-053 për AKSP-në në nëntor të vitit 2011, është krijuar baza ligjore, organizative dhe funksionale për ofrimin e arsimin e lartë në AKSP Ligji i lartpërmendur ka parapara nxjerrjen e disa akteve nënligjore me qëllim të zbatimit dhe funksionalizimit të arsimit të lartë në AKSP.

**Korniza ligjore në bazë të së cilës vepron AKSP janë:**

Ligji për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike dhe aktet nënligjore që dalin nga ky ligj:

1. Rregullore nr. 03/2012 për ofrimin e trajnimeve dhe shërbimeve për personat privat fizik dhe juridik (miratuar nga MPB);
2. Rregullore nr. 38/2012 për planifikimin e trajnimeve dhe koordinimin e donacioneve për trajnimet e institucioneve te sigurisë publike të cilat organizohen dhe mbahen në AKSP (miratuar nga Qeveria);
3. Rregullore nr. 39/2012 për kodin e etikës në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (miratuar nga Qeveria);
4. Rregullore nr. 06/2013 për Bordin e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike (miratuar nga Qeveria);
5. Rregullore (QRK) - nr. 25/2013 për pagesat e personelit trajnues dhe mësimdhënës si dhe ekspertëve të fushave funksionale (miratuar nga Qeveria);
6. Rregullore (QRK) nr. 05/2019 për arsimin e lartë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (miratuar nga Qeveria),shfuqizon:
   - *Rregullore (QRK) - nr. 26/2013 për arsimin e lartë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike*
7. Rregullore (QRK) nr. 05/2014 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike (miratuar nga Qeveria),

Aktet nënligjore të miratuara nga AKSP:

1. Rregullore (AKSP) nr.01/2020 për Studimet Themelore Bachelor në Fakultetin e Sigurisë Publike,
   **shfuqizon:**
   - *Rregulloren (AKSP) nr. 02/2014-KF për kriteret dhe procedurat për pranimin dhe regjistrimin e studentëve;*
   - *Rregulloren (AKSP) - nr. 04/2016-KF për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (AKSP) nr. 02/2014-KF për kriteret dhe procedurat për pranimin dhe regjistrimin e studentëve;*
   - *Rregulloren (AKSP) nr. 01/2017-KF për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (AKSP) - nr. 02/2014-KF për kriteret dhe procedurat për pranimin dhe regjistrimin e studentëve;*
   - *Rregulloren (AKSP) - nr. 04/2014-KF për organizimin e provimeve dhe vlerësimin e studentëve;*

- *Rregulloren (AKSP) – nr. 05/2014-KF për hartimin dhe mbrojtjen e punimit të temës së diplomës;*
- *Rregulloren (AKSP) - nr. 01/2019-KF për ndryshimin dhe plotësimin e rregullorës (AKSP) - nr. 05/2014-KF për hartimin dhe mbrojtjen e punimit të temës së diplomës.*

2. Rregullore (AKSP) nr. 02 - 2020 për kutitë e vërejtjeve, propozimeve dhe sugjerimeve në AKSP
3. Rregullorja (AKSP) 01/2019 e Punës së Sistemit të Menaxhimit Universitar në AKSP;
4. Rregullore (AKSP) - nr. 01/2020 - KF e Punës së Këshillit të Fakultetit të Sigurisë Publike

   **shfuqizon:**

   - *Rregullore (AKSP) - nr. 01/2014-KF e punës së Këshillit të përkohshëm të Fakultetit të Sigurisë Publike;*
   - *Rregullore (AKSP) - nr. 03/2016-KF për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (AKSP) - nr. 01/2014-KF e punës së Këshillit të përkohshëm të Fakultetit të Sigurisë Publike*

5. Rregullore (AKSP) nr. 01/2017 për njohjen e mësimit paraprak në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike;
6. Rregullore (AKSP) - nr. 01/2016-KF për zgjedhjet e studentëve në Fakultetin e Sigurisë Publike;
7. Rregullore (AKSP) - nr. 02/2016- KF mbi Punën e Këshillit të Studentëve në Fakultetin e Sigurisë Publike;
8. Rregullore (AKSP) - nr. 01/2015 për sigurimin, qasjen dhe ruajtjen në hapësirat e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike;
9. Rregullore (AKSP) - nr. 01/2014 për bibliotekën e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike;
10. Rregullore (AKSP) - nr. 02/2014 për shkeljet, masat disiplinore si dhe procedura disiplinore për vijuesit në AKSP;
11. Rregullore (AKSP) - nr. 03/2014-KF për zgjedhjen, emërimin dhe shkarkimin e dekanit, prodekanit dhe të udhëheqësve të njësive të Fakultetit;
12. Udhëzim Administrativ nr. 01/2012 - AKSP për trajnime dhe zhvillimin e kurrikulave;

**Struktura organizative e AKSP-së**




### 1.3.2. Strukturat e menaxhimit dhe marrëveshjet e administratës dhe personelit

**Organizimi i strukturave vendimarrëse në çështjet akademike** - Përgjegjësitë e organeve vendimmarrse në çështje akademike janë të përcaktuara me Rregulloren (QRK) Nr. 05/2019 për Arsimin e lartë ne Akademinë e Kosovës për Siguri Publike dhe Rregullorën (AKSP)-Nr.01/2020 e punën së Këshillit të Fakultetit të Sigurisë Publike. Sipas strukturës së AKSP-së, Fakulteti është përgjegjës për zbatimin e arsimit të lartë. Fakulteti udhëhiqet nga dekani, i zgjedhur nga Këshilli për një periudhë katër (4) vjeçare nga radhët e personelit akademik me marrëdhënie të rregullt pune, me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat. Në menaxhimin e fakultetit dekanin e ndihmojnë prodekani për mësim, kordinatori i programit studimor, Udhëheqësi i Institutit për Hulumtim dhe Zhvillim dhe sekretaria e fakultetit, të cilët për punën e vet i përgjigjen dekanit.

Fakulteti ka Këshillin e Fakulteti i cili përbëhet nga personeli akademik dhe kryesuesi i këshillit të studentëve dhe kryesohet nga Dekani. Është organi më i lartë akademik dhe autoriteti kryesor vendimmarrës i fakultetit. Këshilli trajton çështje të përgjithshme që lidhen me kërkime, studime dhe mësimdhënie në Fakultet, vendosë për veprimtarinë mësimore dhe shkencore të Fakultetit, kryen edhe punë tjera të ndryshme akademike të inicuara nga Drejtori dhe Bordi i Akademisë. Gjithashtu Këshilli, ndër të tjera është përgjegjës për çështjet e përgjithshme strategjike që lidhen me kërkime, studime, mësimdhënie në Fakultet; organizon mësimdhënien, provimet dhe vlerësimet e studentëve; progresin akademik të studentëve, duke përfshirë shërbimet akademike të studentëve; të sigurojnë cilësinë, vlerësimin dhe çështjet e raportimit.

Përfaqësuesi i studentëve është është anëtar i Këshillit të Fakultetit të FSP-së. Kryesuesi i Këshillit të Studentëve ka të drejtë vote vetëm për çështjet që kanë të bëjnë me studentët dhe studimet të përcaktuar më nenin 4 të Rregullores (AKSP) - Nr. 01/2016-KF për Zgjedhjet e Studentëve në FSP.

Organet menaxhuese dhe vendimmarrëse, duke u bazuar në përgjegjësitë e tyre dhe në zbatim të aktiviteteve akademike, në mënyrë të vazhdueshme themelojnë komisione dhe grupe punuese për çështje të caktuara në kuadër të përgjegjësive të tyre.

Bazuar në Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, Fakulteti i Sigurisë Publike e ka të organizuar administratën në nivel të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike dhe zyrën për çështje të studentëve në nivel të Fakultetit.

Aktualisht numri i nëpunësve administrativ në Fakultet është dy, kurse në njësitë tjera organizative në kuadër të vetë AKSP-së e mbështesin Fakultetin në përmbushjen e misionit të tij. Përkundër që numri i nëpunësve administrativ duhet të ketë rritje, administrata e shërbimeve studentore në përgjithësi është treguar mjaft efektive në kryerjen e punëve dhe ka arritur që të realizoj njërin prej qëllimeve që ka, të japë shërbime mbështetëse kualitative për personelin akademik dhe studentët.

Në kuadër të AKSP-së, bazuar në rregulloren e më lartcekur, janë të organizuara këto njësi organizative, si në vijim:

- Divizioni i personelit:
- Divizioni për sigurim të cilësisë:
- Divizioni për teknologji informative:
- Divizioni për shërbime të studentëve:
- Divizioni për buxhet dhe financa
- Divizioni e prokurimit:
- Divizioni e auditimit të brendshëm:
- Zyra për informim dhe komunikim me publikun:
- Divizioni ligjor:
- Biblioteka e AKSP-së:

**Integriteti Akademik** - Fakulteti funksionon mbi bazën e akteve të brendshme që rregullojnë fushën e integritet akademik nëpërmjet të cilave mbrohen vlerat e lirisë akademike, autonomisë institucionale dhe integritetit etik dhe akademik. Kodi i Etikës ka karakter obligativ për zbatim në Fakultet, duke përfshirë personelin akademik, punëtorët e administratës dhe studentët, si dhe të gjithë personat tjerë që në ndonjë formë a tjetër janë të lidhur me fakultetin. Po ashtu, Fakulteti ka edhe Rregulloren për masat dhe procedurat disiplinore ndaj personelit akademik në Fakultet, e cila përcakton procedurat disiplinore dhe masat e zbatueshme në rastet e përgjegjësisë disiplinore të personelit të fakultetit, në pajtim me Statutin e AKSP-së, Kodin e Etikës dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore të zbatueshme në Fakultet**.**

Qëllimi i këtij kodi është që të promovoj vlerat e fakultetit dhe ndërtimin e një etike bashkëkohore, bazuar në vlerat e pranuara bashkërisht për të ndihmuar orientimin në punë dhe për të rritur imazhin e institucionit. Në këtë drejtim Kodi Etik parasheh disa parime siç janë: Të drejtat e garantuara (universale), respektimi i integritetit dhe dinjitetit të personelit të fakultetit, parimi i autonomisë në fakultet, parimi i efikasitetit, parimi i konkurrencës së drejtë, parimi i lirisë akademike në

procesin mësimor dhe në punën kërkimore shkencore dhe profesionale, parimi i përgjegjësisë akademike, parimi i respektimit të ligjeve dhe rregulloreve dhe parimi i ndalimit të ngacmimit dhe diskriminimit.

Të gjitha rregulloret e brendshme të Fakultetit janë të publikuara ueb faqen e AKSP-së. Stafi akademik, administrativ dhe studentët janë të informuar për përmbajtjen e tyre e këtyre akteve, përmes shpërndarjes së broshurave, organizimit të ditëve informuese etj. Gjithashtu, të gjitha vendimet bëhen publike, përjashtimisht atyre që cenojnë integritetin moral të ndonjë zyrtari në pajtim me Ligjin në fuqi për qasje në dokumente publike. Fakulteti publikon informacione të qarta, të sakta, objektive, relevante, të arritshme dhe të detajuara në lidhje me stafin akademik, veprimtaritë kërkimore dhe akademike, programet që ofron, numrin e studentëve të regjistruar, rezultatet e pritshme të mësimit të programeve të saj, kualifikimet që ata i japin, procedurat e mësimdhënies, të mësimit dhe të vlerësimit të përdorura, normat e kalueshmërisë dhe mundësitë e mësimit për studentët.

**Përfaqësimi i studentëve në strukturat organizative të institucionit** -Duke u bazuar në nenin 60 dhe 61 të Rregullores (QRK) - Nr. 05/2019 për Arsimin e Lartë në AKSP (SHM 7.6) shprehin qartë që interesat e studentëve do të përfaqësohen nëpërmes Këshillit të Studentëve. Anëtarët e Këshillit të studentëve zgjedhen në bazë të rezultateve të zgjedhjeve të cilat organizohen sipas rregullores mbi zgjedhjet studentore të miratuar nga Këshilli i Fakultetit. Kryesuesi i Këshillit të Studentëve është anëtar ex-officio i Këshillit të Fakultetit. Procedura e zgjedhjes së përfaqësuesit të studentëve është demokratike, transparente dhe jo diskriminuese, e cila nuk kufizon të drejtën e studentëve për të përfaqësuar dhe për t'u përfaqësuar. Fakulteti nuk është i përfshirë në procesin e zgjedhjes së përfaqësuesve të studentëve.

Aktet normative që rregullojnë organizimin e studentëve Brenda institucionit janë:

- *Rregullore (AKSP) - Nr. 01/2016-KF për Zgjedhjet e Studentëve në FSP (SHM 7.16)*
- *Rregullore (AKSP) - Nr. 02/2016-KF mbi Punën e Këshillit të Studentëve në FSP (SHM 7.17)*
- *Rregullore (AKSP) - Nr. 01/2020-KF e punës së Këshillit të Fakultetit të Sigurisë Publike. (SHM 7.18)*

KPF në mbledhjen e 25-të të dt. 29.04.2016 ka nxjerr vendimin nr.2/25 SHM 7.10) të datës 29.04.2016 për shpalljen e zgjedhjeve të studentëve për Këshillin e Studentëve/KS të FSP-së dhe vendimin nr.3/25 të datës 29.04.2016 për themelimin e Komisionit zgjedhor për përgatitjen, udhëheqjen dhe organizimin e zgjedhjeve studentore në FSP /AKSP.
Pas përfundimit të procesit zgjedhor, me datën 31.05.2016 është mbajtur mbledhja konstituive e KS të FSP-së ku njëkohësisht është zgjedhur edhe kryesuesi i këtij Këshilli i cili është anëtar ex-officio i KPF –së.

**Procedurat për përzgjedhjen e personelit**-Procedurat për përzgjedhjen dhe avancimin e personelit akademik është e rregulluar me Rregulloren (QRK) - nr. 05/2019 për arsimin e lartë në AKSP (SHM 7.6). Sipas nenit 25 të kësaj Rregulloreje çdo anëtar i personelit punësohet mbi bazën e kontratës individuale me AKSP-në përmes konkursit publik të shpallur. Të gjitha kriteret dhe kualifikimet po ashtu janë të përcaktuara në mënyrë transparente.

Dosja e secilit kandidat që konkurron për pozita mësimore në fakultet sipas konkursit të shpallur, shqyrtohet nga një komision vlerësues që përbëhet nga personeli akademik me ekspertizë relevante profesionale në fushën e njëjtë apo të përafërt të lëndëve të përfshira në konkurs dhe të njëjtit i

rekomandojnë Këshillit të Fakultetit zgjedhjen e njërit kandidat në thirrjen akademike të caktuar. Këshilli pas zgjedhjes së kandidatit në thirrjen akademike të caktuar, i propozon Drejtorit të Përgjithshëm të AKSP emërimin e tij.

Zgjedhja në thirrjen akademike, profesor i rregullt, profesor i asocuar, profesor asistent, ligjërues dhe asistent, bëhet në kohëzgjatje prej katër (4) vitesh.

**Emërtimet (titujt) e paraparë për personelin shkencor**-Sipas procedurave përkatëse të parapara me bazën ligjore të zbatueshme në nivel kombëtar, si dhe në AKSP, thirrjet akademike për personelin akademik në mënyrë të pavarur i jep AKSP bazën për emërimin në thirrjen akademike të caktuar shërben Ligji për Arsimin e Lartë dhe Rregullorja (QRK) nr. 05/2019 për Arsimin e Lartë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike. Sipas Rregullores (QRK) nr. 05/2019 për Arsimin e Lartë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (SHM 7.6) personeli akademik i FSP-së përbëhet nga këta tituj akademik:

- *Profesor i rregullt*
- *Profesor i asocuar*
- *Profesor asistent*
- *Ligjërues, dhe*
- *Asistent*

**Ngritja e qendrave tjera** - AKSP/FSP zhvillon vetëm programin studimor "Siguria Publike", me specializimet në drejtimet: Policor, Korrektues dhe Sprovues, Doganor dhe Menaxhimi Emergjent. AKSP/FSP funksionon vetëm në kuadër të kampusit në Vushtrri.

**Koncepti i zhvillimit nën përfilljen e parimeve udhëheqëse dhe të planit financiar**-AKSP-ja ka të përcaktuara parimet e saj mbi bazën e të cilave udhëheq dhe zhvillon planet e saj konform burimeve financiare transparente dhe të planifikuara në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi, të cilat rregullojnë çështjet financiare:

- *Ligji për Menaxhimi i Financave Publike dhe Përgjegjësitë*
- *Ligji per Buxhet i Republikës së Kosovës*
- *Rregullat Financiare të Thesarit dhe Udhëzimet Administrative*

### 1.3.3. Studentët

Regjistrimi i studentëve në Fakultetin e Sigurisë Publike bëhet sipas rregullave të parapara me Rregulloren e Arsimit të Lartë të AKSP, Rregulloren për Studimet Bachelor në FSP, si dhe sipas kushteve dhe kritereve plotësuese të cilat përcaktohet në konkursin e shpallur për regjistrimin e studentëve në vitin përkatës akademik.

Kuotën e përvjetshme prej 65 studentëve të lejuar nga Agjencioni i Akreditimit për regjistrim të studentëve, AKSP e respekton në përpikëri. Bordi i AKSP diskuton lidhur me numrin e nën-kuotave të cilat do t'i ndajnë agjencitë ndërmjet vete.

Deri në vitin akademik 2019/2020, AKSP ka shpallur konkursin, kanë bërë përzgjedhjen, si dhe kanë bërë regjistrimin e studentëve në FSP. Nga viti akademik 2020/2021, me plotësim/ndryshimin e Rregullores për Studimet Bachelor në FSP, konkursi dhe përzgjedhja e studentëve administrohet nga agjencitë e sigurisë ku janë të punësuar zbatuesit e ligjit dhe pas përzgjedhjes, lista rekomanduese i dërgohet FSP-së për regjistrimin kandidatëve në vitin e parë akademik, në përputhje me plotësimin e kushteve dhe kritereve të përcaktuara me rregulloret përkatëse për regjistrimin e studentëve.

Meqenëse programi studimor i dedikohet plotësimit të nevojave të agjencive të sigurisë publike, për rrjedhojë studentët e Fakultetit për Siguri Publike janë të punësuar në institucionet e sigurisë publike, përkatësisht në institucionet: Polici, Shërbimi Korrektues, Shërbimi Sprovues, Inspektorati Policor, Dogana dhe Agjencioni i Menaxhimit Emergjent.

AKSP së bashku me agjencitë përkatëse të sigurisë publike mbulon shpenzimet e studentëve për vijimin e studimeve në programin studimor. Për ta ndjekur programin studimor studentët nuk kanë taksë për të paguar, gjithashtu në koordinim  me agjencitë mbështet studentët duke ua mundësuar marrëdhënien e tyre të rregullt të punës dhe moscenimin e pagës se tyre gjatë dy ditëve të punës që vijojnë studimet në AKSP, ndërsa ditët e mbetura vazhdojnë punën në pozitat e tyre në agjencitë e tyre.

Po ashtu AKSP, studentëve të FSP-së ua ka mundësuar edhe mbulimin e shpenzimeve buxhetore të ushqimit, akomodimin në konvikte, mbështetjen me transportin e rregullt të AKSP-së si dhe shërbime tjera përkatëse.

AKSP/FSP obligohet të krijojë mundësi të barabarta për të gjithë studentët pa dallim gjinie, race, gjuhe, religjioni, orientimi seksual, statusi martesor, përkatësie kombëtare, etnike ose sociale  etj., duke e ndaluar çfarëdo lloj diskriminimi tjetër që mund ta atakoj personalitetin apo integritetin e studentit.

### 1.3.4. Mësimdhënia, mësimi dhe kurrikula

**Mësimdhënia:** FSP është njësi akademike që funksionin në kuadër të strukturës organizative të AKSP dhe ofron programin studimor “Siguria Publike” me drejtimet/specializimet: Drejtimi Policor, Drejtimi Korrektues dhe Sprovues, Drejtimi Doganor dhe Drejtimi i Menaxhimit Emergjent. Në kuadër të këtij programi studimor organizohen dhe zhvillohen studimet universitare të nivelit bachelor. Studimet bachelor organizohen në mënyrë të rregullt dhe pa shkëputje nga puna.

Mësimdhënia është e bazuar nga zbërthimin dhe zbatimin e kurrikulës së këtij programi, duke u plotësuar me përmbushjen me aktivitete të përcaktuara lidhur me arritjen e objektivave të lëndës dhe objektivave të përgjithshme të programit studimor. Për secilën lëndë veç e veç janë paraparë aktivitete me anë të të cilave realizohet programi studimor, duke përshirë, ligjëratat, ushtrimet, punën praktike, seminaret, hulumtimet shkencore, case study, punë individuale dhe grupore, mentorim të studentëve etj.

Mësimdhënësit e FSP janë të kualifikuar dhe me përvojë në mësimdhënie. Fakulteti ka 8 mësimdhënës me marrëdhënie të rregullt të punës, nga të cilët 5 janë me gradën shkencore PhD,

ndërsa 3 të tjerë janë me gradën master. Përgjatë kohës sa janë pjesë e FSP/AKSP, mësimdhënësit kanë pasur mundësi të realizojnë vizita studimore në institucione të rëndësishme simotra në rajon dhe Evropë, si dhe disa kanë arritur grada shkencore në universitete amerikane. Fal përvojës së këtyre mësimdhënësve, studentët kanë mundësi të njihen me metodat më bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Metodologjitë e mësimdhënies janë nga më të ndryshmet, varësisht nga natyra e lëndës që ligjërohet dhe nga niveli i studimeve në përgjithësi dhe të njëjtat janë të përshkruara në modulet përkatëse.
Për çdo vit akademik, përkatësisht çdo semestër organizohet vlerësimi i mësimdhënësve nga ana e studentëve. Ky vlerësim realizohet dhe administrohet nga Zyra e Sigurimit të Cilësisë që vepron në kuadër të Zyrës së Drejtorit të Përgjithshëm. Kjo zyrë harton raportin e vlerësimit dhe e dërgon tek Dekani i FSP-së, i cili obligohet ta ndajë me të gjitha mësimdhënësit e angazhuar në procesin arsimor.

Stafi akademik përdor një mori të metodave dhe strategjive të reja të mësimdhënies të cilat synojnë të zhvillojnë tek studentët aftësi të larta të të menduarit, avancim të njohurive rreth lëmisë apo fushës së tyre studimit, përfshirë të kuptuarit e teorive dhe parimeve, por njëkohësisht edhe shkathtësi që të demonstrojnë mjeshtërinë për të zgjidhur probleme komplekse dhe të paparashikuara në fushën e studimit dhe të realizojnë detyra apo studime të cilat përfshijë menaxhimin e projekteve të cilat mund të përfshijë përgjegjësinë për vendimmarrje në kontekste të reja të studimit apo të menaxhojnë zhvillimin e tyre profesional. Metoda dhe strategji të tilla, si diskutimet e hapura, detyra për ofrimin e zgjidhjeve për çështje specifike, detyra grupore, vlerësime të ndërmjetme, krijim të ‘produkteve’ dhe prezantim të tyre, diskutim argumentues për materialet burimore të fundit, diskutim të rezultateve nga hulumtimet e fundit, etj, krijojnë mundësitë që studentët tanë të krijojnë unin e tyre profesional, të jenë të aftë të gjejnë zgjidhje në situatat praktike por edhe të kenë qëndrime rreth çështjeve relevante në fushën e tyre.

**Mësimi:** Plan-programi i lëndës u prezantohet dhe u dorëzohet studentëve nga ana e bartësit të lëndës në çdo fillim të ligjëratave për semestrin përkatës. Në këtë plan-program mësimor përfshihen të gjitha të dhënat e duhura për lëndën, përfshirë të gjitha aktivitetet e planifikuara nga mësimdhënësi që i ndihmojnë studentëve të përvetësojnë përmbajtjen e lëndës, me qëllim të zhvillimit dhe arritjes së njohurive, aftësive dhe shkathtësive të përcaktuara për kursin përkatës. Me qëllim të arritjes së rezultateve në mësimdhënie dhe në mësimnxënie, në modulin përkatës janë planifikuar metoda të caktuara për arritjen e këtyre rezultateve, përkatësisht: ligjëratat, ushtrimet, punën praktike, seminaret, hulumtimet shkencore, case study, punë individuale dhe grupore, mentorim të studentëve. Këto aktivitete janë të përshkruara në programin studimor, si dhe janë të detajuara në syllabusin e lëndës.
Vijueshmëria e ligjëratave dhe aktiviteteve tjera akademike dhe profesionale është e obliguar dhe evidentohet rregullisht përmes sistemit elektronik.

Progresi i studentëve për çdo kurs vlerësohen në mënyrë permanente me anë të nënshtrimit metodave të ndryshme të vlerësimit të përcaktuara në syllabus të lëndës mësimore.
Studentët kanë qasje në bibliotekën e AKSP e cila është e pajisur me disa tituj të rëndësishëm të librave. Shumica e mësimdhënësve përgatisin materialet relevante për lëndët ku janë bartës përgjatë angazhimeve semestrale. Studentët dhe mësimdhënësit kanë mundësi edhe të qasje në disa databaza të bibliotekave elektronike.

Me qëllim të administrimit efikas dhe efektiv të procesit mësimor, AKSP/FSP posedon një hapësirë moderne të sallave për mbajtjen e ligjëratave. Investimet për përmirësimin e infrastrukturës, përkatësisht për zgjerimin e hapësirave dhe si dhe avancimin e pajisjes tekniko-teknologjike të sallave është i vazhdueshëm, dhe tani bërë investim për ngritjen e një objekti të financuar nga Qeveria, i cili është në fund të përfundimit nga kontraktuesi i autorizuar.

**Kurrikula**: Studimet universitare në FSP bazohen ne programin studimor bachelor. Në vitin 2016, është realizuar "Studimi i Fizibilitetit - Themelimi i studimeve pasuniversitare në sigurinë publike dhe në sektorin e sigurisë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike", nga eksperti i Misionit të OSBE-së në Kosovë Dr. Klaus Welter. Dhe kontributdhënës të tjera nga Projekti IPA-2. Mbi këtë studim të rëndësishëm është duke u punuar edhe programi studimor master dhe synohet të fillohet të zbatohet në vitin 2022. Përmbajtja e programit të tanishëm të studimit udhëhiqet nga mësimdhënësit që janë të caktuar si bartës të drejtimeve që ofrohen në këtë program studimor, ku përfshihen edhe mësimdhënësit e tjerë, menaxhmenti i AKSP, përfaqësuesit e agjencive të sigurisë dhe palët tjera të interesit. Programi i hartuar studimor miratohet nga Këshilli i FSP-së.

Hartimi dhe zhvillimi i kurrikulave në FSP, në esencë ka për qëllim zhvillimin e një mori procese dhe përvoja që studentët duhet t'i zhvillojnë për të arritur një gradë shkencore bachelor në sigurinë publike, sipas drejtimeve përkatëse. Programi studimor parasheh disa komponentë që duhet t'i përmbajë, përkatësisht, objektivat e programit si dhe rezultatet e pritura të të nxënit dhe pastaj në bazë të aktiviteteve të planifikuara në kurikul t'i realizoj në mënyrë që studentët të kanë mundësi të arrijnë objektivat dhe rezultatet e parapara.Gjatë hartimit të kurrikulave rëndësi të veçantë i kushtohet prezantimit të të dhënave të rëndësishme të lëndës mësimorë, përkatësisht qëllimit të lëndës, rezultatet e pritura të nxënies, metoda e vlerësimit të studentit, metodologjia e mësimdhënies, literatura e cila është e përshtatshme për të përdorur gjatë studimeve etj.

Struktura e kurrikulës, me rrjedhën e saj logjike, ofron rezultate të të nxënit dhe zhvillon kompetenca të përgjithshme dhe specifike, të cilat janë të krahasueshme me programet mësimore në shumë institucione evropiane (p.sh. Finlandë, Estoni, Slloveni, etj.). Rezultatet e përgjithshme të të nxënit për programin studimor janë të pasqyruara në pjesën pasuesi të këtij dokumenti, ndërsa rezultatet specifike të të nxënit janë të pasqyruara në përshkrimin e pjesës programore të drejtimeve veç e veç.

FSP me programin e saj studimor synon të diplomojë studentë për t'iu përgjigjur nevojave të agjencive ligj-zbatuese, për arritjen e objektivave të tyre legjitime dhe përgjigjes në sfidat e ndryshueshme që paraqiten.

## 2. VLERËSIMI I PROGRAMIT

### 2.1. Misioni, objektivat dhe administrimi

**Misioni:** Programi i studimit Bachelor "Siguria Publike" është program unik, me përmbajtje multidisiplinare në fushën e sigurisë publike, i hartuar me kujdes të veçantë për studentët e punësuar në agjencitë e sigurisë publike në Republikën e Kosovës, përkatësisht për zyrtarët e punësuar në këto agjenci të sigurisë publike: Polici, Doganë, Shërbimin Korrektues, Shërbimin Sprovues, Inspektoratin Policor dhe Agjencionin për Menaxhimin Emergjent.

Misioni i programit studimor buron nga dokumentet strategjike të zbatueshme nga AKSP, përkatësisht nga Ligji për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, Rregullorja e Qeverisë nr. 05/2019 për Arsimin e Lartë në AKSP, si dhe Strategjia Zhvillimore dhe Plani i Veprimit i AKSP (2019-2022). Misioni i programit studimor konsiston në ofrimin e shërbimeve me cilësi të lartë të arsimit, kërkimit dhe zhvillimit në fushën e sigurisë publike, përkatësisht që studentët t'i përgatisë me njohuri, shkathtësi dhe kompetencë profesionale në kryerjen e detyrave dhe ushtrimin e përgjegjësive ligjore brenda fushëveprimit të agjencive të sigurisë publike.

E rëndësishme për këtë program studimor është synimi që të rrisë nivelin e kërkimit shkencor në fushën e sigurisë publike, si dhe për studentët të zhvillojnë aftësi veprimi, iniciative dhe komunikimi të të menduarit në zgjidhjen e problemeve praktike gjatë zbatimit të ligjit, apo udhëheqjes, përkatësisht menaxhimit të rasteve, bazuar krejtësisht në përdorimin e literaturës së gjerë analitike, kërkimore dhe praktike për të krijuar udhëheqës, menaxher apo edhe ekspert në fushën e sigurisë publike.

Një nivel i tillë i njohurive, shkathtësive dhe kompetencës profesionale është i përcaktuar qartazi në kurrikulën e këtij programi. Programi studimor është i dizajnuar që në tre semestrat e parë të ndjekin studimet e përbashkëta të gjithë studentët e agjencive të sigurisë publike, ndërsa nga semestri i katërt, studentët do të profilizohen sipas drejtimeve përkatëse, përkatësisht sipas agjencive ku janë të punësuar. Përgjatë tri semestrave studentët marrin njohuri dhe shkathtësi profesionale nga fusha e shkathtësive të komunikimit, ligjit dhe etikës, menaxhmentit dhe sigurisë publike, si dhe të raporteve njerëzore dhe sjelljes shoqërore.

Programi studimor është një program studimi katër vjeçar dhe përfshin 8 semestra me gjithsej 240 ECTS. Ky program u mundëson studentëve të arrijnë një nivel të mirë të njohurive, shkathtësive dhe kompetencës profesionale. Programi është i dizajnuar në mënyrë të balancuar ndërmjet studimeve teorike dhe vijimit të praktikës profesionale. Nga 240 ECTS kreditë e gjithëmbarshme, 160 ECTS kredi i dedikohen së studentëve në pjesën teorike, ndërsa 80 ECTS kredi i dedikohen përgatitjes së studentëve për pjesën praktike.

Pjesa teorike dhe pjesa praktike janë të harmonizuara në mënyrë unike, duke i krijuar studentëve përgatitje profesionale tejet të mirë. Koncepti i praktikës profesionale është i përshkruar në Manualin e Intershipit të nxjerrë nga Këshilli i fakultetit, dokument ky i cili është hartuar me pjesëmarrjen aktive të stafit akademik, përfaqësuesve të agjencive të sigurisë publike, menaxhmentit të AKSP, si dhe me mbështetjen e ekspertizës ndërkombëtare nga Akademitë përkatëse të Finlandës dhe Estonisë. Pjesa e praktikës profesionale vijohet në agjencitë e sigurisë publike.

**Objektivat:** Të diplomuarve në programin studimor "Siguria Publike" u kërkohet të kenë ekspertizë dhe aftësi të shumanshme të bazuara në vlerat dhe kodin e sjelljes të pranuar

përgjithësisht në punën e agjencive të sigurisë publike. Synimi strategjik i AKSP, përkatësisht FSP, është të ofrojë arsim të lartë për nevojat e agjencive të sigurisë publike, bazuar në kërkime shkencore dhe njohuri kulturore për studentët që synojnë të arrijnë pozita të avancuara të punës në nivel ekspertësh, udhëheqësish apo menaxherësh në agjencitë punëdhënëse, si dhe të mbështesë rritjen profesionale të secilit student dhe të promovojë të mësuarit gjatë gjithë jetës. Për më tepër, AKSP/FSP ka vendosur bazat për punë kërkimore dhe zhvillimore që do të mbështesin planifikimin dhe zhvillimin e agjencive të sigurisë publike, përkatësisht fushën e sigurisë publike, si dhe mësimdhënien në arsimin e lartë në AKSP.

Programi studimor jep gradën shkencore Bachelor i Sigurisë Publike, me specializimet / drejtimet: Policor, Korrektues dhe Sprovues, Doganor dhe Menaxhimi Emergjent. Programi studimor parasheh objektivat e përgjithshme dhe objektivat specifikë për secilin profil studimor. Objektivat specifikë janë të përshkruara në trajtimin e profileve sipas specializimeve përkatëse dhe ato mund të gjinden në pjesën pasuese të këtij dokumenti. Në objektivat e përgjithshme të programit studimor parashihet që studenti të arrijë:

- *Avancimin e shkathtësive dhe kompetencave gjithëpërfshirëse, teorike dhe praktike, për kryerjen e detyrave dhe funksioneve të specializuara në agjencitë e sigurisë publike;*
- *Avancimin e shkathtësive dhe kompetencave gjithëpërfshirëse, teorike dhe praktike, për kryerjen e detyrave dhe funksioneve udhëheqëse dhe menaxheriale në agjencitë e sigurisë publike;*
- *Shkathtësitë për të ndjekur trendët në zhvillimet praktike nga të cilat sfidohet siguria publike, përkatësisht aftësia e reagimit adekuat dhe proporcional karshi këtyre zhvillimeve;*
- *Shkathtësitë e nevojshme që dalin nga detyrimet ndërkombëtare në lidhje me sigurinë publike;*
- *Shkathtësitë përkatëse të komunikimit dhe gjuhëve;*

**Administrimi** - Çështjet procedurale dhe akademike lidhur me programin studimor janë të pasqyruara në mënyrë transparente në Ligjit për AKSP-në, Rregullores për Arsimin e Lartë, si dhe në Rregulloren për studimet bachelor në Fakultetin e Sigurisë Publike. Këto dokumente janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit, ku studentët, personeli akademik dhe publiku kanë qasje të plotë. Këto dokumente ligjore përcaktojnë kushtet, kriteret dhe procedurat lidhur me zbatimin e programit studimor, përkatësisht të drejtat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga to për personelin akademik, studentët dhe palët tjera të interesit.

Fakulteti i Sigurisë Publike që ofron këtë program studimor, ka kapacitete të kënaqshme akademike, administrative dhe financiare për të mundësuar zbatimin e plotë të programit. Si pjesë e strukturës institucionale, fakulteti është i decentralizuar në njësitë përkatëse organizative sikurse është paraqitur në organogramin e AKSP-së.
Në kuadër të strukturës së brendshme organizative të FSP-së vepron Dekani si udhëheqës i njësisë akademike, i ndihmuar nga një prodekan për çështje mësimore, gjithashtu fakulteti ka edhe koordinatorin e programit studimor bachelor që koordinon aktivitetet akademike ndërmjet palëve të interesit për zbatimin e programit studimor, si dhe për secilin profil studimor që ofrohet në kuadër të programit janë të caktuar bartësit e tyre sipas kualifikimeve relevante dhe kjo reflekton organizimin e brendshëm dhe delegimin e përgjegjësive.

**Analiza SWOT për misionin, objektivat dhe administrimin:**

## A. Pikat e forta

- Misioni i programit studimor "Siguria Publike" është i harmonizuar në tërësi me misionin e FSP-në, përkatësisht AKSP-në;
- AKSP/FSP është i vetmi institucion i mandatuar me ligj për të ofruar arsimimin e lartë për zyrtarët e agjencive të sigurisë publike;
- Objektivat e përgjithshme të programit studimor janë reale, të matshme dhe të arritshme dhe janë refleksion i analizës së nevojave të agjencive, të bazuara në rezultatet e konsultimeve ndërmjet stafit akademik, menaxhmentit të AKSP-së, përfaqësuesve të agjencive, ekspertizës ndërkombëtare etj.;
- Rezultatet e pritura mësimnxënies të programit në tërësi dhe të lëndëve janë në përputhje me nivelin e studimeve bachelor dhe bazohen në kualifikimet e parapara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve;
- Administrimi i programit studimor, duke filluar nga regjistrimi i studentit dhe deri në përfundim e tij, është i qartë dhe është në përputhje me dokumentet ligjore dhe strategjike të AKSP;
- Ndërlidhje e plotë e pjesës teorike dhe asaj praktike, përkatësisht gërshetim ndërmjet objektivave teorike akademike dhe nevojave praktike operative;
- Staf akademik i kualifikuar dhe kapacitete të kënaqshme akademike, administrative dhe financiare për të zbatuar suksesshëm programin studimor;
- Digjitalizimi i shërbimeve administrative për nevoja akademike dhe studentore;
- Mobiliteti i stafit akademik dhe studentëve në institucione të arsimit të lartë ku AKSP ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi dhe ka krijuar bashkëpunim për nevoja arsimore, hulumtuese dhe nevoja tjera;

## B. Dobësitë

- Mungesa e caktuar e literaturës shkencore në gjuhën shqipe për t'i mbuluar lëndët e caktuara;
- Nevoja për rritjen e numrit të stafit akademik me marrëdhënie të rregullt të punës;
- Angazhimi i studentëve në detyra operacionale përgjatë kohës sa vijojnë pjesën teorike të programit studimor;
- Mungesa e funksionalizimit të rrjetit alumni, përkatësisht një zyre për zhvillim të karrierës;

## C. Mundësitë

- Krijimi i programit master sipas nevojave konkrete të agjencive të sigurisë publike;
- Ngritja e kapaciteteve hulumtuese që do të mbështesin planifikimin dhe zhvillimin e agjencive të sigurisë publike, përkatësisht fushën e sigurisë publike, si dhe mësimdhënien në arsimin e lartë në AKSP;
- Krijimi i hapësirave moderne për mësimdhënie, hulumtim dhe mësimdhënie pas inaugurimit të objektit të FSP-së;

**D. Sfidat**

- Mungesa e ndërlidhjes së programit të trajnimit bazik, me programin studimor të arsimit të lartë "Siguria Publike" sipas drejtimeve përkatëse;
- Mungesa e promovimit të studentëve në grada dhe detyra në agjencitë e tyre pas përfundimit të studimeve;

## 2.2. Menaxhimi i cilësisë

Fakulteti posedon një sistem të mirëfilltë për sigurimin dhe vlerësimin e cilësisë që bazohet në një politikë të qëndrueshme e cila bazën e ka në Statutin e AKSP-së, doracakun për sigurimin e cilësisë, paketën e instrumentëve të matjes së cilësisë dhe dokumentin e treguesve të përformancës në nivel të institucioni, të publikuara në ueb faqen e institucionit.
Të gjitha dokumentet e Fakultetit, janë në përputhje me Ligjin për arsimin e lartë, Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve, Kornizën Evropiane, Strategjinë kombëtare për arsim të lartë, dhe manualet dhe udhëzuesit e AKA-së.

Funksionet e sigurimit të cilësisë në të gjithë institucionin janë integruar plotësisht në strategjitë normale të zhvillimit dhe planifikimit në një cikël të përcaktuar të planifikimit, zbatimit, vlerësimit dhe rishikimit. Sistemi i sigurimit të cilësisë mbulon të gjithë gamën e aktiviteteve institucionale. Plani Strategjik ka paraparë fuqizimin e mëtejmë e të gjithë sistemit të sigurimit të cilësisë, duke e mbyllur ciklin e dokumenteve që përbëjnë politikën e fakultetit për menaxhim të cilësisë, si dhe duke detajuar kompetencat e organeve që merren me këtë proces. Sigurimi i cilësisë në Fakultet, përfshinë:
- *Studentët;*
- *Stafin akademik*
- *Stafin administrativ dhe*
- *Menaxhmentin.*

Vlerësimet e rregullta bëhen në fund të çdo semestri dhe raportohen raporte që ofrojnë një pasqyrë të performancës për institucionin në tërësi dhe për njësitë organizative dhe funksionet kryesore brenda saj.

### 2.2.1. Përshkrimi i sistemit për sigurimin e cilësisë së brendshme

Sistemi për sigurimin e cilësisë së brendshme përqendrohet në çështjet akademike të mësimdhënies, mësim-nxënies, përkrahjes së studentëve, zhvillimin e stafit akademik dhe jo akademik. AKSP e ka ndërtuar dhe jetësuar sistemin për menaxhimin e cilësisë së brendshme bazuar në standardet dhe udhëzimet evropiane për ta siguruar qëndrueshmërinë e institucionit. Politikat dhe procedurat formale janë zhvilluar dhe zbatuar si një kornizë për sigurimin e cilësisë në të gjitha aktivitetet e AKSP -së. Sistemi i zbatuar i cilësisë jep një pasqyrë të parimeve të menaxhimit të cilësisë në AKSP dhe formon bazën për përmirësimin e performancës dhe përsosmërisë organizative. Sistemi për menaxhimin e cilësisë së brendshme i AKSP-së përshkruhet në Doracakun e Cilësisë (SHM 7.4) i cili është një dokument i rëndësishëm i AKSP -së pra është një dokument i inkurajimit që AKSP-ja të vazhdoj të performoj me sukses në realizimin e misionit, vizionit të saj. Doracaku i cilësisë (SHM 7.4) është hartuar nga AKSP në bashkëpunim me ekspertët nga Finlanda dhe Estonia në kuadër të Projektit të binjakëzimit ,,Përmirësimi i arsimit në sektorët e rendit dhe sigurisë publike në Kosovë"" dhe si i tillë është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i AKSP-së me datë 30.09.2013, i cili është publikuar dhe është vënë në dispozicion për të gjithë anëtarët e stafit. Poashtu ky doracak rishikohet np faza dhe periudha kohore në përputhje me informatat kthyese të marara nga mekanzimat vlerësues,

plotësim/ndryshimeve programore në përshtatshmërinë e programit studimor si dhe në atë të avancimit të shpërbimeve për AKSP dhe FSP në përgjithësi, andaj në këtë apsket doracaku i cilësisë është rishikuar në vitin 2017 në përshtatje të programeve profesionale dhe atyre arsimore si dhe rishikimi i fundit është bërë në vitin 2020 duke avncuar mekanizmat vlerësues në formatin elektronik në përputhje me përshtatshmëriё aktuale pandemike.

Doracaku i cilësisë (SHM 7.4) në pajtim me sistemin për menaxhimin e cilësisë së brendshme, përshkruan proceset dhe nën-proceset thelbësore të AKSP-së, bazën për planifikim (planifiko), aktivitetet (kryej), monitorimi dhe vlerësimi (kontrollo), si dhe metodat dhe procedurat për përmirësim (vepro). Doracaku i cilësisë (SHM 7.4) përshkruan parimet dhe procedurat e cilësisë së AKSP -së, aktivitetet kryesore, qëllimet, treguesit e matshëm dhe praktikat lidhur me vlerësimin, matjen dhe zhvillimin e aktiviteteve. Sistemi për menaxhimin e cilësisë së brendshme përdoret nga menaxhmenti i AKSP-së si një kornizë për udhëheqjen e organizatës drejt performancës së përmirësuar dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërlidhet me katër proceset thelbësore dhe 15 nën proceset e AKSP-së, të cilat janë të përshkruara në hollësi përmes 4 hapave vijues të ciklit të cilësisë së "Deming-ut".

Thelbi i sistemit për menaxhimin e cilësisë së brendshme bazohet në Kornizën e përgjithshme të standardeve (SHM 7.4), e cila ndihmon për të planifikuar dhe identifikuar një sërë aktivitetesh të nevojshme për arritjen e një procesi të qëndrueshëm dhe të zbatueshëm të sigurimit të cilësisë në AKSP. Korniza e përgjithshme e standardeve përdoret si një metodë funksionale për përshkrimin e të gjitha proceseve relevante, nën-proceseve dhe synimeve të cilësisë në institucion dhe kjo kornizë është e bashkangjitur si shtojcë në Doracakun e Cilësisë (SHM 7.4). Korniza përshkruan në hollësi treguesit e matshëm për të gjitha qëllimet e cilësisë, shpeshtësinë e aktiviteteve që duhet të përmbushen, mjetet dhe kriteret e vlerësimit, bartësit e procesit dhe veprimet për përmirësim (SHM 7.4 faqja 30-32).

### 2.2.2. Rregulloret e Institucionit për procedurat e sigurimit të cilësisë

Bazuar në Rregulloren QRK nr. 05/2019 për arsimin e lartë në AKSP, institucioni e zhvillon sistemin e tij për sigurimin e cilësisë me qëllim që të përmirësojë cilësinë dhe të garantojë arritjen e objektivave të saj (SHM 7.6, neni 62-65).

Në kuadër të strategjisë zhvillimore të AKSP-së 2019 – 2022 njëra ndër objektivat e përgjithshme të saj është "***Implementimi i politikave të sigurimit të cilësisë sipas standardeve bashkëkohore***".
Në kuadër të këtij objektivi strategjik për arritjen e tij janë paraparë këto objektiva specifike:
4.1. Rishikimi i politikave të sigurimit të cilësisë;
4.2. Vlerësimi i programeve profesionale, trajnuese dhe arsimore.

Monitorimi i aktiviteteve të miratuara në dokumentin e lartpërmendur kryhet rregullisht nga ana e menaxhmentit të lartë të AKSP-së në çdo fundvit.

Doracaku i cilësisë (SHM 7.4) paraqet një pasqyrë të hollësishme për atë se si të gjitha proceset menaxhohen nga pikëpamja e vlerësimit dhe përmirësimit të cilësisë në fushat thelbësore. Sigurimi i cilësisë në akademi bazohet në parimet e "Deming-ut", që do të thotë se aktivitetet për realizimin e secilit proces planifikohen dhe zbatohen, performanca brenda proceseve monitorohet, matet dhe analizohet (gjithashtu shpeshtësia e aktiviteteve monitoruese përcaktohet), aktivitete për përmirësimin e proceseve zbatohen në bazë të rezultateve, dhe objektivat e reja përcaktohen.

### 2.2.3. Procedurat për rishikimin e programeve të studimit

Me qëllim të azhurnimit dhe mbajtjes së cilësisë të programit Studimor, akademia përmes doracakut të cilësisë ka paraparë procedurat, fazat për rishikim të programit studimor. Rishikimi i programit bachelor ne Sigurinë Publike është bërë nga grupi punues me Vendim nr. 08/2020 të datës 01.07.2020 nga Këshilli i FSP-së për formimin e Komisionit për procesin e ri/akreditimit dhe njëheresh ishikimit të programit studimor (SHM 7.23). Gjatë rishikimit të programit studimor janë marrë për bazë rekomandimet e eksperteve vlerësues, fidbeku i studentit , propozimet e stafit akademik i rregullt dhe i angazhuar , kërkesat e palëve të interesit-agjencive.

### 2.2.4. Instrumentet për vlerësimin e cilësisë së programit

Vlerësimi është përdorur si një mjet kryesor për sigurimin e cilësisë së programeve studimore. Informatat kthyese janë mbledhur nga studentët, mësimdhënësit, dhe punëdhënësit përmes pyetësorëve mbi informatat kthyese. Vlerësimi i të dhënave dhe informatat kthyese janë përdorur në zhvillimin e vazhdueshëm të proceseve dhe plan-programeve, rezultateve mësimore dhe materialeve mësimdhënëse. Sistemi për menaxhimin e cilësisë së brendshme i përshkruar në doracakun e cilësisë paraqet një pasqyrë të plotë të mjeteve të vlerësimit që përdoren për grumbullimin e të dhënave dhe përcakton njësitë dhe personat përgjegjës për menaxhimin dhe sigurimin e cilësisë.

Llojet e pyetësorëve të përdorur janë:

- *Formulari për vlerësimin e cilësisë së punës të mësimdhënësve nga ana e studentëve*
- *Formulari për vlerësimin e mjedisit arsimor dhe studimor nga ana e studentëve*
- *Formulari për vlerësimin e cilësisë së internshipit*

Pra me qëllim të ngritjes dhe monitorimit të cilësisë së programit studimor përmes informatave kthyese nga studentët janë realizuar katër raporte vlerësuese për nivelin e performacës së personelit akademik, dy raporte vlerësuese për mjedisin studimor si dhe katër raporte vlerësuese për Intershipin.

### 2.2.5. Mekanizmat për zbatimin e masave për sigurimin e cilësisë

Doracaku i cilësisë (SHM 7.4) paraqet një pasqyrë të hollësishme për atë se si të gjitha proceset menaxhohen nga pikëpamja e vlerësimit dhe përmirësimit të cilësisë në fushat thelbësore. Sigurimi i cilësisë në akademi bazohet në parimet e “Deming-ut”, që do të thotë se aktivitetet për realizimin e secilit proces planifikohen dhe zbatohen, performanca brenda proceseve monitorohet, matet dhe analizohet (gjithashtu shpeshtësia e aktiviteteve monitoruese përcaktohet), aktivitete për përmirësimin e proceseve zbatohen në bazë të rezultateve, dhe objektivat e reja përcaktohen. Ndërsa rezultatet e pritura kryesore dhe stafi përgjegjës përcaktohen për secilin proces, është lehtë të vlerësohet zbatimi i masave për sigurimin e cilësisë dhe procedurat plotësuese nga Drejtori i Përgjithshëm, menaxhmenti i lartë, Bordi i AKSP-së dhe KPF- së.

Si mekanizëm konkret për zbatimin e masave për sigurimin e cilësisë përgatitën raportet me rekomandime të cilat pasqyrojnë procesin e zhvillimit arsimor në Akademi, këto raporte me rekomandime si feedback përcillen tek menxhmenti i lartë, dekani dhe stafi përgjegjës për fushat e caktuara, që kanë për qëllim përmirësimin e cilësisë në AKSP.

Akademia e realizon permirësimin duke shfrytëzuar të dhënat e vlerësimeve paraprake të proceseve, rekomandimeve dhe dokumenteve tjera vlerësuese:
• *Grumbullimi i të dhënave – Raporteve të punës*
• *Të dhënat administrative dhe statistikore nga palët e interesit*
• *Vlerësimi i programit studimor*
• *Vlerësimi i arritjes së objektivave strategjike*

**Vlerësimi i stafit akademik**. Vlerësimi i stafit akademik bëhet në harmoni me planin e punës të Divizionit për sigurim të cilësisë, më së paku në baza formale vjetore dhe përveç vlerësimit të deritanishëm – vlerësimi i studentëve për stafin akademik, vetëvlerësimi i stafit, vlerësimi nga kolegët dhe vlerësimi nga dekani. Rezultatet e vlerësimit në varësi të përmbajtjes, diskutohen me stafin individualisht, ndërkohe që bëhet një përmbledhje e cila ndahet me të gjithë stafin akademik. 10% e rezultateve pozitive bëhen publike në mënyrë të përgjithshme. Në rastet e vlerësimit më të ulët se mesatarja, dekani i fakultetit bisedon drejtpërdrejtë me mësimdhënësin/en dhe ai/ajo përpilon planin e ndërhyrjes për përmirësim. Plani monitorohet dhe sigurohet përmirësimi. Në rastet e rezultateve të larta, për stafin jepen mirënjohje nga dekani.
Nëse performanca e stafit konsiderohet më pak se e kënaqshme, kërkohen kërkesa të qarta për përmirësim. Fakulteti po monitoron nga afër përmirësimet në aktivitetin e stafit, veçanërisht në segmentet e nënvizuara gjatë vlerësimeve.

**Në proces të vlerësimit të performancës** dhe në bazë të rezultateve të dala nga pyetësorët, zyra për sigurimin e cilësisë harton rekomandime lidhur me vlerësimin e fituar nga mekanzimat vlerësues. Raportet adresohen fillimisht tek dekani dhe tek i vlerësuari ku varësisht nga rezultati i vlerësimit dhe komunikimit hartohet plani i përmirësimit. Plani i përmirësimit monitorohet nga dekani. Në rast të përsëritjes së rezultatet edhe pas aktiviteteve për përmirësim (pjesëmarrje në trajnim, takime të përbashkëta me kolegë etj), për vitin akademik pasardhës angazhohet një bashkë ligjërues. Për profesorët apo asistentët me plan përmirësimi, krijohet mundësia që të jenë pjesë e trajnimeve përkatëse apo vizitave me qëllim shkëmbim të eksperiencave.

**Analiza SWOT për menaxhimin e cilësisë:**

### A. Pikat e forta

- Sistem të menaxhimit të cilësisë së brendshme bazuar në standardet evropiane.
- Politika dhe procedura të zhvilluara dhe të zbatuara në një kornizë logjike të sigurimit të cilësisë.
- Doracaku i cilësisë në pajtueshmëri të plotë me menaxhimin e brendshëm të cilësisë dhe politikave të jashtme vlerësuese.
- Procese dhe nën-procese të detajuara në hollësi sipas ciklit të Demingut.
- Procedura të vendosura për rishikimin e programeve të studimit. Program të rishikuar nga stafi akademik i programit me pervoja edhe nga Insititucionet tjera të arsimit të lartë.
- Mekanizma të avancuara vlerësues të sigurimit të cilësisë.
- Implementimi i E-vlerësimit

- Sistem implementues të masave dhe procedurave plotësuese për përmirësim të vazhdueshëm të zbatuar në nivelin edukativ programor si dhe atë gjithpërfshirës studentor, mësimdhënës dhe staf.
- Azhurnimi i politikave dhe procedurave të sigurimit të cilësisë, si dhe vetëvleresim periodik i publikuar.

**B. Dobësitë**

- Mungesë e vendosjes së një risistemimi organizativ institucional me një organogram të plotë në kuptimin e funksionimit në fushën e avancimin të njësive, përfshirë edhe sigurimin e cilësisë.
- Mungesë në promovimin e rendësisë së sigurimit të cilësisë.
- Mungesa e Asociacionit ALUMNI.
- Mosfunksionimi i plote i Institutit per Hulumtim dhe Zhvillim.

**C. Mundësitë**

- Bashkërendim i politikave të sigurimit të cilësisë së brendshme dhe të jashtme, vendore dhe ndërkombëtare.
- E-sistem të avancuar të zbatueshëm në të gjitha proceset dhe nën-proceset e sigurimit të cilësisë.
- Procese përmirësuese të dokumentuara dhe të implementuara.
- Zgjerimin e games së programeve të akredituara.

**D. Sfidat**

- Sistem implementues i masave dhe procedurave plotësuese për përmirësim të vazhdueshëm.
- Sistemi i cilësisë i zbatuar në të gjitha nivelet institucionale.

### 2.3. Stafi akademik

Fakulteti i Sigurisë Publike, AKSP në vazhdimësi është duke u konsoliduar me personelin e saj akademik me qëllim të përmbushjes së kërkesave arsimore dhe për të siguruar cilësi dhe standarde të niveleve të kërkuara.
Stafi aktual akademik në FSP është një staf i dëshmuar në kualifikime dhe përvoja të përshtatshme për përgjegjësitë e veçanta të mësimdhënies. Ata përdorin metodologji mësimore të përshtatshme për lloje të ndryshme të rezultateve të mësuarit, e të nxënënit dhe marrin pjesë në aktivitete për të përmirësuar efektivitetin e tyre të mësimdhënies.

Stafi akademik i FSP-së përbëhet nga mësimdhënës të moshës relativisht të re dhe me një strukturë heterogjene gjinore, që janë pjesë e angazhimeve të rregullta akademike në këtë institucion, pothuajse nga themelimi i tij në vitin 2014. Stafi akademik përbëhet nga mësimdhënës me status të rregullt të marrëdhënies së punës dhe mësimdhënës të angazhuar part-time. Mësimdhënësit me

marrëdhënie rregullt të punës kanë marrë pjesë në trajnime dhe vizita studimore për hulumtime shkencore dhe metoda të mësimdhënies të personelit akademik në disa institucione ndërkombëtare, si dhe kanë qenë pjesë aktive e të dy projekteve të binjakëzimit lidhur me themelimin dhe forcimin e arsimit të larta në AKSP, projekte këto që janë implementuar nga Estonia dhe Finlanda dhe janë financuar nga BE.

Pjesa më e madhe e trajnimeve dhe zhvillimit të tyre është bërë përmes bashkëpunimit me institucionet jashtë vendit dhe kontakteve të drejtpërdrejta me profesorë të lëndëve gjegjëse dhe bartja e përvojave nga këto bashkëpunime, të cilat vetëm pasurohen me përvoja të reja.

### 2.3.1. Stafi, proceset e punësimit dhe zhvillimi profesional

Ligjet, Rregullore QRK-Nr.05-2019 për arsimin e lart në AKSP, Rregullorja e AKSP-së, aktet nënligjore dhe rregullorja e brendshme që përcakton kushtet dhe rregullon procedurat e rekrutimit të personelit akademik sigurojnë që i gjithë personeli akademik i rekrutuar i ka kualifikimet përkatëse për të menaxhuar në mënyrë efektive aktivitetet edukative, shkencore, kërkimore. Procesi i punësimit fillon duke u bërë publik konkursi për pozitën. Pas përmbylljes së konkurrimit, këshilli i fakultetit, formon komisionin vlerësues në përbërje të përcaktuar me rregulloret e brendshme – së paku dy anëtarë të komisionit vlerësues duhet të jenë nga fusha e ngushtë me lëndët për të cilat është shpallur konkursi, kurse të gjithë anëtarët duhet të kenë thirrje më të lartë akademike ose së paku të njëjtë me pozitën për të cilën ka aplikuar kandidati. Raporti i komisionit vlerësues me miratimin e këshillit të fakultetit nëpërmes Buletinit publikohet në ueb faqen e Fakultetit. Kandidatët e pakënaqur kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë dhe të cilat shqyrtohen nga komisioni i ankesave dhe përfundimisht lidhur me raportin e komisionit vlerësues dhe ankesat vendoset në këshillin e fakultetit.

Vendimi i Këshillit pas shqyrtimit të ankesave është vendim përfundimtar në nivel të Fakultetit. Të gjitha këto procedura, duke kaluar nëpër disa faza të kontrollit të brendshëm sigurojnë që stafi akademik i punësuar në institucion i ka kualifikimet përkatëse të përcaktuara sipas kushteve të kërkuara. Në raste të caktuara, nëse asnjëri nga kandidatët nuk i plotëson kushtet pozita do të rishpallet.
Rregulloret përkatëse që përcaktojnë kushtet dhe rregullojnë procedurat e rekrutimit të punëtorëve të administratës, gjithashtu garantojnë që personeli administrativ i punësuar në institucion i ka kualifikimet përkatëse të përcaktuara sipas kushteve të kërkuara. Kushtet dhe kriteret e kualifikimit janë të parapara me përshkrimin e detyrave të punës, bazuar në Katalogun e vendeve të punës të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Për të siguruar një konkurrencë më të madhe në aplikim, Fakulteti në konkurs parasheh më së paku tri fusha të studimit për kandidatë që aplikojnë. Edhe procedurat e mëtejme sigurojnë që kandidati i përzgjedhur i plotëson kushtet e punësimit. Për këtë do të kujdesen komisionet përzgjedhëse të cilat i emëron punëdhënësi i cili do ti zhvilloj të gjitha procedurat vlerësuese duke filluar nga vlerësimi i kualifikimit dhe përvoja e kandidatëve që kanë aplikuar deri në testet vlerësuese me shkrim dhe intervista me gojë. Këto procese të kombinuara të vlerësimit sigurojnë që kandidatët e përzgjedhur me lehtësi do to menaxhojnë proceset administrative në Fakultet.

**Personeli akademik i Fakultetit në vazhdimësi është i përfshirë** në aktivitete shkencore dhe që mundësojnë që ata të mbesin të azhurnuar me zhvillimet e fundit në fushën e tyre. Gjithashtu edhe personeli administrativ nëpërmes trajnimeve do të pajiset me njohuri të reja lidhur me ekzekutimin më të lehte të detyrave dhe përgjegjësive që i ka për pozitën e punës.
Proceset e rekrutimit sigurojnë që stafi të ketë fushat specifike të ekspertizës, kualifikimit dhe përvojës për pozicionet që ata zënë. Proceset e rekrutimit sigurojnë trajtim të barabartë të të gjithë aplikantëve.
Procedura vlerësuese për avancim përkatësisht emërim në thirrjen akademike mbështetet në kriteret që dalin nga aktivitetet në vijim:

- *Aktiviteti hulumtues*
- *Aktiviteti shkencor dhe*
- *Aktiviteti profesional*

Për rekrutimin/emërimin e kandidatëve në thirrjen përkatëse akademike përkatësisht avancimin e tyre, kërkohet plotësimi i minimumit të kritereve të parapara në Rregulloren 05/19, me të cilën janë përcaktuar procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes, avancimit dhe emërimit të personelit akademik, përkatësisht publikimi i numrit të caktuar të punimeve shkencore në revistat ndërkombëtare në varësi të thirrjes akademike. Konkursi është i barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi, ashtu siç parashihet me ligjet dhe aktet në fuqi.
Kualifikimet e stafit akademik, në kuadër të përshkrimit të detyrave të punës përcaktojnë kualifikime ekuivalente dhe të krahasueshme ndërkombëtare.

**Stafit të ri të mësimdhënies i jepet** një orientim efektiv për të siguruar njohje me institucionin dhe shërbimet e tij, programet dhe strategjitë e zhvillimit të studentëve, si dhe prioritetet institucionale për zhvillim.
Pas pranimit të stafit të ri, atyre ju ofrohet mbështetje maksimale nga profesorët e lëndëve dhe menaxhmentin, duke filluar nga përgjegjësit e profileve deri tek dekani. Ai/ajo pajiset me të gjitha dokumentet dhe rregulloret e brendshme që i shërbejnë si orientim fillestar për të siguruar njohje me institucionin dhe shërbimet që i kryen institucioni

**Niveli i ofrimit të stafit mësimdhënës** (raporti i studentëve për anëtar të stafit me orar të plotë) është adekuat për programet e ofruara. Ngarkesat mësimore janë të barabarta në të gjithë institucionin, duke marrë parasysh natyrën e kërkesave të mësimdhënies në fusha të ndryshme të studimit.
Grupet zakonisht konsiderohen të mundshme në qoftë se ata që arrijnë një regjistrim minimal prej 9 studentëve dhe një grup i ri zakonisht do të krijohet në qoftë se regjistrimi rritet në ose mbi 25 studentë për ushtrime numerike apo mbi 65 studentë për ligjërata.
Proporcioni i studentëve për mësimdhënësit ndryshon në mënyrë të konsiderueshme nga lënda në lëndë dhe nga programi në program, në lidhje me nevojat specifike mësimore të vetë klasës.

**I gjithë personeli i punësuar në institucion** (akademik, shkencor, administrativ) ka kualifikimet përkatëse në mënyrë që ata të jenë në gjendje të menaxhojnë në mënyrë efektive aktivitetet edukative, shkencore, kërkimore, krijuese dhe proceset administrative.

**Personeli akademik i Fakultetit** në vazhdimësi është i përfshirë në aktivitete shkencore dhe që mundësojnë që ata të mbesin të azhurnuar me zhvillimet e fundit në fushën e tyre. Gjithashtu edhe personeli administrativ nëpërmes trajnimeve do të pajiset me njohuri të reja lidhur me ekzekutimin më të lehte të detyrave dhe përgjegjësive që i ka për pozitën e punës.

Norma e orëve të stafit akademik është 40 orë në javë, nga të cilat norma bazë për stafin akademik me thirrje profesor asistent, profesor i asocuar dhe profesor i rregullt është 8 orë në javë ligjërata; të paktën 2 orë në javë konsultime me studentë; dhe koha tjetër është e ndarë ndërmjet konsultimeve më studentë për punime të diplomave bachelor dhe punimin e temës së "Intershipit", punë kërkimore individuale apo ekipore në shërbim të publikimeve apo pjesëmarrjes në konferenca; punë administrative për përdorimin e SMU dhe sigurimin e aspektit administrativ për lëndët si vendosja përmbajtjeve, materialeve, syllabusit, detyrave, vlerësimeve të ndërmjetme në SMU si dhe angazhime të tjera në funksion të zhvillimit personal profesional, zhvillimit të fakultetit.

Nëse i referohemi numrit të publikimeve të stafit akademik në tre vitet e fundit, mesatarisht çdo profesor/e ka publikuar dy artikuj. Pjesëmarrja në konferenca nuk është llogaritur në këtë mesatare. Numri i publikimeve nga viti në vit është duke u rritur në vazhdimësi.
Nga stafi akademik me angazhim të plotë, në aspekt të kualifikimeve kemi këtë shpërndarje**, pesë** doktorë shkence dhe **tre** master shkence.

**Institucioni ka plan të qartë për të gjithë zhvillimin profesional të stafit**, një qasje të strukturuar në identifikimin e nevojave të tilla dhe cakton burimet e duhura për zbatimin e tij.
Fakulteti e ka të miratuar Planin për zhvillimin e personelit. Plani mbështetet në tri objektivat strategjike:

1. *Zhvillimi dhe avancimi i personelit akademik;*
2. *Mbështetja e personelit akademik në hulumtime shkencore dhe*
3. *Mbështetja e personelit akademik në botimin e publikimeve.*

Plani për zhvillimin e personelit akademik i dedikohet personelit akademik në marrëdhënie të rregullt pune në fakultetet, me qëllim të zhvillimit dhe avancimit të mësimdhënësve në pjesën hulumtuese dhe pedagogjike, që programeve të studimit ti sigurohet funksionim cilësor akademik. Plani për zhvillimin e personelit akademik e ka në masë të madhe edhe mbështetjen financiare nga burimet financiare të Fakultetit. Një numër i aktiviteteve të caktuara në kuadër të planit për zhvillimin e personelit akademik janë të ndërlidhura me aktivitetet që zhvillohen nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe nga programet e përbashkëta me universitetet tjera publike në kuadër te bashkëpunimit, si dhe nga projektet ku Fakulteti është përfitues dhe që nuk kërkojnë buxhetim nga AKSP-ja.

Fakulteti ka planin e tij të zhvillimit të stafit akademik brenda një periudhe tre vjeçare, plan i cili përfshin angazhimin e stafit në studimet e thelluara [doktoratë ose post doktoratë], publikime të ndryshme, pjesëmarrje në konferenca, publikime të librave apo materialeve me interes për studentët etj.

Për stafin e rregullt akademik, si pjesë e zhvillimit të tyre akademik dhe profesional, është planifikuar:
- *Stafi akademik do te trajnohet ne përmirësimin e metodave te mësimdhënies, sipas planit strategjik, me dy trajnimet (trajnimi bazik dhe trajnimi i avancuar).*
- *Stafi akademik është trajnuar edhe për rishikimin e syllabusit.*

- *Stafi akademik mbështetët ne ndjekjen e se paku një Konference ne fushën specifike te studimit, sipas planit strategjik.*
- *Stafi akademik mbeshtetet ne pjesemarrje ne mobilitete.*

Stafit akademik i mundësohet pushime me pagese në rastet e mobilitetit akademik apo në rastet e studimeve semestrale doktorale, apo periudhave të studimeve doktorale.

### 2.3.2. Stafi akademik i rregulltë

AKSP në vazhdimësi është duke u konsoliduar me personelin e saj akademik me qellim te përmbushjes se kërkesave arsimore dhe për të siguruar cilësi dhe standarde të niveleve të kërkuara. Për të ushtruar veprimtarinë mësimore, shkencore dhe profesionale në FSP, AKSP ka rekrutuar tetë (8) mësimdhënës të rregullt (me orar të plotë).

Paraqitja tabelore për angazhimin e stafit të rregullt akademik

| **PROGRAMI SIGURI PUBLIKE** | **Stafi Akademik i rregullt 2020/2021** |
|---|---|
| LËNDËT E PËRGJITHSHME | Gjithësejtë janë tetë (8) mesimëdhënes të rregullt:<br>1 Profesor i Asocuar<br>4 Profesor Asistentë<br>3 Ligjërues<br>Të njejtit angazhohen në të gjitha profilet e programit studimor. |
| POLICOR | |
| KORREKTUES DHE SPROVUES | |
| MENAXHIMI EMERGJENT | |
| DOGANOR | |
| GJITHSEJT | |

Paraqitja tabelore për stafin e rregullt akademik

| Emri Mbiemri | Kualifikimi | Thirrja Akademike | Kohëzgjatja e kontratave zyrtare (valide ) | Ngarkesa në mesimdhenie | Ngarkesa për provime | Këshillime | Veprimtari administrimi | Ngarkesa për hulumtim |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Bejtush Gashi | Dr.sc | Prof.Asoc. | 31.12.2022 | | | | | |
| Vilard Bytyqi | Dr.sc | Prof.Ass. | 10.01.2023 | | | | | |
| Ferid Azemi | Dr.sc | Prof.Ass. | 29.06.2024 | | | | | |
| Nexhat Jashari | Dr.sc | Prof.Ass. | 31.12.2022 | | | | | |
| Besnik Fetahu | Dr.sc | Prof.Ass. | 31.12.2022 | | | | | |
| Florentina Shala | Ma.Sc | Ligjerues | 15.02.2023 | | | | | |
| Halil Asllani | Ma.Sc | Ligjerues | 31.12.2022 | | | | | |
| Anita Zenuni | Ma.Sc | Ligjerues | 01.10.2022 | | | | | |

Paraqitja tabelore për angazhimin e stafit të rregullt akademik

| **PROGRAMI SIGURI PUBLIKE** | **Stafi Akademik i rregullt 2020-2021** |
|---|---|
| LËNDËT E PËRGJITHSHME | Gjithësejtë janë tetë (8) mesimëdhënes të rregullt, të njejtit angazhohen në të gjitha profilet e programit studimor |
| POLICOR | |
| KORREKTUES DHE SPROVUES | |
| MENAXHIMI EMERGJENT | |
| DOGANOR | |
| GJITHESEJT | |

### 2.3.3. Stafi akademik i angazhuar

Me qëllim të realizimt sa më cilësor të programit studimor, përveç personelit akademik me orar të plotë (të rregullt), AKSP ka angazhuar 32 (tridhjet e dy) mësimdhënës me honorar nga UP "Hasan Prishtina" dhe ISP -të (PK, SHKK, SHSK, DK, AME dhe IPK).

Bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit (SHM 7.13), UP "Hasan Prishtina" në kontinuitet është duke mbështetur AKSP-në në zhvillimin e arsimit të lartë në të gjitha lëmitë akademike dhe shkencore me theks të veçantë në angazhimin e personelit akademik të UP-së në ligjërimin e lëndëve të njëjta me lëndët e njësive akademike të UP-së, dhe angazhimin e personelit akademik të UP-së në komisionet recenzuese me rastin e përzgjedhjes se personelit akademik të AKSP-së. Gjithashtu duke u bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit që AKSP ka me ISP-të (SHM 7.13) personeli i tyre është i angazhuar të ligjërojë lëndë profesionale në FSP me qëllim të avansimit të planprogramit studimor.

Paraqitja tabelore për stafin e angazhuar akademik

| Emri | Mbiemri | Kualifikimi | Thirrja Akademike | Kohëzgjatja e kontratave zyrtare (valide ) | Ngarkesa në mësimdhenie | Ngarkesa për provime | Këshillime | Veprimtari administrimi | Ngarkesa për hulumtim |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Liridon | Veliu | Dr.Sc. | Ligjërues | 30.09.2021 | | | | | |
| Enver | Hasani | Dr.Sc. | Ligjërues | / | | | | | |
| Kadri | Sylejmani | Dr.Sc. | Ligjërues | / | | | | | |
| Naim | Uka | Dr.Sc. | Ligjërues | / | | | | | |
| Besfort | Rrecaj | Dr.Sc. | Ligjërues | 30.09.2021 | | | | | |
| Haki | Demolli | Dr.Sc. | Ligjërues | 30.09.2021 | | | | | |
| Samedin | Mehmeti | Dr.Sc. | Ligjërues | 30.09.2021 | | | | | |
| Refki | Morina | Ma.Sc | Ligjërues | 30.09.2021 | | | | | |
| Çlirim | Hajdini | Ma.Sc | Ligjërues | / | | | | | |
| Aferdita | Qekaj-Thaqi | Dr.Sc. | Ligjërues | / | | | | | |
| Fatos | Haziri | Dr.Sc. | Ligjërues | 30.09.2021 | | | | | |
| Ahmet | Nuredini | Dr.Sc | Ligjërues | 30.09.2021 | | | | | |
| Luan | Gashi | Ma.Sc | Ligjërues | 30.09.2021 | | | | | |
| Hajriz | Sejdiu | Ma.Sc | Ligjërues | 30.09.2021 | | | | | |
| Alush | Beqiri | Ma.Sc | Ligjërues | / | | | | | |
| Bekim | Sadiku | Ma.Sc | Ligjërues | / | | | | | |
| Muhamet | Pllana | Ma.Sc | Ligjërues | 30.09.2021 | | | | | |
| Nexhat | Behrami | Ma.Sc | Ligjërues | / | | | | | |
| Veli | Karaqa | Ma.Sc | Ligjërues | 30.09.2021 | | | | | |
| Kastriot | Lajçi | Ma.Sc | Ligjërues | 30.09.2021 | | | | | |
| Hava | Zeqiri | Ma.Sc | Ligjërues | / | | | | | |
| Malë | Gashi | Ma.Sc | Ligjërues | 30.09.2021 | | | | | |
| Lulzim | Feta | Ma.Sc | Ligjërues | 30.09.2021 | | | | | |
| Bashkim | Arifi | Ma.Sc | Ligjërues | / | | | | | |
| Yll | Mehmetaj | Ma.Sc | Ligjërues | / | | | | | |
| Ibrahim | Xhaka | Ma.Sc | Ligjërues | / | | | | | |
| Shefqet | Berisha | Ma.Sc | Ligjërues | 30.09.2021 | | | | | |
| Agim | Selamani | Ma.Sc | Ligjërues | / | | | | | |
| Bedri | Abdyli | Ma.Sc | Ligjërues | / | | | | | |
| Burim | Haliti | Ma.Sc | Ligjërues | / | | | | | |
| Naim | Kamberaj | Ma.Sc | Ligjërues | / | | | | | |
| Ismer | Mulaj | Mr.Sc | Ligjërues | / | | | | | |
| Blerim | Krasniqi | Ma.Sc | Ligjërues | 30.09.2021 | | | | | |
| Adem | Shala | Ma.Sc | Ligjërues | / | | | | | |
| Metije | Ademi | Ma.Sc | Ligjërues | / | | | | | |
| Bejtush | Uka | Ma.Sc | Ligjërues | / | | | | | |
| Besa | Sahiti-Tahiri | Ma.Sc | Ligjërues | / | | | | | |
| Hivzi | Syla | Ma.Sc | Ligjërues | 30.09.2021 | | | | | |
| Ramë | Arifaj | Ma.Sc | Ligjërues | / | | | | | |
| Armend | Llapi | Ma.Sc | Ligjërues | / | | | | | |
| Jeton | Mehmetaj | Ma.Sc | Ligjërues | 30.09.2021 | | | | | |

Paraqitja tabelore për angazhimin e stafit të rregullt akademik sipas drejtimit dhe hulumtimit

| **PROGRAMI SIGURI PUBLIKE** | **Stafi Akademik i angazhuar 2020-2021** |
|---|---|
| *Lëndët e pergjithshme* | **7** |
| *Policor* | 5 |
| *Korrektues dhe sprovues* | 4 |
| *Menaxhimi emergjent* | 9 |
| *Doganor* | 7 |
| GJITHESEJT | **32** |

### 2.3.4. Stafi akademik vizitor

Me qëllim të realizimit sa më të mirë të programit studimor, kemi pasur personel akademik profesor vizitor sipas kërkeses së institucionit në aspektin vullnetar.

Deri më tani në mësimdhenie në FSP në cilësinë e profesorit vizitor kemi pasur:

- Prof.Dr.sc Fatmir Sejdiu ish president i Republikes së Kosovës
- Prof.Dr.sc Enver Hasani ish Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
- MA Krista Haak, Akademia e Estonisë e Shkencave të Sigurisë (2018)
- Dr. Robert Blunder, Austri (2019)
- Dr John R. Fischer, Universiteti Utah Valley, SHBA (2019)
- Dr. Chris Lindquist, Universiteti Utah Valley, SHBA (2019)
- Kol.Ejup Maqedonci dhe Kol. Sefer Isufi, Forca e Sigurisë së Kosovës. (2019)
- Mr. Edward Anderson, Director – Department of Security and Public Safety for the OSCE Mission in Kosovo (2019)

CV-të e personelit të rregullt akademik si dhe atyre të angazhuar janë të përgatitura në formë elektronike dhe pdf file për të gjitha kategoritë e personelit (një dosje me tri nën dosje –SHM 7.14) si vijon:

- Personeli i rregullt akademik
- Personeli i angazhuar akademik
- Personeli akademik visitor

### 2.3.5. Plani për zhvillimin e stafit akademik

AKSP është e perkushtuar në zhvillimin e personelit akademik, duke perkrahur pjesëmarrjen e mësimdhënësve në trajnime, seminare, konferenca shkencore, si dhe vizitat studimore jashtë vendit.
Fakulteti ka Planin për zhvillimin e personelit akademik, ndërsa zhvillimi i personelit është pjesë edhe e objektivit të planit strategjik të FSP-së, në të cilin në vazhdimësi sigurohet që stafi të trajnohet për metodologjitë e reja të mësimdhënies në arsimin e lartë.
Për me tepër, është mirëpritur rekomandimi i ekspertëve ndërkombëtar në procesin e akreditimit të programit studimor, për hartimin e një plani të detajuar për zhvillimin e personelit akademik, me ç'rast me datën 29/04/2016 është formuar grupi punues për hartimin e Planit të Zhvillimit të Personelit (SHM 7.15). Plani i Zhvillimit të Personelit, është miratuar në mbledhjen e mbajtur me datën 09/03/2017 të KPF me vendimin me numer 1/40

Plani për zhvillimin e personelit ka tri objektiva kryesore:

- *Mbështetja e stafit akademik në hulumtime shkencore;*
- *Zhvillimi dhe avancimi i personelit akademik;*
- *Mbështetja në botimin e publikimeve.*

Plani për zhvillimin e personelit në kuadër të objektivave kryesore ka nën-objektivat e tij dhe i dedikohet personelit akademik në marrëdhënie të rregullt të punës, duke iu siguruar kushte modeste për zhvillim, avancim dhe promovim akademik. Po ashtu, në kuadër të këtij dokumenti, në parim është përcaktuar se do të ndiqet politika e mundësive të barabarta gjatë rekrutimit të personelit te ri akademik duke i krijuar mundësi ngritjes së pjesëmarrjes së gjinisë femërore në përbërjen e personelit akademik.

Raporti i stafit akademik të rregullt dhe të angazhuar

| PROGRAMI SIGURI PUBLIKE | STAFI AKADEMIK 2020-2021 | |
|---|---|---|
| | Stafi Akademik i rregullt | Stafi Akademik i angazhuar |
| | 9 | 29 |
| **GJITHESEJT** | **38** | |

### 2.3.6. Dosja e stafit akademik

AKSP ka të përgatitura të gjitha dosjet e personelit të saj akademik ne formë të shtypur të cilat menaxhohen konform legjislacionit te aplikueshem mbi menaxhimin e dosjeve. Pjesë përbërëse e këtyre dosjeve janë: CV, diplomat, nostrifikimi, vendimi mbi thirrjen, etj.

**Analiza SWOT për stafin akademik:**

**A. Pikat e forta**

- Stafi akademik ka kualifikimet përkatëse dhe është kompetent në punën me student;
- Ekziston numër i mjaftueshëm i mësimdhënësve të kualifikuar dhe me ekspertizë profesionale relevante për ta mbuluar programin studimor;
- Mosha e mësimdhënësve është relativisht e re, çka përbënë një bazë për zhvillim afatgjatë të arsimit të lartë në AKSP;
- Ekziston një marrëdhënie e përshtatshme ndërmjet numrit të stafit akademik dhe studentëve që vijojnë programin studimor;
- Performanca shkencore dhe profesionale është përcaktuar si kriter me rastin e zgjedhjes/avancimit në detyrë të stafit akademik.
- I gjithë stafi akademik është përfshirë në mobilitete ndërkombëtare.

**B. Dobësitë**

- Mungesa e sistemit të mbështetjes për zhvillimin e kompetencave pedagogjike dhe didaktike të mësimdhënësve.
- Mungesa e ndërtimit të resurseve buxhetore që i dedikohet ekskluzivisht stafit akademik për të mbështetur zhvillimin e tyre nëpërmjet pjesëmarrjes në konferenca shkencore, publikime shkencore dhe shkëmbime akademike.

**C. Mundësitë**

- Krijimi i rrjeteve të bashkëpunimit ndërinstitucional kombëtar dhe ndërkombëtar me qëllim të avancimit të kompetencave në mësimdhënie dhe hulumtime.
- Aplikimi i programit të mobilitetit të stafit akademik nëpërmes instrumenteve të ndryshme që mbështeten dhe financohen nga fondet kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Shkëmbimi i përvojave të mësimdhënies përmes programit të bashkëpunimit me profesorët vizitorë nga universitetet e tjera kombëtare, të rajonit dhe më gjerë.
- Pjesëmarrja e vazhdueshme në trajnime për ngritjen e aftësive dhe kompetencave në mësimdhënie dhe hulumtime.

**D. Sfidat**

- Vendosja në rregulloret përkatëse e rezultateve nga aftësitë dhe kompetencat për hulumtime shkencore për tu marrë parasysh në vlerësimin periodik dhe promovimin e stafit akademik.

### 2.4. Përmbajtja e procesit arsimor

Përmbajtja e procesit mësimor në programin e studimeve themelore është i ndarë në 8 semestra, përkatësisht 4 viteve studimi. Programi studimor është i gërshetuar ndërmjet pjesës teorike dhe pjesës praktike. Zhvillimit të kompetencave praktike i është dhënë një rëndësi e posaçme përgjatë 4 viteve të studimit dhe se kjo pjesë konsumon 1/3 e kredive nga 240 ECTS kreditë e gjithmbarshme që parashihen me program studimor.

Tri semestrat e parë janë paraparë si studime të integruara, përkatësisht është paraparë vijimi i përbashkët i studimeve nga të gjithë zyrtarët e agjencive të sigurisë. Në semestrin e katërt, studentët vazhdojnë studimet e profilizuara në drejtimet përkatëse sipas agjencive ku janë të punësuar dhe i përfundojnë të njëjtat me përgatitjen dhe mbrojtjen e temës së diplomës.

Paraqitja tabelore për përmbajtjen e programit studimor

| **Programi i studimit Bachelor "Siguri Publike" 240 ECTS** | | | |
|---|---|---|---|
| **S p e c i a l i z i m e t** | | | |
| ↓ | ↓ | ↓ | ↓ |
| **Policor** | **Korrektues dhe Sprovues** | **Doganor** | **Menaxhimi emergjent** |

| | |
|---|---|
| **Viti 1** | Studime të përgjithshme - të përbashkëta (45 ECTS) |
| | Praktika (Intershipi) I profesionale (20 ECTS) |

| | |
|---|---|
| **Viti 2** | Studime të përgjithshme - të përbashkëta (20 ECTS) |
| | Studime të specializuara (20 ECTS) |
| | Praktika (Intershipi) II profesionale (20 ECTS) |

| | |
|---|---|
| **Viti 3** | Studime të specializuara (40 ECTS) |
| | Praktika (Intershipi) III profesionale (20 ECTS) |

| | |
|---|---|
| **Viti 4** | Studime të specializuara (20 ECTS) |
| | Praktika (Intershipi) IV profesionale (25 ECTS) |
| | Tema e diplomës (15 ECTS) |

**Administrimi i procesit mësimor:** Sipas Rregullores (QRK) NR. 05/2019 për e arsimin e lartë në AKSP", Këshilli do të miratojë plan-programin dhe personeli akademik do të angazhohet në zhvillimin e plan-programit. Në fillim të çdo viti akademik, ligjëruesi i dorëzon udhëheqësit të departamentit dhe dekanit, programin e hollësishëm mësimor. Përkrahja administrative për planin-programin bëhet nga Departamenti për trajnime dhe përkrahje arsimore.

Përditësimi i plan-programeve në AKSP/FSP ndjek parimet kryesore të menaxhimit të cilësisë të përshkruara në "Doracakun e Cilësisë të AKSP-së" (SHM 7.4 Kapitulli 5.2.1), e të cilat bazohen në 4 hapat e qarkut/rrethit Deming të cilësisë (planifiko, bëj, kontrollo, vepro). Në doracak azhurnimi i plan-programeve, është përshkruar brenda procesit të studimit si një ndër proceset më të rëndësishme. Në kornizën logjike të cilësisë, e cila është një shtojcë e doracakut, janë të specifikuar treguesit e cilësisë, aktivitetet, mjetet e vlerësimit dhe kriteret e vlerësimit pë zhvillimin e plan-programit.

Procesi i azhurnimit të plan-programeve në AKSP bazohet në parimet kryesore të mëposhtme:

1. *Të gjitha plan-programet në AKSP duhet të shqyrtohen një herë në vit, duke përfshirë programin e arsimit të lartë si dhe plan-programin e trajnimit themelor (bazik).*
2. *Sektori për plan-programe dhe testime në bashkëpunim me zyren për sigurimin e cilësisë, janë njësitë përgjegjëse për azhurnimin e rregullt të plan-programeve.*
3. *Para se të zbatohen, të gjitha azhurnimet në plan-programe duhet të miratohen nga KPF.*

4. *Duhet të formohen grupet e rregullta punuese për zhvillimin dhe azhurnimin e plan-programeve, për të siguruar përfshirjen e të gjithë palëve të rëndësishme të interesit.*
5. *Në zhvillimin dhe azhurnimin e plan-programeve duhet të përfshihen: përfaqësuesit e MPB-së, agjencive përkatëse, stafi përkatës administrativ dhe akademik i Akademisë, si dhe përfaqësuesit e studentëve të diplomuar (alumni).*
6. *Zhvillimi dhe azhurnimi i plan-programeve bazohet në legjislacionin vendor, qëllimet strategjike të AKSP-së, rezultatet e informatave kthyese të mbledhura dhe të analizuara dhe në rezultatet përfundimtare të standardeve profesionale në të ardhmen.*

Metoda e vlerësimit është mënyra për të dëshmuar arritjen e kompetencave. Zgjedhja e metodës është e bazuar në mësimnxënien e parapërcaktuar. Sipas Rregullore (QRK) Nr. 05/2019 për arsimin e lartë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (SHM 7.6, neni 37-44) metodat vijuese do të aplikohen për vlerësimin e suksesit akademik: provimi kollokfiumi, punimi seminarik, praktika profesionale dhe testi praktik gjatë ushtrimeve. KPF ka nxjerr Rregullore (AKSP) nr.01/2020 për Studimet Themelore Bachelor në Fakultetin e Sigurisë Publike (SHM 7.7) qëllimi i së cilës është përcaktimi i procedurave për organizimin e provimeve dhe vlerësimin e studentëve në FSP.

Kriteri i vlerësimit është përshkrimi i nivelit të kompetencës së dëshmuar, arritur ose synuar dhe kapaciteti i cili është matur me metodën e vlerësimit. Kriteret e vlerësimit janë përcaktuar në bazë të mësimnxënies me hollësi të shumta.

Ekzistojnë dy lloje të vlerësimit në plan-program:
1) *Vlerësimi i diferencuar: niveli i mësimnxënies së arritur është shënuar ose notuar me shkronjë ose numër.*
2) *Vlerësimi jo diferencues (kalon ose dështon) – niveli i kriterit të kalimit ose dështimit është caktuar.*

Nëse niveli është arritur, realizimi do të shënohet me shprehjen “miratuar” dhe nëse jo me “nuk miratohet”. Niveli me dy shkallë i vlerësimit jo të diferencuar përdoret kur qëllimi do të shënojë se nëse niveli bazik i kompetencës është apo nuk është arritur dhe nëse diferencimi është i pamundur, jo i nevojshëm ose i vështirë për tu realizuar. Në rast të vlerësimit të jo diferencuar kriteri i kalimit/pragut të kalueshmërisë është i caktuar.

Provimet do të vlerësohen me notat 10 – 9 (shkëlqyeshëm), 8 (shumë mirë), 7 (mirë), 6 (mjaftueshëm) dhe 5 (pa mjaftueshëm). Kandidati kalon provimin me notat prej 6 – 10. Provimet do të vlerësohen nga kontrolluesi ose nga komisioni për provime. Kjo e fundit zbatohet nëse

studenti ankohet apo nëse është e caktuar me programin e studimeve. Metodat e mësimdhënies dhe të vlerësimit do të përcaktohen nga programi mësimor i lëndës.

Provimet do të mbahen gjatë afatit të provimeve të janarit, të qershorit dhe të shtatorit. Periudha e saktë për çdo afat është e përcaktuar në kalendarin e studimeve. Me kërkesë të studentëve, fakulteti mund të organizojë edhe dy afate shtesë të provimeve për studentë në muajin prill dhe nëntor. Orari i provimeve do të përcaktohet në atë mënyrë që studenti të mos ketë më shumë se një provim në ditë dhe ky orar do të shpallet jo më vonë se shtatë (7) ditë para datës së provimit.

Në të gjitha rastet kur studentët mungojnë pa arsye ose abstenojnë nga provimi, konsiderohet se kanë dështuar. Me kërkesë të studentit, dekani mund të lejojë që ai/ajo të hyjë në provim më herët nëse ai/ajo merr pjesë në ndonjë program ndërkombëtar për shkëmbim të përvojave studimore studenti ka të drejtë për riprovim deri në 3 herë në lëndën të cilën ai/ajo nuk e ka kaluar. Në rast se studenti dështon për të katërtën (4) herë në provim, ai e humbë statusin e studentit. Pas përfundimit të semestrit të fundit të studimeve, studentit do t‟i caktohet një periudhë prej 12 muajve për t‟i përfunduar studimet dhe ai/ajo mund të kërkojë nga dekani zgjatjen e periudhës së diplomimit për 12 muaj të tjerë.

Sipas Rregullores (QRK) nr. 05/2019 për arsimin e lartë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (SHM 7.6, neni 47), ECTS-të e fituara nga studimet e mëparshme jashtë AKSP-së mund të njihen dhe të integrohen në rezultatet studimore të studentit.

### 2.4.1. Pasqyra e programit

| **Viti i I** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Semestri i I** | | | **Orë/javë** | | | |
| **Nr.** | **O/Z** | **Lëndët** | **L** | **U** | **ECTS** | **Mesimdhenesi** |
| 1 | O | M1 Siguria Kombëtare | | | 5 | Bejtush Gashi |
| 2 | O | G6 Shkrim Akademik | | | 5 | Halil Asllani |
| 3 | O | L4 Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut | | | 4 | Nexhat Jashari |
| 4 | O | G2 Gjuhë angleze I | | | 4 | Halil Asllani |
| 5 | Z | L1 Fillet e së drejtës | | | 4 | Nexhat Jashari |
| 6 | Z | M2 Menaxhmenti dhe zhvillimi organizativ | | | 4 | Liridon Veliu |
| **Semestri i II** | | | | | | |
| 1 | O | L6 E drejta Penale | | | 6 | Florentina Shala |
| 2 | O | H4 Metodologjia hulumtuese shkencore | | | 5 | Besnik Fetahu |
| 3 | O | G3 Gjuhë angleze II | | | 4 | Halil Asllani |
| 4 | O | H1 Psikologjia e Përgjithshme | | | 4 | Anita Zenuni |
| 5 | Z | G7. Teknologjia e informimit dhe komunikimit | | | 4 | Kadri Sylejmani |
| 6 | Z | M4 Menaxhmenti financiar | | | 4 | Vlora Prenaj |
| 7 | O | I1 Hyrje në Organizatat e Siguris Publike | | | 15 | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Viti II** | | | | | | |
| **Semestri i III** | | | | | | |
| 1 | O | L7 E drejta administrative me procedure administrative | | | 5 | Nexhat Jashari |
| 2 | O | L3 E drejta kushtetuese | | | 4 | Vilard Bytyqi |
| 3 | O | H2 Shoqëria dhe mirëqenia sociale | | | 4 | Besnik Fetahu |
| 4 | O | M5 Statistike | | | 4 | Servet Tasholli |
| 5 | Z | G8 Anglishtja për qëllime specifike | | | 4 | Halil Asllani |
| 6 | Z | H3 Lidershipi dhe menaxhimi i burimeve njerëzore | | | 3 | Sevdije Alshiqi Bekteshi |
| 7 | Z | R2 Psikologjia e stresit | | | 3 | Anita Zenuni |
| **Drejtimi i Menaxhimit Emergjent** | | | | | | |
| **Semestri i IV** | | | | | | |
| 1 | O | E2 Bazat e menaxhimit emergjent | | | 4 | Hajriz Sejdiu |
| 2 | O | E25 Identifikimi, Analizimi dhe vlerësimi i rreziqeve | | | 4 | Alush Beqiri |
| 3 | O | E26 Parandalimi dhe zvogëlimi i rreziqeve nga fatkeqësitë | | | 4 | Alush Beqiri |
| 4 | O | E4 Gatishmëria emergjente | | | 4 | Hajriz Sejdiu |
| 5 | Z | E17 Siguria e brendshme dhe menaxhimi emergjent | | | 4 | Bejtush Gashi |
| 6 | Z | E11 Planifikimi kontigjent | | | 4 | Nehat Koçinaj |
| 7 | O | I2. Metodat e punës dhe operacionet nështërbimin emergjent | | | 20 | |
| **Viti i III** | | | | | | |
| **Semestri i V** | | | | | | |
| 1 | O | E16 Sistemi i integruar i menaxhimit Emergjent | | | 4 | Alush Beqiri |
| 2 | O | E22 Planet operative emergjente / Plani i reagimit kombëtar | | | 4 | Hajriz Sejdiu |
| 3 | O | E8 Dizajnimi i ushtrimeve | | | 4 | Hajriz Sejdiu |
| 4 | O | E15 Vendimarrja në menaxhimin emergjent | | | 4 | Veli Karaqa |
| 5 | Z | E27 Menaxhimi emergjent dhe terrorizmi | | | 4 | Bejtush Gashi |
| 6 | Z | E6 Teknikat e shuarjes dhe shpëtimit nga zjarri | | | 4 | Bahri Pajaziti |
| **Semestri i VI** | | | | | | |
| 1 | O | E4 Reagimi në fatkeqësi | | | 4 | Bejtush Gashi |
| 2 | O | E9. Rimëkëmbja nga fatkeqësitë | | | 4 | Hajriz Sejdiu |
| 3 | O | E19.Sistemi i komandës së incidentit dhe qendrat operative emergjente | | | 4 | Hajriz Sejdiu |
| 4 | O | E13 Menaxhimi i materieve të rrezikshme | | | 4 | Nexhat Behrami |
| 5 | Z | E5 Sociologjia e fatkeqësive | | | 4 | Bejtush Gashi |
| 6 | Z | E10 Shëndeti publik dhe menaxhimi Emergjent | | | 4 | Bekim Sadiku |
| 7 | O | I3. Organizimi i shërbimit emergjent | | | 20 | |
| **Viti i IV** | | | | | | |
| **Semestri i VII** | | | | | | |
| 1 | O | P8 Menaxhimi i krizave | | | 4 | Bejtush Gashi |
| 2 | O | E20 Operacionet humanitare në fatëkeqësit ndërkombëtare | | | 4 | Bejtush Gashi |
| 3 | O | E1 Aplikimi i Teknologjisë Informative në menaxhimin mergjent | | | 4 | Luan Gashi |
| 4 | O | E21 Ushtrimet me simulime - lojërat | | | 4 | Hajriz Sejdiu |
| 5 | Z | E18 Instrumentet e sigurisë nga zjarri | | | 4 | Shaban Salihu |
| 6 | Z | E12 Teknikat e shuarjes dhe shpetimit nga zjarri II | | | 4 | Muhamet Pllana |
| **Semestri i VIII** | | | | | | |
| 1 | O | Tema e diplomës | | | 15 | |
| 2 | O | I4. Menaxhmenti dhe lidershipi i avancuar në shërbimin emergjent | | | 25 | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Drejtimi Doganor** | | | | | | |
| **Semestri i IV** | | | | | | |
| 1 | O | D2 Doganat e Kosovës | | | 4 | Nexhat Jashari |
| 2 | O | D24 E-Dogana | | | 4 | Agron Sadiku |
| 3 | O | D25 Njohja e mallrave dhe teknikat e klasifikimit | | | 4 | Bashkim Arifi |
| 4 | O | D26 Sistemi i harmonizuar dhe klasifikimi i mallrave | | | 4 | Bashkim Arifi |
| 5 | Z | D27 Klasifikimi i mallrave me normë të ndryshme doganore | | | 4 | Bashkim Arifi |
| 6 | Z | D3.Menaxhmenti dhe lidershipi ne Dogana | | | 4 | Ibrahim Xhaka |
| 7 | O | I5.Metodat dhe operacionet e punës në Dogana | | | 20 | |
| **Viti i III** | | | | | | |
| **Semestri i V** | | | | | | |
| 1 | O | D29 Shpeditimi dhe shpedicioni | | | 4 | Nexhat Jashari |
| 2 | O | D30 Importi dhe eksporti i mallrave | | | 4 | Bashkim Arifi |
| 3 | O | D12 Zbatimi i politikës fiskale në dogana | | | 4 | Mevlude Dibra |
| 4 | O | D31 Origjina e mallrave | | | 4 | Bashkim Arifi |
| 5 | Z | P3 E drejta e procedurës penale | | | 4 | Florentina Shala |
| 6 | Z | D32 Lehtësira doganore | | | 4 | Ibrahim Xhaka |
| **Semestri i VI** | | | | | | |
| 1 | O | D20 Magazinimi doganor | | | 4 | Bashkim Arifi |
| 2 | O | D23 Kontrabanda dhe informaliteti | | | 4 | Shefqet Berisha |
| 3 | O | D1 Institucionet globale dhe tregtia ndërkombëtare | | | 4 | Nexhat Jashari |
| 4 | O | D14 Vlera doganore e mallrave | | | 4 | Bashkim Arifi |
| 5 | Z | D19 Përpunimi i brendshëm doganor dhe përpunimi nënkontrollin doganor | | | 4 | Bashkim Arifi |
| 6 | Z | D18 Kontrolli i trafikut ajror dhe i pasagjerëve | | | 4 | Bahri Berisha |
| 7 | O | I6. Organizimi i doganave | | | 20 | |
| **Viti i IV** | | | | | | |
| **Semestri i VII** | | | | | | |
| 1 | O | P8 Menaxhimi i krizave | | | 4 | Bejtush Gashi |
| 2 | O | D21 Intelegjenca dhe hetimi | | | 4 | Bahri Berisha |
| 3 | O | D22 Analiza e rrezikut dhe kontrolli post-doganor | | | 4 | Bahri Berisha |
| 4 | O | D17 Kontrolli i trafikut rrugor | | | 4 | Burim Haliti |
| 5 | Z | D33. E drejta Biznesore | | | 4 | Nexhat Jashari |
| 6 | Z | P26 Menaxhimi dhe kontrolli i kufinjëve | | | 4 | Agron Rukiqi |
| **Semestri i VIII** | | | | | | |
| 1 | O | Tema e diplomës | | | 15 | |
| 2 | O | I7. Menaxhmenti dhe lidershipi i avancuar në dogana | | | 25 | |
| **Drejtimi Policor** | | | | | | |
| **Semestri i IV** | | | | | | |
| 1 | O | P1 Lidershipi dhe menaxhimi i organizatës së policisë | | | 4 | Samedin Mehmeti |
| 2 | O | P5 Policimi dhe autorizimet policore | | | 4 | Vilard Bytyqi |
| 3 | O | P3 E Drejta e Procedurës Penale | | | 4 | Florentina Shala |
| 4 | O | P4 Parandalimi i krimit | | | 4 | Vilard Bytyqi |
| 5 | Z | P2 E drejta Penale Ndërkombëtare | | | 4 | Florentina Shala |
| 6 | Z | P25 Migrimi ilegal, të huajt dhe azili | | | 4 | Nexhat Jashari |
| 7 | O | I8. Metodat dhe operacionet e punës në PK apo IPK | | | 20 | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Viti i III** | | | | | | |
| **Semestri i V** | | | | | | |
| 1 | O | P27 E drejta penale – Pjesa e posaqme | | | 5 | Florentina Shala |
| 2 | O | P9 Menaxhimi i sigurisë së informacionit | | | 4 | Fatos Haziri |
| 3 | O | P15 Hetimi i Krimit: parimet dhe praktika | | | 4 | Vilard Bytyqi |
| 4 | O | P10. Stresi dhe incidentet kritike në zbatimin e ligjit | | | 3 | Anita Zenuni |
| 5 | Z | R18 Viktimologjia | | | 4 | Ferid Azemi |
| 6 | Z | P23 Mjekësia Ligjore | | | 4 | Flamur Blakaj |
| **Semestri i VI** | | | | | | |
| 1 | O | P18 Kriminalistika | | | 5 | Vilard Bytyqi |
| 2 | O | P21 Kriminologjia | | | 4 | Ferid Azemi |
| 3 | O | P19 Anti-Terrorizmi | | | 4 | Fatos Haziri |
| 4 | O | P20 Anazlia e Inteligjencës | | | 4 | Fatos Haziri |
| 5 | Z | P13 Mbrojtja e të dhënave personale | | | 3 | Nexhat Jashari |
| 6 | Z | P28 Teknika kriminalistike | | | 3 | Vilard Bytyqi |
| 7 | O | I9. Organizimi në PK apo IPK | | | 20 | |
| **Viti i IV** | | | | | | |
| **Semestri i VII** | | | | | | |
| 1 | O | P16 Krimi i Organizuar | | | 5 | Vilard Bytyqi |
| 2 | O | P8. Menaxhimi i Krizave | | | 4 | Bejtush Gashi |
| 3 | O | P26 Menaxhimi dhe Kontrolli i Kufirit | | | 4 | Agron Rukiqi |
| 4 | O | P29 Kundërvajtjet dhe menaxhimi i trafikut | | | 4 | Samedin Mehmeti |
| 5 | Z | P7 Menaxhimi i Sigurisë Publike | | | 3 | Naim Rexha |
| 6 | Z | P17 Krimet Financiare | | | 3 | Sejdi Rexhepi |
| **Semestri i VIII** | | | | | | |
| 1 | O | Tema e diplomës | | | 15 | |
| 2 | O | I10. Menaxhmenti dhe lidershipi i avancuar në PK apo IPK | | | 25 | |
| **Drejtimi Korrektues dhe Sprovues** | | | | | | |
| **Semestri i IV** | | | | | | |
| 1 | O | P21 Kriminologjia | | | 5 | Ferid Azemi |
| 2 | O | R12 Puna Sociale | | | 4 | Besnik Fetahu |
| 3 | O | R6. Siguria dhe menaxhimi | | | 4 | Bejtush Uka |
| 4 | O | R5 Parandalimi i krimit | | | 4 | Vilard Bytyqi |
| 5 | Z | R19 Masat dhe dënimet alternative | | | 3 | Armen Mustafa |
| 6 | Z | R20 Etika dhe drejtësia sociale | | | 3 | Ferid Azemi |
| 7 | O | I10. Metodat dhe operacionet e punës në shërbimin korrektues dhe sprovues | | | 20 | |
| **Viti i III** | | | | | | |
| **Semestri i V** | | | | | | |
| 1 | O | R2 Krimi dhe ndëshkimi | | | 5 | Ferid Azemi |
| 2 | O | R3 Drejtësia për të mitur | | | 4 | Florentina Shala |
| 3 | O | R1 Penologjia | | | 4 | Ferid Azemi |
| 4 | O | R21 Socializimi dhe riintegrimi | | | 4 | Besnik Fetahu |
| 5 | Z | E25.Ekzekutimi i dënimeve kryesore | | | 3 | Florentina Shala |
| 6 | Z | R24 Politika Sociale | | | 3 | Besnik Fetahu |
| **Semestri i VI** | | | | | | |
| 1 | O | R22 Trajtimi dhe programet e rehabilitimit | | | 4 | Besnik Fetahu |
| 2 | O | R16 Teknikat e këshillimit psikologjik | | | 4 | Anita Zenuni |
| 3 | O | R8 Vlerësimi i rrezikut | | | 4 | Resmi Hoxha |
| 4 | O | R14 Puna në komunitet | | | 4 | Armen Mustafa |
| 5 | Z | R9 Menaxhimi i situatave emergjente | | | 4 | Ramë Arifaj |
| 6 | Z | P3 E drejta e procedures penale | | | 4 | Florentina Shala |
| 7 | O | I11. Organizimi i shërbimit korrektues dhe sprovues | | | 20 | |
| **Viti i IV** | | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Semestri i VII** | | | | | | |
| 1 | O | R23 Menaxhimi i burgut dhe shërbimit sprovues | | | 4 | Ferid Azemi |
| 2 | O | P 8 Menaxhimi i krizave | | | 4 | Bejtush Gashi |
| 3 | O | R4 Kriminalistika | | | 4 | Vilard Bytyqi |
| 4 | O | R18 Viktimologjia | | | 4 | Ferid Azemi |
| 5 | Z | R26. Krimi dhe abuzimi me substanca narkotike | | | 4 | Ferid Azemi |
| 6 | Z | P13 E drejta per mbrojtjen e te dhënave personale | | | 4 | Nexhat Jashari |
| **Semestri i VIII** | | | | | | |
| 1 | O | Tema e diplomës | | | 15 | |
| 2 | O | I12. Menaxhimi dhe lidershipi i avancuar në shërbimin korrektues dhe sprovues | | | 25 | |

### 2.4.2. Lëndët e përshkruara mësimore

**Programi i studimit**

| | |
|---|---|
| Emërtimi i programit të studimit | Siguria Publike |
| Niveli i kualifikimit sipas KKK (*me shkurtesat BA, MA, PhD, program doktorate, kurs universitar, çertifikatë apo diplomë profesionale*) | BA |
| Grada akademike dhe emërtimi i diplomës nëformë të plotë dhe të shkurtuar | Baçelor i Sigurisë Publike |
| Fusha e studimit sipas Erasmus Area Codes (ESAC) | 16.0 |
| Profili i programit akademik (*specializimi*) | Shkencor |
| Kohëzgjatja minimale e studimit | 4 vite |
| Forma e studimit (*e rregullt, pa shkeputje nga puna, studim në distancë*) | E rregullt (*pa shkëputje nga puna*) |
| Numri i ECTS kredive (total dhe për vit) | 240 ECTS (të ndara në vite)<br>*Viti I = 60 ECTS;*<br>*Viti II = 60 ECTS;*<br>*Viti III =60 ECTS;*<br>*Viti IV = 60 ECTS:* |
| Modulet/Lëndët (titujt) | **Lëndët e përgjithshme** |
| | 1. Siguria Kombëtare |
| | 2. Shkrim akademik |
| | 3. Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut |
| | 4. Gjuhë angleze I |
| | 5. Fillet e së drejtës |
| | 6. Menaxhmenti dhe Zhvillimi organizativ |
| | 7. E drejta Penale |
| | 8. Metodologjia hulumtuese shkencore |
| | 9. Gjuhë angleze II |
| | 10. Psikologjia e Përgjithshme |
| | 11. Teknologjia e informimit dhe komunikimit |
| | 12. Menaxhmenti financiar |
| | 13. Anglishtja për Qëllime Specifike (ESP) |
| | **I1 Hyrje në Organizatat e Siguris Publike** |
| | **Semestri i III -të** |
| | 14. E drejta administrative me procedure administrative |
| | 15. E drejta Kushtetuese |
| | 16. Shoqëria dhe mirëqenia sociale |
| | 17. Statistike |

| | |
|---|---|
| | 18. Lidershipi dhe menaxhimi i burimeve njerëzore |
| | 19. Psikologjia e stresit |
| | **Profili Policor** |
| | **Semestri i IV -të** |
| | 20. Lidershipi dhe menaxhimi I orgaganizatës së policisë |
| | 21. Policimi dhe autorizimet policore |
| | 22. E drejta e procedures penale |
| | 23. Parandalimi i krimit |
| | 24. Edrejta penale ndërkombëtare |
| | 25. Migrimi illegal, të huajt dhe azili |
| | **I8. Metodat dhe operacionet e punës në PK apo IPK** |
| | **Semestri i V-të** |
| | 26. E drejta penale - pjesa e posaçme |
| | 27. Menaxhimi dhe mbrojtja e informacionit |
| | 28. Hetimet e krimit |
| | 29. Stresi dhe incidentet kritike në zbatimin e ligjit |
| | 30. Viktimologjia |
| | 31. Mjekësia Ligjore |
| | **Semestri i VI-të** |
| | 32. Taktika dhe metodika kriminalistike |
| | 33. Kriminologjia |
| | 34. Terrorzmi |
| | 35. Intelegjenca dhe analiza |
| | 36. E drejta për mbrojtjen e të dhënave personale |
| | 37. Teknika kriminalistike |
| | **I9. Organizimi në PK apo IPK** |
| | **Semestri i VII-të** |
| | 38. Krimi i organizuar |
| | 39. Menaxhimi I krizave |
| | 40. Menaxhimi dhe kontrolli I kufijve |
| | 41. Kundërvajtjet dhe menaxhimi I trafikut |
| | 42. Menaxhimi i sigurisë publike |
| | 43. Krimet financiare |
| | **Semestri i VIII-të** |
| | **I10. Menaxhmenti dhe lidershipi i avancuar në PK apo IPK** |
| | Tema e diplomës |
| | **Profili Shërbimi Korrektues dhe Sprovues** |
| | **Semestri i IV-të** |
| | 44. Kriminologjia |
| | 45. Puna sociale |
| | 46. Siguria dhe menaxhimi |
| | 47. Parandalimi I krimit |
| | 48. Masat dhe denimet alternative |
| | 49. Etika dhe drejtësia sociale |
| | **I10. Metodat dhe operacionet e punës në shërbimin korrektues dhe sprovues** |
| | **Semestri i V-të** |
| | 50. Krimi dhe ndëshkimi |
| | 51. Drejtësia për të mitur |
| | 52. Penologjia |
| | 53. Socializimi dhe integrimi |
| | 54. Ekzekutimi i dënimeve kryesore |
| | 55. Politika sociale |

| | |
|---|---|
| | **Semestri i VI-të** |
| | 56. Trajtimi dhe programet e rehabilitimit |
| | 57. Teknikat e këshillimit psikologjik |
| | 58. Vlerësimi i rrezikut |
| | 59. Puna në komunitet |
| | 60. Menaxhimi i situatave emergjent |
| | 61. E drejta e procedures penale |
| | **I11. Organizimi i shërbimit korrektues dhe sprovues** |
| | **Semestri i VII-të** |
| | 62. Menaxhimi i burgut dhe shërbimit sprovues |
| | 63. Menaxhimi i krizave |
| | 64. Kriminalistikë |
| | 65. Viktimologjia |
| | 66. Krimi dhe abuzimi me substanca narkotike |
| | 67. E drejta për mbrojtjen e të dhënave personale |
| | **Semestri i VIII-të** |
| | **I12. Menaxhimi dhe lidershipi i avancuar në shërbimin korrektues dhe sprovues** |
| | Tema e diplomës |
| | **Profili i Doganave** |
| | **Semestri i IV-të** |
| | 68. Doganat e Kosovës |
| | 69. E-dogana |
| | 70. Njohja e mallrave dhe teknikat e klasifikimit |
| | 71. Sistemi i harmonizuar dhe klasifikimi i mallrave |
| | 72. Klasifikimi i mallrave me normë të ndryshme doganore |
| | 73. Menaxhmenti dhe lidershipi ne Dogana |
| | **I5.Metodat dhe operacionet e punës në Dogana** |
| | **Semestri i V-të** |
| | 74. Shpeditimi dhe shpedicionet |
| | 75. Importi dhe eksporti i mallrave |
| | 76. Zbatimi i politikës fiskale në dogana |
| | 77. Origjina e mallrave |
| | 78. E drejta e procedurës penale |
| | 79. Lehtësirat doganore |
| | **Semestri i VI-të** |
| | 80. Magazinimi doganor |
| | 81. Kontrabanda dhe informaliteti |
| | 82. Institucionet globale dhe tregtia ndërkombëtare |
| | 83. Vlera doganore e mallrave |
| | 84. Përpunimi i brendshëm doganor dhe përpunimi nënkontrollin doganor |
| | 85. Kontrolli i trafikut ajror dhe i pasagjerëve |
| | **I6. Organizimi i doganave** |
| | **Semestri i VII-të** |
| | 86. Menaxhimi i krizave |
| | 87. Intelegjenca dhe hetimi |
| | 88. Analiza e rrezikut dhe kontrolli post-doganor |
| | 89. Kontrolli i trafikut rrugor |
| | 90. E drejta Biznesore |
| | 91. Menaxhimi dhe kontrolli i kufinjëve |
| | **Semestri i VIII-të** |

| | |
|---|---|
| | **I7. Menaxhmenti dhe lidershipi i avancuar në dogana** |
| | Tema e diplomës |
| | **Profili i Emergjencave** |
| | **Semestri i IV -të** |
| | 92. Bazat e menaxhimit emergjent |
| | 93. Identifikimi, Analizimi dhe vlerësimi i rreziqeve |
| | 94. Parandalimi dhe zvogëlimi i rreziqeve nga fatkeqësitë |
| | 95. Gatishmëria emergjente |
| | 96. Siguria e brendshme dhe menaxhimi emergjent |
| | 97. Planifikimi kontigjent |
| | **I2. Metodat e punës dhe operacionet në shërbimin emergjent** |
| | **Semestri i V-të** |
| | 98. Sistemi i integruar i menaxhimit emergjent |
| | 99. Planet operative emergjente / Plani i reagimit kombëtar. |
| | 100. Dizajnimi i ushtrimeve |
| | 101. Vendimarrja në menaxhimin emergjent |
| | 102. Menaxhimi emergjent dhe terrorizmi |
| | 103. Teknikat e shuarjes dhe shpëtimit nga zjarri |
| | **Semestri i VI-të** |
| | 104. Reagimi në fatkeqësi |
| | 105. Rimëkëmbja nga fatkeqësitë |
| | 106. Sistemi i komandës së incidentit dhe qendrat operative emergjente |
| | 107. Menaxhimi i materieve të rrezikshme |
| | 108. Sociologjia e fatkeqësive |
| | 109. Shëndeti publik dhe menaxhimi emergjent |
| | **I3. Organizimi i shërbimit emergjent** |
| | **Semestri i VII-të** |
| | 110. Menaxhimi i krizave |
| | 111. Operacionet humanitare në fatëkeqësit ndërkombëtare |
| | 112. Aplikimi i Teknologjisë Informative në menaxhimin emergjent |
| | 113. Ushtrimet me simulime – lojërat |
| | 114. Instrumentet e sigurisë nga zjarri |
| | 115. Teknikat e shuarjes dhe shpetimit nga zjarri II |
| | **Semestri i VIII-të** |
| | **I4.Menaxhmenti dhe lidershipi i avancuar në shërbimin emergjent** |
| | Tema e diplomës |
| Numri i vendeve të studimit | **65** |
| Udhëheqësi i drejtimit/programit të studimit | Prof. Asoc. Dr. Bejtush Gashi, Dekan |
| Personeli i përhershëm shkencor/artistik (Numri sipas kategorive të personelit) | 1. Prof. Asoc. Dr. Bejtush Gashi |
| | 2. Dr. Nexhat Jashari, Ligjërues |
| | 3. Dr. Besnik Fetahu, Ligjërues |
| | 4. Dr. Vilard Bytyqi, Ligjërues |
| | 5. Anita Zenuni, Ligjëruese |
| | 6. Dr. Ferid Azemi, Ligjërues |
| | 7. Florentina Shala, Ligjëruese |
| | 8. Halil Asllani, Ligjërues |
| Taksat e studimit | Nuk ka |

# I. Programi i përgjithshëm

## Lëndët e përgjithshme

Në kuadër të lëndëve të përgjithshme studenti do të familjarizohet me njohuritë bazë për shoqërinë, grupet shoqërore, rolin e individit në shoqëri, fuqin dhe autoritetin, stratifikimin shoqëror, mirëqenien sociale etj. Nga lëndët e përgjithshme studenti do të përvetësoj njohuri themelore mbi metodat e zhvillimit të një hulumtimi shkencorë, zhvillimit të mendimit kritik ndaj fenomeneve të ndryshme shoqërore, si dhe përvetësimit të shkathtësive të shkrimit akademik sipas stileve bashkohore.

Qëllimi i lëndëve me kërkesa themelore është që të njoftohet studenti me lëndët e rendit dhe sigurisë, menaxhimin e krizave, teoritë e udhëheqjes, lëndët ligjore, administratën në Kosovë dhe përmes programit studimor të përgjithshëm ta pajis studentin me perspektivën gjithëpërfshirëse të pozitës së punës në fushën përkatëse dhe rëndësinë për shoqërinë, jetën e përditshme si në Kosovë dhe jashtë saj me qëllim që studenti të familjarizohet me bazat e përgjithshme teorike dhe komunikimeve në fushën përkatëse.

Në lëndët e përgjithshme gjuhësore të gjithë studentët kërkohen që ta arrijnë nivelin e kompetencës në gjuhen angleze, i cili nivel i përgjigjet nivelit të kompetencës gjuhësore lidhur me zyrtarët të cilët kanë një titull universitar dhe të cilët punojnë në mjediset me dygjuhësi si dhe shkathtësinë në një ose dy gjuhë të huaja të cilat janë qenësore për studentin që ta praktikoj profesionin e tij/saj dhe në këtë mënyrë edhe zhvillimin profesional.

Për secilën lëndë përshkrimi i përmbajtjes, mësimnxënia e pritur, metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies, metodat e vlerësimit si dhe literatura janë të përcaktuara (specifikuara) në planprogram.

**Fushat e mësimnxënies në lëndët e përgjithshme -** lëndët e përgjithshme janë të bazuara në zhvillimin e katër fushave të mësimnxënies:

a) *Shkathtësitë e komunikimit,*
b) *Ligji dhe etika,*
c) *Menaxhmenti dhe siguria publike, dhe*
d) *Raportet njerëzore dhe sjellja shoqërore.*




Fig 1. Paraqitja grafike e katër fushave të mësimnxënies

Shkathtësitë e mira të komunikimit nënkuptojnë që studenti është në gjendje të:

- Zotërojë softuerin dhe harduerin aktual për t‟i qasur dhe përkatësisht komunikuar informatat,
- Kuptojë rregullat e autorësisë dhe etikës së nxjerrjes, përcjelljes dhe citimit të burimit të informatave,
- Mësojë qasjet e ndryshme për t‟i shpalosur dhe zbatuar mënyrat e ndryshme të mësimit të gramatikës, të folurit dhe dëgjimit, leximit dhe shkrimit në gjuhën angleze.

Profesionalizmi i përgjithshëm në ligj dhe etikë nënkupton që studenti është në gjendje të:

- Përkushtohet për zhvillimin e integritetit personal dhe përgjegjësisë shoqërore të studentit në pajtim me etikën, të drejtat individuale, parimet e qëndrueshmërisë dhe qytetërimit në një shoqëri demokratike;
- Pranojë përgjegjësi për këtë dhe të veprojë në atë mënyrë e cila i pasqyron vlerat e komuniteteve dhe organizatave e të ndërlidhet me të tjerët në mënyre të respektueshme, njerëzore dhe profesionale.

Mësimnxëniet e përgjithshme në menaxhment dhe lidership nuk janë specifike për agjencinë por ndërlidhen me shkathtësitë e përgjithshme të cilat mundësojnë:

- Marrjen e përgjegjësisë për këtë dhe veprimi në atë mënyrë e cila i pasqyron vlerat e komuniteteve dhe organizatave, të ndërlidhet me të tjerët në mënyre të respektueshme, njerëzore dhe profesionale,
- Menaxhimin në mënyrë efektive dhe raportet me të tjerët brenda organizatave.

Në fushën e raporteve njerëzore dhe sjelljes shoqërore studentët duhet të jenë në gjendje të:

- Shpjegojnë elementet themelore dhe operimin e sistemit socio-kulturor,
- Shpjegojnë bashkëveprimin ndërmjet individëve dhe mjediseve të tyre socio-kulturore dhe natyrore,
- Zbatojnë perspektivën e shkencës shoqërore për një çështje të veçantë dhe të identifikojnë faktorët të cilët ndikojnë në ndryshim (në të kaluarën ose tani).

**Paraqitja tabelore e lëndëve të përgjithshme të bazuara në zhvillimin e katër fushave të mësimnxënies**

| **Lëndët dhe modulet** | **ECTS** | **Semestri** |
|---|---|---|
| G2. Gjuha angleze I | 4 | 1 |
| G3. Gjuha angleze II | 4 | 2 |
| G6. Shkrimi akademik | 5 | 1 |
| *Zgjedhore* | | |
| G7.Teknologjia e informimit dhe komunikimit | 4 | 2 |
| G8. Anglishtja për qëllime specifike (ESP) | 4 | 3 |
| **Ligji dhe etika** | | |
| L3. E Drejta kushtetuese | 4 | 3 |
| L4. Mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut | 4 | 1 |
| L6. E Drejta penale | 6 | 2 |
| L7 E drejta administrative me procedure administrative | 5 | 3 |
| *Zgjedhore* | | |
| L1. Fillet e së drejtës | 4 | 1 |
| **Menaxhmenti dhe siguria publike** | | |
| M1. Siguria kombëtare | 5 | 1 |
| M5. Statistike | 4 | 3 |
| *Zgjedhore* | | |
| M2. Menaxhmenti dhe zhvillimi organizativ | 4 | 1 |
| M4. Menaxhmenti financiar | 4 | 2 |
| **Raportet njerëzore dhe sjellja shoqërore** | | |
| H1. Psikologjia e Përgjithshme | 4 | 2 |
| H2. Shoqëria, mirëqenia sociale | 4 | 3 |
| H4. Metodologjia Hulumtuese Shkencore | 5 | 2 |
| *Zgjedhore* | | |
| H3. Lidershipi dhe menaxhimi i burimeve njerëzore | 3 | 3 |
| R2. Psikologjia e stresit | 3 | 3 |
| **Periudha e punës praktike** | | |
| I1. Hyrje në organizatat e sigurisë publike | 15 | Viti i 1-ë |

## M1. Siguria Kombëtare

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 5 ECTS |
| Orët në klasë: | 45 |
| Orët individuale: | 80 |
| Periudha: | Semestri 1 |
| Lloji i lëndes | Obligative |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Lënda përfshinë trajtimin e teorive të përgjithshme mbi studimin bashkëkohor të Sigurisë Kombëtare, duke filluar nga konceptet mbi sigurinë në botën bashkëkohore, legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar si dhe dokumentet tjera të cilat rregullojnë fushën e sigurisë kombëtare. Në lëndë trajtohen edhe institucionet e sigurisë kombëtare dhe politika e sigurisë. Lënda trajton edhe aspektet e legjislacionit dhe institucionet e Sigurisë Kombëtare në Republikë e Kosovës. Në këtë lëndë do të shqyrtohet shpërndarja e fuqive të sigurisë kombëtare midis të tri degëve të pushtetit.

Gjithashtu, studentët të njihen nga afër me proceset,reformat dhe sfidat me të cilat përballen sistemet e sigurisë bashkëkohore. Koncepti mbi kërcënimet ka ndryshuar në atë masë sa që studimet e sigurisë përfshijnë brenda tyre rreziqe që varirojnë nga pandemitë, degradimi mjedisor, deri dhe shqetësimet sigurie të lidhura me dhunën e dretëpërdrejtë, si terrorizmi dhe konflikti ndërshtetëror. Qëllimi i kësaj lënde është studimi i këtyre faktorëve, si dhe njohja me organizimin struktural të sektorit nacional të sigurisë për tu përballur me këto çështje

**Mësimnxënia**

Studenti është në gjendje të:

- Njoh konceptet dhe teoritë e marrëdhënieve ndërkombëtare në fushën e sigurisë kombëtare
- Të identifikojë, ndaj dhe përcaktojë faktorët e sigurisë,
- Analizojë dhe vlerësojë situatat e sigurisë dhe kërcënimet e mundshme,
- Aplikojë parimet e sigurisë,
- Zhvillojë një plan që ka për qëllim rritjen e sigurisë.

**Përmbajtja**

- Hyrje në përkufizimin e lëndës Siguri Kombëtare
- Përkufizimi i konceptit të sigurisë,
- Studimet e paqes, origjina, studimet e paqes sot, reagimi ndaj sfidave të reja të sigurisë.
- Krimet kibernetike
- Llojet e kërcënimeve dhe krimeve Kibernetike
- Terrorizmi ndërkombëtar,
- Pandemitë.
- Sistemi i sigurisë kombëtare i Republikës së Kosovës
- Politika e Sigurisë

**Metodat mësimore**

- Ligjëratat
- Puna me grup

**Metodat e vlerësimit**

- Punimi seminarik
- Testi,
- Aktiviteti në klasë
- Provimi

**Literatura**

- Peter Hough, Understanding Global Security, London, 2018
- Collins, Alan, Studime Bashkëkohore të Sigurisë, Oxford UniversityPress, përkthyer në shqip nga Universiteti Evropian i Tiranës, 2012;
- NATIONAL SECURITY LAW & POLICY, 3RD Ed. (John Norton Moore, Guy B. Roberts, and Robert F. Turner eds., 2015.

## 6. Shkrimi akademik

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 5 ECTS |
| Orët në klasë: | 60 |
| Orët individuale: | 65 |
| Periudha: | Semestri 1 |
| Lloji i lëndes | Obligative |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët t'i përvetsojnë konceptet themelore të të shkruarit akademik dhe të mësojnë të shkruajnë shkrime akademike gjatë studimeve dhe punës së tyre në fushën profesionale. Kjo lëndë synon t'u ndihmojë studentëve për të shkruar sipas normave standarde gjuhësore, për të ndërtuar fjali dhe paragrafe, për të shkruar një ese, për të punuar një seminar, punim shkencor, punim diplome etj. Të gjitha këto do të trajtohen në aspektin përmbajtësor, teknik, metodologjik edhe në atë drejtshkrimor. Qëllimi kryesor i lëndës shkrim akademik është që t'i njoftoj studentët me kulturën e gjuhës në përgjithësi e sidomos me kulturën e të shkruarit në veçanti.

**Mësimnxënia**

Në fund të këtij kursi, pritet që studenti të jetë në gjendje:

- të zhvillojë mendimin kritik dhe të realizojë lexime kritike të literaturës;
- të përvetësojë (nxë) njohuri dhe aftësi të mjaftueshme për të shkruar në mënyrë akademike;
- të dijë ta vendosë tezën brenda një teksti argumentative dhe të analizojë dhe të vlerësojë fuqinë e argumentit të shkruar;
- të kuptojë konceptet themelore të hulumtimit;
- të shkruajë në mënyrë efektive për audiencë të posaçme;
- të mbështesë një qëndrim në mënyrë logjike, të rregullt dhe koherente;
- të dijë si t'i sistemojë idetë dhe fragmentet e huazuara të tekstit sipas sistemeve ndërkombëtare të të cituarit;
- të përdorë me sukses gjuhën standard në të shkruar.

**Përmbajtja**

- Përkufizimi i shkrimit akademik dhe i artit të të shkruarit.
- Proceset dhe mënyrat e realizimit të shkrimit akademik.
- Si bëhet hyrja në një temë të caktuar, zhvillimi dhe nyjëtimi i shkrimit, mbyllja e shkrimit, gjithnjë, duke pasur parasysh një platformë studimore shkencore dhe duke bërë referime e citime të nevojshme.
- Përfshirja e një procesi më thelbësor kognitiv duke përfshirë të menduarit, kuptuarit dhe të mësuarit.
- Kuptimi, roli dhe rëndësia e drejtshkrimit,
- Të kuptuarit e të shprehurit dhe zbatimi i tij.

**Metodat mësimore**

- Ushtrime,demonstrime,interpretime, praktika,
- Diskutime debatuese
- Punimet seminarike
- Puna individuale & Puna në grup

**Metodat e vlerësimit**

- Ese
- Punë praktike
- Pjesëmarrje aktive në procesin mësimor
- Testi me shkrim

**Literatura**


- Kane, T. (2010). Si të shkruajmë shqip. Tiranë: Qendra për Arsim Demokratik (CDE).
- Barnet, S., Ballanca, P., Stubbs, M. (2000). Shkrim Akademik. Tiranë: Dita.
- Publication Manual of the American Psychological Association (APA); 7th edtion (2019)
- Memushaj, R. (2005). Shqipja standarde; Si ta flasim dhe ta shkruajmë. Tiranë: Toena.

## L4. Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 70 |
| Periudha: | Semestri 1 |
| Lloji i lëndes | Obligative |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

### Hyrje në lëndën mësimore

Qëllimet e lëndës kanë të bëjnë me shqyrtimin e dispozitave, rasteve, standardeve dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut, si dhe masave në dispozicion kundër këtyre shkeljeve në sistemin ekzistues të zbatimit të ligjit. Do të shqyrtohet korniza kushtetuese dhe institucionale për të drejtat e njeriut në Kosovë, përfshirë zbatimin në praktikë të të drejtave të mbrojtura në rendin juridik të Kosovës. Kjo do të bëhet përmes analizës së një sërë rastesh të zgjedhura gjyqësore nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatave të rregullta në vendin tonë. Trajtimi i lëndës cdo here do të bëhet ne frymën e akteve dhe jurisprudences ndërkombëtare dhe nacionale.

### Mësimnxënia

Studentët janë në gjendje të:

- Kuptojë sistemin aktual botëror të të drejtave të njeriut, si burimet ashtu dhe institucionet dhe instrumentet kryesore ligjore në fuqi;
- Shpjegojë sistemet rajonale për të drejtat e njeriut, veçanërisht sistemin evropian të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut;
- Veprojnë si zbatues të ligjit në përputhje me rregullat për garantimin e drejtave të njeriut
- Njohin aspekte specifike të të drejtave të njeriut, si për shembull të drejtën në jetë dhe të drejtën në gjykim të drejtë, ndalimin e diskriminimit, mbrojtjen e refugjatëve, si dhe sfidat në realizimin e këtyre të drejtave;
- Respektojë dinjitetin njerëzor dhe të drejtat e tjera të garantuara gjatë zbatimit të ligjit

### Përmbajtja

- Koncepti i të drejtave të njeriut dhe Sistemi i OKB-ës për të drejtat e njeriut (Instrumentet dhe Institucionet), dhe Sistemet rajonale ndërkombëtare të drejtave dhe lirive të njeriut,
- Jurisprudenca e GJEDNJ, Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatave të rregullta të Kosovës për të drejtat dhe liritë e njeriut; Të drejtat e njeriut sipas legjislacion të zbatueshëm në Kosovë,
- Aplikimi i parimeve të përgjithshme të Drejtat e Njeriut nga zbatuesit e ligjit; Sjellja etike dhe ligjore; Mosdiskriminimi në zbatimin e ligjit,
- Hetimet e policisë; Arrestimi, Paraburgimi; Përdorimi i forcës dhe armëve të zjarrit; Mbrojtja e të Miturve, Refugjatët, Të drejtat e viktimave, Shkeljet e të Drejtave të Njeriut nga policia
- E drejta për jetë; E drejta për një proces të drejtë dhe të paanshëm; E drejta e pronës dhe e drejta për lirinë dhe sigurinë e personit; Gjenocidi

### Metodat mësimore

- Ligjeratat,
- Ushtrimet,
- demonstrimet;
- Diskutime debatuese dhe Puna në grup;
- Punimet seminarike

### Metodat e vlerësimit

- Teste me shkrim;
- Vlerësime seminarike,
- Detyrë shtëpie;
- Vlerësim klase;
- Provimi përfundimtar

### Literatura


- Gruda, Z. (2010). Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut. Botues: UBT.
- Kushtetuta e Kosovës; Legjislacioni dhe praktika për të drejtat e njeriut në Kosovë
- Human Rights Standards and Practice for the Police Expanded Pocket Book on Human Rights for the Police United Nations New York and Geneva, 2004
- Zejnullah Gruda, Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut (Prishtinë 2007)
- Mark W. Janis, Richard S. Kay, AnthonyW. Bradley, E drejta evropiane e të drejtave të njeriut, 2002
- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;
- Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;

## G2. Gjuha angleze I

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 45 |
| Orët individuale: | 55 |
| Periudha: | Semestri 1 |
| Lloji i lëndes | Obligative |
| Lloji i vlerësimit | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Qëllimi i këtij kursi është që studentëve t'u ofroj njohuri të përgjithshme të gjuhës angleze duke u mundësuar atyre që të arrijnë përvetësimin e katër shkathtësive kryesore të të nxënit të gjuhës, të cilat do t'u shërbejnë atyre në jetën personale dhe profesionale në të njëjtën kohë.

Synimi i kësaj lënde është që të krijoj një bazë të mirë gjuhësore, gjithnjë duke iu referuar normave dhe rregullave standarde, në mënyrë që t'u mundësoj studentëve t'i zhvillojnë dhe ndërtojnë shkathtësitë e tyre gjuhësore duke e ngritur nivelin e përgjithshëm të përvetsimit të gjuhës. Përmbajtja e lëndës ka për bazë nivelin para- mesatar, në mes të A2 dhe B1 (sipas kornizës së përbashkët evropiane të referimit = CEFR), duke përfshirë tema të ndryshme relevante te cilat mundësojnë zhvillimin e katër shkathtësive kryesore gjuhësore siç janë: leximi, shkrimi, dëgjimi dhe të folurit.

**Mësimnxënia**

Studenti është në gjendje të**:**

- marr njohuri përgjithshme dhe koncepte bazike të gjuhës angleze
- t'i kuptoj dhe përvetësoj rregullat bazë të funksionimit të gjuhës angleze
- të kuptoj gramatikën si pjesë qendrore të gjuhës
- të arrij të krijoj një bazë të mirë gjuhësore dhe ta kuptoj funksionimin dhe perdorimin e gjuhës angleze në bazë të normave gramatikore.
- Të arrij t'i përvetësoj katër shkathtësitë kryesore të gjuhës, siç janë: leximi, shkrimi, dëgjimi dhe të folurit

**Përmbajtja**

- Mësimi i gjuhës duke përdorur material autentike
- përdorimi i gjuhës së synuar (angleze) duke kryer detyra të caktuara me fokus të caktuar gramatikor dhe përmbajtsor.
- Gramatika e gjuhës angleze (funksionet gramatikore),
- Kuptimi i përgjithshme i emrave, mbiemrave, foljeve, ndajfoljeve, dhe i pjesëve tjera të ligjëratës.
- Ushtrime dhe detyra të strukturuara mirë për të arritur përvetësimin e gjuhës dhe për të ngritur edhe vetëbesimin tek studentët.

**Metodat mësimore**

- Ligjërata
- Diskutime
- Ilustrime me shembuj

**Metodat e vlerësimit**

- Detyra
- Testi me shkrim

**Literatura**


- Cunningham, Sarah & Peter Moor, (2014) Cutting Edge - Pre-intermediate, Third Edition Student's book, Pearson Longman
- Cunningham, Sarah & Peter Moor, (2014) Cutting Edge - Pre-intermediate, Third Edition Workbook, Pearson Longman
- Class CDs

## L1. Fillet e së drejtës

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 70 |
| Periudha: | Semestri 1 |
| Lloji i lëndes | Zgjedhore |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

### Hyrje në lëndën mësimore

Qëllimi i lëndës është që studentëve të vitit të parë t‟u ofrohen njohuritë themelore lidhur me nocionet, fenomenet dhe ligjshmëritë shtetërore juridike. Kjo lëndë është hyrje në drejtësi dhe etikë duke përfshirë edhe teorinë e së drejtës dhe sjelljen e gabuar, teorinë e vlerave (të mirat dhe të këqijat) prapa drejtësisë.

### Mësimnxënia

Studenti është në gjendje të:

- Kuptojë njohuritë themelore për shtetin dhe të drejtën;
- Sqarojë kuptimet themelore për shtetin dhe të drejtën dhe lidhshmërinë e tyre me jetën praktike;
- Identifikojë format e shtetit dhe të së drejtës;
- Kuptojë dhe identifikojë aktet juridike;
- Lexojë, shpjegojë, analizojë dhe vlerësojë problemet etike të zgjidhura nga drejtësia;
- Mendojë në mënyrë kritike dhe analitike lidhur me çështjet etike dhe juridike

### Përmbajtja

- Objekti, kuptimi dhe metodat e studimit në hyrje të së drejtës,
- Shteti, e drejta dhe shoqëria,
- Nocioni i shtetit,
- Format e sundimit politik,
- Demokracia, nocioni dhe llojet,
- Format e rregullimit shtetëror,
- Format e pushtetit shtetëror,
- Rendi juridik dhe normat juridike,
- Akti juridik, kuptimi dhe përmbajtja e aktit juridik,
- Aktet juridike si burim i së drejtës,
- Marrëdhëniet juridike,
- Nocioni i zbatimit të së drejtës,
- Interpretimi i së drejtës, mënyrat dhe llojet,
- Sistemi i së drejtës, nocionet dhe elementet.

### Metodat mësimore

- Ligjëratat
- Rastet studimore
- Puna në grup
- Punime seminarike

### Metodat e vlerësimit

- Provim me shkrim

### Literatura


- Ismaili, O. (2013). *Fillet e së drejtës.* Universiteti i Prishtinës.
- Berisha, F. (2015). *Hyrje në të drejtën*. Universiteti “Haxhi Zeka”.

## M2. Menaxhimi dhe zhvillimi organizativ

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 70 |
| Periudha: | Semestri 1 |
| Lloji i lëndes | Zgjedhore |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

### Hyrje në lëndën mësimore

Qëllimi i kësaj lënde është planifikimi i matur, përpjekje e gjerë organizative për ta shtuar efektivitetin ose efikasitetin e organizatës. Menaxhimi i njerëzve, strategjive, projekteve dhe programeve është njëkohësisht nxitës dhe sfidues. Ai kërkon një varg të theksuar të njohurive dhe shkathtësive. Menaxherët efektiv duhet ta dinë punën, të jenë kompetent në raportet ndër-personale, të sillen me etikë, të japin diagnozën, të merren me burimet njerëzore dhe me mjedisin organizativ.

Zbatimi i planifikimit strategjik është në thelbin e asaj se si të bëhet ndryshimi i krejt asaj që ndodh në organizatë. Për planifikimin strategjik të një organizate është e nevojshme që punonjësit ta kuptojnë dhe ndajnë bashkërisht vizonin, misionin dhe objektivat strategjike të saj. Të gjitha këto aspekte të zhvillimit organizativ dhe menaxhimit të ndryshimit janë të lidhura me shkathtësitë ekzistuese të menaxhimit. Në kuadër të menaxhimit dhe zhvillimit organizativ studentët do të jenë të përqendruar në zhvillimin organizativ (ZHO) të aftësisë dhe shkathtësisë personale në fushat vendimtare të lidershipit dhe menaxhimit.

**Mësimnxënia**
Studenti është në gjendje të:
- Identifikojë mjedisin e jashtëm dhe të brendshëm të organizatës.
- Përcaktojë parametrat për matjen e sektorit të rendit dhe sigurisë
- Bëj matjen e rezultateve dhe suksesit organizativ në sektorin publik
- Zbatojë mjetet strategjike dhe formulojë strategjitë
- Përcaktojë dhe zbatojë masat e ZHO-së me qëllim të arritjes së qëllimeve organizative.
- Përshkruajë se çfarë duhet të bëjnë menaxherët në proceset e ZHO.
- Renditë sfidat dhe mundësitë qe menaxheret te përdorin konceptet e ZHO.
- Pajisë studentet me njohuritë baze te nevojshme për te shpjeguar ne mënyrë racionale sjelljen e punonjësve ne ndryshimin e organizatave.

**Përmbajtja**
- Struktura organizative
- Mjedisi i organizatës
- Planifikimi strategjik
- Matjet e baraspeshuara të suksesit organizativ,
- Menaxhimi i komunikimeve organizative në ZHO
- Vendim-marrja në organizatë

**Metodat mësimore**
- Ligjëratat
- Rastet studimore
- Puna në grup

**Metodat e vlerësimit**
- Provim me shkrim

**Literatura**


- Donald Andersen. (2016). Organization development: The practice of leading organizational change ( 4th ed.).
- Warner Burke (2016). Organization change: Theory and Practice . (Foundation for Organizational Siciences.

## L6. E Drejta Penale

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 6 ECTS |
| Orët në klasë: | 45 |
| Orët individuale: | 105 |
| Periudha: | Semestri 2 |
| Lloji i lëndes | Obligative |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Qëllimi i lëndës mësimore është që studentët të fitojnë njohuri themelore në fushën e të drejtës penale. Pas mbarimit me sukses të lëndës, pritet që studentët të kenë fituar njohuri solide për të drejtën penale dhe ligjin penal, veprën penale dhe përgjegjësinë e kryerësit, sanksionin penal dhe pasojat e sanksionit penal.

Pas mbarimit të lëndës nga studentët pritet që të jenë në gjendje t‟i diskutojnë në mënyrë të argumentuar konceptet e mësuara, të jenë të aftë t‟i hulumtojnë thellësisht, si dhe ta vlerësojnë drejtshmërinë e vendimeve gjyqësore relevante.

**Mësimnxënia**

Studenti është në gjendje të:

- Të kuptojë dhe demonstroj njohuri të mjaftueshme lidhur me të drejtën penale,
- Të përkufizojë veprat penale ,
- Të identifikojë përgjegjësinë penale,
- Të përcaktojë shkaqet të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale,
- Të kuptojë sistemin e sanksioneve penale,
- Të përcaktojë dhe identifikoj veprat penale,
- Të aplikojnë përvojat e fituara nga e drejta kushtetuese.

**Përmbajtja**

- Nocioni, lënda dhe funksioni i së drejtës penale,
- Kodi penal, interpretimi i ligjeve penale dhe veprimi i legjislacionit penal,
- Nocioni, elementet, objekti, subjekti dhe ndarja e veprave penale,
- Veprimi, kundërligjshmëria, shkaqet të cilat e përjashtojnë kundërligjshmërinë,
- Përgjegjësia penale, përgjegjshmëria, faji,
- Përgjegjësia për format e kualifikuara të veprave penale, lajthimi, veprimet përgatitore dhe tentativa e veprës penale,
- Bashkimi i veprave penale, bashkëpunimi,
- Nocioni, funksioni dhe sistemi i sanksioneve penale,
- Shuarja e dënimit,
- Pjesa e posaçme e së drejtës penale, veprat penale në Kodin Penal të Kosovës

**Metodat mësimore**

- Ligjërata; Ushtrimet, demonstrimet, interpretimet, praktika; Diskutime debatuese; Punimet seminarike; Vetë hulumtim; Puna në grup

**Metodat e vlerësimit**

- Provimi me shkrim
- Vet-hulumtim

**Literatura**


- Salihu, I. (2014). E Drejta Penale – Pjesa e Përgjithshme. Prishtinë.
- Salihu, I. (2014). E Drejta Penale – Pjesa e Posaçme. Prishtinë.
- Salihu, I., Zhitija, H., & Hasani, F. (2014). *Komentar i Kodit Penal të Kosovës*. GIZ.
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës.

## H4. Metodologjia Hulumtuese Shkencore

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 5 ECTS |
| Orët në klasë: | 50 |
| Orët individuale: | 50 |
| Periudha: | Semestri 2 |
| Lloji i lëndës: | Obligative |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Qëllimi i kësaj lënde është njoftimi dhe familjarizimi me teknikat dhe metodat themelore të kerkimit shkencor, e që janë të një rëndësie parësore në fushën e studimeve shkencore. Gjithashtu, në këtë lëndë do të synohet shqyrtimi sa më i gjerë i metodave hulumtuese dhe koncepteve relevante për studime kërkimore. Kjo lëndë ka për qëllim që të hedh dritë mbi ndikimet e faktorëve të shumte në proceset kërkimore ne shkenca shoqërore.

Qëllimi i hulumtimit shkencor në shkencat shoqërore është të zbulohen ligjet dhe postulatet e teorive të cilat mund t'i shpjegojnë fenomenet shoqërore ose me fjalë të tjera, ndërtimin e njohurisë shkencore. Me rëndësi është të kuptohet që kjo njohuri mund të jetë jo e përkryer ose madje edhe shumë larg nga e vërteta. Qëllimi i lëndës mësimore është njoftimi i studentit me mendimin shkencor dhe procesin e hulumtimit. Studenti po ashtu do të njoftohet me bazat e mbledhjes së të dhënave dhe analizën e të dhënave.

**Mësimnxënia**

Studenti është në gjendje të:

- Mbledhë të dhëna shkencore,
- Planifikojë formën e hulumtimit për një problem të hulumtimit,
- Analizojë rezultatet e bazuara në përshkrimin të statistikave,
- Shfrytëzojë dhe zbatoj (kombinimin) e bazave të ndryshme me të dhënat statistikore ,
- Kryejë një studim.

**Përmbajtja**

- Shkenca dhe mendimi shkencor,
- Procesi hulumtues,
- Format e hulumtimit,
- Mbledhja e të dhënave: anketa, eksperimenti, rasti studimor,
- Analiza e të dhënave cilësore,
- Analiza e të dhënave sasiore ,
- Besueshmëria dhe vlefshmëria,
- Etika e hulumtimit.

**Metodat mësimore**

- Ligjëratat
- Praktika

**Metodat e vlerësimit**

- testi
- Prezantimi i punimit të shkurtër hulumtues

**Literatura**


- Creswell, John W. J. David Creswell. Research Design: Qualitative, Quantitative, and Mixed Methods Approaches. Publisher: SAGE Publications, Inc; 5th edition, 2018.
- Burkholder, Gary J. Kimberley A. Cox, Linda M. Crawford. Research Design and Methods: An Applied Guide for the Scholar-Practitioner. Publisher: SAGE Publications, Inc; 1st edition, 2019.
- Yin, Robert K. Case Study Research and Applications: Design and Methods. Publisher: SAGE Publications, Inc; 6th edition, 2017.

## G3. Gjuhe Angleze II

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 45 |
| Orët individuale: | 55 |
| Periudha: | Semestri 1 |
| Lloji i lëndes | Obligative |
| Lloji i vlerësimit | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Qëllimi i këtij kursi është që studentëve t‟u ofroj njohuri të përgjithshme të gjuhës angleze të kombinuar me njohuri të fushave përkatëse të tyre të cilat do t‟u shërbejnë atyre në jetën personale dhe profesionale në të njëjtën kohë. Synimi i kësaj lënde është që t‟i pavarësoj studentët në përdorimin e gjuhës dhe rrjedhimisht t‟i zgjeroj njohuritë gjuhësore në fushat përkatëse të sigurisë publike.
Krijimi i një baze themelore gjuhësore nga kursi paraprak do t‟u mundësoj studentëve të kalojnë në fusha dhe tërminologji më specifike dhe të interest për ta.

Përmbajtja e lëndës ka për bazë nivelin mesatar, B1-B1+ (sipas kornizës së përbashkët evropiane të referimit = CEFR), duke përfshirë tema të ndryshme që kanë karakter të përgjithshëm por edhe profesional. Zhvillimi i katër shkathtësive kryesore gjuhësore siç janë: leximi, shkrimi, dëgjimi dhe të folurit janë pjesë e pandarë e këtij kursi.

**Mësimnxënia**

Studenti është në gjendje të:

- marr njohuri përgjithshme dhe koncepte bazike të gjuhës angleze
- t‟i kuptoj dhe përvetësoj rregullat bazë të funksionimit të gjuhës angleze
- të kuptoj gramatikën si pjesë qendrore të gjuhës
- tw njoftohet me terminologji tw fushave pwrkatwse profesionale
- të arrij të krijoj një bazë të mirë gjuhësore dhe ta kuptoj funksionimin dhe perdorimin e gjuhës angleze në bazë të normave gramatikore.
- Të arrij t‟i përvetësoj katër shkathtësitë kryesore të gjuhës, siç janë: leximi, shkrimi, dëgjimi dhe të folurit

**Përmbajtja**

- Mësimi i gjuhës duke përdorur material autentike të fushave të ndryshme profesionale, kryesisht të sigurisë publike.
- përdorimi i gjuhës së synuar (angleze) duke kryer detyra të caktuara me fokus të caktuar gramatikor dhe përmbajtsor.
- Gramatika e gjuhës angleze (funksionet gramatikore),
- Familjarizimi me terminologji që ka të bëjë me zbatimin e ligjit.
- Ushtrime dhe detyra të strukturuara mirë për të arritur përvetësimin e gjuhës dhe për të ngritur edhe vetëbesimin tek
- studentët.

**Metodat mësimore**

- Ligjërata
- Diskutime
- Ilustrime me shembuj

**Metodat e vlerësimit**

- Detyra
- Testi me shkrim

**Literatura**


- Cunningham, Sarah & Peter Moor, (2013) Cutting Edge - Intermediate, Student's book, Pearson Longman
- Cunningham, Sarah & Peter Moor, Cutting Edge - Intermediate, Workbook, Pearson Longman
- Class CDs
- Gillian D. Brown, Sally Rice (2007)Professional English in Use - Law - Cambridge University Press;

## H1. Psikologjia e përgjithshme

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 48 |
| Orët individuale: | 52 |
| Periudha: | Semestri 2 |
| Lloji i lëndës; | Obligative |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Ky modul ka për qëllim ofrimin e njohurive për studentët rreth aspekteve të ndryshme të shoqërisë njerëzore dhe të zgjerojë në mënyrë cilësore dhe të plotë, hapësirën e këndvështrimeve social-psikologjike mbi problemet e ndryshme në shoqëri. Duke qenë një disiplinë me zbatim të gjerë në shumë fusha të studimit, shpesh të menduarit nën perspektivën psikologjike rezulton e domosdoshme. Përvetësimi i koncepteve të rëndësishëme në psikologji, ndihmon në të kuptuarit dhe të vlerësuarit e drejtë të problematikave të ndryshme të cilat zhvillohen në shoqëri dhe qasjen ndaj të tjerëve.
Ndërlidhja e informatave të ndryshme që trajtohen do te jetë tema kryesore e njohurive të përfituara e të arritura nga studentët, sepse një subjekt i këtillë i studimit kaq tërësor në një periudhë kohore kaq të shkurter nuk mund të jetë më shumë se hyrje dhe ide e përgjithshme kundrejt kësaj shkence.

**Mësimnxënia**

Studenti është në gjendje të:
- kuptojë nocionet, konceptet, çështjet kyçe që mësohen në lëndën e Psikologjisë
- Të jetë i aftë që të përshkruaj, diskutoj dhe debatoj për nocionet themelore të psikologjisë
- Të zhvilloj mendimin kritik rreth çështjeve të diskutuara
- Të aftësohet që ti përdorë njohuritë e marra nga lënda në kurse më të avancuara gjatë studimeve

**Përmbajtja**

Rëndësia e psikologjisë për zyrtarët e agjencive të sigurisë publike
- Personaliteti dhe teoritë e tij
- Grupi dhe ndikimi i tij
- Stresi dhe përshtatja
- Menaxhimi i kohes dhe konsumimi professional
- Grupi dhe identiteti social
- Format e ndikimit social
- Sjellja prosociale
- Paragjykimet
- Psikologjia ligjore

**Metodat mësimore**
- Ligjërata interaktive
- Seminaret dhe prezantime praktike,
- Ushtrimet e komunikimit dhe ushtrimet me role,
- Puna grupore dhe diskutimet,
- Mendimet pasqyruese dhe reflektimi i rasteve.

**Metodat e vlerësimit**

Vlerësimi do të bëhet nëpërmjet testeve gjysmë semestrale dhe finale. Studentët e pakënaqur me notën mund t'i nënshtrohen provimit përfundimtar me test.
- Pjesëmarrja dhe angazhimi në ligjërata
- Testet gjysmë-semestral
- Testi semestral
- Seminar/Prezantim/Detyra tjera

**Literatura**

- Dragoti, Edmond. (2017). Psikologjia sociale. Tiranë: Media print.
- Stangor, Ch (2011). Introduction to Psychology. E disponueshme: http://ocw.mit.edu/ans7870/9/9.00SC/MIT9_00SCF11_text.pdf
- Morris, Ch. A & Maisto, A.A. (2008). Hyrje ne Psikologji. Tirane
- Pettijohn, T. Psikologjia, Një Hyrje Koncize, 1996 Juniku. N. Nocionet Themelore të Psikologjisë.
- Stangor, Ch (2011). Introduction to Psychology. E disponueshme: http://ocw.mit.edu/ans7870/9/9.00SC/MIT9_00SCF11_text.pdf

**G7. Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit**

| | |
|---|---|
| Numri: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 66 |
| Periudha: | Viti i dytë |
| Lloji i lëndës | Zgjedhore |
| Lloji i vlerësimit | I diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Lënda Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit ngërthen në vete shpjegimin e koncepteve bazike të përdorimit të kompjuterëve, duke përfshirë pjesët harduerike dhe softuerike të tij.

Qëllimi i kësaj lënde është që t‟i përgatisë dhe trajnoj studentet që marrin pjesë në ligjërata dhe ushtrime, në përdorimin e resurseve të TI-së siç janë: hardueri (kompjuteri, printeri, skaneri dhe pajisjet e tjera periferike) dhe softueri (sistemi operativ, programet aplikative MS Word, MS Excel dhe MS Powerpoint).

**Mësim nxënia**

Studenti është në gjendje të:

- Studentet duhet të arrijnë të kuptojnë si të aplikohet hardueri dhe softueri për nevoja të trajnimeve, studimeve, punëve zyrtare, në punën me te gjitha llojet e dokumenteve, dosjeve, arkivimin dhe printimin tyre.
- Të menaxhojnë me lloje të ndryshme të softuerëve varësisht nga qëllimi i përdorimit të tyre, krijimin dhe menaxhimin me dosje në Microsoft Word, Excel, PowerPoint, E- mail, Internet, etj.
- T‟i demonstrojnë shkathtësitë e fituara në praktikë.
- T‟i paraqesin shkathtësitë e fituara në aplikimin e Sistemit Operativ, pakos së Microsoft Office, e-mailit, Internetit etj., me ushtrimet laboratorike duke demonstruar në këtë mënyrë aplikimin e TI-së në vendin e tyre të punës.

**Përmbajtja**

- Konceptet bazike të sistemeve kompjuterike;
- Sistemet operative;
- MS Word;
- MS Excel;
- MS PowerPoint;
- Shfletuesit e uebit.

**Metodat mësimore**

- Ligjërata
- Ushtrime laboratorike
- Pune ekipore

**Metodat e vlerësimit**

- Pjesëmarrja dhe aktiviteti
- Testi i I-rë
- Testi i II-të
- Provimi përfundimtar

**Literatura**


- Libri ECDL 2010, Word, Excel dhe, PowerPoint.
- ECDL ( European Computer Driving Licence), 2013, Arben Çokaj, Tiranë
- Agni Dika,2005 Bazat e Informatikës dhe të Kompjuterikës.
- Introduction to Computers, Peter Norton, 6th International Edition (McGraw-Hill)

## M4. Menaxhmenti Financiar

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 70 |
| Periudha: | Semestri 2 |
| Lloji i lëndës: | Zgjedhore |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

### Hyrje në lëndën mësimore

Menaxhmenti financiar ndikon në krijimin e vlerës, përmirësimin e shërbimeve si dhe zvogëlimin shpenzimeve apo kostove. Secili Institucion, organizatë, ka nevojë për menaxhim të mirë të financave me qëllim shfrytëzimit të mjeteve të tyre financiare në mënyrë sa më efikase dhe efektive. Gjatë ligjëratave do të shtjellohen tema të ndryshme në konceptin e përgjithshëm të Menaxhmentit Financiar.

Studentët do të njoftohen edhe mbi rolin dhe rëndësinë e vendimmarrjes së menaxherëve financiar të cilët para se të vendosin se cilat aktivitete duhet të financohen, në çfarë forme, në çfarë mase, si të mos ekspozohet Institucioni rreziqeve financiare, duhet ti marrë parasysh një mori faktorësh si: normat financiare, nivelin e riskut ekonomik dhe politik, rregullativat mbi lëvizjen e kapitalit, dhe faktorë e tjerë.

### Mësimnxënia

Studenti është në gjendje të:

- Kuptojë dhe vlerësojë funksionet e menaxhmentit financiar, karakterin shkencor të saj për gjatë fazave të zhvillimit të saj.
- Kuptojë dhe analizojë rolin dhe rëndësinë e menaxhmentit financiar në kuadër të organizimit institucional dhe ndikimet e tyre;
- Shtjellojë dhe zbatojë financat në strukturën (organizative) institucionale;
- Zhvillojë plane financiare.

### Përmbajtja

- Përkufizimi i menaxhmentit financiar
- Parashikimi i ndikimeve financiare në kuadër të investimeve, financimeve, apo rreziqeve financiare;
- Zbatimi i financave, sigurimi i mjeteve financiare dhe koncepti i vendimmarrjes në kuadër të menaxhmentit financiar.
- Leximi, analizimi dhe zhvillimi i planifikimeve financiare

### Metodat mësimore

- Ligjëratat
- Punimet seminarike
- Puna në grup
- Aktivitetet tjera të menaxhmentit financiar si lëndë mësimore

### Metodat e vlerësimit

- Studime rasti
- Testi me shkrim

### Literatura


- Mustafa, I. (2007). *Menaxhmenti financiar*. Prishtinë : Riinvest.
- Pascal Grandin (2006): "Performanca e portofolit", New York.

## G8. Anglishtja për Qëllime Specifike

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët praktike të punës: | 45 |
| Periudha: | Semestri i III-të |
| Lloji I lëndës: | Zgjedhore |
| Llojiivlerësimit: | I Diferncuar |

**Hyrje në periudhën e punës praktike**
Anglishtja për qëllime specifike është krijuar për të përmbushur dhe ngritur kompetencën gjuhësore në anglishte të zyrtarëve të zbatimit të ligjit. Ky kurs është i përshtatshëm për zyrtarët e zbatimit të ligjit nga agjencionet e sigurisë publike sikurse Policia e Kosoves, Inspektorati Policor i Kosovës, Doganat e Kosoves, Sherbimi Korrektues dhe Sprovues i Kosoves, Agjencia e Menagjimit te Emergjencave etj.

Temat në kuadër të këtij kursi janë përzgjedhur me kujdes duke u përshtatur me kontekstet specifike të fushës së zbatimit të ligjit. Janë përfshirë një gamë e gjerë e situatave të ndryshme të zbatimit të ligjit si për shembull: identifikimi i automjeteve, ndalimi dhe kërkimi, kontrolli i turmës, marrja e deklaratave, kontrolli doganor, etj. Kursi është i pasur me fjalor terminologjik specifik dhe synon të ndihmojë personelin e zbatimit të ligjit të veprojë me lehtësi në anglisht në punët e tyre të përditshme. Ai u siguron atyre aftësi për t'u marrë me situatat në anglisht dhe për të shpjeguar pasojat (ligjore ose të tjera) të çdo veprimi.

Ky kurs ofrohet si lëndë zgjedhore për shkak se është i një niveli më të avancuar dhe kërkon kompetencë më ta lartë gjuhësore. Kjo lëndë iu mundëson studentëve ngritjen e kompetencës gjuhësore profesionale.

**Mësimnxënia**
Studenti është në gjendje të:
- marr njohuri specifike të gjuhës angleze në fusha të ndryshme të zbatimit të ligjit
- të përvetësoj terminologji specifike në situata dhe kontekste reale të punës në agjencionet e zbatimit të ligjit
- të kuptoj dhe përdor gjuhën angleze duke respektuar rregullat gramatikore
- të arrij të krijoj një bazë të mirë gjuhësore dhe ta kuptoj funksionimin dhe perdorimin e gjuhës angleze në bazë të nevojave profesionale të punës.
- Të arrij t‘'i përvetësoj katër shkathtësitë kryesore të gjuhës, siç janë: leximi, shkrimi, dëgjimi dhe të foluritKuptojë dhe identifikojë aktet juridike

**Përmbajtja**
- Mësimi i gjuhës duke përdorur material autentike
- përdorimi i gjuhës së synuar (angleze) duke kryer detyra të caktuara me fokus të caktuar gramatikor dhe përmbajtsor.
- Trajtimi i temave të interesit për zyrtarët e zbatimit të ligjit
- Tema të caktuara specifike me terminologji në fushën e zbatimit të ligjit.
- Ushtrime dhe detyra të strukturuara mirë për të arritur përvetësimin e gjuhës dhe për të ngritur edhe vetëbesimin tek studentët.

**Metodat**
- Ligjërata
- Diskutime
- Ilustrime me shembuj

**Metodat e vlerësimit:**
- Detyra
- Testi me shkrim

**Literatura**

- Charles Boyle, Ileana Chersan (2009) - English for Law Enforcement- Macmillan Education
- Gillian D. Brown, Sally Rice (2007) - Professional English in Use - Law - Cambridge University Press.

## I1. Hyrje në Organizatat e Sigurisë Publike

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 15 ECTS |
| Orët praktike të punës: | 375 |
| Periudha: | Viti i 1-ë |
| Lloji I lëndës: | Obligative |
| Llojiivlerësimit: | I Diferncuar |

**Hyrje në periudhën e punës praktike**

Periudha e pare e punës praktike bazohet në vizitën studimore monitoruese dhe njoftuese në një agjencion tjeter prej nga vjen studenti. Vizita monitoruese do të raportohet sipas doracakut të Intershipit.

Studentët bëhen të afërt me mjediset kryesore operative në organizatat e sigurisë publike të cilat janë PK, IPK, SHKK, SHSK, Doganat dhe AME.

Objektiva e vendeve të punës është që t"iu mundësohet studentëve të mësojnë dhe kuptojnë parimet kryesore dhe metodat e punës në agjencion. Studentët do të hartojnë një raport lidhur me sistemin e menaxhimit, kornizën legjislative, funksionet kryesore dhe klientelën e organizatës nikoqire.

Ata do ta njohin zhvillimin e tyre profesional dhe mund ta vlerësojnë punën e tyre si dhe metodat të cilat zbatohen.

Ata mësojnë si ta përvetësojnë një qasje hetimore dhe të identifikojnë çështjet etike lidhur me mjedisin operativ.

**Mësimnxënia**

Studenti është në gjendje të:

- Përcaktojë dhe klasifikojë shërbimet publike;
- Përcaktojë funksionet kryesore të organizatave të sigurisë publike;
- Përcaktojë aktin administrativ dhe identifikimin e llojeve të tij;
- Analizojë llojet dhe format e kontrollit administrativ
- Përcaktojë bazën juridike dhe rregullative për organizatat nikoqire
- Hartojë raportin krahasues ndërmjet nikoqirit dhe organizatës vetanake
- Kuptojë dhe identifikojë aktet juridike

**Përmbajtja**

- Vlerat organizative
- Legjislacioni
- Strukturat organizative
- Mjedisi në organizatë
- Funksionet e organizatës
- Vendimmarrja në organizatë
- Kultura organizative
- Procedimet administrative

**Metodat**

- Detyrat mësimore për punë praktike
- Portofoli
- Udhëzimi nga mentori

**Metodat e vlerësimit:**

- Portofoli i punës praktike
- Raporti i punës praktike
- Raporti i Vetvlersimit
- Prezantimi i raportit të punës praktike në seminar

## L7. E Drejta Administrativ me Procedurë Administrative

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 5 ECTS |
| Orët në klasë: | 45 |
| Orët individuale: | 80 |
| Periudha: | Semestri 3 |
| Lloji i lëndes | Obligative |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Qëllimi i lëndës "E drejta administrative me procedure administrative" është që studentëve të vitit të parë të fakultetit të sigurisë publike t"iu ofroj njohuritë themelore lidhur me marrëdhëniet juridike administrative.

Në theks të veçantë kjo lëndë studentëve do t „iu mundësojë njohuri rreth organeve të administratës, shërbimeve publike, kontrollit admirativ, administratës publike në Kosovë, si dhe njohuri zhvillimit të procedurës administrative, konfliktit administrativ dhe procedurës kundërvajtëse.

**Mësimnxënia**
Studenti është në gjendje të:

- Jap kuptimin e marrëdhënieve shoqërore në përgjithësi dhe marrëdhënieve juridike administrative në veçanti;
- Dijë nocionin, parimet e punës dhe llojet e organeve të administratës;
- Të përkufizoj dhe klasifikoj shërbimet publike;
- Të kuptoj nocionin dhe llojin kompetencave administrative;
- Të njoh zgjidhjen e konflikti të kompetencave;
- Të kuptoj si fillon, si zhvillohet dhe si përfundon një procedim administrativ.

**Përmbajtja**

- Çështje të përgjithshme të së drejtës administrative;
- Organet e administratës;
- Kuptimi. Llojet dhe format e kontrollit
- Gjendja e administratës publike, me theks të veçantë të Kosovës
- Parimet themelore të procedurës administrative,
- Njohuri të përgjithshme rreth nocionit të kompetencës administrative, delegimit, zëvendësimit dhe zgjidhjes së konflikteve të kompetencës.
- Fillimi, zhvillimi dhe përfundimi i procedimit administrative
- Kuptimi i kundërvajtjeve dhe procedura kundërvajtëse.

**Metodat mësimore**
- Ligjërata
- Ushtrimet, demonstrimet, interpretimet, praktikat,
- Diskutime debutuese
- Punimet seminarike
- Puna në grup

**Metodat e vlerësimit**
- Teste me shkrim
- Vlerësime seminarike, detyrë shtëpie
- Vlerësim klase
- Provimi përfundimtar

**Literatura**

- Esat Stavileci, Agur Sokoli, Mirlinda Batalli, 2010: Administration, Control of the work of administration and its political responsibility, Computerization of administration, Prishtinë
- Ermir Dobjani, 2004: Administrative Law, Botues: SH.B.L.U, Tiranë,
- Prof. Esat Stavileci, Prishtinë 2005: Notions and principles of the public administration
- Prof. Agur Sokoli, Prishtinë 2009: Control of the work of administration and its political responsibility,
- Bajram Pollozhani, Esat Stavileci, Ermir Dobjani, 2001: Administrative Law in comparative aspects - Botues: Asdreni, Shkup

## L3. E Drejta Kushtetuese

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 70 |
| Periudha: | Semestri 3 |
| Lloji i lëndes | Obligative |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**
Qëllimi i lëndës mësimore është që studentët pas përfundimit të këtij kursi të fitojnë njohuri themelore në fushën e së drejtës kushtetuese dhe sistemit kushtetues të zbatueshëm në Kosovë. Pas mbarimit me sukses të lëndës, pritet që studentët të kenë fituar njohuritë mbi nocionet, dukuritë dhe rolin dhe funksionet e institucioneve kushtetuese të Kosovës. Lënda do t'u mundësojë studentëve të fitojnë kompetencë dhe shkathtësi në sektorin e sigurisë dhe në përputhje me Kapitullin II të Kushtetutës së Kosovës, të veprojnë duke garantuar të drejtat dhe liritë themelore kushtetuese.

**Mësimnxënia**
Studentët janë në gjendje të:
- Të kuptojë dhe njohin institucionet themelore juridike dhe politike të sistemit kushtetues,
- Të aplikojnë përvojat e fituara nga e drejta kushtetuese,
- Të zbatojnë njohuritë e tyre lidhur me të drejtat kushtetuese dhe qytetare, dhe respektimin e tyre në jetën e përditshme,
- Të kuptojë rolin e Kushtetutës ne garantimin e lirive dhe të drejtave themelore
- Të krahasojë liritë dhe të drejtat qytetare me sistemin juridik të Kosovës, me sistemin ndërkombëtar të mbrojtjes së këtyre të drejtave

**Përmbajtja**
- Kuptimi, rëndësia, objekti, metoda, përmbajtja dhe burimet e së drejtës kushtetuese;
- Kushtetuta si akt juridiko - politik i shtetit, klasifikimi i kushtetutave,
- Miratimi dhe ndryshimi i kushtetutave,
- Kushtetutshmëria dhe ligjshmëria, kontrolli dhe mbrojta e kushtetutshmërisë,
- Shteti dhe organet e pushtetit shtetëror,
- Të drejtat dhe liritë themelore kushtetuese
- Preambula dhe dispozitat themelore kushtetuese
- Kuvendi, Presidenti dhe Qeveria
- Sistemi i Drejtësisë,
- Gjykata Kushtetuese e Kosovës,
- Sektori i sigurisë
- Avokati i Popullit

**Metodat mësimore**
- Ligjërata,
- Ushtrimet,
- Demonstrimet,
- Interpretimet, praktikat,
- Diskutime debatuese,
- Punimet seminarike,
- Vetë hulumtim dhe hartime krijuese

**Metodat e vlerësimit:**
- Teste me shkrim
- Vlerësime seminarike
- Detyrë shtëpie; Vlerësim klase
- Provimi përfundimtar

**Literatura**


- Bajrami, A. (2011). *Sistemi Kushtetues i Republikës së Kosovës*. Universiteti i Prishtinës.
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës
- Ligji për Gjykatat dhe Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës
- Ligji për Presidentin
- Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës
- Ligji për Prokurorité

## H2. Shoqëria dhe Mirëqenia Sociale

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 50 |
| Orët individuale: | 50 |
| Periudha: | Semestri 3 |
| Lloji i lëndës: | Obligative |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Në kuadër të kësaj lënde studenti do të mësojë konceptet bazë siç janë: ç'eshtë shoqëria; ç'janë grupet shoqërore; cili është roli i individit në shoqëri; ç'është stratifikimi shoqëror, sjelljet konformiste dhe shmangëse, zanafilla e krimit sipas teorisë biologjike, psikologjike she sociologjike. Kjo lëndë do ju ofrojë informacion të gjerë studentëve lidhur me fuqin dhe autoritetin, tipet e autoritetit, burokracinë, modelet e organizimit të institucioneve institucioneve të sigurisë dhe ruajtjes së rendit Në kuadër të kësaj lënde studentët do të marrin informacion edhe për teoritë e ndryshme shkencore mbi shoqërinë, si teoria funksionaliste, teoria e konfliktit, strukturalizimi dhe fenomenologjia, te cilat bejne interpretime te ndryshme sa i perkete rolit të indvidit në shoqëri, organizimi i shoqërisë, funksionimi i institucioneve kryesore në shoqëri.organizimi shoqerore. Studentët do të njihen edhe me format bashkëkohore të organizimit të policimit në komunitet, luftimin e radikalizmit dhe ekstremizimit.

Ne kudaer te kesaj lende studentet do te njihen edhe me trajtimin shkencore te problemeve sociale si varferia, papunesia, pabarazia etj. Do të familjarizohen me konceptet baze te mireqenies sociale, me modelet e saj, me tipologjine e shtetit social, me programet e ndryshme sociale, si skemat e asistences sociale e te tjera, te cilat lidhen ndrejtperdrjte me solidaritetin dhe sigurine sociale ne shoqeri.

**Mësimnxënia**

Studenti është në gjendje të:

- Të zotëroje njohuri baze per shoqerine, llojet e saj, dhe raportin e saj me individin;
- Te zhvilloje njohuri rreth grupeve shoqerore, stratifikimit shoqerore, burokracise.
- Te analizoje shperndarjen e fuqise brenda shoqerise, autoritetin si dhe tipet e autoritetit.
- Te njihet me problemet e ndryshme sociale si varferia, papunesia, pabarazia.
- Te zhvilloje njohuri rreth mireqenies sociale, modeleve te saj ne regjion dhe bote, rendesise se saj ne ruajtjen e stabilitetit social, politik dhe ekonomik brenda nje shoqerie.
- Te njihet me teorite sociologjike dhe politike mbi interpretimin e rolit te individit dhe organizimit te shoqerise.

**Përmbajtja**

- Perkufizimi i koncepteve baze si: c‟eshte shoqeria, c‟jane grupet shoqerore;
- Stratifikimi shoqerore, roli I individit ne shoqeri;
- Fuqia, autoriteti dhe tipet e autoritetit ne shoqeri.
- Perkufizimi i koncepteve baze te mireqenies sociale dhe lojeve te saj,
- Problemet sociale, varferisa, papunesia dhe pabarazia.
- Solidariteti social dhe stabiliteti politik brenda nje shoqerie.
- Policimi në komunitet

**Metodat mësimore**

- Ligjëratat
- Puna grupore
- Interaktivitet

**Metodat e vlerësimit**

- Punim seminarik
- Test
- Aktiviteti në klasë
- Provim

**Literatura**


- Berg-Weger, Marla. Social Work and Social Welfare: An Invitation. Publisher: Routledge; 5th edition, 2019.
- Robson, William Alexander. Welfare State and Welfare Society: Illusion and Reality. Publisher: Routledge; 1st edition, July 20, 2018.
- Novak, Kenneth. Gary Cordner, Bradley Smith, Roy Roberg. Police & Society. Publisher: Oxford University Press; 8th edition, 2019..

## M5. Statistikë

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 70 |
| Periudha: | Viti 2 / Semestri 3 |
| Lloji i lëndës: | Obligative |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**
Lënda e statistikës përmban informata dhe njohuri të rëndësishme praktike dhe teorike dhe prezanton një pamje gjithëpërfshirëse të teknikave dhe metodave të ndryshme statistikore të rëndësishme për mbledhjen, grupimin dhe analizimin e të dhënave të ndryshme.

Objektivi i kursit të statistikës është që të ju mundësoi studentëve që gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve të fitojnë njohuri të mjaftueshme mbi rolin dhe rëndësinë e statistikës së përgjithshme lidhur me principet themelore, metodat dhe modelet statistikore dhe mënyrën e aplikimit të tyre në analizat e përgjithshme të problemeve shoqërore.

**Mësimnxënia**
Studenti është në gjendje të:
- Shpjegojnë kuptimin e statistikës, elementet e analizës statistikore, variablat kualitative dhe kuntitative si dhe mënyrat e vrojtimit statistikorë,
- Kuptojë llojet e grupimit statistikor, formojnë e seritë e distribucionit të frekuencave, prezantojnë grafikisht seritë e distribucionit të frekuencave, si dhe forma të tjera të paraqitjeve grafike.
- Llogarisë treguesit e ndryshëm të statistikes deskriptive dhe të bëjnë interpretimin e tyre
- Llogarisë dhe interpretojnë tregues të ndyrshëm të analizës dinamike, si indekset parametrat e trendit linear, eksponencial, etj
- Kuptojë konceptet bazë të teorisë së probabilitetit, qasjet, rregullat dhe metodat e llogaritjes së probabiliteteve të dy apo më shumë ngjarjeve.
- Analizojë ndërvarësinë midis dy variablave, të studiojnë lidhjen që ekziston midis tyre duke u bazuar në modelime të thjeshta, të analizojë lidhjet korrelative midis variablave

**Përmbajtja**
- Kuptimi dhe rëndësia e statistikës;
- Përmbledhja dhe grupimi i të dhënave statistikore - shpërndarja e frekuencave dhe paraqitjet grafike;
- Përmbledhja dhe grupimi i të dhënave statistikore - shpërndarja e frekuencave dhe paraqitjet grafike;
- Matësit e tendencës qendrore - madhësitë mesatare;
- Treguesit e variacionit dhe tregues të tjerë të përshkrimit të të dhënave;
- Një vështrim mbi konceptet bazë të probabilitetit;
- Numrat indeksorë;
- Analiza e regresionit dhe korrelacionit të thjeshtë linear;
- Analiza e regresionit dhe korrelacionit të thjeshtë linear; analiza e serive kohore dhe parashikimi;

**Metodat mësimore**
- Ligjërata, Ushtrimet, demonstrimet
- Prezantime individuale dhe grupore
- Demonstrime te rezultateve te hulumtimit ne SPSS

**Metodat e vlerësimit**
- Prezantime individuale dhe grupore
- Punim seminari
- Test mes‟semestral
- Provimi përfundimtar

**Literatura**

- Rahmije Mustafa - Topxhiu: Hyrje në statistikë, Prishtinë, 2016
- Prem S. Man, Introductory Statistics, Seventh Edition, John Wiley & Sons, 2010, USA,
- Milan Papiq, Statistika e aplikuar në MS Excel, përkthim nga kroatishtja, Kolegji Universitar “Victory”. Prishtinë, 2007

### H3. Lidershipi dhe menaxhimi i Burimeve Njerëzore

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 3 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 45 |
| Periudha: | Semestri 3 |
| Lloji i lëndës: | Zgjedhore |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Njohja e rëndësisë së zhvillimit të shkathtësive ndër-njerëzore të menaxherëve është e lidhur ngushtë me nevojën e organizatës për t‟i marrë dhe mbajtur zyrtarët më të mirë. Menaxherët i kryejnë punët përmes të tjerëve.

Ata duhet të jenë në gjendje t‟i alokojnë burimet dhe t‟i drejtojnë aktivitete e të tjerëve për t‟i arritur qëllimet organizative. Menaxherët i kryejnë punët nëpër organizata. Megjithatë, kultura organizative i rregullon raportet ndër-njerëzore dhe shtrirjen e kompetencave. Në bazë të lëndës mësimore studenti është në gjendje t‟i shprehë shkathtësitë e përgjithshme të lidershipit në kuptimin e organizatave të rendit dhe sigurisë.

**Mësimnxënia**

Studenti është në gjendje të:

- Shfrytëzojë dhe zbatojë teoritë e lidershipit në kuptimin e tyre organizativ,
- Analizojë dhe pasqyrojë sjelljen e vete të një lidershipi,
- Të ruajë dhe menaxhojë raportet profesionale me të punësuarit dhe motivojë nëpunësit ,
- Të menaxhojë dhe zgjidh konfliktet,
- T‟i bëjë vendimet konstruktive në organizata,
- Të hulumtojë lidhur me lidershipin dhe satisfakcionin në punë.

**Përmbajtja**

- Organizatat dhe kultura organizative: konceptet dhe struktura themelore,
- Teoritë e lidershipit,
- Grupet dinamike, bashkëveprimi dhe vendimmarrja ,
- Formulimi i punës dhe ekipeve,
- Teoritë bashkëkohore të motivacionit: nga konceptet drejt zbatimeve praktike,
- Matja e satisfakcionin në punë,
- Strategjitë dhe praktikat e MBNJ-ve,
- Ligji i punës ,

**Metodat mësimore**

- Ligjëratat
- Raste studimore
- Puna grupore

**Metodat e vlerësimit**

- Vet-vlerësim
- Punim i shkurtër hulumtues

**Literatura**


- Northouse, P. (2010): Leadership. Theory and Practise (5th edition). Sage Publishing
- Perry, J. (ed.) (2010): Public and Non-profit Leadership. Jossey-Bass.
- Robbins, S. & Judge T. (2012): Organizational Behavior (15th Edition). Prentice Hall.
- Schein, E. (2010): Organizational Culture and Leadership (4th edition). Jossey-Bas

## R2. Psikologjia e Stresit

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 3 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 45 |
| Periudha: | Semestri 3 |
| Lloji i lëndës: | Zgjedhore |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Lënda do të ofroj një shpjegim të marrëdhënieve midis faktorëve psikologjik dhe shëndetit apo sëmundjeve të trupit. Për këtë arsye, theksi do të vendoset në tematikat që kanë të bëjnë me stresin dhe aftësitë e përpunimit dhe përballimit të tij, mirëqenia psikologjike dhe cilësia e jetës, sjellja në sëmundje dhe varësia nga recetat, modifikimet e stileve jo të shëndetshme të jetesës, marrëdhënia psikolog-klient, reagimet fiziologjike dhe psikologjike.

**Mësimnxënia**

Studenti është në gjendje të:

- Të përkufizojë konceptet e stresit dhe të përshtatjes;
- Të përshkruaj diferencat individuale lidhur me reagimet ndaj stresit.
- Të përcaktojë faktorët psikologjik që ndikojnë në sëmundjet fizike.
- Të përshkruajë procesin e përballimit të stresit të orientuar në zgjidhjen e detyrës.

**Përmbajtja**

Stresi; Ç'është dhe çfarë e shkakton:

- Reagimet fiziologjike
- Reagimet psikologjike
- Stresorët
- Përcaktimi i stresit
- Përballimi i stresit
- Teknikat relaksuese
- Ndryshimi i mënyrave stresante të të menduarit
- Ndryshimi i sjelljeve stresante
- Administrimi i kohës
- Rezistimi më i mire i stresit

**Metodat mësimore**

- Ligjërata interaktive
- Diskutime individuale dhe grupore
- Prezantime, studim rasti

**Metodat e vlerësimit**

- Testi gjysmësemestral
- Testi semestral
- Prezantimi
- Pjesëmarrja dhe aktiviteti

**Literatura**


- Cavalcanti L, Azevedo S. (2013). Psychology of Stress: New Research, Nova Science
- Simo, P. (2008). Psikologjia e shendetit. Tirane, Albania: Dita.
- Simo, P. (2009). TrajtimiIsëmundjevepsikologjike. Tiranë, Albania: Dita.
- Morris, Ch&Maisto, A.(2008).Psikologjia.Tiranë, QendrapërArsimDemokratik.
- Karaj, Th.(1998). Psikologjia e stresit. Tiranë

## II. Drejtimi Policor - Studimet e specializuara

**Misioni, objektivat dhe administrimi**

**Misioni** – Drejtimi / Specializimi "Policor" është një nga 4 drejtimet / specializimet që ofrohen në kuadër të programi studimor "Siguri Publike". Ky drejtim / specializim është unik, i hartuar me kujdes të veçantë për studentët e punësuar në agjencinë e Policisë së Kosovës. Misioni i drejtimit / specializimit "Policor" është i harmonizuar dhe konsiston në misionin që ka programi studimor bachelor "Siguri Publike", përkatësisht ka për synim avancimin e shkathtësive dhe kompetencave profesionale të zyrtarëve policor, në funksion të rritjes së efikasitetit në sektorin e sundimit të ligjit.
Studimet në këtë drejtim / specializim i japin studentëve njohuri, shkathtësi dhe kompetenca të specializuara dhe të avancuara, në nivelin e parë të zbatimit të ligjit, duke përfshirë gjithashtu edhe menaxhimin efektiv në pozitat e zyrtarëve policorë të vijës së parë dhe të mesme të menaxhmentit.
Kurrikula e këtij drejtimi / specializimi është dizajnuar t'i përmbush nevojat e organizatës së policisë për ngritjen e kapaciteteve të tyre profesionale për gradat policore të përcaktuara me Ligjin nr. 04/L-076 për Policinë, përkatësisht për gradat policore: 'polic', polic i lartë', 'rreshter', 'toger', si dhe 'kapiten'. Në përputhje me misionin e drejtimit / specializimit, kurrikula e ofruar është mundësi e jashtëzakonshme për zyrtarët policor me gradën policore 'polic' dhe polic i lartë', që t'i zhvillojnë dhe avancojnë shkathtësitë dhe kompetencat e tyre profesionale për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive të punës, si dhe shërben si bazë e rëndësishme për t'i arritur gradat më të larta policore.
Kjo kurrikulë shërben në mënyrë të jashtëzakonshme edhe për zyrtarët policorë që shërbejnë si rreshterë, e që menaxhojnë p.sh. operacionet e përditshme rutinore, si dhe për toger dhe kapiten që punojnë në stacionet policore ose në administratë si planifikues ose në pozitat e tjera të ekspertit.
Lëndët e specializuara janë të krahasueshme me akademitë policore bashkëkohore që arsimojnë zbatuesit e ligjit. Këto lëndë kanë synim përgatitjen dhe aftësimin e zbatuesve të ligjit që përgjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësive të tyre të bazuara në kushtetutë dhe ligj, të kenë nivelin e përgatitjes më të lartë profesionale dhe aftësinë për të administruar me situatat ku kërkohen shkathtësi të veçanta veprimi.
Ky program i specializuar është i gërshetuar ndërmjet aspekteve operative dhe atyre menaxhuese, me çka krijohet ndërlidhje e veçantë ndërmjet nivelit veprues dhe atij menaxhues.
**Objektivat -** Synimi strategjik i AKSP/FSP, për drejtimin / specializimin "Policor" është të ofrojë arsim të lartë për nevojat e Policisë së Kosovës, bazuar në kërkime shkencore dhe njohuri kulturore për studentët që synojnë të arrijnë pozita të avancuara të punës në nivel ekspertësh, menaxherësh apo udhëheqësish, si dhe të mbështesë rritjen profesionale të secilit student dhe të promovojë të mësuarit gjatë gjithë jetës.
Drejtimi / specializimi "Policor" ka synime strategjike për përmbushjen e nevojave që ka organizata e policisë nëpërmjet zhvillimit dhe avancimit të shkathtësive dhe kompetencave në tri fusha kryesore

të veprimit dhe menaxhimit policor, përkatësisht në: **a) siguri publike**, **b) hetimi i krimeve**, dhe **c) menaxhimi i kufijve**.

Përmbajtja e programit përfshin njohuritë praktike të menaxhimit të koncepteve dhe parimeve të cilat janë thelbësore dhe të domosdoshme në operacionet, hetimet dhe çështjet kufitare të policisë. Studentët do të marrin njohuri për rolin e menaxherit ose të ekspertit në organizatën e policisë.

Qëllimi i programit është avancimi i shkathtësive dhe kompetencave profesionale për zyrtarët e policisë në pozitat e specializuara, përkatësisht pozitat menaxhuese, ashtu që ata të jenë në gjendje të zbatojnë ligjin, përkatësisht t'i kontrollojnë dhe komandojnë operacionet e policisë, t'i udhëheqin ekipet hetimore dhe ta menaxhojnë kufirin.

Efektiviteti në arritjen e objektivave të organizatës policore varet nga procesi menaxhues, që përbëhet prej tri faktorëve kryesorë: *të sjelljes, teknik* dhe *funksional*. *Faktorët e sjelljes* përfshijnë të gjitha llojet e komunikimit, të cilat merren me bashkëveprimin njerëzor në vendin e punës. *Faktorët teknik* përfshijnë shkathtësitë të cilat janë të njëjta për të gjitha agjencitë policore. Ato përfshijnë aftësinë për të hetuar krimet dhe aksidentet, si dhe të kryejnë procedurat policore rutinore, si p.sh. patrullimin parandalues. Këto shkathtësi si të tilla nuk janë synim i veçantë vetëm për nivelin specialistik, por janë edhe qëllim i mbikëqyrjes nga menaxheri. *Faktorët funksional* janë ata faktorë të cilët janë të përfshirë në arritjen e rezultateve të dëshirueshme. Ata janë menduar ta ndihmojnë menaxherin e policisë gjatë kontrollimit të operacioneve dhe aktiviteteve policore. Këta faktorë përfshijnë planifikimin, organizmin, vendim-marrjen, zgjedhjen e problemit dhe menaxhimin sipas objektivave.

Nga objektivat e përgjithshme të programit studimor "Siguri Publike" rrjedhin dhe objektivat specifikë për drejtimin / specializimin "Policor". Objektivat specifikë për këtë drejtim / specializim janë:

- *Avancimi i shkathtësive dhe kompetencave gjithëpërfshirëse, teorike dhe praktike, për kryerjen e detyrave dhe funksioneve të specializuara bazuar në nevojat e organizatës policore;*
- *Avancimi i shkathtësive dhe kompetencave gjithëpërfshirëse, teorike dhe praktike, për kryerjen e detyrave dhe funksioneve udhëheqëse dhe menaxheriale bazuar në nevojat e organizatës policore;*
- *Zhvillimi dhe avancimi i shkathtësive për të ndjekur trendët praktike nga të cilat sfidohet siguria publike, përkatësisht aftësia e reagimit adekuat dhe proporcional karshi këtyre zhvillimeve bazuar në nevojat e organizatës policore;*
- *Zhvillimi dhe avancimi i shkathtësive për t'iu përgjigjur detyrimeve ndërkombëtare në lidhje me sigurinë publike bazuar në nevojat e organizatës policore.*

**Administrimi -** Studenti i cili është regjistruar në programin studimor nëpërmjet organizatës së policisë, në semestrin e 4 orientohet në drejtimin policor. Gjatë ndjekjes së studimeve në drejtimin policor, studenti duhet të mbledh 140 ECTS kredi sikurse është paraparë me programin studimor. Struktura e lëndëve në drejtimin policor është e njëjtë përgjatë 4 semestrave, përkatësisht studenti

duhet t'i përfundojë me sukses lëndët obligative dhe një nga dy lëndët zgjedhore të ofruara për semestër. Në lëndët e specializuara studenti duhet t'i ndjek tri intershipet e parapara me program, bazuar në doracakun e intershipit. Në semestrin e fundit, studenti duhet të zgjedh temën e diplomës dhe mentorin për udhëheqje.

Për ta administruar me drejtimin/specializimin "Policor", Këshilli i FSP-së zgjedh një udhëheqës i cili i përgjigjet hierarkisë akademike të FSP-së dhe është përgjegjës për çështjet e kurrikulave mësimore, përkatësisht për implementimin e standardeve dhe procedurave që kërkohen për zbatimin dhe administrimin e programit në këtë drejtim studimor.

**Rezultatet e të nxënit në drejtimin / specializimin policor**

Pas përfundimit të studimeve në drejtimin / specializimin policor, i diplomuari:

- Kupton parimet e organizmit dhe planifikimit në organizatën e policisë dhe është i udhëzuar në aktivitetet dhe mbi vlerat themelore të organizatës policore dhe mbi standardet etike të një zyrtari policor;
- Udhëhiqet nga rregullat ligjore të zbatueshme të Republikës së Kosovës dhe nga të drejtat themelore dhe i zbaton ato në përputhje me detyrat e organizatës policore;
- Zbaton veprimtaritë kryesore të policisë në kryerjen e detyrave profesionale;
- Njeh fushën e çështjeve penale, të operacioneve, të sigurisë publike dhe kufijve, si dhe fushën e përgjegjësive të agjencive tjera dhe institucioneve të sektorit/sigurisë publike në punën policore dhe gjen zgjidhjet e nevojshme për problemet e shfaqura;
- Punon në mënyrë të pavarur, përkatësisht merr përgjegjësi për vendim-marrje në situatat e paparashikuara të punës dhe nëse është e nevojshme bashkëpunon dhe është në gjendje të punojë në një mjedis multi-kulturor;
- Përballon dhe menaxhon stresin, emocionet e tij dhe të njerëzve të tjerë dhe kujdeset për shëndetin e tij;
- Aftësia për të analizuar dhe parashikuar zgjidhje operative në çështjet e sigurisë dhe për të bashkëpunuar në ofrimin e sigurisë;
- Aftësia për të menaxhuar dhe kontrolluar metodat standarde, procedurat dhe proceset në aktivitetet e sigurisë dhe policisë.

## Struktura e kurrikulës për drejtimin / specializimin policor

| Lëndët dhe modulet | ECTS | Semestri |
|---|---|---|
| **Orientimi në fushën e policisë** | | |
| P1 Lidershipi dhe menaxhimi në organizatën e policisë | 4 | 4 |
| P5 Policimi dhe autorizimet policore | 4 | 4 |
| P4 Parandalimi i krimit | 4 | 4 |
| P3 E drejta e procedurës penale | 4 | 4 |
| *Lëndët zgjedhore:* | | |
| P2 E drejta penale ndërkombëtare | 4 | 4 |
| **Siguria publike** | | |
| P29 Kundërvajtjet dhe menaxhimi i trafikut | 4 | 7 |
| P8 Menaxhimi i krizave | 4 | 7 |
| P9 Menaxhimi dhe mbrojtja e informacionit | 4 | 5 |
| P10 Stresi dhe incidentet kritike në zbatimin e ligjit | 3 | 5 |
| *Lëndët zgjedhore:* | | |
| P13 Mbrojtja e të dhënave personale | 3 | 6 |
| P7 Menaxhimi i sigurisë publike | 3 | 7 |
| **Hetimi i krimit** | | |
| P15 Hetimi i krimit: parimet dhe praktika | 4 | 5 |
| P16 Krimi i organizuar | 5 | 7 |
| P18 Kriminalistika | 5 | 6 |
| P19 Anti-terrorizmi | 4 | 6 |
| P20 Analiza e inteligjencës | 4 | 6 |
| P21 Kriminologjia | 4 | 6 |
| *Lëndët zgjedhore:* | | |
| P17 Krimet financiare | 3 | 7 |
| R18 Viktimologjia | 4 | 5 |
| P23 Mjekësia ligjore | 4 | 5 |
| P28 Teknika kriminalistike | 3 | 6 |
| **Menaxhimi i kufijve** | | |
| P26 Menaxhimi dhe kontrolli i kufirit | 4 | 7 |
| P27 E drejta penale – pjesa e posaçme | 5 | 5 |
| *Lëndët zgjedhore:* | | |
| P25 Migrimi ilegal, të huajt dhe azili | 4 | 4 |
| **Periudhat e punës praktike (Intershipi)** | | |
| I8. Metodat dhe operacionet e punës në PK apo IPK | 20 | Viti i 2-të |
| I9. Organizimi në PK apo IPK | 20 | Viti i 3-të |
| I10. Menaxhmenti dhe lidershipi i avancuar në PK apo IPK | 25 | Viti i 4-të |
| Tema e diplomës | 15 | Pas vitit 4-të |

## P1. Lidershipi dhe menaxhimi në organizatën e policisë

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 70 |
| Periudha: | Semestri 4 |
| Lloji i lëndës: | Obligative |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Kjo lëndë ka synim që ta trajtojë *udhëheqjen* dhe *menaxhimin* si aftësi të ndara që duhet t'i ketë lideri apo menaxheri i suksesshëm në organizatën e policisë, duke ilustruar për studentët se si bashkohen të dy aftësitë për të përmirësuar efikasitetin individual dhe organizativ në polici. Studenti do të mund të dijë pse kanë rëndësi vendimet organizative dhe ndikimi që kanë ato në njësitë organizative dhe funksionale të organizatës. Qëllimi i lëndës është ofrimi i njohurive, shkathtësive dhe kompetencave në punën menaxheriale në organizatën policore. Përveç kësaj, lënda synon të fokusohet në rolin dhe përgjegjësitë e menaxherit në organizatën e policisë dhe kompetencat specifike të detyrave mbikëqyrëse në organizatë.

**Mësimnxënia**

Studenti është në gjendje të:

- Përshkruajë funksionet esenciale të organizatës së policisë ;
- Shpjegojë rolin e udhëheqësit dhe menaxherit;
- Planifikojë shkathtësitë dhe talentet e vartësve;
- Ilustrojë faktorët të cilët ndikojnë në mirëqenien e vendit të punës;
- Planifikojë, menaxhojë dhe të merr vendime dhe zgjidhë problemet efektivisht në zbatimin e ligjit;
- Shpjegojë mundësitë për bashkëpunimin policor në nivel ndërkombëtar;

**Përmbajtja**

- Hyrje në organizatat policore
- Struktura organizative e policisë
- Teoria organizative dhe organizatat e policisë
- Rekrutimi, trajnimi dhe mbajtja
- Motivimi dhe planifikimi i punës
- Lidershipi policor
- Lidershipi: fuqia dhe pajtueshmëria
- Stresi dhe djegia profesionale (burnout)
- Planifikimi strategjik dhe menaxhimi i projekteve
- Planifikimi dhe menaxhimi i buxhetit
- Implikimet organizative të inovacionit policor
- Matja e performancës individuale
- Aksidentet organizative dhe shpërndarja
- Çështjet bashkëkohore në organizatat policore
- Bashkëpunimi policor ndërkombëtar

**Metodat mësimore**

- Ligjërata, Ushtrime, demonstrime, interpretimet;
- Diskutime debatuese dhe puna në grup;
- Punimet seminarike dhe Vetë hulumtim.

**Metodat e vlerësimit**

- Prezantime individuale dhe grupore
- Punim seminari
- Test semestral dhe provim përfundimtar

**Literatura:**


- Christine Hess Orthmann & Shaun E. LaDue. (2015): Management and Supervision in Laë Enforcement. Publisher : Cengage Learning.
- Haberfeld, M. R. (2012): Police Leadership Organizational and managerial decision making process. Second Edition. Pearson
- Ronald G. Lynch & Scott R. Lynch (2017). The Police Manager. Publisher : Routledge; 8th edition. Thibault, E., Lynch, R. & McBride, B. (2007): Proactive Police Management. Pearson Prentice Hall

## P5. Policimi dhe autorizimet policore

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 70 |
| Periudha: | Semestri 4 |
| Lloji i lëndës: | Obligative |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Autorizimet policore rregullojnë veprimet policore që mund t'i ndërmarrin zyrtarët policor për t'i kryer detyrat e përcaktuara me ligj, përkatësisht të administrojnë me rendin publik brenda mandatit të tyre për përmirësimin e shëndetit, sigurisë, sjelljes dhe mirëqenies së përgjithshme të qytetarëve. Autorizimet policore përcaktohet sipas kornizës kushtetuese dhe ligjore. Qëllimi i kësaj lënde është që t'i njoftojë studentët për konceptin e policimit, autorizimet policore, teoritë dhe praktikat më të mira të policimit modern dhe mekanizmat e kontrollit dhe monitorimit të policisë. Do të elaborohen konceptet themelore të të kuptuarit të policimimit dhe të autorizimeve policore, metodologjinë dhe metodat e saj, si dhe funksionimin dhe mënyrat e zbatimit të autorizimeve policore.

**Mësimnxënia**

Studenti është në gjendje të:

- Shpjegojë rolin dhe konceptin e policisë në shoqëri duke i marrë parasysh të drejtat kushtetuese
- Përshkruajë konceptet themelore, nocionin dhe etikën të përfshira në autorizimet policore.
- Zbatojë autorizimet policore në mënyrë profesionale në të gjitha aktivitetet e policisë
- Zgjidh problemet në rastet konkrete të zbatimit të ligjit në cilësinë e policit
- Zbatojë procedurat përkatëse kur në ballafaqim janë personat që gëzojnë imunitet diplomatik, si dhe bagazhi i tyre

**Përmbajtja**

- Nocioni, historiku dhe strategjitë e policimit
- Policimi ne komunitet dhe i bazuar ne inteligjencë
- Problemet e rendit publik dhe profesionalizimi i Policisë
- Etika Policore
- Kontrolli dhe mbikëqyrja e Policisë
- Roli i policisë ne ruajtjen e rendit publik
- Zhvillimet dhe themelet e policimit modern
- Kompetencat e Policisë, ndalimi dhe kontrolli
- Kompetencat e Policisë në ndalim dhe arrestim
- Kompetencat e Policisë gjatë hyrjes dhe bastisjes së lokaleve dhe administrimi i provave
- Mekanizmat e kontrollit dhe monitorimit të policisë
- Privilegjet dhe Imunitetet Diplomatike – Imuniteti Personal, Imunitetet e përfaqësuesve diplomatike; Privilegjet e përfaqësuesve diplomatike;

**Metodat mësimore**

- Ligjërata, demonstrimet,
- Punimet seminarike
- Vetë hulumtim dhe hartime krijuese
- Puna në grup

**Metodat e vlerësimit**

- Prezantime individuale dhe grupore
- Punim seminari
- Test semestral
- Provimi përfundimtar

**Literatura**


- Jason-Lloyd, Leonard (2013). Introduction to Policing and Police Poëers. Publisher: Taylor and Francis.
- Michael Dean Reisig; Robert J Kane (2014). The Oxford handbook of police and policing. Publisher: Oxford University Press.
- Thomas, D. (2011): Professionalism in Policing, an Introduction. Delmar. Cengage Learning
- Villiers, P (2009): Police and Policing. Ëaterside Press
- Kodi i Procedurës Penale
- Ligji për Policinë dhe Ligji për Inspektoratin Policor të Kosovës
- Ligji për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror
- Ligji për sigurinë në komunikacionin rrugor dhe Ligji për rregullat e trafikut rrugor

## P3. E drejta e procedurës penale

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 70 |
| Periudha: | Semestri 4 |
| Lloji i lëndës | Obligativ |
| Lloji i vlerësimit | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Ky program mësimor mundëson përvetësimin e njohurive nga e drejta e procedurës penale, e cila si pjesë e shkencës juridiko penale, në kuptimin e gjerë i kontribuon luftës kundër kriminalitetit. I gjithë programi studimor nga lënda e procedurës penale, do të shtjellohet në aspektin teorik dhe atë praktikë (nëpërmjet ligjëratave, përpilimin e shkresave procedural – penale, seminareve, debateve dhe diskutimeve). Qëllimi i këtij programi është përgatitja dhe aftësimi i studenteve, që si shërbim policor me lehtësi të përballeni me sfidat e zgjidhjes së çështjeve me natyrë proceduralo-penale, të përpiloj me lehtësi shkresat procedurale, të adresojnë drejtë kalimin e çështjeve penale nga njëra faze e procedurës në tjetrën dhe kështu t'i kontribuojnë luftës parandaluese të kriminalitetit.

**Mësimnxënia**
**Studenti është në gjendje të:**

- Të zbatojë me saktësi parimet bazë te se Drejtës së Procedurës Penale të Kosovës.
- Të identifikojë detyrat dhe autorizimet e subjekteve themelore (gjykatës, prokurorit te shtetit dhe policisë) ne procedure penale.
- Të identifikojë fazat zhvillimit të procedurës penale sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.
- Të kuptojë instrumentet juridike dhe llojet e tyre sipas të Drejtës së Procedurës Penale të Kosovës.

**Përmbajtja:**

Njohuritë themelore për të drejtën e procedurës penale

- Lënda (objekti) e procedurës penale
- Palët proceduralo-penale
- Masat për sigurimin e të pandehurve në procedurën penale
- Procesi i të provuarit në procedurën penale
- Procedura parapenale dhe procedura paraprake
- Procedurat alternative
- Procedura penale kryesore dhe akuzimi
- Procedura me mjete juridike

**Metodat mësimore**

- Ushtrimet, demonstrimet, interpretimet, praktikat,
- Diskutime debatuese
- Punimet seminarike
- Vetë hulumtim dhe hartime krijuese
- Puna në grup

**Metodat e vlerësimit**

- Teste me shkrim
- Vlerësime seminarike,detyrë shtëpie
- Vlerësim klase
- Provimi përfundimtar

**Literatura**


- Sahiti E. dhe Murati R. (2016): E drejta e procedurës penale. Artini
- Kodi i Procedurës Penale i Republikë së Kosovë.
- Ligji për Gjykatat i Republikë së Kosovë.
- Kodi i Drejtësisë për të mitur i Republikë së Kosovë.
- Ligji për Gjykatën Kushtetuese i Republikë së Kosovë.
- Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës i Republikë së Kosovë.
- Ligji për Prokurorin e Shtetit i Republikë së Kosovë.
- Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës.
- Ligji për Avokatinë i Republikë së Kosovë.

## P4. Parandalimi i krimit

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 70 |
| Periudha: | Semestri 4 |
| Lloji i lëndës: | Obligative |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Parandalimi i krimit në pikëpamje të aplikimit kuptohet si tërësi masash, politikash dhe strategjish që zbatohen ndaj kriminalitetit me qëllim të mbrojtjes nga dukuritë e kundërligjshme, me qëllim të arritjes së mënyrës më efikase në luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit. Politika e parandalimit të kriminalitetit mund të kuptohet si sistem masash për parandalimin dhe luftimin me qëllim të mbrojtjes së shoqërisë nga kriminaliteti. Qëllimi i kësaj lënde është të njoftohen studentët me teknikat dhe metodat e parandalimit të krimit, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre gjatë ekzekutimit të aktiviteteve policore.

**Mësimnxënia**

**Studenti është në gjendje të:**

- Të fitojë njohuri parandalimin e krimit dhe për vlerësimin e kriminalitetit në përgjithësi dhe për rolin e sistemit institucional në parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit
- Të jetë në gjendje ti identifikojë dobësitë dhe përparësitë e sistemit institucional në parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit
- Analizoj shkaqet dhe faktorët e paraqitjes së kriminalitetit me qëllim të parandalimit dhe luftimit efikas të tij
- Hartojë strategji dhe të zbatojë programe bashkëkohore për parandalim dhe luftim të kriminalitetit
- Zbatojë njohuritë e fituara në parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit

**Përmbajtja:**

- Kuptimi dhe historiku i parandalimit të krimit
- Parimet dhe teoritë mbi parandalimin e kriminalitetit
- Tipologjia e parandalimit të kriminalitetit
- Bartësit kryesor të parandalimit të krimit
- Familja, shkolla dhe parandalimi i krimit
- Masmediat dhe parandalimi i krimit
- Policia dhe parandalimi i krimit
- Sistemi i drejtësisë dhe parandalimi i krimit
- Sanksionet penale dhe parandalimi i krimit
- Format e parandalimit dhe luftimit të kriminalitetit
- Parandalimi dhe luftimi i korrupsionit dhe terrorizmit
- Parandalimi terciar i krimit
- Strategjia kombëtare e parandalimit të krimit

**Metodat mësimore**

- Ligjërata
- Punë grupore
- Mësimi interaktiv/punishte
- Studime rasti

**Metodat e vlerësimit**

- Prezantime individuale dhe grupore
- Punim seminari
- Test mes'semestral
- Provimi përfundimtar

**Literatura**


- Latifi, V., Elezi, I. & Hysi, V. (2012) Politika e luftimit të kriminalitetit. Juridika.
- Lab, S. (2016). Crime Prevention: Approaches, Practices, and Evaluations. Publisher: Routledge.
- Schneider, S. (2009). Crime Prevention: Theory and Practice. Paperback.
- Strategjia shtetërore për parandalimin e krimit e Kosovës.

## P2. E drejta penale ndërkombëtare

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 70 |
| Periudha: | Semestri 4 |
| Lloji i lëndës | Zgjedhore |
| Lloji i vlerësimit | Diferencuar |

### Hyrje në lëndën mësimore

Qëllimi i kësaj lënde është që t'iu ofrohet studentëve njohuri lidhur me parimet themelore, funksionin mbrojtës, analizën e trendit dhe dinamikat e të drejtës penale ndërkombëtare, përkatësisht krimet e gjenocidit, krimet kundër njerëzimit, krimet e luftës, krimet kundër paqes, terrorizmi, trafikimi me qenie njerëzore, kontrabanda me armë, me narkotikë, pastrimi i parasë, korrupsioni, delikuenca e të miturve, shkelja flagrante e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, vrasjet nga motive te ndryshme, fenomen këto që po e përcjell shoqërinë njerëzore në vazhdimësi, mund t'i kundërvihemi me sukses, jo vetëm me mekanizmin e preventivës dhe represionit, por edhe me thëllimin e studimeve rreth njohjes së shkaqeve dhe rrethanave që kushtëzojnë këtë fenomen negativ në relacione kombëtare-shtetërore dhe ndërkombëtare.

### Mësimnxënia

**Studenti është në gjendje të:**

- Demonstrojë njohuri të mjaftueshme lidhur me përkufizimin dhe entitetet e të drejtës penale ndërkombëtare
- Identifikojë karakteristikat e të drejtës penale ndërkombëtare
- Analizojë perspektivat e të drejtës penale ndërkombëtare
- Të njoh juridiksionin e së drejtës penale ndërkombëtare në raport me të drejtën nacionale
- Të njoh format e bashkëpunimit policor dhe organizata ma të rëndësishme ndërkombëtare të policisë
- Të kuptojë procedurat (ekstradimit, tarnsferit, njohjes dhe ekzekutimit të aktgjykimeve të huaj) rreth formave të ndihmës penale ndërkombëtare

### Përmbajtja

- Burimet, parimet themelore, nocioni, subjekti dhe funksioni i të drejtës penale ndërkombëtare
- Aktualiteti dhe funksioni mbrojtës i të drejtës penale ndërkombëtare
- Kontributi i të drejtës penale ndërkombëtare në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në fushën e të drejtës penale ndërkombëtare.
- Gjykatat penale ndërkombëtare – Gjykata penale për ish – Jugosllavin, Ruandë dhe Gjykata e Përhershme Penale
- Nocioni, karakteristikat dhe format e ndihmesës ndërkombëtare penalo-juridike
- Burimet juridike të ndihmesës ndërkombëtare penalo-juridike në kuptimin e gjerë
- Procedurat dhe pengesat për ekstradimin e personave te akuzuar ose të dënuar
- Bashkëpunimi policor ndërkufitar
- Veprat penale, përgjegjësia penale dhe sanksionet penale në të drejtën penale ndërkombëtare

### Metodat mësimore

- Ushtrimet, demonstrimet, interpretimet,
- Diskutime debatuese
- Punimet seminarike
- Vetë hulumtim dhe hartime krijuese
- Puna në grup

### Metodat e vlerësimit

- Teste me shkrim
- Vlerësime seminarike, detyrë shtëpie
- Vlerësim klase
- Provimi përfundimtar

### Literatura


- Salihu, I. (2016). E Drejta Penale Ndërkombëtare. UBT.
- Gasser, H. (2000). E drejta ndërkombëtare humanitare. Gjenevë.
- Statuti i Gjykatës penale ndërkombëtare për ish Jugosllavi, 1993.
- Statuti i Gjykatës penale ndërkombëtare për Ruandën, 1994.
- Statuti i Romës për Gjykatën e përhershme penale ndërkombëtare, 1998.
- Konventat e Gjenevës (1949)
- Konventat e Hagës.

## P25. Migrimi ilegal, të huajt dhe azili

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 70 |
| Periudha: | Semestri 4 |
| Lloji i lëndës: | Zgjedhore |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

### Hyrje në lëndën mësimore

Qëllimi i kësaj lënde mësimore është që studentët të marrin njohuri dhe të fitojnë shkathtësi dhe kompetencë për çështjet që kanë të bëjnë me migrimin e parregullt, procedurat ligjore në lidhje me azilkërkuesit dhe shtetasit e huaj për qëndrim në Republikën e Kosovës dhe çështjet e trafikut me njerëz dhe rreziqet që dalin nga aktivitetet ilegale.

### Mësimnxënia

Studenti është në gjendje të:

- Identifikojë karakteristikat e migrimit të parregullt
- Zbatojë procedurat për azilkërkuesit, të huajt, personat pa shtetësi dhe të tjerët
- Zbatojë kërkesat ligjore dhe llojet e qëndrimit të shtetasve të huaj në vend
- Procedojë rastet pranë organeve kompetente
- Përdor mjetet teknike dhe udhëheq procedurat sipas udhëzimeve ligjore dhe rregullave standarde në raport me personat që ballafaqohet gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare
- Të analizojë rreziqet e trafikimit me qenie njerëzore me rastin e kalimi legal të kufirit

### Përmbajtja

- Kuadri ligjor për migracionin, azilin dhe të huajt
- Bashkëpunimi ndërkombëtar me agjencitë përkatëse kundër migrimit ilegal dhe trafiqeve
- Strategjitë kundër migracionit të paligjshëm dhe mekanizmat e kontrollit operacional,
- Respektimi i lirisë së lëvizjes dhe rreziqet
- Kalimi ilegal i kufirit dhe deportimi
- E drejta e azilit, procedura, deportimi, strehimi, të drejtat dhe detyrimet e azilantit
- Parimi i mos-dënimit
- Regjimi i migrimit i BE-së
- Te huajt dhe procedurat ligjore ndaj tyre ne shtetin transit ose te destinimit
- Refugjatët, azili dhe rreziqet e trafikut me njerëz
- Masat preventive dhe represive kundër migrimit ilegal dhe trafikut me njerëz

### Metodat mësimore

- Ligjëratat; Ushtrimet, demonstrimet; Diskutime debatuese; Punimet seminarike; Vetë hulumtim dhe hartime krijuese; Puna në grup

### Metodat e vlerësimit

- Prezantime individuale dhe grupore; Punim seminari; Test semestral; Provimi përfundimtar

### Literatura


- Handbook on European laë relating to asylum, borders and immigration (2013). European Union Agency for Fundamental Rights. Council of Europe.
- Gruda, Zejnullah (2010).Mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut. Botues: UBT.
- Baseline study on cross-border mobility in the OSCE region, 2014 OSCE.
- Ligji për azil i Republikës së Kosovës.
- Ligji për të huajt i Republikës së Kosovës.

## P27. E Drejta e Penale – Pjesa e Posaçme

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 5 ECTS |
| Orët në klasë: | 45 |
| Orët individuale: | 80 |
| Periudha: | Semestri 5 |
| Lloji i lëndës | Obligativ |
| Lloji i vlerësimit | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Qëllimi i kësaj lënde është fitimi i njohurive themelore në lidhje me të drejtën penale të posaçme e cila i studion veprat penale me elementet e tyre si dhe përcakton dimensionin mbrojtës penalo-juridik të vlerave dhe të mirave themeloret të njeriut. Ky program mësimor mundëson përvetësimin dhe thellimin e njohurive nga e drejta penale, e cila si pjesë e shkencës juridiko penale, në kuptimin e gjerë I kontribuon luftës kundër kriminalitetit.

**Mësimnxënia**

**Studenti është në gjendje të:**

- Të kuptoj sistemim e veprave penale sipas Kodit Penal të Kosovës
- Të kuptojë objektin grupor , të përbashkët të secilit kapitull të veprave penale;
- Të njohë objektin mbrojtës
- Të identifikoj elementet konstituive të natyrës objektive veprës penale
- Të analizoj elementet subjektive të veprës penale
- Të përcaktoj rrethin e kryerësve
- Të analizoj format e ndryshme t

**Përmbajtja:**

- Nocioni dhe lënda e pjesës së posaçme të së drejtës penale;
- Metodat dhe sistemi i pjesës së posaçme;
- Veprat penale kundër Kosovës dhe banorëve të saj
- Veprat penale kundër të drejtës ndërkombëtare
- Veprat penale kundër jetës dhe trupit
- Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut
- Veprat penale kundër integritetit seksual
- Veprat penale kundër martese dhe familjes
- Veprat penale kundër të drejtë

**Metodat mësimore**

- Ushtrimet, demonstrimet, praktikat;
- Diskutime debutuese;
- Punimet seminarike;
- Vetë hulumtim dhe puna në grup.

**Metodat e vlerësimit**

- Teste me shkrim
- Vlerësime seminarike, detyrë shtëpie
- Vlerësim klase
- Provimi përfundimtar

**Literatura**


- Salihu, I. (2014). E Drejta Penale – Pjesa e Posaçme. Prishtinë.
- Salihu, I., Zhitija, H., & Hasani, F. (2014). *Komentar i Kodit Penal të Kosovës*. GIZ.
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës.

## P9. Menaxhimi i sigurisë së informacionit

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 70 |
| Periudha: | Semestri 5 |
| Lloji i lëndës: | Obligative |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Menaxhimi i sigurisë së informacionit paraqet grup praktikash dhe masash që synojnë të mbajnë të sigurta të dhëna fizike apo elektronike nga ndërhyrjet ose ndryshimet e paautorizuara që synohet të bëhen tek të dhënat që ruhen apo që transmetohen. Qëllimi kryesor i kësaj lënde është që studentëve tu ofrojë njohuri dhe kompetencë të menaxhimit të sigurisë së informacionit, përkatësisht me dobësitë dhe kërcënimet e sistemeve ekzistuese të sigurisë së informacionit dhe për t'u aftësuar të hartojnë dhe të zhvillojnë sistemet e sigurta të sigurisë së informacionit. Gjithashtu do të njoftohen për konceptet themelore, kërcënimet, modelet, çështjet ligjore, apo konceptet e qasjes themelore të kontrollit nga siguria e informacionit.

**Mësimnxënia**

Studenti është në gjendje të:

- Përshkruaj karakteristikat kryesore të sigurisë së informacionit;
- Shpjegojë kategoritë dominuese të kërcënimeve ndaj sigurisë së informacionit;
- Diskutojë karakteristikat kryesore të udhëheqjes dhe menaxhimit;
- Përshkruajë rëndësinë e rolit të menaxherit në sigurimin e burimeve të informacionit të një organizate;
- Dallojë menaxhimin e sigurisë së informacionit nga menaxhimi i përgjithshëm i organizatës;

**Përmbajtja**

- Hyrje në menaxhimin e sigurisë së informacionit
- Pajtueshmëria: ligji dhe etika
- Administrimi dhe planifikimi strategjik për sigurinë
- Politika e sigurisë së informacionit
- Zhvillimi i programit të sigurisë
- Menaxhimi i rrezikut: vlerësimi i rrezikut
- Menaxhimi i rrezikut: trajtimi i rrezikut
- Modelet e menaxhimit të sigurisë
- Praktikat e menaxhimit të sigurisë
- Planifikimi për paparashikueshmëritë
- Mirëmbajtja e sigurisë
- Mekanizmat e mbrojtjes

**Metodat mësimore**

- Ligjërata, ushtrime dhe demonstrime
- Diskutime dhe punë në grup
- Punim seminari
- Vetë hulumtim.

**Metodat e vlerësimit**

- Prezantime individuale dhe grupore
- Punim seminari
- Test semestral
- Provimi përfundimtar

**Literatura**


- Michael E. Whitman, Herbert J. Mattord (2018). Management of Information Security. Sixth Edition. Publisher: Cengage Learning.
- Michael E. Whitman, Herbert J. Mattord (2011). Principles of Information Security. The fourth edition. Publisher: Course Technology.
- Ligji për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë i Republikës së Kosovës.

## P15. Hetimi i krimit: parimet dhe praktika

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 70 |
| Periudha: | Semestri 5 |
| Lloji i lëndës: | Obligative |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Kjo lëndë është gërshetim i trajtimit të ligjit, procedurave dhe standardeve ligjore në njërën anë dhe praktikës së operimit në situatat konkrete, në anën tjetër. Kjo lëndë trajton autorizimet ligjore të hetuesit, prokurorit dhe gjyqtarit në menaxhimin e hetimit të krimit dhe veprimet praktike që duhet t'i ndërmarrin ata përgjatë veprimeve hetimore. Lënda u ofron zbatuesve të ligjit një spektër të gjerë dhe të përshtatshëm të njohurive dhe shkathtësive profesionale, duke u krijuar mundësi për të arritur kompetencë të nevojshme për ta njohur teorikisht ligjin dhe për ta zbatuar atë praktikisht në mënyrë efektive. Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të mësojnë për ndërlidhjen e ligjit dhe zbatimin e tij korrekt në praktikë, për të përmbushur objektivat e përmbajtjes së kësaj lëndë, përkatësisht rezultatet e mësim-nxënies.

**Mësimnxënia**

Studenti është në gjendje të:

- Menaxhojë hetimet penale si një udhëheqës hetimor në krimet e ndryshme;
- Zbatojë procedurat e përgjithshme të hetimit duke përfshirë hapat që nevojiten të ndërmerren për hetimin e rasteve penale;
- Përdorë metodat e intervistimit në përputhje me rrethanat;
- Zbatojë procedurat dhe praktikat e marrjes në pyetje, masave të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit, identifikimit, kontrollit dhe konfiskimit;
- Udhëheq në mënyrë të pavarur në hetime, duke hetuar raste të veprave penale të ndryshme;

**Përmbajtja**

- Autorizimet ligjore të gjyqtarit, prokurorit dhe policisë në procedurën parapenale dhe penale;
- Etika dhe integriteti në hetime;
- Menaxhimi i fillimit të hetimeve;
- Procedura dhe praktika e zbatimit të masave të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit
- Procedura dhe praktika e zbatimit të kontrollit dhe konfiskimit;
- Procedura dhe praktika e marrjes së provave para ngritjes së aktakuzës;
- Procedura dhe praktika e marrjes në pyetje e të pandehurit dhe dëshmitarit;
- Menaxhimi dhe praktika e mbrojtjes së të dëmtuarve dhe dëshmitarëve;
- Procedura dhe praktika e identifikimit dhe arrestimi i të dyshuarve;
- Menaxhimi dhe zbatimi i masave të sigurisë;

**Metodat mësimore**

- Ligjërata, ushtrime dhe demonstrime
- Diskutime dhe punë në grup
- Punim seminari dhe Vetë-hulumtim.

**Metodat e vlerësimit**

- Prezantime individuale dhe grupore
- Punim seminari
- Test semestral dhe provim përfundimtar.

**Literatura**


- Sahiti E. dhe Murati R. (2016). E drejta e procedurës penale. Artini.
- Fisher B. and Fisher D. (2012): Techniques of Crime Scene Investigation. Taylor & Francis
- Peter Stelfox (2009). Criminal Investigation: An introduction to principles and practice. Routledge.
- Hess, K., Hess, M & Orthmann, C. (2011). Criminal Investigation in Police Operations: Theory and Practice. Delmar. Cengage Learning.
- Kodi i Procedurës Penale dhe Ligji për Policinë i Republikës së Kosovës.

**P10. Stresi dhe incidentet kritike në zbatimin e ligjit**

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 3 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 45 |
| Periudha: | Semestri 5 |
| Lloj i lëndës; | Obligative |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Zyrtarët e zbatimit të ligjit kanë shumë të përbashkëta. Shumica janë të përkushtuar ndaj idealeve "Shërbim dhe Mbrojtje" dhe rrezikojnë jetën e tyre në shërbim të komunitetit të tyre. Lënda: "Stresi dhe incidentet kritike në zbatimin e ligjit" është projektuar për të siguruar informacion konciz dhe praktik për zyrtarët që kanë përjetuar incidente kritike. Lënda, gjithashtu përfshin informacion të dobishëm për agjencionin policor për të planifikuar dhe zhvilluar protokollet e incidentit kritik.

**Mësimnxënia**

**Studenti është në gjendje të:**

- Të kuptojë nocionet, konceptet kyçe që lidhen me stresin dhe incidentet kritike;
- Të përshkruaj, diskutoj dhe debatoj për ngjarjet stresuese pa paragjykim dhe njëanshmëri;
- Të identifikojnë dhe formulojnë problemet që ndikojnë në zgjidhjen e problemit të menaxhimit të situatës traumatike;
- Të vlerësoj rëndësinë e shërbimeve psikologjike në ndryshimin e gjendjes psikologjike pas situatave kritike;
- Të jetë në gjendje të zbatoj teknikat e psikohigjienës si preventiv nga djegia profesionale;

**Përmbajtja**

- Stresi, reagimet fiziologjike dhe psikologjike
- Incidentet kritike dhe traumatike
- Rreziku, Stresoret e rrezikshëm, dhe konfrontimi
- Stresi post-traumatike, PTSD
- Ceshtjet e incidenteve kritike, strategjite, dhe konceptet
- Informacionet per reflektim ndaj incidentit
- Stresi traumatik: shoku, ndikimi dhe sherimi
- Faktorët ndikues për vetë-vrasje në mesin e zyrtarëve policor
- Trauma: Historia kronologjike dhe historia psikologjike
- Crregullimet ne lidhje me stresin – DSM
- Te kuptuarit e kufinjeve professional dhe psikohigjena

**Metodat mësimore**

- Ligjërata interaktive
- Diskutime
- Punë grupore edhe individuale
- Role – play (luajtja e rolit) dhe raste studimore.

**Metodat e vlerësimit**

- Testi gjysmësemestral
- Testi semesstral
- Prezantimi
- Pjesëmarrja dhe aktiviteti

**Literatura**


- Jack A. Digliani, PhD, EdD (2012), Laë Enfrocement Critical Incident Handbook
- Huber, M. (2013). Trauma the pasojat. Diakonie: Prishtine
- Huber, M. (2016).Trauma dhe trajtimi i Traumës. Diakonie: Prishtinë

## R18. Viktimologjia

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 70 |
| Periudha: | Semestri 5 |
| Lloji i lëndës | Zgjedhore |
| Lloji i vlerësimit | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Viktimologjia është fushë shkencore qe studion demet, fizike, emocionale dhe financiare te njerëzve si shkak i aktiviteteve ilegale. Viktimologjia më së shumti studion vuajtjet dhe dhimbjen e viktimave. Qëllimi kryesore i kësaj lënde është t'i njoftoj dhe t'i familjarizoj studentët me njohurit rreth viktimave të krimit, shkallen e viktimizimit, shkallën e përgjegjësisë së viktimave ne viktimizim. Të sqaroj viktimat primare dhe sekondare, të trajtoj vuajtjet dhe dhimbjen e viktimave në mënyrë objektive dhe subjektive. Kjo lende trajton viktimat dhe llojet e tyre, si dhe lidhshmëria e viktimave me kriminelët.

**Mësimnxënia**

**Studenti është në gjendje të:**

- Evaluon termet kryesore dhe çështjet kryesore te viktimologjisë;
- Analizoj teoritë e viktimizimit;
- Evaluon format e viktimizimit dhe pasojat e viktimizimit;
- Ofroj zgjidhje për problemet që kanë të bëjnë me viktimizimin dhe sistemin e drejtësisë.

**Përmbajtja**

- Hyrje ne viktimologji
- Hetimi dhe zbulimi i viktimave
- Burimet dhe informatat rreth viktimave
- Krimet e dhunshme, vrasjet dhe rrëmbimet
- Kontributi i viktimave ne krim
- Viktimat dhe sistemi i dritësisë
- Fëmijët si viktima
- Viktimat e dhunës nga të dashurit dhe anëtarët e familjes
- Viktimat e dhunimeve dhe akteve tjera seksuale
- Grupet e viktimave me probleme të veçanta
- Vjedhja e identitetit dhe mashtrimet kibernetike
- Viktimat e vendit te punës
- Viktimat ne shekullin 21
- Viktimat e sulmeve ne trafik
- Viktimat dhe pikëpamjet e tyre

**Metodat mësimore**

- Ligjërata dhe diskutime
- Punime grupore dhe individuale
- Vizita studimore
- Seminare, teste dhe kuize

**Metodat e vlerësimit**

- Test me shkrim
- Punime
- Test semestral dhe provimi përfundimtar
- Diskutime intensive

**Literatura**


- Andrew Karmen( 2021), Crime Victims: An introduction to Victimology (9th ed,)
- Ferid Azemi (2014) Criminal Justice and Laë Enforcement Practices. (1st ed).
- Ferid Azemi (2013) Mental disorders, violence, pedophilia and child molesting (Manual).

**P23. Mjekësia ligjore**

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 70 |
| Periudha: | Semestri 5 |
| Lloji i lëndës: | Zgjedhore |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Mjekësia Ligjore është shkencë e veçantë, e cila organeve të hetuesisë u ndihmon në zgjedhjen dhe njohjen me karakter biologjikë dhe mjekësorë, në zbulimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përcaktimin e vdekjes, mekanizmin të saj, shkakun e vdekjes, parandalimin e shumë sëmundjeve, përgjegjshmërinë dhe papërgjegjshmërinë penale të të akuzuarve etj. Qëllimi i lëndës është që studentët të kenë njohuri rreth metodave në ndihmë të organeve të hetimit dhe të gjykimit në luftën ndaj kriminalitetit. Lënda mëson teknikat dhe metodat e zbulimit të gjurmëve, nëpërmjet autopsisë për të përcaktuar shkakun e vdekjes, mjeteve dhe mekanizmave me të cilat është realizuar krimi, dhe me fakte shkencore të argumentohet autori i veprës penale.

**Mësimnxënia**

Studenti është në gjendje të:

- Kuptojë se cila është përmbajtja dhe metodat mjekësisë ligjore,
- Përshkruajë teknikat dhe metodat e zbulimit të gjurmëve, etj. Zbulojë, fotografojë, fiksojë provat përmes trupit te viktimës nga ana e eksperteve të mjekësisë ligjore dhe
- Arkivojë dokumentet e mjekësisë ligjore
- Dije lidhur me vdekjen, shkakun e vdekjes dhe mekanizmin e vdekjes.
- Kualifikoje lëndimet trupore dhe e përshkrimin e certifikatave mjekësore.
- Dij njohuritë e nevojshme lidhur me obligimet ligjore te njerëzve ne pune, si dhe përgjegjësitë penale te mjekeve ne raste te shkeljeve mjekësore

**Përmbajtja**

- Objekti i studimit dhe detyrat e shkencës së mjekësisë ligjore;
- Vdekja dhe ndryshimet pas vdekjes;
- Ekspertimet mjekoligjore të kufomës;
- Traumatologjia mjeko-ligjore;
- Lëndimet mekanike;
- Toksikologjia mjeko-ligjore;
- Psikologjia mjekësore;
- Psikopatologjia mjekoligjore (special dhe klinike);
- Identifikimi i provave materiale dhe individëve (metodat);
- Veprat penale kundër shëndetit dhe përgjegjësitë ligjore të personelit mjekësorë;
- Deliktet seksuale;
- Komentet mjeko-ligjore në ligjin penal

**Metodat mësimore**

- Ligjerata;
- Ushtrimet, demonstrimet, interpretimet, praktikat;
- Diskutime debatuese;
- Punimet seminarike

**Metodat e vlerësimit**

- Teste me shkrim;
- Seminare;
- Detyrë shtëpie;
- Vlerësim klase;
- Provimi përfundimtar

**Literatura**


- Blakaj, Flamur (2019). Mjekësia ligjore. Prishtinë.
- Bardhyl Çipi, Naim Haliti, Admir Sinamati (2017). Mjekësia ligjore. Universiteti i Prishtinës.
- Wyatt, J., Squires, T., Norfolk, G. & Payne-James, J. (2011): Oxford Handbook of Forensic Medicine, Oxford University Press,

**P18. Kriminalistika**

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 5 ECTS |
| Orët në klasë: | 45 |
| Orët individuale: | 80 |
| Periudha: | Semestri 6 |
| Lloji i lëndës: | Obligative |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Qëllimi kryesor i kësaj lënde është që studentët të marrin njohuri dhe shkathtësi kriminalistike nga taktika dhe metodika, në funksion për zbulimin, sqarimin dhe të provuarit e veprave penale. Ky modul trajton edhe mjetet teknike, taktike dhe rekomandimet metodike kriminalistike në përputhje me legjislacionin penal materiale, atë procedural, si dhe akte të tjera ligjore në zbatim të ligjit.

**Mësimnxënia**

Studenti është në gjendje të:

- Kuptojë nocionin, funksionet dhe parimet e kriminalistikës;
- Zbatojë metodat e organizimit te punës së organit procedues në hetimin e llojeve të ndryshme te veprave penale;
- Dokumentojë motivet e kryerjes së veprave penale dhe mënyrat e kryerjes së tyre;
- Bashkëpunojë në nivel ndërkombëtar për shkëmbimin e informacioneve në funksion të luftës efikase kundër krimit;
- Zbulojë veprën penale duke përdorur njohuritë dhe shkathtësitë kriminalistike.

**Përmbajtja**

- Kuptimi dhe parimet e kriminalistikës;
- Pyetjet e arta të kriminalistikës;
- Sistemi i ndarjes së kriminalistikës
- Bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e kriminalistikës kundër kriminalitetit;
- Kuptimi, bazat shkencore dhe sistemi i taktikës kriminalistike;
- Taktika e marrjes së masave operative;
- Veprimtaria informative;
- Indiciet, versionet kriminalistike;
- Taktika e zbulimit të motivit;
- Patrullimi, vëzhgimi, prita, bastisja dhe veprimtaria e gjurmimit;
- Taktika e ballafaqimit me njohje të të dyshuarve, dëshmitarëve dhe sendeve;
- Metodika e zbulimit dhe e sqarimit të veprave penale të veçanta.

**Metodat mësimore**

- Ligjërata, ushtrime, demonstrimet;
- Diskutime debutuese;
- Punimet seminarike;
- Vetë hulumtim dhe hartime krijuese.

**Metodat e vlerësimit**

- Prezantime individuale dhe grupore;
- Punim seminari;
- Test mes'semestral;
- Provimi përfundimtar.

**Literatura**


- Latifi, V. & Demolli, H. (2019). *Kriminalistika*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.
- Saferstein, Richard (2014). *Kriminalistika: Një hyrje në shkencat ligjore*. Shkup: Tabernakul.
- Orthmann, Christine M. H.;Hess, Kären M (2010). *Criminal investigation*. Publisher: Delmar, Cengage Learning.
- Korajlić, N. & Muharremi, D. (2009). Kriminalistika. Prishtinë: Riinvest.

## P21. Krimonologjia

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 70 |
| Periudha: | Semestri 6 |
| Lloji i lëndës: | Obligative |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Qëllimi kryesore i kësaj lënde është t'i familjarizoj studentët me shkaqet e krimit dhe teoritë e krimit, duke u përqendruar në parandalimin e krimit. Studentët do të zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik, që do të aplikohet për të diskutuar perspektivat teorike të krimit. Kjo lëndë do t'i pajis studentët me aftësi për ta trajtuar krimin në mënyrë kritike. Kriminologjia si shkencë multidisiplinare do të ketë në fokus dimensionet shkencore të të menduarit rreth krimeve. Lënda trajton të gjitha format dhe shkaqet e krimit nga konteksti klasik, biologjik, psikologjik dhe social. Lënda sqaron trajtimin e krimit nga konteksti historik, e deri tek qasja në kohen bashkëkohore. Metodat shkencore te sqarimit te krimit me raste studimi do te përfshihen ne këtë lende.

**Mësimnxënia**

**Studenti është në gjendje të:**

- Evaluon çështjet sociale dhe kriminologjike si dhe adresimin e këtyre çështjeve;
- Analizon sjelljet kriminale, shkaqet dhe masat parandaluese;
- Implementon strategjinë parandaluese dhe strategjinë e luftimit të krimit në përgjithësi;
- Përpilojë programe dhe projekte hulumtuese në fushën e kriminologjisë;
- Analizon krimet jake-bardha dhe teoritë e krimeve jake-bardha.

**Përmbajtja**

- Hyrje ne Kriminologji
- Tipologjitë e krimit.
- Rrënjët biologjike te krimit
- Elementet psikologjike dhe psikiatrike të sjelljeve devijante
- Abuzimi i fëmijëve
- Teoritë sociale te krimit
- Teoria e frenimit
- Vrasjet serike
- Krimet Jakë bardha
- Krimet ndaj pronës
- Krimet pa viktima dhe viktimat pa krime
- Teknologjia dhe krimet
- Krimet e drogave
- Terrorizmi: Justifikimi moral
- E ardhmja e krimeve

**Metodat mësimore**

- Ligjërata dhe ushtrime
- Raste studimi, Vizita studimore
- Video dokumentaro-shkencore
- Punë hulumtuese-grupore

**Metodat e vlerësimit**

- Test me shkrim
- Punime individuale
- Provimi përfundimtar
- Diskutime intensive

**Literatura**


- Frank Schmalleger (2021) Criminology Today: An integrative introduction (9th ed.)
- Stephen E. Brown/Fin-Ann Esbensen and Gilbert Gei (2009) Criminology: Explaining Crime and its Context
- Ferid Azemi (2021). Kriminologjia (Cikël ligjëratash të përgatitura nga mësimdhënësi).

## P19. Anti-terrorizmi

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 70 |
| Periudha: | Semestri 6 |
| Lloji i lëndës: | Obligative |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

### Hyrje në lëndën mësimore

Anti-terrorizmi përfshin praktikën, taktikat, teknikat dhe strategjinë, që qeveria, organet e zbatimit të ligjit përdorin për të luftuar apo parandaluar terrorizmin. Strategjia kundër terrorizmit përdorur instrumentet e fuqisë kombëtare për të neutralizuar terroristët, organizatat e tyre dhe rrjetet e tyre në mënyrë që t'i bëjë ata të paaftë për të përdorur dhunë, për të futur frikë, apo për të detyruar qeverinë ose qytetarët e saj të reagojnë në përputhje me qëllimet e terroristëve. Qëllimi i kësaj lënde është që studentëve t'u ofrohen njohuri mbi terrorizmin bashkëkohor, mënyrën dhe format e shfaqjes së tij, qëllimet që terroristët dëshirojnë t'i arrijnë, financimin, mbështetja politike, ndikimi i religjionit, ideologjisë dhe nacionalizmit, format bashkëkohore të shfaqjes së terrorizmit, lufta dhe reagimi shoqëror ndaj tij.

### Mësimnxënia

Studenti është në gjendje të:

- Përkufizojë nocionin e terrorizmit dhe ligjet e aplikueshme kundër terrorizmit;
- Identifikojë format e manifestimit dhe faktorët që ndikojnë në paraqitjen e terrorizmit;
- Njohë konceptin e të drejtave të njeriut në luftën kundër terrorizmit;
- Zbatojë procedurat profesionale dhe format për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit;
- Identifikojë rolin që kanë agjencitë e zbatimit të ligjit në luftën ndaj terrorizmit.

### Përmbajtja

- Hyrje në anti-terrorizëm;
- Kushtet e favorshme për përhapjen e terrorizmit;
- Përmbledhje e kornizës ligjore nacionale dhe ndërkombëtare anti-terrorizëm;
- Përgjigjet e drejtësisë penale ndaj terrorizmit;
- Qasjet rajonale anti-terrorizëm;
- Qasjet e konflikteve ushtarake / të armatosura në luftën anti-terrorizëm;
- Kundër-terrorizmi dhe situatat e emergjencës publike
- Të drejtat e njeriut dhe anti-terrorizmi;
- Privatësia, teknikat hetuese dhe mbledhja e inteligjencës dhe anti-terrorizmi;
- Mosdiskriminimi dhe liritë themelore dhe anti-terrorizmi dhe viktimat e terrorizmit;
- Çështje bashkëkohore të anti-terrorizmit;
- Lidhjet midis krimit të organizuar dhe terrorizmit.

### Metodat mësimore

- Ligjërata, ushtrime dhe demonstrime
- Diskutime dhe punë në grup
- Punim seminari
- Vetë hulumtim.

### Metodat e vlerësimit

- Prezantime individuale dhe grupore
- Punim seminari
- Test semestral
- Provimi përfundimtar

### Literatura


- Abrams, N. (2018). Anti-Terrorism and Criminal Enforcement. West Academic Publishing
- Ana Maria Salinas De Frias, Katja Samuel, Nigel Ëhite (2012). Counter-Terrorism: International Laë and Practice. Publisher: Oxford University Press.
- Demolli, H. (2005). Terrorizmi. Prishtinë.

## P20. Analiza e inteligjencës

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 70 |
| Periudha: | Semestri 6 |
| Lloji i lëndës: | Obligative |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Analiza e inteligjencës është procesi me të cilin informacioni i mbledhur përdoret për t'iu përgjigjur pyetjeve taktike në lidhje me operacionet aktuale ose për të parashikuar sjelljen në të ardhmen. Qëllimi kryesor i kësaj lënde është që t'i njoftojë studentët me njohuri të përgjithshme për procesin e analizës së inteligjencë, me dobësitë dhe kërcënimet e sistemeve ekzistuese të shërbimeve të inteligjencës dhe për t'u aftësuar që ata të hartojnë dhe të zhvillojnë sistemet e sigurta të analizës së inteligjencës.

**Mësimnxënia**

Studenti është në gjendje të:

- Përkufizojë nocionin e inteligjencës dhe procesit te inteligjencës.
- Identifikojë dobësitë dhe kërcënimet në sistemet e shërbimeve të inteligjencës
- Menaxhimi i informatave te inteligjencës.
- Vlerësojë ligjet e aplikueshme të inteligjencës.
- Demonstrojë format e bashkëpunimi ndërkombëtar në aspektin e inteligjencës dhe analizës.

**Përmbajtja**

- Inteligjenca dhe ciklet e inteligjencës
- Mbledhja dhe burimet e informatave
- Shfrytëzimi i burimeve të hapura (publike) brenda analizës së krimit,
- Vlerësimi i informatave dhe i inteligjencës,
- Përpilimi i raportit të inteligjencës,
- Plotësimi i formularëve C1,
- Menaxhimi i informacioneve,
- Produktet e Inteligjencës
- Vlerësimi i kërcënimit serioz dhe vlerësimi nga krimi i organizuar (SOCTA),
- Çështjet ligjore në aspektin e Inteligjencës dhe Analizës.
- Bashkëpunimi ndërkombëtar në aspektin e Inteligjencës dhe Analizës

**Metodat mësimore**

- Ligjërata, ushtrime dhe demonstrime;
- Diskutime dhe punë në grup;
- Punim seminari dhe Vetë-hulumtim.

**Metodat e vlerësimit**

- Prezantime individuale dhe grupore;
- Punim seminari;
- Test semestral dhe Provimi përfundimtar.

**Literatura**


- Garner, G. & McGlyn, P. (2018). Intelligence Analysis Fundamentals. Publisher: CRC Press.
- Clark, Robert M (2019). Intelligence Analysis: A Target-Centric Approach. Publisher: SAGE.
- Patrick F. Walsh (2011). Intelligence and Intelligence Analysis. Publisher: Willan.
- Richards, J. (2010): The Art and Science of Intelligence Analysis.
- Heuer Jr, R. (2010): Structured Analytic Techniques for Intelligence Analysis.

**P13. Mbrojtja e të dhënave personale**

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 3 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 45 |
| Periudha: | Semestri 6 |
| Lloji i lëndës | Zgjedhore |
| Lloji i vlerësimit | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Qëllimi i lëndës është që studentët të fitojnë njohuri themelore sa i përket të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale. Do të mësojnë parimet themelore të përpunimit të dhënave personale, mbrojtjen e të dhënave, mënyrat e sigurimit të dhënave, të drejtat e subjektit të cilit i takojnë të dhënat.

**Mësimnxënia**

Studenti është në gjendje të:

- Përshkruajë të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Zbatojë njohuri në fushën e përpunimit të dhënave personale.
- Njohë rëndësinë dhe theksin e sigurimit të dhënave personale
- Zbatojë parimet bazë të mbrojtjes së të dhënave personale

**Përmbajtja**

- Kuptimi i të dhënave personale
- Përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale
- Përpunimi i të dhënave personale të ndjeshme
- Mbrojtja e të dhënave personale në BE
- Mbrojtja e të dhënave personale
- Përpunimi për qëllime shkencore, historike dhe statistikore
- Zbulimi i të dhënave personale
- Sigurimi i të dhënave personale
- Sistemi i dosjeve
- Të drejtat e subjektit të të dhënave
- Mbrojtja institucionale e të dhënave personale
- Qarkullimi ndërkufitar i të dhënave personale

**Metodat mësimore**

- Ushtrimet, demonstrimet, praktikat,
- Diskutime debutuese dhe seminare
- Vetë hulumtim dhe hartime krijuese
- Puna individuale dhe në grup

**Metodat e vlerësimit**

- Teste me shkrim
- Vlerësime seminarike
- Detyrë shtëpie
- Vlerësim klase
- Provimi përfundimtar

**Literatura**


- Dowling, Donald Jr (2009): International Data Protection and Privacy Law.
- Ligji per mbrojtjen e te dhenave personale i Republikes se Kosoves.
- Robinson, N, Botterman, M., Graux, H.. & M., Valeri, L. (2009): Revieë of the European Data Protection Directive. Information Commissioner’s Office

**P28. Teknika kriminalistike**

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 3 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 45 |
| Periudha: | Semestri 6 |
| Lloji i lëndës: | Zgjedhore |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Teknika kriminalistike merret me gjetjen, studimin, përshtatjen dhe avancimin e metodave dhe të mjeteve më të përshtatshme shkencore – teknike për luftimin e kriminalitetit nga fusha e shkencave natyrore dhe teknike, me qëllim të zbulimit, të sigurimit, të fiksimit dhe të interpretimit të gjurmëve për qëllime prove në procedurë penale. Qëllimi i kësaj lënde është që studentet të mësojnë rreth metodave dhe të mjeteve shkencore dhe teknike se si zbulohen dhe sqarohen gjurmët dhe sendet dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale që janë të rëndësishme për zbulimin dhe sqarimin e veprës penale, identifikimin e kryesit, të objektit të sulmuar dhe të objekteve të tjera.

**Mësimnxënia**

Studenti është në gjendje të:

- Klasifikojë llojet e gjurmëve dhe funksionin e tyre në dokumentimin e veprave penale;
- Të zbatojë ekspertimet e nevojshme kriminalistike dhe teknologjitë e reja në teknikën kriminalistike;
- Njohë mënyrën e marrjes së gjurmëve, paketimin e tyre, dokumentin dhe përcaktimin e peshës së tyre;
- Zbatojë shkathtësitë e fituara në funksion të zbulimit të veprave penale ku ka gjurmë të veprave penale;
- Udhëheqë me menaxhimin e hetimit dhe ti përcaktojë rëndësinë e gjurmëve për ndërtimin e rastit për të dokumentuar kryesin e veprës penale dhe mënyrës së kryerjes së veprës penale.

**Përmbajtja**

- Teknika kriminalistike – kuptimet themelore;
- Klasifikimi i gjurmëve
- Këqyrja dhe rikonstruksioni;
- Mjetet, metodat dhe teknikat në kriminalistikën teknike;
- Ekspertizat biologjike dhe fiziko-kimike;
- Ekspertizat daktiloskopike;
- Ekspertizat e dokumenteve dhe të dorëshkrimeve;
- Sendet si gjurmë;
- Ekspertimet në teknikën kriminalistike;
- Teknologji të reja në teknikën kriminalistike;
- Relativizimi i rezultateve të ekspertizave kriminalistike – teknike; Gjurmët dhe ekspertizat e aksidenteve të komunikacionit

**Metodat mësimore**

- Ligjërata, ushtrime dhe demonstrime
- Diskutime dhe punë në grup
- Punim seminari
- Vetë hulumtim.

**Metodat e vlerësimit**

- Prezantime individuale dhe grupore
- Punim seminari
- Test semestral
- Provimi përfundimtar

**Literatura**


- Latifi, V., & Demolli, H. (2019). *Kriminalistika*. Universiteti i Prishtinës.
- Saferstein, Richard (2014). *Kriminalistika: Një hyrje në shkencat ligjore*. Tabernakul.
- Saferstein, R. (2017). Criminalistics: An Introduction to Forensic Science. Pearson.
- Korajlic, N., & Muharremi, D. (2009). Kriminalistika. Riinvest.

## P16. Krimi i Organizuar

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 5 ECTS |
| Orët në klasë: | 45 |
| Orët individuale: | 80 |
| Periudha: | Semestri 7 |
| Lloji i lëndës: | Obligative |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

### Hyrje në lëndën mësimore

Krimi i organizuar është njëri ndër format e kriminalitetit më të rrezikshëm në shoqërinë bashkëkohore. Ajo paraqet një nga organizimet më të mirëfillta kriminale që k anë si qëllim pasurimin material, duke mos kursyer asnjë nga normat sociale. Ajo vepron kur së paku tre persona kanë një marrëveshje për të kryer krimin e caktuar, duke u organizuar në nivele të organizimit me qëllim të realizimit të planit kriminal. Krimi i organizuar ka kaluar kufijtë nacional dhe paraqet kërcënim global. Qëllimi i kësaj lënde është përgatitja dhe aftësimi i zyrtarëve policor që t'i përdorin me sukses njohuritë, shkathtësitë e fituara në fushën e krimit të organizuar me qëllim të luftimit dhe parandalimit të suksesshëm të tij.

### Mësimnxënia

Studenti është në gjendje të:

- Shpjegojë nocionin e krimit të organizuar dhe ligjet e aplikueshme që i kushtohen luftimit të krimit të organizuar.
- Identifikojë format e paraqitjes, faktorët që ndikojnë në paraqitjen e krimit të organizuar
- Demonstrojë metodat për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar
- Hartojë strategji për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar
- Demonstrojë shkathtësi për t'u përballur me sukseset me format më të rrezikshme të këtij lloji të kriminalitetit

### Përmbajtja

- Përkufizimet dhe tregjet e krimit të organizuar
- Tregjet e krimit të organizuar dhe infiltrimi i krimit të organizuar në biznes dhe qeveri
- Konceptimi dhe matja e krimit të organizuar
- Shkaqet dhe faktorët lehtësues të krimit të organizuar
- Modelet e grupeve të organizuara kriminale
- Mjetet dhe bashkëpunimi për zbatimin e ligjit
- Strategjitë e prokurorisë
- Sekuestrimi dhe konfiskimi në krimin e organizuar
- Bashkëpunimi ndërkombëtar për të luftuar krimin e organizuar ndërkombëtar
- Parandalimi i krimit të organizuar
- Konventa e kombeve të bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional dhe instrumente tjera
- Krimi i organizuar kibernetikë
- Lidhjet midis krimit të organizuar dhe terrorizmit

### Metodat mësimore

- Ligjërata, ushtrime dhe demonstrime
- Diskutime dhe punë në grup
- Punim seminari
- Vetë hulumtim.

### Metodat e vlerësimit

- Prezantime individuale dhe grupore
- Punim seminari
- Test semestral
- Provimi përfundimtar

### Literatura


- Abadinsky, H. (2010). Organized Crime. Wadsworth Publishing
- Gottschalk, P. (2009): Policing Organized Crime: Intelligence Strategy Implementation. CRC Press.
- Gpunev, P. & Ruggiero, V. (2012). Corruption and Organized Crime in Europe: Illegal partnerships (Organizational Crime)
- Materiale nga OSBE, BE, Europol, Interpol, UNODC
  WËeb: http://organized-crime.de/ & https://www.unodc.org/e4j/en/tertiary/organized-crime.html

**P8. Menaxhimi i Krizave**

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 70 |
| Periudha: | Semestri 7 |
| Lloji i lëndës: | Obligative |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Qëllimi kryesor është t'i njoftojë studentët me menaxhimin e krizës si proces, menaxhimin e ngjarjeve të mëdha që kërcënojnë apo dëmtojë organizimin e sistemit, apo publikun e gjerë.

**Mësimnxënia**

Studenti është në gjendje të:

- Përcaktojë kuptimin dhe lëndën e menaxhimit të krizave.
- Zbatojë njohurinë e fituar në menaxhimin e krizës duke përfshirë kërcënimet dhe shmangien e kërcënimeve
- Menaxhojë situatat e krizës sipas rolit
- Identifikojë rolet e institucioneve të sigurisë të përfshira në menaxhimin e krizës
- Njohë modelet dhe teoritë lidhur me menaxhimin e krizave në Kosovë

**Përmbajtja**

- Kuptimi i krizave dhe veçoritë e krizave
- Llojet e krizave-burimet shkaqet dhe pasojat
- Tipologjia e krizave-llojet dhe ndikimet e mundshme
- Modelet dhe teoritë lidhur me menaxhimin e krizës
- Parashikimi i krizave dhe planifikimi i menaxhimit të krizave
- Planifikimi i emergjencave
- Korniza institucionale e menaxhimit të krizave-struktura kombëtare e manaxhimit
- Roli dhe përgjegjësit e institucioneve në menaxhimin e krizave
- Izolimi i krizave dhe komunikimi gjatë krizave
- Shkollat e menaxhimit të krizave
- Roli i lidershipit në menaxhimin e krizave

**Metodat mësimore**

- Ushtrimet, demonstrimet, interpretimet, praktikat,
- Diskutime debatuese
- Punimet seminarike
- Vetë hulumtim dhe Puna në grup

**Metodat e vlerësimit**

- Teste me shkrim
- Vlerësime seminarike
- Detyrë shtëpie
- Vlerësim klase dhe Provimi përfundimtar

**Literatura:**

Gashi,B., Jusufi, Xh. (2012): Menaxhimi i Krizave, Dukagjini, Pejë
- Faggiano, V. (2011): Critical Incident Management: A Complete response Guide. 2 Edition. CRC
- United Nations Foundation, OCHA, Harvard Humanitarian Initiative and Vodafone foundation. 2011. Disaster relief 2.0, the future of information sharing in humanitarian emergencies.
- http://ëëë.unfoundation.org/neës-and-media/publications-and-speeches/disaster-relief-2report.html
- Fink, S. (2002): Crisis Management, planning for Inevitable, SHBA
- Mitroff, I., Anagnos, G. (2001): Managing Crises Before They Happen Neë York
- Hillyard, M. (2000): Public Crisis Management, SHBA
- Boin, A., Hart, P.l, Stern, E., Sundelius, B. (2005): The Politics of Crisis Management, Britani e Madhe,
- Sistemi i Integruar i Menaxhimit te Emergjencave dhe Plani i Reagimit Kombëtar - I miratuar nga Qeveria e Republikes se Kosoves, Prishtinë 2011.

## P26. Menaxhimi dhe kontrolli i kufirit

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 70 |
| Periudha: | Semestri 7 |
| Lloji i lëndës: | Obligative |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Qëllimi i lëndës është që studentëve t'u ofrojë njohuri në aspektin e menaxhimit të kufijve dhe kontrollin e tyre. Në kuadër të këtij moduli do të kenë mundësi të njihen edhe për mundësinë e vëzhgimit, patrullimit të kufirit, dokumentet identifikuese dhe metodat tjera për menaxhimin sa më të mirë të kufirit. Ne kuadër te lëndës do të elaborohen edhe kërcënimet tradicionale dhe asimetrike, por do të përqendrohet kryesisht mbi kërcënimet asimetrike të tilla si krimi i organizuar, terrorizmi, armët e shkatërrimit në masë, dhe pandemia.

**Mësimnxënia**

Studenti është në gjendje të:

- Përshkruajë legjislacionin relevant kombëtar dhe ndërkombëtar për aktivitetet e policisë kufitare dhe Përshkruajë trendët kombëtare dhe globale që ndikojnë në sigurinë kufitare
- Kontrollojë autencitetin e dokumenteve dhe të zbulojë dhe identifikojë dokumentet relevante;
- Identifikojë informatat relevante për rreziqet dhe kërcënimet relevante dhe zbatojë menaxhimin e rrezikut dhe teknikat lidhur me kontrollin kufitar
- Zbatojë aktivitetet operacionale dhe teknikat e mbikëqyrjes për vëzhgimin e kufijve dhe mbledhjen e informatave
- Menaxhojë procedurat e pikë kalimeve kufitare
- Vlerësojë shkeljet, procedurat ligjore dhe hetimore në bashkëpunim me autoritetet relevante dhe planifikojë, mbikëqyrë dhe vendos burimet për kontrollin e kufitar dhe të aktiviteteve ekipore
- Shpjegojë rolet e aktorëve për sigurinë bashkëkohore kombëtare dhe ndërkombëtare dhe ilustrojë si t'i kundërvihet kërcënimeve transnacionale

**Përmbajtja**

- Konteksti i sigurisë së kufirit kombëtar
- Kontrolli kufitar lidhur me legjislacionin
- Menaxhimi i integruar i kufirit të Kosovës
- Ekzaminimi i dokumenteve
- Kontrolli kufitar në aeroporte
- Mangësitë dhe mbrojtja e kufirit ajror
- Kufiri lidhur me rendin dhe sigurinë
- Kontrolli kufitar në kufijtë tokësorë
- Menaxhimi i kontrolleve dhe vëzhgimit kufitar
- Bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar
- Zhvillimi i kontrollit kufitar në Evropë, rregulloret e Shengenit
- Sistemi informativ i kontrollit kufitar
- Teknologjia e kontrollit kufitar, Kartografia, detyrat dhe metodologjia e saj
- Rreziqet dhe kërcënimet transnacionale
- Procedurat e kërcënimit dhe analiza e rrezikut në menaxhimin e kontrollit kufitar
- Instrumentet, teknikat e menaxhimit të rrezikut
- Lufta kundër krimeve transkufitare

**Metodat mësimore**

- Ligjërata, Ushtrimet
- Diskutime debatuese
- Punimet seminarike
- Vetë hulumtim dhe puna në grup

**Metodat e vlerësimit**

- Prezantime individuale dhe grupore
- Punim seminari
- Test mes'semestral
- Provimi përfundimtar

**Literatura**


- Zaiotti, R. (2011): Cultures of Border Control: Schengen and the Evolution of Europe's Frontiers. Publisher: The University of Chicago Press
- Pecoud, A.& de Guchteneire, P. (2006): International Migration, Border Controls and Human Rights: Assessing the Relevance of a Right to Mobility.
- Ligji për Menaxhimin e Integruar dhe kontrolli i Kufirit Shtetërorë
- Pickering,S.& McCulloch, J. (2012): Borders and Crime: Pre-Crime, Mobility and Serious Harm in the Age of Globalization (Transnational Crime, Crime Control and Security). Palgrave Macmillan

**P29. Kundërvajtjet dhe menaxhimi i trafikut**

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 70 |
| Periudha: | Semestri 7 |
| Lloji i lëndës: | Obligative |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Qëllimi kryesor i kësaj lënde është që studentët të fitojnë njohuri, shkathtësi dhe kompetencë nga lëmi i kundërvajtjeve, përkatësisht nga vepra kundërvajtëse, përgjegjësia kundërvajtëse dhe sanksionet kundërvajtëse dhe në pjesën tjetër të lëndës të fitojnë kompetencë për menaxhimin e trafikut, përkatësisht hetimin e aksidenteve, drejtimin e trafikut, kontrollet në trafik dhe aspekte të tjera të trafikut në përputhje me legjislacionin penal, si dhe akte të tjera ligjore në zbatim të ligjit

**Mësimnxënia**

Studenti është në gjendje të:

- Zbatojë dispozitat kundërvajtëse
- Zbatojë ligjin për sigurinë në komunikacionin rrugor
- T'i kuptojë veprat kundërvajtëse dhe t'i bëjë dallimet me veprat penale
- Të dijë rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale kundërvajtëse
- Aranzhojë detyrat policore në trafik
- Kryejë hetimin e aksidenteve.
- Demonstrojë dobinë e përdorimit të pajisjeve të sigurisë
- Kryejë rikonstruimin e vendit të ngjarjes dhe shpjegojë rëndësinë e saj në hetim

**Përmbajtja**

- Veprat, përgjegjësia dhe sanksionet;
- Zbatimi i procedurës kundërvajtëse dhe asaj gjyqësore për kundërvajtje;
- Siguria në komunikacionin rrugor;
- Menaxhimi dhe kontrolli i trafikut rrugor
- Hetimi i aksidenteve: menaxhimi i vendit të ngjarjes dhe raportimi, mbledhja e dëshmive, fotot,etj, rikonstruimi i vendit të ngjarjes, matjet dhe skicimet;
- Ligjshmëria e matjes së shpejtësisë në komunikacion;
- Fizika dhe dinamika e automjeteve;
- Materialet e rrezikshme në rrugë;

**Metodat mësimore**

- Ligjerata, Ushtrimet
- Diskutime debatuese; Punime seminarike
- Vetë hulumtim dhe hartime krijuese
- Puna në grup

**Metodat e vlerësimit**

- Teste me shkrim
- Vlerësime seminarike
- Detyrë shtëpie dhe klase
- Provimi përfundimtar

**Literatura**


- Elvik, R., Vaa, T., Hoye, A. & Sorensen, M (Eds. 2009): The Handbook of Road Safety Measures. Emerald Group Publishing Limited
- Hess, K. & Orthmann, C. (2011): Traffic: Policing in a country on the move in Police Operations. Delmar. Cengage Learning
- R.Ë. Rivers (2011): Traffic Crash Investigators' Manual. Charles C Thomas
- Ligji për sigurinë në komunikacionin rrugor dhe Ligji për rregullat e trafikut rrugor.
- Kodi i Procedurës Penale.
- Ligji për Policinë e Kosovës dhe Ligji i zbatueshëm për kundërvajtje.

**P7. Menaxhimi i sigurisë publike**

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 3 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 45 |
| Periudha: | Semestri 7 |
| Lloji i lëndës: | Zgjedhore |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Qëllimi kryesor i kësaj lënde është që t'i njoftojë studentët me konceptet dhe praktikat e më të mira të menaxhimit të sigurisë publike. Të ndajë dhe të vlerësojë punën e secilit prej aktorëve të sigurisë në Kosovë si: Këshilli i Sigurisë, policisë, emergjencës civile si dhe sektorit të drejtësisë. Përmes kësaj lënde do të sqarohen konceptet themelore që nevojiten për studentët e sektorit të sigurisë.

**Mësimnxënia**

Studenti është në gjendje të:

- Përshkruajë sigurinë publike sipas rregullimit ligjor në Kosovë
- Njohë dhe interpretojë arkitekturën përgjithshme të sigurisë në Kosovë
- Përshkruajë politikat e sigurisë në konceptin global, kërcënimet dhe legjislacioni i sigurisë publike
- Veprojë sipas rolit të zyrtarit policor në sektorin e sigurisë publike
- Hartojë strategji për menaxhimin e sigurisë publike

**Përmbajtja**

- Nocioni dhe përkufizimi i sigurisë publike
- Historiku i sektorit të sigurisë në Kosovë
- Rendi dhe qetësia Publike
- E drejta e lirisë dhe sigurisë
- Institucionet e sigurisë publike kategoritë e menaxhimit të sigurisë publike
- Tubimet Publike
- Armët, eksplozivët dhe kontrolli i tyre
- Roli i inteligjencës për sigurinë publike
- Institucionet e drejtësisë dhe roli i tyre në sigurinë publike
- Sistemi i integruar i menaxhimit të cilësisë në Kosovë

**Metodat mësimore**

- Ligjerata, Ushtrime, demonstrime
- Diskutime debatuese
- Punimet seminarike
- Vetë hulumtim dhe hartime krijuese

**Metodat e vlerësimit**

- Teste me shkrim
- Vlerësime seminarike
- Detyrë shtëpie; Vlerësim klase
- Provimi përfundimtar

**Literatura**


- Adams, T. & Foust, J. (2013) Police Field operations. Prentice Hall
- Ekblom, P. (2011): Crime Prevention, Security and Community Safety Using the 51s Frameëork, London
- Haberfeld, M. (2012): Police Leardership: Organizational and Managerial Decision Making Process. Prentice Hall
- Miller, L., Hess, K., Orthman, C. (2012): Partnership for Problem Solving
- Kappeler, V.(2012): Community Policing: A contemporary Perspective. Anderson
- Ligji për rendin dhe qetësinë publike i Republikës së Kosovës.

## P17. Krimet financiare

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 3 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 45 |
| Periudha: | Semestri 7 |
| Lloji i lëndës: | Zgjedhore |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Qëllimi kryesor i kësaj lënde është që t'i njoftojë studentët me njohuri lidhur me hetimet financiare, analizat operative, hetimin e korrupsionit dhe metodave te tjera të mashtrimit në prokurim dhe në sisteme bankare

**Mësimnxënia**

Studenti është në gjendje të:

- Zbatojë dhe shfrytëzojë si duhet njohurinë profesionale për parandalimin e krimit financiar
- Përkufizojë nocionin e krimit financiar dhe ligjet e aplikueshme që i kushtohen luftimit të krimit financiar.
- Identifikojë format e paraqitjes, faktorët që ndikojnë në paraqitjen e krimit financiar.
- Hetojë dhe dokumentojë dëshmitë e krimeve financiare

**Përmbajtja**

- Nocioni, përkufizimi i krimit financiar
- Hetimet e krimit financiar
- Analiza operative dhe financiare
- Hetimi i korrupsionit, kontrabandës dhe shkeljeve të hyrave doganore
- Hetimi i falsifikimit
- Kontabiliteti themelor
- Mashtrimet ne Prokurim dhe korrupsioni
- Metodat e dëshmisë
- Depozitat bankare
- Njësia e Inteligjencës Financiare
- Hetimi i mashtrimit me TVSH
- Sekuestrimi dhe konfiskimi i aseteve
- Parandalimi dhe luftimi i krimit financiar

**Metodat mësimore**

- Ligjëratat, ushtrimet, demonstrimet, interpretimet, praktikat,
- Diskutime debatuese
- Puna në grup

**Metodat e vlerësimit**

- Prezantime individuale dhe grupore
- Punim seminari
- Test mes'semestral
- Provimi përfundimtar

**Literatura**


- Bond, M. (2013): Anti-Bribery and Financial Crime Handbook. John Ëiley & Sons
- Edelbacher, M., Kratkosci, P.& Theil, M. (2012): A Threat to Global Security (Advances in Police Theory and Practice). CRC Press
- Gottschalk, P. (2012): Investigation and Prevention of Financial Crime. Goëer
- Payne, B. (2012): Ëhite-Collar Crime: The Essentials. Sage Publications

## I8. Metodat dhe operacionet e punës në polici

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 20 ECTS |
| Orët e punës praktike: | 500 |
| Periudha: | Viti i 2-të |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencues |

### Hyrje në periudhën e punës praktike

Qëllimi i kësaj periudhe praktike është që t'i ofrohet mundësia studentëve për të zbatuar njohurinë dhe shkathtësitë e fituara në shërbimin e policisë.

**Mësimnxënia**

**Studenti është në gjendje të:**

- Zbatojë parimet e menaxhmentit dhe lidershipit në Policin e Kosovës / IPK;
- Vlerësojë rëndësinë e informacionit për shfrytëzimin e burimeve me efektivitet
- Përshkruajë shfrytëzimin e treguesve në planifikimin strategjik
- Zbatojë legjislacionin e shërbimit të policisë në punën e përditshme
- Zbatojë parimet e mirëqenies së punës në aktivitet në vendin e punës

**Përmbajtja**

- Roli i policisë në shoqëri
- Parimet e ligjshmërisë në të gjitha aktivitete e policisë
- Procedurat e planifikimit në polici.
- Qeverisja demokratike në praktikë
- Ushtrimet praktike lidhur me ligjshmërinë e policisë
- Menaxhimi i personelit
- Menaxhimi sipas objektivave
- Angazhimi i treguesve në punën strategjike
- Mirëqenia në vendin e punës

**Metodat**

- Detyrat mësimore për punë praktike
- Portofoli
- Udhëzimi nga mentori

**Metodat e vlerësimit**

- Portofoli i punës praktike
- Raporti i punës praktike
- Raporti i vetëvlerësimit
- Prezantimi i raportit të punës praktike në seminar

## I9. Organizimi i policisë

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 20 ECTS |
| Orët e punës praktike: | 500 |
| Periudha: | Viti i 3-të |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencues |

**Hyrje në periudhën e punës praktike**

Qëllimi i kësaj periudhe praktike është që t'i ofrohet mundësia studentëve për të punuar në nivelin menaxhues në operacionet, hetimet e policisë dhe menaxhimin e policisë kufitare nën mbikëqyrje.

**Mësimnxënia**
**Studenti është në gjendje të:**

- Zbatojë procedurat operative të policisë në praktikë
- Zbatojë procedurat e hetimit të krimit në praktikë
- Zbatojë parimet dhe proceset e menaxhimit të kufijve në praktikë
- Demonstrojë profesionalizimin në detyrat e shërbimit të klientëve
- Përshkruaj metodat në menaxhimin i incidenteve kritik

**Përmbajtja**

- Menaxhimi i operacioneve të sigurisë publike (duke përfshirë trafikun rrugor) në praktikë
- Menaxhimi i incidenteve kritike
- Procedura e hetimit të krimit dhe raste vetanake të hetimit.
- Vendimet e menaxhimit të kufijve
- Metodat dhe operacionet e punës me klientë

**Metodat**

- Detyrat mësimore për punë praktike
- Portofoli
- Udhëzimi nga mentori

**Metodat e vlerësimit**

- Portofoli i punës praktike
- Raporti i punës praktike
- Raporti i vetëvlerësimit
- Prezantimi i raportit të punës praktike në seminar

## I10. Praktika e menaxhimit dhe lidershipit të avancuar në polici

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 25 ECTS |
| Orët e punës praktike: | 750 |
| Periudha: | Viti i 4-të |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencues |

### Hyrje në periudhën e punës praktike

Qëllimi i kësaj periudhe praktike është që t'i ofrohet mundësia studentëve të praktikojnë njohurinë dhe shkathtësitë e fituara në nivelin e avancuar të menaxhmentit.

**Mësimnxënia**
**Studenti është në gjendje të:**

- Zbatojë parimet e menaxhimit dhe lidershipit në shërbimet policore
- Vlerësojë shkathtësitë e veta të lidershipit
- Përshkruajë shfrytëzimin e treguesve në planifikimin strategjik
- Zbatojë rregullat dhe legjislacionin policor në punën e përditshme
- Zbatojë parimet e mirëqenies në punë në kuadër të aktiviteteve në vendin e punës
- Merr përgjegjësi në pozitën menaxhuese ku ai/ajo nuk ka punuar më parë

**Përmbajtja**

- Procedurat e planifikimit në njësitë e policisë.
- Qeverisja demokratike në praktikë
- Menaxhimi i personelit
- Menaxhimi sipas objektivave
- Shfrytëzimi i treguesve në punën strategjike
- Mirëqenia në vendin e punës
- Parimet në buxhetimin dhe planifikimin e burimeve njerëzore

**Metodat**

- Detyrat mësimore për punë praktike
- Portofoli
- Udhëzimi nga mentori

**Metodat e vlerësimit**

- Portofoli i punës praktike
- Raporti i punës praktike
- Raporti i vetëvlerësimit
- Prezantimi i raportit të punës praktike në seminar

## III.Drejtimi Korrektues dhe Sprovues – Studimet e specializuara

### Lëndët e specializuara për Shërbimin Korrektues dhe Sprovues

**Vizioni** i Fakultetit të Sigurisë Publike është që programin korrektues dhe sprovues ta bëjë një nga programet studimore shkencore dhe profesionale si të vetmen në vend, që kontribuon në ndërtimin e shërbimeve korrigjuese me integritet të lartë dhe përkushtim ndaj përsosërisë në shërbim.

**Qëllimi** i programit korrektues dhe sprovues është të kontribuojë në krijimin e resurseve njerëzore profesionale në shërbimin korrektues dhe sprovues me mision ruajtjen dhe mbrojtjen e një shoqërie të drejtë, paqësore dhe të sigurtë, duke ofruar njohuri shkencore dhe profesionale rreth praktikave të zbatimit të dënimeve të shqiptuara nga gjykatat, ruajtjen e dinjitetit njerëzor të të burgosurve duke zhvilluar tek ata ndjenjën e përgjegjësisë sociale.

**Misioni** i programit korrektues dhe sprovues është vendosja e rehabilitimit të burgosurve në qendër të programit studimor në partneritet me agjencinë e Shërbimit Korrektues dhe Sprovues, përmes:

- Zbatimit dhe drejtimit të integruar të procesit mësimor me përqendrim në korrigjimin e sjelljes ofenduese, promovimin e përgjegjësisë sociale dhe zhvillimin e përgjithshëm të personit nën sprovim;
- Sigurimi me kosto efektive i lehtësirave korrektuese që do të promovojnë siguri efikase, korrigjim, kujdes dhe shërbime zhvillimi brenda një mjedisi të mundshëm të të drejtave të njeriut;
- Praktika progresive dhe etike të menaxhimit të stafit korrektues dhe sprovues brenda të cilave çdo zyrtar kryen një rol efektiv korrigjues dhe mbështetës.

**Objektivat** e programit korrektues dhe sprovues janë si në vijim:

**Administrimi:**

- Sigurimi i funksioneve administrative, menaxheriale, financiare, sigurimit të informacionit, zhvillimit të komunikimit dhe qeverisjes së mirë në të gjitha fushat e shërbimeve korrektuese dhe sprovese;
- Sigurimi i shërbimit efektiv të brendshëm mbështetur në bazën ligjore dhe zhvillimi i masave që synojnë çrrënjosjen e korrupsionit;
- Përmirësimi i kapacitetin dhe praktikave menaxhuese me burime njerëzore për t'i dhënë mundësi shërbimit korrektues dhe sprovues të përmbushë mandatin e saj;
- Sigurimi i një menaxhimi efikas të njohurive në shërbimin korrektues dhe sprovues përmes sistemeve të përmirësuara të menaxhimit të informacionit dhe shërbimeve të teknologjisë informative në mënyrë që të sigurojë vendimmarrje të drejtuar nga informacioni;

**Siguria:**

- Sigurimi i një mjedisi të shëndetshëm dhe të përshtatshëm për ruajtjen e dinjitetit njerëzor për të gjithë personat e burgosur dhe duke bërë kështu zhvillimin e kapaciteteve të sigurisë së të burgosurve, personelit korrektues dhe sprovues.
- Parandalimi i pjesëmarrjes së të burgosurve në aktivitete kriminale dhe zhvillimi i një mjedisi që ofron siguri për të gjithë personat nën kujdesin e shërbimit korrektues dhe sprovues si dhe sigurinë e zyrtarëve korrektues dhe sprovues.
- Sigurimi i shoqëris duke parandaluar arratisjet dhe duke mbikëqyrur në mënyrë efektive shkelësit e ligjit që janë nën mbikëqyrjen e komunitetit.
- Të zhvilloj siguri për zyrtarët korrektues dhe sprovues, shkelësit e ligjit, të paraburgosurit në pritje të gjykimit, komunitetin dhe ofruesit e shërbimeve sociale, psikologjike dhe mjekësore në qendrat korrektuese.

**Korigjimi (korrektimi):**

- Zhvillimi i planeve të dënimit korrektues bazuar në nevoja, duke vlerësuar rreziqet e sigurisë dhe profilin kriminal të individëve, si dhe duke u përqëndruar në veprën për të cilën një person është dënuar me burgim.
- Adresimi i nevojave specifike rehabilituese për të gjithë personat që janë dënuar me vuajtje dënimi në një qendër korrektuese dhe janë liruar me kusht përmes vlerësimit të rregullt sprovues.
- Zhvillimi i programeve korrektuese të bazuara në nevoja që kontribuojnë në ulje të shkallës së recidivizmit.
- Përmirësimi i praktikave menaxhuese në të gjitha Qendrat Korrektuese dhe Qendrat e Paraburgimit.

**Kujdesi:**

- Zhvillimi i programeve të kujdesit bazuar në nevoja që synojnë mirëmbajtjen e mirëqenies së personave të burgosur që i janë besuar kujdesit të shërbimit korrektues dhe sprovues.
- Sigurimi i mirëqenies personale të personave të burgosur duke ofruar shërbime të ndryshme bazuara në nevoja në përputhje me konventat ndërkombëtare.
- Zhvillimi i shkathtësive të punës dhe sjelljes produktive duke siguruar programe arsimore të bazuara në nevoja, aftësi dhe programe të tjera të lidhura me zhvillimin, në mënyrë që të lehtësojë ri-integrimin e shkelësve të ligjit në shoqëri.
- Ofrimi i shërbimeve të përqendruara në përgatitjen e shkelësve të ligjit për lirimin, mbikëqyrjen efektive pas lirimit dhe lehtësimin e riintegrimit të tyre shoqëror.
- Lehtësimi i pranimit shoqëror dhe ri-integrimi efektiv i shkelësve të ligjit dhe ndihma ndaj tyre në përmbushjen e të gjitha kushteve të mbikëqyrjes korrektuese dhe sprovuese.

## Fushat e mësimnxënies




## Legjislacioni dhe Etika

Studenti është në gjendje të:

- njihet me origjinën e ligjeve vendore dhe ndërkombëtare dhe aspektet e sjelljes etike veçanërisht të fokusuar në sanksionet penale.
- dijë pse ligji është i nevojshëm dhe zbatimi i tij, arsyet për ndryshimin apo lëshimin e një ligji ose të akteve nënligjore. Studenti është në gjendje të zbatojë të gjitha të sipërpërmendurat.

## Siguria dhe Kontrolli

Studenti është në gjendje të:

- ketë kompetencë të përgjithshme në fushën e sigurisë, veçanërisht në *Institucionet për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale* (IESP).
- vlerësoj, menaxhoj, këshillojë dhe të mbroj sistemin e sigurisë në IESP dhe të arrijë kompetencën në teori dhe praktikë në siguri dhe sigurimin e IESP.

## Risocializimi

Studenti është në gjendje të:

- kuptoj natyrën e njeriut dhe sjelljen sipas teorive kryesore bashkëkohore,
- kuptoj aspektet sociale, gjendjen socio-psikologjike , dhunën dhe llojet e saj të manifestimit,
- njohë grupin dhe funksionimin e tij, nevojat dhe kontekstin social dhe rrjetin e komunitetit,
- menaxhojë faktorët e stresit, teknikat dhe menaxhimin e tij dhe organizimin e ekuilibrit të tij/saj në mes punës dhe të jetës së përditshme,
- organizoj programet e përshtatshme rehabilituese, veçanërisht planet e sakta të dënimit,

| **Lëndët dhe modulet** | **ECTS** | **Semestri** |
|---|---|---|
| **Legjislacioni dhe etika** | | |
| P21 Kriminologjia | 4 | 4 |
| R1. Penologjia | 4 | 5 |
| R2. Krimi dhe ndëshkimi | 5 | 5 |
| R3. Drejtësia për të mitur | 4 | 5 |
| R4. Kriminalistika | 4 | 7 |
| ***Lëndët zgjedhore:***<br>**Vëllimi obligativ i ECTS për studentin: 4 ECTS** | | |
| R20 Etika dhe drejtësia sociale | 3 | 4 |
| P3 E drejta e procedures penale | 4 | 6 |
| **Siguria dhe kontrolli** | | |
| R5. Parandalimi i krimit | 4 | 4 |
| R6. Siguria dhe menaxhmenti | 4 | 4 |
| R8. Vlerësimi i rrezikut | 4 | 6 |
| R23 Menaxhimi i burgut dhe shërbimit sprovues | 4 | 7 |
| P8. Menaxhimi i krizë | 4 | 7 |
| ***Lëndët zgjedhore:*** | | |
| R25.Ekzekutimi i dënimeve kryesore | 3 | 5 |
| R9 Menaxhimi i situatave emergjente | 4 | 6 |
| R26.Krimi dhe abuzimi me substanca narkotike | 4 | 7 |
| P13 E drejta per mbrojtjen e te dhenave personale | 4 | 7 |
| **Rehabilitimi dhe efikasiteti** | | |
| R12. Puna sociale | 4 | 4 |
| R18. Viktimologjia | 4 | 7 |
| R21 Socializimi dhe riintegrimi | 4 | 5 |
| R22 Trajtimi dhe programet e rehabilitimit | 4 | 6 |
| R14. Puna në komunitet | 4 | 6 |
| R16. Teknikat e këshillimit psikologjik | 4 | 6 |
| ***Lëndët zgjedhore:*** | | |
| R19 Masat dhe dënimet alternative | 3 | 4 |
| R24 Politika Sociale | 3 | 5 |
| **Periudhat e punës praktike** | | |
| I11. Metodat dhe operacionet e punës në Shërbimin Korrektues dhe Sprovues | 20 | Viti i 2-të |
| I12. Organizimi i Shërbimit Korrektues dhe Sprovues | 20 | Viti i 3-të |
| I13. Menaxhmenti dhe lidershipi i avancuar në Shërbimin Korrektues dhe Sprovues | 25 | Viti i 4-të |
| Tema e diplomës | 15 | Pas vitit të 4-të |

## P21. Kriminologjia

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 5 ECTS |
| Orët në klasë: | 45 |
| Orët individuale: | 80 |
| Periudha: | Semestri 4 |
| Lloji i lëndës: | Obligative |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Qëllimi kryesore i kësaj lënde është t‟i njoftoj dhe t‟i familjarizoj me shkaqet e krimit dhe elementet ne shoqeri duke u përqendruar në prarandalimin e krimit. Së pari, studentët do të zhvillojnë aftësit e të menduarit kritik, që do të aplikohet për të diskutuar përspektivat teorike të krimit. Së dyti, kjo lëndë do t‟i furnizoj studentët me aftësi për ta trajtuar krimin në mënyrë kritike. Së treti, kjo lëndë do të ketë në fokus dimensionet shkencore e të menduarit rreth krimeve. Në përfundim, temat që do të mbulohen në këte lëndë do të ken theks të veqant në lidhshmërin e të menduarit kritik ne kontekstin social.

**Mësimnxënia**

Studenti është në gjendje të:

- Evaluon qeshtjet sociale dhe kriminologjike si dhe adresimin e ketyre qeshtjeve.
- Analizon sjelljet kriminale, shkaqet dhe masat parandaluese.
- Implementon strategjinë parandaluese dhe strategjinë e luftimit të krimit në përgjithësi.,
- Përpilojë programe dhe projekte hulumtuese në fushën e kriminologjisë.
- Analizon krimet jake-bardha dhe teroit e krimeve jake-bardha

**Përmbajtja**

- Hyrje në Kriminologji
- Teorit e krimit
- Tipet e krimit
- Rrënjët biologjike të krimit
- Baza psikologjike dhe psikiatrike e sjelleve kriminale
- Teorit sociale te krimit
- Proceste sociale
- Konfliktet sociale
- Krimet në botën moderne
- Krimet ekonomike
- Krimet kunder prones
- Krimet pa viktima dhe viktimat pa krime
- Teknologjia dhe krimi
- Drogat dhe krimi
- E ardhmja e krimeve

**Metodat mësimore**

- Diskutime interaktive
- Punime grupore
- Punime individuale
- Seminra
- Teste dhe kuize

**Metodat e vlerësimit**

- Test me shkrim
- Punime shkencore
- Test mes‟semestral
- Provimi përfundimtar
- Diskutime intensive

**Literatura**

- Frank Schmalleger dhe John Ortiz Smykla (2007).Corrections in the 21st Centurty
- Frank Schmalleger (2007) Criminology Today: An integrative introduction.
- Robert Bohem and Keith Haley (2007). Introduction to Criminal Justice

**Literatura shtes**

- Azemi, F. ( 2014). Criminal justice and law enforcement practices

## R12. Puna Sociale

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 40 |
| Orët individuale: | 60 |
| Periudha: | Semestri 4 |
| Lloji i lëndës: | Obligative |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Lënda ofron njohuri bazike mbi Punën Sociale. Kjo lëndë u ofron studenteve informata, dhe njohuri mbi zanafillën e punës sociale. Njoftim me bazat e Punes Sociale, me drejtimet e saj shkencore dhe me raportin ne mes të teorisë dhe praktikes. Nga studentët kërkohet aftësi reaguese, ndërhyrje dhe zgjidhje urgjente, në një situatë sociale krejtësisht të paralizuar, të pajetë, ku çdo individ ka përgjegjësitë e tij. Studentët do të mësojnë për natyren e shërbimeve sociale që ofrohen në Shërbimin Korrektues dhe Shërbimin Sprovues. Studentët do të njihen me rolin e punëtorit social në qendrat korrektuese, duke filluar me përgatitjen e anamnezës sociale, planifikimin e dënimit, intervistat e rregullta, raportet rreth sjelljes dhe përmirësimit të të burgosurve dhe të paraburgosurve, këshilli multidisiplinar. Profesioni i punës sociale udhëhiqet nga parimet e drejtësisë sociale, të drejtat e njeriut, përgjegjësisë kolektive, si dhe respektimin e diversitetit. Punë sociale angazhon njerëzit dhe strukturat për të adresuar sfidat e jetës dhe nevojen të rrisin mirëqenien e tyre. Në kuadër të kësaj lënde do të paraqiten studime rasti te një punëtori social duke filluar me riedukimin e personave me sjellje devijante, aftësitë për jetë, aftësitë sociale, zhvillimi i komunitetit, puna sprovuese, , socializimi, legjislacioni, marrëdhëniet organizative, përfshirjes sociale, të drejtat e njeriut, menaxhimin e refuzimit social, rehabilitimi, terapi sjellje dhe aftësi të kufizuara.

**Mësimnxënia**

Studenti është në gjendje të:

- Të kuptojë nocionin e punës sociale
- Të identifikojë problemet sociale në komunitet
- Të njohë teoritë shkencore nga fusha e punës sociale
- Të analizojë programet për punë sociale
- Të aplikojë njohuritë bazikë nga fusha e punës sociale në praktik

**Përmbajtja**

- Hyrje në punën sociale
- Qasjet teorike te Punes Sociale
- Teorite mbi nevojat, problemet psikosociale, sjelljet devijante
- Roli i punëtorit social në qendrat korrektues
- Metodat e Punes Sociale
- Puna sociale në shërbimin sprovues.
- Standardet etike te Punes Sociale
- Puna Sociale si sherbimdhe intrvenim ne rast krize

**Metodat mësimore**

- Ligjerata, diskutime,debate,puna në grupe dhe punë praktike, seminare.

**Metodat e vlerësimit**

- Testi
- Puna seminarike
- Provimi

**Literatura**


- Ritter, Jessica. Social Work Policy Practice: Changing Our Community, Nation, and the World. Publisher: Cognella Academic Publishing; 2nd edition, 2018.
- Latessa, Edward J. What Works (and Doesn't) in Reducing Recidivism. Publisher: Routledge; 2nd edition, 2020.
- Martin, Michelle. Introduction to Social Work: Through the Eyes of Practice Settings. Publisher: Pearson; 1st edition, 2015.

## R6. Siguria dhe menaxhimi

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 70 |
| Periudha: | Semestri 4 |
| Lloji i lëndës | Obligative |
| Lloji i vlerësimit | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Institucionet për Ekzekutimin e Sanksioneve e kanë mandatin për krijimin e një mjedis sa më të sigurte, ta ruajnë rendin dhe të kujdesen për personalin, të burgosurit dhe shoqërinë. Gjatë e studimit te lendes mësimore studentet do te njoftohen për sistemet e sigurisë dhe menaxhimit me objektiv primar i cili është parandalimi i arratisjeve nga burgjet dhe te mbaj sistem sa me te sigurt. Studentet do te kenë mundësi te mësojnë tri elementet me kryesore te sigurisë te cilat janë Sigurimi Fizik, Procedural dhe ai Dinamik, ata do te kenë mundësi te mësojnë se sa janë te rëndësishme dhe te ndërlidhura këto tri elemente për te arritur një nivel te lart te sigurisë.

**Mësimnxënia**

Studenti është në gjendje të:

- Identifikoj, dhe te përcaktoj rrezikun te reagoj me kohë te merr informatën me kohë dhe te përcjell atë informatë ne vendin e duhur.
- Analizoj, mirë situatën se çfarë mund te ndodh duke i pasur parasysh mjetet qe posedojmë si dhe te merr sa me shumë informata lidhur me incidentin.
- Zbatoj, te gjitha procedurat e sigurisë te merr masat e duhura lidhur me incidentin dhe kontrollet e vazhdueshme lidhur me sistemin e sigurisë.
- Zhvilloj, planin e veprimit,
- te parandaloj zgjerimin e incidentit dhe marrjen e te gjitha masave për te parandaluar incidentin

**Përmbajtja**

- Përkufizimet, se çka kuptojmë me sigurimin Fizik, Dinamik dhe atë Procedural.
- Planet eventuale ne rast rrezikut për incidentet e mundshme qe mund te ndodhin.
- Masat e marruar ne rast te kërcënimit nga jashtë
- Aktivitete e ndryshme për menaxhimin e situatave te ndryshme në institucionet për ekzekutimin e sanksioneve penale.

**Metodat mësimore**

- Ligjëratat
- Raste studimore,
- Puna ne grupe
- Aktivitete ne rast tentim ikje

**Metodat e vlerësimit**

- Testet me shkrim
- Praktika

**Literatura**

- Byrne, James M. 2007 The culture of prison violence / James M. Byrne, Don Hummer, Faye S. Taxman Boston: Pearson, Parker, Michael. 2007 Dynamic security: the democratic therapeutic community in prison / edited by Michael Parker; foreword by John Gunn.
- Jessica Kingsley 2013, Electronically monitored punishment: international and critical perspectives / edited by Mike Nellis, Kristel Beyens and Dan Kaminski. London: Routledge, Howard League for Penal Reform 2008/ High security prisons: prisoner perspectives London, Fergus McNeill, Peter Raynor, Chris Trotter (eds.) Cullompton, Devon: Willan, 2010 Offender supervision: new directions
in theory, research and practice

## R5. Parandalimi i krimit

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 70 |
| Periudha: | Semestri 4 |
| Lloji i lëndës: | Obligative |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Politika e parandalimit të kriminalitetit është me rëndësi për çdo shoqëri demokratike. Kjo politikë në pikëpamje të aplikimit të saj kuptohet si tërësi masash të cilat në shoqërinë e caktuar zbatohen në luftë kundër kriminalitetit me qëllim të mbrojtjes nga dukuritë e rrezikshme, ndërsa në aspektin shkencor definohet si shkencë e cila merret me studimin e këtyre masave me qëllim të arritjes së mënyrave dhe metodave shoqërore më efikase në luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit. Politika e parandalimit të kriminalitetit mund të kuptohet si sistem masash për parandalimin dhe luftimin me qëllim të mbrojtjes së shoqërisë nga kriminaliteti. Qëllimi i kësaj lënde është të njoftohen studentët me teknikat dhe metodat e parandalimit të krimit, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre gjatë ekzekutimit të aktiviteteve policore.

**Mësimnxënia**

Studenti është në gjendje të:

- Fitojë njohuri për politikën e parandalimit dhe luftimit të kriminalitetit dhe vlerësimin e kriminalitetit në përgjithësi dhe për rolin e sistemit institucional në parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit
- Identifikojë dobësitë dhe përparësitë e sistemit institucional në parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit
- Analizoj shkaqet dhe faktorët e paraqitjes së kriminalitetit me qëllim të parandalimit dhe luftimit efikas të tij
- Hartojë strategji dhe të zbatojë programe bashkëkohore për parandalim dhe luftim të kriminalitetit
- Zbatojë njohuritë e fituara në parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit

**Përmbajtja:**

- Nocioni, emërtimi, historiku i parandalimit te krimit
- Parimet dhe teoritë mbi parandalimin e kriminalitetit
- Llojet e parandalimit (tipologjia) të kriminalitetit
- Bartësit kryesor të parandalimit të kriminalitetit
- Roli parandalues i familjes, shkollës, i orientimit profesional, i institucioneve të specializuara, i ndihmës postpenale, i trajtimit individual dhe grupor,
- Roli parandalues i organizatave ndërkombëtare, i opinionit publik, mjetet e informimit
- Roli i policisë në parandalimin e kriminalitetit
- Roli i institucioneve prokuroriale dhe gjyqësore në parandalimin e kriminalitetit
- Roli i politikës ndëshkimore në parandalimin e kriminalitetit
- Format e parandalimit dhe luftimit të kriminalitetit
- Parandalimi dhe luftimi i korrupsionit dhe terrorizmit

**Metodat mësimore**

- Ligjërata
- Punë grupore
- Mësimi interaktiv/punishte
- Studime rasti

**Metodat e vlerësimit**

- Prezantime individuale dhe grupore
- Punim seminari
- Test mes‟semestral
- Provimi përfundimtar

**Literatura**


- Latifi, Vesel etj. Politika e luftimit të kriminalitetit. Prishtë, 2012
- David Mackey, Kristine Levan. Crime Prevention. Paperback, 2011
- Stephen Schneider. Crime Prevention: Theory and Practice. Paperback, 2009
- Steven P Lab. Crime Prevention: Approaches, Practices, and Evaluations. Paperback, 2013

## R19. Masat dhe dënimet alternative

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 3 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 45 |
| Periudha: | Semestri 4 |
| Lloji i lëndës | Zgjedhore |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

### Hyrje në lëndën mësimore

Kjo lëndë ka për qëllim që të ofrojë njohuri të avancuara për studentë lidhur me qasjet e ndryshme teorike dhe praktike që kanë të bëjnë me problemet themelore të ekzekutimit të dënimeve alternative në shoqërinë bashkëkohore. Po ashtu, ata do të kenë mundësi që t'i thellojnë njohuritë e tyre lidhur me rregullimin ligjor të kësaj fushe dhe standardet ndërkombëtare që duhet zbatuar lidhur ekzekutimin e këtyre dënimeve. Në kuadër të kësaj lënde do të trajtohen njësi të shumta mësimore, ku duhet veçuar temat si vijon: karakteristikat dhe llojet e dënimeve alternative; Organizimi i ekzekutimit të dënimeve dhe masave alternative; Ekzekutimi i dënimit me kusht; Ekzekutimi i dënimit me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues; Ekzekutimi i dënimit me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues; Ekzekutimi i dënimit me kusht me urdhër për punë në dobi të përgjithshme; Ekzekutimi i dënimit në gjysmëliri; si dhe do të elaborohet edhe roli i Shërbimit sprovues në ekzekutimin e këtyre dënimeve.

### Mësimnxënia

Studentët janë në gjendje të:

- Të kenë njohuri të mjaftueshme lidhu qasjet e ndryshme teorike dhe praktik ekzekutimin e dënimeve alternative.
- Ti zbatojnë dënimet alternative.
- Të aftësohen që të kenë qasje kritike pikëpamjeve të autorve të ndryshëm lidh kuptimin, karateristikat dhe problem ekzekutimit të dënimeve alternativ shoqërinë bashkëkohore si dhe me trajti pozitës së personave të dënuar.

### Përmbajtja

- Kuptimi, lënda dhe metodat e studimit të Ekzekutimit të dënimeve alternative;
- Llojet e dënimeve dhe masave alternative dhe ekzekutimi i tyre;
- Organizimi i ekzekutimit të dënimeve dhe masave alternative;
- Ekzekutimi i dënimit me kusht;
- Ekzekutimi i dënimit me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues;
- Ekzekutimi i dënimit me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga Shërbimi sprovues;
- Ekzekutimi i dënimit me urdhër për punë në dobi të përgjithshme;
- Ekzekutimi i dënimit në gjysmëliri;

### Metodat mësimore

- Ligjëratat, Ushtrimet, demonstrimet;
- Diskutime debatuese
- Puna në grup;
- Punimet seminarike

### Metodat e vlerësimit

- Teste me shkrim;
- Vlerësime seminarike,
- Detyrë shtëpie dhe vlerësim klase;
- Provimi përfundimtar

### Literatura


- Rexhep Gashi, Ekzekutimi i dënimeve alternative, Prishtinë, 2013;
- Craig Russel, Alternatives to Prison: Rehabilitation and Other Program, Mason Crest Publishers, 2006;
- Dean J.Champion, Probation, Parole and Community Corrections (6 edition), Prentice Hall, 2007;
- Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale, Prishtinë, 2013; Kodi i drejtësisë për të mitur, 2010
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2013.

## R20. Etika dhe Drejtesia Sociale

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 3 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 45 |
| Periudha: | Semestri 4 |
| Lloji i lëndës | Zgjedhore |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Etika dhe Drejtesia Sociale jan dy fusha te gershetuara ne kete lende, qe sqartojne rolin e etikes dhe lidhshmerin e etikes me moralin, si dhe vene ne pah qeshtjet e drejtesis social si pergjegjesia e administratorve ndaj grupeve te ndryshme ne shoqeri, barazija gjinore, racore e relegjioze. Lidhshmeria e etikes me vendimarrje jane pika kyqe e kesaj lende. Kjo lende do t‟i ndihmoj studentet te arrin kompetencen etike dhe teknike. Gjithashtu, kjo lennde theks te veqant ka edhe vendomarrjet etike nga udheheqesit e organizatave publike, pastaj qeshtjet e te drejtave te njeriut, pergjegjesis etike dhe profesionale, dhe konfikitin e interesit. Nje aspekt te veqant qe kjo lende prek eshte edhe paknaqesija e sherbysve civil ndaj vendimarrjeve jo-etike nga udheheqesit e organizatave, qe kjo shendrrohen ne nje sistem te kundershtimit. Kjo lende trajton edhe problemet e ndryshme qe kan te bejne me etiken ne organizatat e zbatimit te ligjit.

**Mësimnxënia**

Studentët janë në gjendje të:

- Të kenë njohuri të mjaftueshme lidhur me qasjet e ndryshme teorike dhe praktike mbi etiken dhe pergjegjesin etike te sherbysve civil.
- Evaluojne vendimarrjet e administratorve apo sherbysve civil ne poziten e lidershipit.
- Të analizojne dilemat etike per qeshtje komplekse si dhe konfliktet e pergjegjesi profesionale
- Të zhvillojne dizjane etike per sherbyesit civil, dhe organizata publike.

**Përmbajtja**

- Kuptimi i etikes dhe vendimarrja etike
- Administrata publike ne shoqerine moderne dhe postmoderen: Konteksti i etikes administrative
- Pergjegjesit administrative; Qelsi i etikes administrative
- Konflikti i pergjegjesi: Dilema etike
- Etika ne organizate: Integrimi i etikes ne normat dhe strukturat organizative.
- Konfliktet eksternale dhe internale
- Rujtja e autonomis etike ne organizata: perballja me udheheqes jo-etik
- Orientimi seksual, racor dhe relegjioz ne organizatat e zbatimit te ligjit.
- Dizajnimi i filozofive etike ne administrate publike dhe korrektuese.

**Metodat mësimore**

- Ligjëratat, Ushtrimet, demonstrimet;
- Diskutime debatuese
- Puna në grup;
- Punimet seminarike

**Metodat e vlerësimit**

- Teste me shkrim;
- Vlerësime seminarike,
- Detyrë shtëpie dhe vlerësim klase;
- Provimi përfundimtar

**Literatura**


- Cooper, L. Terry (2012). The responsible administrator: An Approach to ethics for administrative Role. (6th ed. ). SAGE PUBLICATIONS.
- O‟Leary, R. ( 2014). The ethics of dissent: Managing guerrilla government. ( 2nd ed.).CQ Press, Sage Publications. Thousand Oaks, CA.

## R2. Krimi dhe Ndëshkimi

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 5 ECTS |
| Orët në klasë: | 45 |
| Orët individuale: | 80 |
| Periudha: | Semestri 5 |
| Lloji i lëndës: | Obligative |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Krimi dhe Ndëshkimi eshte nje fush e gjer qe përfshihen te gjitha juridiksionet e organeve të rendit, dhe vendimet e tyere morale. Këtu sqarohen dilemat etike të profesionistëve te drejtësis. Rëndësija e vlerave etike është theks i veqant ne kete fushë. Qëllimi kryesore i kësaj lënde është t‟i njoftoj dhe t‟i familjarizoj sudenët me njohurit rreth krimit dhe ndëshkimit, aplikimi i vendimeve dhe gjykimi moral i ndeshkimit. Justifikimi i ndeshkimit dhe qështjet dhe llojet e ndëshkimit.

**Mësimnxënia**

Studenti është në gjendje të:

- Analizoj termev kryesore dhe qështjeve kryesore te ndëshkimit
- Evaluon teorit dhe filozofin e ndëshkimit
- Njoh vlerat etike dhe mishërimi i tyre nga profesionist të forcave të rendit.
- Ofroj zgjidhje për problemet që kan të bëjnë me ndëshkimet dhe alternativat ne parandalimin e krimit

**Përmbajtja**

- Etika në drejtësi
- Etika dhe forcat e rendit
- Diskriminimi racial ne sistemin e dretesis
- Advokatët dhe etika
- Qëllimi i denimit Kriminal
- Etika dhe krijimi i rregulloreve e politikave publike
- Konsiderimi i pasojave te ndëshkimit
- Etika dhe lufta kundër terrorizmit

**Metodat mësimore**

- Diskutime interactive
- Punime grupore
- Punime individuale
- Seminra
- Teste dhe kuize

**Metodat e vlerësimit**

- Diskutime interaktive
- Punime grupore
- Punime individuale
- Seminra
- Teste dhe kuize

**Literatura**


- Banks Cindy ( 2009). Criminal Justice ethics: Theory and Practice.(2nded).
- Azemi Ferid (2014)Criminal Justice and Law Enforcement Practices. (1st ed).
- Roth, Michel (2011). Crime and Punishment; A history of Criminal Justice System

## R3. Drejtësia për të mitur

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 70 |
| Periudha: | Semestri 5 |
| Lloji i lëndës: | Obligative |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Kriminaliteti i të miturve është pjesë integrale e kriminalitetit të përgjithshëm, mirëpo për shkak të moshës si dhe shumë karakteristikave të tjera sociologjike, psikologjike, kriminalo-politike, juridike etj., në të drejtën penale kryerësit e mitur të veprave penale kanë një trajtim tjetër, trajtim me të butë, më të favorshëm në krahasim me kryerësit madhorë të veprave penale. Në të drejtën penale për të mitur janë përcaktuar dispozita të së drejtës penale materiale, të procedurës penale dhe të penologjisë përkatësisht të ekzekutimit të masave të diversitetit, masave edukative dhe të dënimeve të cilat mund të ju shqiptohen kryerëseve të mitur të veprave penale.

**Mësimnxënia**

Studenti është në gjendje të:

- Të fitojë njohuri rreth legjislacionit që aplikohet ndaj të miturve
- Të fitojë njohuri rreth karakteristikave psiko-fizike të miturve
- Të zhvillojë njohuri mbi arrestimin e përkohshëm, ndalimin policor dhe paraburgimin ndaj të miturve
- Të zhvillojë njohuri mbi ekzekutimin e masave të diversitetit, masave edukative-korrektuese dhe masave të trajtimit të detyrueshëm
- Të zhvillojë njohuri mbi ekzekutimin e dënimeve plotësuese dhe dënimit me burg për të mitur
- Të fitojë njohuri rreth qasjes dhe mënyrës së trajtimit ndaj të miturve gjatë qëndrimit në Institucion
- Të fitojë njohuri rreth risocializimit dhe ri-integrimit pas përfundimit të masës apo dënimit me burg.

**Përmbajtja**

- Parimet udhëzuese dhe dispozitat hyrëse
- Masat e diversitetit
- Masat edukative
- Gjoba dhe urdhri për punë në dobi të përgjithshme
- Burgimi për të mitur
- Masat e trajtimit të detyrueshëm dhe dënimet plotësuese
- Arrestimi i përkohshëm, ndalimi policor dhe paraburgimi
- Ekzekutimi i masave të diversitetit
- Ekzekutimi i masave edukative-korrektuese
- Ekzekutimi i dënimeve
- Ndihma pas ekzekutimit të masave për edukimin institucional ose burgimit e të miturit
- Ekzekutimi i masave për trajtimin e detyrueshëm rehabilitues ose trajtimin e detyrueshëm psikiatrik

**Metodat mësimore**

- Ligjërata
- Ushtrime
- Punë hulumtuese-grupore
- Studime rasti

**Metodat e vlerësimit**

- Teste me shkrim
- Vlerësime seminarike
- Detyrë shtëpie
- Analiza e rasteve

**Literatura**


- Prof.Dr. Ismet Salihu 2005 "E drejta penale për të mitur" Prishtinë, Shtypshkronja " Leoprint" ndërsa. Katalogimi Biblioteka Kombëtare Universitare e Kosovës.
- Prof. Dr. Azem Hajdari 2010 " Sistemi I drejtësis për të mitur" Komentari.
- Prof.Dr. Ismet Salihu. Prof. Dr. Azem Hajdari 2005 " E drejta e procedurës penale për

## R1. Penologjia

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 70 |
| Periudha: | Semestri 5 |
| Lloji i lëndës: | Obligative |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Penologjia merret me studimin, teorinë dhe praktikën e sanksioneve penale. Penologjia është shkencë mbi ndëshkimin e cila është e përbërë prej hulumtimit, pasojave gjyqësore të sjelljes devijuese të delinkuentëve. Penologjia paraqet sanksionimin e veprave kriminale dhe masave alternative për të akuzuarit. Qellimi i Penologjis është që të anlizojë dhe verifikojë njohurinë lidhur me zhvillimin e ndëshkimit, sistemet kryesore të ekzekutimit të sanksioneve, analizimin e kritereve të klasifikimit të personave të dënuar sipas ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale në burg dhe risocializimin si dhe arsyet për ndëshkim.

**Mësimnxënia**

Studenti është në gjendje të:

- Analizon problemet e qenrave korrektues, dhe te burgosurve
- Identifikon dukurit kriminale dhe te aplikoj njohuri për përmirsimin e shërbimeve në qendrat korrektues.
- Pregatit pasqyre te funksionimit te qenrave korrektues ne te kaluaren, tani dhe ne te ardhmen
- Zhvillon programe procese te kohes moderne te qendrave korrektues
- Aplikoj metodat me te avancuara te rehabilitimit ne qendrat korrektues dhe burgje.

**Përmbajtja**

- Hyrje në Penologji
- Ndëshkimet dhe efektet e tyre
- Diversiteti dhe sprovusja
- Ndëshkimet intermediate
- Burgjet
- Lirimet me kusht
- Bota e të burgosurve dhe jeta në burgje
- Popullata dhe grupet e veqanta neper burgje
- Siguria neper qendrat korrektuese dhe problemet
- Korrektusja per te mitur

**Metodat mësimore**

- Diskutime interaktive
- Punime grupore
- Punime individuale
- Seminre
- Teste dhe kuize

**Metodat e vlerësimit**

- Test me shkrim
- Punime shkencore
- Test mes‟semestral
- Provimi përfundimtar
- Diskutime intensive

**Literatura**


- Frank Schmalleger dhe John Ortiz Smykla (2007).Corrections in the 21st Centurty
- Frank Schmalleger (2007) Criminology Today: An integrative introduction.
- Robert Bohem and Keith Haley (2007). Introduction to Criminal Justice

## R21. Socializimi dhe ri-integrimi

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 70 |
| Periudha: | Semestri 5 |
| Lloji i lëndës: | Obligative |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Lënda Socializimi dhe re-integratimi do të japë një pasqyrë të punës shkencore në fushën e socializimit dhe ri-integrimit. Kjo lëndë synon të paraqesë konceptet kyçe dhe qasjet metodologjike për të kuptuar se si proceset dhe institucionet e formësojne socializimin dhe integrimin. Qëllimi i lëndës është t'i mundësoj studentëve të paraqesin, të kuptojnë, dhe zbatojnë konceptet kyçe dhe qasjet metodologjike për të kuptuar se si proceset dhe Institucionet Korrektuese e formësojnë dhe zbatojnë socializimin, ri-integrimin dhe ri-edukimin e të dënuarve. Pastaj të zhvillojë një vlerësim të çështjeve sociale në shoqërinë bashkëkohorë. Si dhe t'i mundësojnë studenteve të zbatojnë fushat e lëndës në përvojën e tyre të jetës.

**Mësimnxënia**

Studenti është në gjendje të:

- Njoh pozicione të ndryshme në debatin akademik të socializimit dhe re-integrimit;
- Demonstrojë një vetëdije kritike të natyrës së shpjegimit dhe teoritë mbi socializimin dhe integrimin;
- Do të njoh më mirë Institucionet Korrektuese dhe punën sistematike që e bëjnë këto lidhur me socializimin, ri-integrimin dhe riedukimin;
- Çështjet teorike të ofruara në këtë lëndë, studentët do të kenë mundësi ti aplikojnë gjatë punës së tyre praktike;
- Të marrin vendime dhe zgjidhin probleme me efektivitet dhe në zbatimin e ligjit

**Përmbajtja**

- Një vështrim: trajektorët e socializimit;
- Procesi i socializimit dhe ri-integrimit;
- Individi dhe shoqëria;
- Planifikimi i dënimit në Institucionet Korrektuese
- Tretmanët në Institucionet Korrektuese;
- Llojet e benificioneve në IK;
- Procesi i trajtimit dhe rehabilitimit;
- Institucionet sociale

**Metodat mësimore**

- Ligjëratat;
- Mësim interaktiv;
- Punë individuale;
- Punime seminarike;
- Puna në grupe;
- Aktivitete në hartimin e programeve;
- Rastet studimore.

**Metodat e vlerësimit**

- Teste me shkrim;
- Prezantimi i punimit seminarik;
- Vlerësime seminarike;
- Detyrë shtëpie;
- Provimi përfundimtar.

**Literatura**


- Ragip Halili, Penologjia, E drejta e Ekzekutimit të Sanksioneve Penale, 2014.
- Enrico Ferri. Criminal Sociology. Published by: Nisyros Publishers, 2014.
- Ligji mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, Prishtinë 2017;
- Udhëzimi Administrativ: Rendi shtëpiak në Institucionet Korrektuese, Prishtinë 2015;
- Rregull e brendshme, Tretmanët për të dënuar, Prishtinë 2019;

## R25. Ekzekutimi i dënimeve kryesore

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 3 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 45 |
| Periudha: | Semestri 5 |
| Lloji i lëndës | Zgjedhore |
| Lloji i vlerësimit | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Kjo lëndë ka për qëllim që të ofrojë njohuri të avancuara për studentë lidhur me qasjet e ndryshme teorike dhe praktike që kanë të bëjnë me problemet themelore të ekzekutimit të dënimeve kryesore në shoqërinë bashkëkohore. Po ashtu, ata do të kenë mundësi që t'i thellojnë njohuritë e tyre lidhur me rregullimin ligjor të kësaj fushe dhe standardet ndërkombëtare që duhet zbatuar lidhur ekzekutimin e këtyre dënimeve. Në kuadër të kësaj lënde do të trajtohen njësi të shumta mësimore, ku duhet veçuar temat si vijon: karakteristikat dhe llojet e dënimeve kryesore; Organizimi i ekzekutimit të dënimeve kryesore dhe llojeve te tij dhe tema te tjera te rendesishme.

**Mësimnxënia**

Studentët janë në gjendje të:

- Kuptoje denimet kryesore dhe ndarjen e tyre sipas legjislacionit ne fuqi
- Zbatoje dispozitat ligjore per ekzekutimin e denimeve kryesore dhe obligimeve tjera ligjore gjate zbatimit
- Hartoje plan te detajizuar per personat qe prishin rendin shtepiak qe te pergjigjen ne organet disiplinore
- Vleresoje sjelljet e personave qe jane ne vuajtje te denimit dhe te pershkruaje me raporte sjelljen e tyre nga fillimi dhe gjate vuatjes se denimit

**Përmbajtja**

- Kuptimi, lënda dhe metodat e studimit të ekzekutimit të dënimeve kryesore;
- Llojet e dënimeve kryesore;
- Organizimi dënimeve kryesore;
- Ekzekutimi i dënimit me burgim,
- Ekzekutim i dënimit me burgim afatgjatë
- Ekzekutimi i dënimit me gjobë
- Shtyerja, revokimi dhe nderprerja e ekzekutimit të dënimeve kryesore
- Kujdesi, vendosja, te drejtat e personave te denuar
- Rendi shtepiak i burgut, shkeljet disiplinore, masat dhe ekzekutimi i tyre
- Lirimi me kusht, efektet dhe afatet kohore
- Kompetenca dhe procedura për ekzekutimin e dënimit me gjobë

**Metodat mësimore**

- Ligjëratat, Ushtrimet, demonstrimet;
- Diskutime debatuese
- Puna në grup;
- Punimet seminarike

**Metodat e vlerësimit**

- Teste me shkrim;
- Vlerësime seminarike,
- Detyrë shtëpie dhe vlerësim klase;
- Provimi përfundimtar

**Literatura**

- Ismet Salihu (2015). E drejta penale – Pjesa e pergjithshme. Prishtine
- Ragip Halili (2013). Penologjia. Prishtine
- Kodi Penal i Kosoves
- Ligji per ekzekutimin e sanksioneve penale ne Kosove

## R24. Politikat Sociale

| | |
|---|---|
| Vëllimi | 3 ECTS |
| Orët në klasë: | 36 |
| Orët individuale: | 39 |
| Periudha: | Semestri 7 |
| Lloji i lëndës: | Zgjedhore |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Lënda ofron njohuri themelore rreth marrëdhënies në mes të politikave sociale në njërën anë, dhe ndryshimeve (transformimeve) shoqërore dhe kulturore që po ndodhin në shoqëri. Politikat sociale mbulojnë të gjitha dispozitat dhe masat që synojnë të parandalojnë, të mënjanojnë ose të lehtësojnë situatat e problemeve sociale, në nivel individual dhe kolektiv. Në kuadër të kësaj lënde studentët do të njihen me politikat bashkëkohore të vendeve perëndimore në përkrahjen e grupeve më të brishta të shoqërisë. Studentët do të njoftohen se politika sociale konsiston në përdorimin e pushtetit politik për të zëvëndësuar, plotësuar ose ndryshuar mekanizmat e sistemit ekonomik-social me synim për të arritur rezultate që sistemi vet nuk mund t'i arrinte. Një politikë sociale efikase ndihmon individët të jetojnë pa ankthe dhe të përshtaten me mundësitë e reja të rritjes ekonomike. Në të kundërtën, një politikë e keqe sociale është sinonim i mbetjes në varfëri ose i përjashtimit social.
Në kuptimin e ngushtë, politika sociale përcakton masat që shërbejnë drejtpërdrejt në luftën kundër varfërisë ose parandalimit të saj, në rradhë të parë sigurimet shoqërore dhe ndihma shoqërore, si dhe pagesa të tjera në mvartësi të burimeve të mundëshme. Në kuptimin e gjërë, fusha të tjera përfshihen gjithashtu në politikën sociale, të tilla si politika e tregut të punës dhe e punësimit, politika e arsimimit, e shëndetit, e strehimit, ose edhe e politika fiskale..

**Mësimnxënia**

Studenti është në gjendje të:

- Të kuptojë nocionin e punës sociale
- Të identifikojë problemet sociale në komunitet
- Të njohë teoritë shkencore nga fusha e punës sociale
- Të analizojë programet për punë sociale
- Të aplikojë njohuritë bazikë nga fusha e punës sociale në praktiktik

**Përmbajtja**

- Hyrje në politikat sociale
- Historia e krijimit te Politikave Sociale
- Teorite e Politikave Sociale
- Modelet e politikave sociale në vend dhe regjion
- Politikat sociale në vendet perëndimore
- Vullentarizimi dhe kujdesi shoqëror
- Ndikimi i politikave sociale
- Problemet sociale

**Metodat mësimore**

- Ligjerata, diskutime,debate,puna në grupe dhe punë praktike, seminare.

**Metodat e vlerësimit**

- Testi semestral
- Punime seminarike
- Provimi

**Literatura**


- Reisch, Michael. Social Policy and Social Justice (Meeting the Challenges of a Diverse Society) 3rd Edition. Publisher: Cognella Academic Publishing; 3rd edition, 2018.
- Kourachanis, Nikos. Citizenship and Social Policy, From Post-War Development to Permanent Crisis. Publisher: Palgrave Macmillan, 2020.
- Stohr, Mary K. Anthony Walsh. Corrections: From Research, to Policy, to Practice 1st Edition. Publisher: SAGE Publications, Inc; 1st edition, 2017..

## R22. Trajtimi dhe programet e rehabilitimit

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 5 ECTS |
| Orët në klasë: | 50 |
| Orët individuale: | 75 |
| Periudha: | Semestri 6 |
| Lloji i lëndës: | Obligative |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Në kuadër të kësaj lënde studenti do të njihet me procesin e trajtimit dhe rehabilitimit të të burgosurve dhe paraburgosurve. Do të mësoj për format e trajtimit, duke filluar nga ato tradicionale, psikoanalitike, bihevioriste, bihevioriste-kognitive, trajtimi sipas Milieut, Roxhersit dhe format e edukimit shoqërorë. Kjo lëndë ofron të kuptuarit e sfidave te veçanta me të cilat ballafaqohen zyrtarët korrektues, parimet dhe teknikat e veprimit, rezistenca ndaj trajtimit, dilemat etike, kufinjet e kompetences dhe ruajtja e ekspertizes. Studentët do të njihen me programet bashkëkohore rehabilituese që aplikohen në vendet perëndimore duke filluar me programin për menaxhimin e zemërimit, programi për rehabilitim nga substancat psikoaktive, programet e dhunës në familje, programet për parandalimin e dukurisë së vetëvrasjes tek të burgosurit. Rëndësi e veçantë u kushtohet të mësuarit të modeleve dhe roleve shoqërore sipas Bandurës.

Në kuadër të kësaj lënde studentët do të fitojnë njohuri dhe shkathtësi për teknikat e hartimit të programeve rehabilituese, si dhe metodat për implementimin e këtyre programeve, me theks të veçantë do tu shërbej në punën e përditshme për të trajtuar më mirë të burgosurit duke siguruar programe adekuate me qëllim trajtimin dhe rehabilitimin e tyre më të lehtë.

**Mësimnxënia**

Studenti është në gjendje të:

- Identifikojë nevojat personale të burgosurit
- Analizojë dhe kontrollojë gjendjen sociale dhe psikologjike
- Hartojë dhe zbatojë programin më të mirë, konform nevojave të burgosurve
- Zhvillojë një program pune për rehabilitim dhe trajtim.
- Të kuptojë praktikat dhe metodat më të mira për rehabilitimin e të burgosurve.

**Përmbajtja**

- Përkufizimi i trajtimit dhe programeve te rehabilitimit si koncept i gjere/Hyrje
- Metodat dhe teknikat e trajtimit dhe programet e rehabilitimit
- Llojet e trajtimeve dhe programeve rehabilituese.
- Sfidat në aplikimin e teknikave dhe programeve të ndryshme rehabilituese.
- Përvojat më të mira të rehabilitimit nga vendet e zhvilluara perëndimore
- Programet rehabilituese në parandalimin e dukurive negative.

**Metodat mësimore**

- Ligjëratat
- Punishte /Interaktivitet
- Puna në grupe
- Aktivitete në hartimin e programeve
- Rastet studimore

**Metodat e vlerësimit**

- Test me shkrim
- Vlerësime seminarike
- Detyrë shtëpie
- Provimi përfundimtar

**Literatura**


- Kratcoski, Peter C. Correctional Counseling and Treatment. Publisher: Springer; 6th ed. 2017.
- Walsh, Anthony. Jessica Wells, Shaun M. Gann. Correctional Assessment, Casework, and Counseling 6th ed. 2020 Edition. Publisher: Springer; 6th ed. 2020.
- Van Voorhis, Patricia. Emily J. Salisbury. Correctional Counseling and Rehabilitation. Publisher: Routledge; 9th edition, 2016.

## R16. Teknikat e keshillimit psikologjik

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 64 |
| Orët individuale: | 36 |
| Periudha: | Semestri 6 |
| Lloji i lëndës; | Obligative |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Këshillimi është proces thelbësor për menaxhimin dhe zhvillimin e njerëzve. Këshillimi psikologjik është këshillim i projektuar për ndërtimin dhe forcimin e motivimit të brendshëm të njerëzve, për ndryshim pozitiv të sjelljes.

Lënda ka për qëllim të pajisë studentët me aftësitë për të përcaktuar parimet dhe udhëzimet e këshillimit psikologjik, shpjeguar funksionet e parimeve të profesionit të këshillimit si dhe për te zotëruar njohuritë rreth teorive dhe teknikave të ndryshme duke i ndihmuar individët të zhvillojnë një stil personal të këshillimit.

**Mësimnxënia**

Studenti është në gjendje të:

- kuptoje dhe demostroje konceptet bazike te këshillimit psikologjik;
Klasifikimi i mallrave është baza për të gjitha procedurat doganore. Lënda përfshin të gjitha parimet qeverisëse të klasifikimit të mallrave sipas nomenklaturës. Kjo lëndë i jep studentëve kuptimin e përgjithshëm të tarifës doganore dhe si të interpretohen të dhënat e siguruara,p.sh informatat lidhur me masat ( taksat doganore dhe rregulloret e tjera të eksportit dhe importit). Tarifa doganore përmban detyrimet, kufizimet e eksportit dhe importit që janë marrë nga ligjet dhe rregulloret e doganave të Kosovës. Përmes kësaj lënde studentët do të kuptojnë rolin dhe rëndësinë e klasifikimit të mallrave dhe po ashtu do të jenë në gjendje ta bëjnë dallimin e mallrave që janë klasifikuar në kapitujt e ndryshëm për shkak të përgatitjeve shtesë

**Mësim nxënia**
Studenti është në gjendje të:
- Kuptoj Tarifën e Integruar të Kosovës - TARIK
- Klasifikojë mallrat sipas tarifës në Kosovë.
- Dallojë kapitujt e ndryshëm ku kemi raste që mallrat janë klasifikuar në dy emërtime të njëjta
- Zbatojë teknikat e klasifikimit për vendim-marrje në fushat e ndryshme
- Dijë kuptimin e klasifikimit të mallrave
- Përcaktoj dhe kuptoj efektet e përcaktimit të saktë të kodit të mallrave.
- Kuptojë rolin fiskal të klasifikimit të saktë
- Kuptojë historikun e zhvillimit të tarifave
- Kuptojë rolin e unionit doganor.
- Dallojë rolin e klasifikimit në mbrojtjen e ekonomisë gjatë historisë
- Kuptojë rolin dhe rëndësinë e zbatimit të klasifikimit të mallrave dhe po ashtu do të jetë në gjendje ta kuptojë rolin e territorit doganor dhe çështjet e tjera të përfshira në klasifikimin e mallrave;
- Mësojë lidhur me sistemin e harmonizuar të tarifës.
- Mësojë lidhur me nomenklaturën e kombinuar dhe ndryshimin e nomenklaturës

**Përmbajtja**
- Shpjegim i gjithmbarshëm i Nomenklaturës së kombinuar
- Shpjegime të hollësishme të rregullave të përgjithshme për klasifikimin e mallrave me shembuj praktik
- Shpjegime të rolit të TARIK në mbledhjen adekuate të taksave të parapara doganore

**Metodat mësimore**
- Ligjërata
- Studime-rasti
- Punë ekipore

**Metodat e vlerësimit**
- Testi me shkrim
- Raste studimi
- Punime seminarike
- Shembuj praktik

**Literatura**
- Kodi doganor dhe i akcizave i Kosovës në fuqi
- Kodi Doganor në fuqi i BE-së
- Ligjet e tjera të zbatueshme lidhur me TARIK dhe tarifa e integruar e Kosovës
- TARIK i vitit aktual
- Shënimet shpjeguese për Nomenklaturën e Harmonizuar

## D27 Klasifikimi i mallrave me normë të ndryshme doganore

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 70 |
| Periudha: | Semestri 4 |
| Lloji i lëndës: | Zgjedhore |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Lënda jep një pasqyrë të përgjithshme të rëndësisë së klasifikimit tarifor të mallrave me akcizë dhe autorizimet si dhe përgjegjësitë e doganave në jetësimin dhe zbatimin e legjislacionit doganor dhe ligjeve të tjera të aplikueshme në Kosovë që kanë të bëjnë me mallrat me akcizë. Studenti do të kuptojë se çka nënkupton tatimi i brendshëm dhe ai në kufi. Lënda i promovon aktivitetet lidhur me kompetencën profesionale në pajtim me klasifikimin e mallrave, zbatimin e ligjeve të zbatueshme dhe rëndësinë e mbrojtjes së shëndetit përmes mjeteve të kontrollit doganor.

Lënda jep një pasqyrë të plotë të rëndësisë së klasifikimit tarifor të mallrave me shkallë zero. Zyrtarët doganor duhet t'i dinë autorizimet e tyre në jetësimin dhe zbatimin e legjislacionit doganor dhe ligjet e tjera të zbatueshme në Kosovë lidhur me mallrat në këtë kategori. Përmes trajnimit, studenti do të kuptojë rolin e angazhimit fiskal në tarifë, zhvillimin industrial, shportën e klientit, etj dhe po ashtu rëndësinë dhe kuptimin e këtyre për importuesin

**Mësimnxënia**

**Studenti është në gjendje të:**

- Kuptojë se çka në nënkupton klasifikimi i mallrave me akcizë;
- Përcaktojë kodin e mallit në bazë të ligjeve të zbatueshme për mallrat me akcizë.
- Kuptojë efektet e përcaktimit të kodit të mallit për mallrat me akcizë
- Kuptojë se çka nënkupton klasifikimi i mallrave me shkallë zero.
- Kuptojë efektet e përcaktimit të kodit të mallit për mallrat me shkallë zero.
- Kuptojë rolin mbështetës të gjatë përcaktimit të kodit të saktë tarifor

**Përmbajtja**

- Shembujt e akcizave ( benzinë dhe derivate të tjera, taksa në duhan dhe alkool, taksat për veturat më të vjetra se 13 vite)
- Shpjegim i hollësishëm i mallrave të klasifikuar sipas kapitullit 24
- Shpjegimi i hollësishëm i mallrave të klasifikuar sipas kapitullit 27
- Shpjegimi i hollësishëm i mallrave me akcizë të klasifikuar sipas kapitujve 8703 dhe 8704
- Shembujt e detyrimeve me shkallë zero përmes rasteve praktike me qëllim të arritjes së kuptimit të rolit të doganave në përcaktimin e numrit të saktë tarifor
- Shpjegim i shembujve konkret të mallrave me shkallë zero të detyrimeve
- Shpjegim i rolit të MSA në shkallën e detyrimeve

**Metodat mësimore**

- Ligjërata
- Studime-rasti
- Shembuj
- Ushtrime

**Metodat e vlerësimit**

- Testi me shkrim
- Raste studimi

Punime seminarike

**Literatura bazë:**

- Kodi doganor dhe i akcizave në fuqi dhe Ligjit mbi TVSh në fuqi Dhe:
- Ligjet e tjera të zbatueshme lidhur me TARIK
- Ligjet dhe rregulloret e tjera lidhur me akcizën
- Rregullorja për përjashtim nga taksat doganore
- Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA)

## D13. Menaxhmenti dhe lidershipi në dogana

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 48 |
| Orët individuale: | 52 |
| Periudha: | Semestri 6 |
| Lloji i lëndës: | Obligative |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

### Hyrje në lëndën mësimore

Administratat e doganave po ballafaqohen me sfida të reja në raport me globalizmin, shtimin e kërkesës për lehtësimin e tregtisë efikase dhe kërcënimet ndërkombëtare të sigurisë. Doganat kanë një rol unik dhe të shumanshëm në mesin e autoriteteve publike. Administrata e doganave nevojitet të ketë menaxherë profesional të cilët janë të shkathtë, kanë njohuri dhe janë në pozitë të marrin përgjegjësi për krijimin e efikasitetit, motivimit dhe integritetit në organizatë.

### Mësimnxënia

Studenti është në gjendje të:

- Kuptojë konceptet e menaxhmentit dhe lidershipit.
- Shpjegojë rolin, përgjegjësitë dhe strukturën organizative të doganave.
- Kuptojë rolin e menaxherëve brenda organizatës doganore.
- Kuptojë rolin kryesor të menaxherit në shtrirjen e etikës, barabarësisë, qeverisjes së mirë dhe shërbimit të mirë.
- Përvetësojë parimet e buxhetimit dhe planifikimit e burimeve njerëzore.
- Zhvillojë, identifikojë dhe monitorojë treguesit kryesore të performancës.
- Komunikojë në mënyrë efikase dhe motivuese.
- Kuptojë rolin e menaxherit në menaxhimin e rrezikut.

### Përmbajtja

- Doganat e Kosovës në kuptimin global, rajonal dhe kombëtar
- Vizioni, misioni, vlerat dhe strategjitë në Doganat e Kosovës
- Struktura organizative dhe menaxhuese në Doganat e Kosovës
- Roli dhe përgjegjësitë e menaxherëve në Doganat e Kosovës
- Integriteti dhe barabarësia në dogana
- Vetëdijesimi i menaxherit

### Metodat mësimore

- Ligjërata
- Studime-rasti
- Punë ekipore
- Ushtrime

### Metodat e vlerësimit

- Diskutime seminarike
- Ese
- Studim rasti

### Literatura


- Deutschman, Alan (2010): Walk the Walk: The # 1 Rule for Real Leaders.
- Goleman, Daniel (2006): Emotional Intelligence: 10th Anniversary Edition;
- Kosovo Customs- internal rules and regulations.
- Kotter, John P. (1996): Leading Change. Harvard Business School Press.
- World Customs Organization (2008): PICARD Professional Standards. WCO.

## D29. Shpeditimi dhe shpedicionet

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 70 |
| Periudha: | Semestri 5 |
| Lloji i lëndës: | Obligativ |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Qëllimi i kësaj lënde është që t‟i ofrohet studentit një pamje e përgjithshme e shpedicioneve dhe mënyrës së operimit të tyre me fokus tek shpedicionet ndërkombëtare si pjesë e pandashme e këmbimit ndërkombëtar të mallrave. Kjo lëndë i ofron studenteve njohuritë të mjaftueshme të kuptimit teorik dhe praktik të funksionimit të shpedicionit ndërkombëtar në procesin e qarkullimit ndërkombëtar të mallrave. Sudenti po ashtu merr njohuri

**Mësim nxënia**

**Studenti është në gjendje të:**

- Kuptoj rolin dhe rëndësinë e shpedicioneve ndërkombëtare në këmbimin ndërkombëtar të mallrave
- Të mësoj dhe kuptoj mënyrën e përgatitjes së dokumentacionit përcjellës të mallit
- Të kuptoj dhe mësoj mënyrën e kryerjes së pagesave të transaksioneve ndërkombëtare
- Kuptoj kufizimet dhe licencimet e kërkuara në qarkullimin ndërkombëtar të mallrave

**Përmbajtja**

- Historiku i shpedicioneve ndërkombëtare
- Baza ligjore e operimit të agjentëve doganor dhe shpedicioneve
- Kosova dhe shpeditimi i mallrave
- Mënyra e operimit të agjentëve doganorë në BE dhe Kosovë
- Dallimet mes Shpedicioneve dhe Deklaruesve të mallit
- Dokumentacioni përcjellës i mallrave
- Rregullat Incoterms
- FIATA-Federata e ndërkombëtare e shoqatave të shpedicionit
- TIR Konventa

**Metodat mësimore**

- Ligjërata
- Demonstrime teorike dhe praktike
- Diskutime

**Metodat e vlerësimit**

- Testi me shkrim
- Raste studimi dhe punime seminarike
- Demonstrim praktik i njohurive të fituara

**Literatura:**


- Kodi Doganor dhe i Akcizave në Kosovë 03/L-109 dhe i amandementuar
- Savy M. dhe N.Burnham, “Freight Transport and the Modern Economy” Routledge, London, 2013
- Kodi Doganor në fuqi i BE
- Udhëzimet në fuqi lidhur me operimin e agjentëve doganor në Kosovë
- WTO (GATT: GATS dhe TRIPS) marrëveshjet
- *Incoterms 2010*
- *Incoterms 2020*
- Ligji pwr marwdhwniet e detyrimevev
- Convention on the international transport of goods under cover of tir carnets (TIR Convention, 1975)

## D30. Importi dhe eksporti i mallrave

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 39 |
| Orët individuale: | 70 |
| Periudha: | Semestri 5 |
| Lloji i lëndës: | Obligative |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

### Hyrje në lëndën mësimore

Importi i mallrave zakonisht kërkon përfshirjen e autoriteteve doganore si në vendin importues dhe në atë eksportues dhe shpeshherë i nënshtrohet kuotave të importit, tarifave dhe marrëveshjeve të tregtisë. Kur "importet" caktohen për mallrat dhe shërbimet e importuara, po ashtu ato "importet" nënkuptojnë vlerën ekonomike e të gjitha mallrave dhe shërbimeve të importuara. Importi është cilado e mirë( p.sh një mall) ose shërbim i bartur nga një vend në vendin tjetër në mënyrë legjitime, kryesisht për tu tregtuar.

### Mësimnxënia

Studenti është në gjendje të:

- Përshkruajë të gjitha trajtimet dhe përdorimet e miratuara doganore dhe procedurat doganore të cilat janë zbatuar kur mallrat janë deklaruar për import/eksport të paraqitura tek autoritete doganore (T1).
- Dijë se si të zbatojë të gjitha trajtimet dhe përdorimet e miratuara doganore dhe procedurat doganore të importit/eksportit në punën praktike.
- Njohë kërkesat dhe masat lidhur me importin/eksportin e mallrave sipas Kodit doganor dhe të Akcizës.
- Përcaktojë borxhin doganor, dijë të vlerësojë tatimet dhe taksat e mbledhura nga doganat, udhëzojë klientët në pyetjet lidhur me krijimin e borxhit doganor, palët përgjegjëse për pagesë dhe format e pagesës.
- Marrë parasysh sanksionet administrative lidhur me tatimimin në import/eksport.
- Jetë i vëmendshëm për procedurat e posaçme të importit/eksportit, siç janë pezullimi tarifor dhe kontingjentet tariforë, shkallët preferenciale, origjina e mallrave dhe certifikimet, marrëveshja CITES, informatat e detyrueshme mbi origjinën
- Zbatojë marrëveshjet ndërkombëtare që e kufizojnë tregtinë dhe transferin e llojeve të caktuara të mallrave dhe informatave, p.sh mallrat të ndërlidhura me armë të shkatërrimit në masë, pajisjet e avancuara të telekomunikacionit dhe po ashtu disa artefakte artistike dhe arkeologjike.
- Kuptojë barrierat tregtare (ligjet, rregulloret, politikat e qeverisë)

### Përmbajtja

- Format e transportit
- Arritjet (T1) /shkuarjet (EX1)
- Trajtimet ose përdorimet doganore të miratuara: vendosja e mallrave në procedurë doganore
- Paraqitja e deklaratës doganore
- Kufizimet e importit
- Kufizimet e eksportit
- Kontrolli i mallrave dhe mbrojtja e klientit
- Trajtimet ose përdorimet doganore të miratuara doganore
- Lirimi nga mbikëqyrja doganore

### Metodat mësimore

- Ligjërata
- Studime-rasti
- Punë ekipore

### Metodat e vlerësimit

- Testi me shkrim
- Ushtrime praktike
- Prezantime të projekteve të vogla

### Literatura bazike:

- Kodi doganor dhe i akcizave në fuqi Dhe:
- Udhëzimi administrativ nr. 09/2011
- Marrëveshjet ndërkombëtare si p.sh. Nuclear Suppliers Group, Australia Group,
- Wassenaar Agreement, Missile Technology Control Regime, CITES Agreement
- Kodi doganor dhe i akcizave 03/L-109
- UA për zbatimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave - UA 09/2011
- Ligji Nr. 05/L -037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar
- Material i përgatitur nga ligjërimet
- Bazat e Sistemit Doganor, Ylber Rraci Prishtinë, 2010
- EU Customs Code (Kodi Doganor i BE)
- Unioni Doganor në BE – Broshurë
- Konventa e Vjenës mbi shitjen ndërkombëtare të mallit
- Konventa doganore mbi transportin e mallit në bazë të TIR dhe ATA Karnetit
- Tarifa kosovare / TARIK 2020, MSA
- Doracaket e doganës së Kosovës për aplikimin e procedurave të ndryshme doganore.
- Burimet e hapura ne internet si ato të: komisionit evropian, kodit doganor shqiptar etj.

## D12. Zbatimi i politikës fiskale në dogana

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 70 |
| Periudha: | Semestri 5 |
| Lloji i lëndës: | Obligativ |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Politika fiskale është një prej mjeteve kryesore përmes së cilës qeveria e një vendi synon të arrijë objektivat e saja si: mbledhja e fondeve për buxhetin e konsoliduar, planifikimi i aktiviteteve në investime, zhvillmi ekonomik si dhe stimulimi i prodhimeve të ndryshme me theks të veçantë në prodhimet bujqësore. Varësisht nga niveli i zhvillimit ekonomik dhe asaj që qeveria dëshiron të arrijë, kjo e fundit i krijon ose i zhvillon elementet e politikës fiskale të zbatuara në forma dhe metoda të ndryshme. Kështu rëndësia e politikës ndaj politikës fiskale dhe zbatimit të autorizimeve doganore në pajtim me ligjin e doganave është vendimtare për institucionet e vendit duke marrë parasysh që të hyrat doganore përbëjnë deri në 70% të buxhetit të vendit.

**Mësimnxënia**

Studenti është në gjendje të:

- Kuptojë rëndësinë e politikës përkatëse fiskale dhe elementet e saja.
- Kuptojë lindjen e borxhit doganor dhe pagesën e saj.
- Zbatojë në praktikë akcizën, TVSH-në dhe tatimet e tjera, shkallët tatimore dhe tatimin me shkallë zero.
- Përvetësojë njohurinë e tarifave të ndryshme dhe barrierave jo-tarifore dhe po ashtu masave të ndryshme mbrojtëse

**Përmbajtja**

- Politika fiskale dhe elementet e saja.
- Borxhi doganor i pjesshëm në import, eksport, etj.
- Shlyerja e borxhit doganor
- Kuptimi i taksës doganore, akcizës TVSH dhe zbatimi i tyre praktik,
- Niveli taksave
- Përjashtimi nga taksat e importit
- Barrierat tarifore
- Barrierat jo tarifore: lejet e importit, autorizimet, ndalesat etj.
- Masat mbrojtëse në import: anti-dumping, taksa kompensuese dhe masat e veçanta

**Metodat mësimore**

- Ligjërata
- Studime-rasti
- Punë ekipore

**Metodat e vlerësimit**

- Test me shkrim
- Ese referues
- Raport referues

**Literatura:**

- Kodi doganor dhe i akcizave dhe Ligji për TVSH në fuqi Dhe:
- Udhëzimi administrativ nr. 09/2011
- Ligji për masat e veçanta
- Ligji nr. 03/L-097 për anti-dumping
- Kodi doganor dhe i akcizave 03/L-109
- UA për zbatimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave - UA 09/2011
- Ligji Nr. 05/L -037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar
- Material i përgatitur nga ligjërimet
- Bazat e Sistemit Doganor, Ylber Rraci Prishtinë, 2010
- EU Customs Code (Kodi Doganor i BE)
- Unioni Doganor në BE – Broshurë
- Tarifa kosovare / TARIK 2020.
- MSA

## D31. Origjina e mallrave

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 70 |
| Periudha: | Semestri 5 |
| Lloji i lëndës: | Obligative |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

### Hyrje në lëndën mësimore

Origjina e mallit ka rëndësi mjaft të madhe me rastin e importit dhe eksportit të mallit. Nuk është njëjtë nëse importohet – eksportohet mall nga (në) një vend me të cilin kemi marrëveshje të tregtisë së lirë apo me një vend me të cilin nuk kemi marrëveshje, pasi nga kjo varen edhe taksat të cilat iu nënshtrohet produkti konkret. Qëllimi i kësaj lënde është ta shpjegoj rolin dhe rëndësinë e trajtimit preferencial të mallrave në këmbimin ndërkombëtar të tyre.

### Mësimnxënia

Studenti është në gjendje të:

- Të fitojnë njohuri se ç „është origjina ( o r i g j i na preferenciale dhe jo-Preferenciale),
- Te dijnë rëndësinë e kumulimi bilateral, diagonal, kumulimi pan-euromediteran;
- Të kuptojnë rolin e origjinës dhe MSA
- Te fitojnë njohuri se a munden të gjitha produktet të kenë tretman favorizues në pajtim me origjinën preferenciale
- Të fitojnë njohuri cilat dokumente dëshmojnë origjinën e mallit, a ka përjashtime nga vërtetimi i origjinës.

### Përmbajtja

- Baza ligjore për përcaktimin e origjinës së mallrave
- Kuptimi i origjinës
- Përfitimi i origjinës
- Llojet e origjinës se mallit
- Marrëveshjet e ndryshme shtetërore dhe protokollet: MSA
- Origjina preferenciale dhe jo preferenciale
- Rregullat e kumulimit

### Metodat mësimore

- Ligjërata
- Studime-rasti
- Punë ekipore

### Metodat e vlerësimit

- Testi me shkrim
- Raste studimi
- Punime seminarike

### Literatura:

- Përmbledhja TAXUD 2008 për origjinën e mallrave
- Kodit Doganor dhe të akcizave në Kosovë ( Ligji Nr.03/L-109 të datës 11 Nëntor 2008)

Të tjera

- Udhëzimi Administrativ 11/2009 për implementimin e Kodit Doganor dhe te Akcizave te Kosovës
- Kodi Doganor i BE
- Udhëzuesi për përcaktimin e origjinës së mallrave
- Marrëveshja „GATT „„ pjesa e origjinës së mallrave
- Marrëveshjet ndërkombëtare/Memorandumet

## P3. E drejta e procedurës penale

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Oret individuale: | 70 |
| Periudha: | Semestri 4 |
| Lloji i lëndës | Zgjedhore |
| Lloji i vlerësimit | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Qëllimi i këtij kursi është përgatitja dhe aftësimi i studenteve, që si shërbim policor me lehtësi të përballen me sfidat e zgjidhjes së çështjeve me natyrë proceduralo-penale, të përpiloj me lehtësi shkresat procedurale, të adresojnë drejtë kalimin e çështjeve penale nga njëra faze e procedurës në tjetrën, të përgatisë drejtë dhe me lehtësi mjetet juridike me të cilat atakohen vendimet e gjykatave dhe kështu t‟i kontribuojnë luftës parandaluese të kriminalitetit.

**Mësimnxënia**

**Studenti është në gjendje të:**

- Të zbatojë me saktësi parimet bazë te se Drejtës së Procedurës Penale të Kosovës.
- Të identifikojë detyrat dhe autorizimet e subjekteve themelore (gjykatës, prokurorit te shtetit dhe policisë) ne procedure penale.
- Të identifikojë fazat zhvillimit të procedurës penale sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.
- Të kuptojë instrumentet juridike dhe llojet e tyre sipas të Drejtës së Procedurës Penale të Kosovës.

**Përmbajtja**

- Lënda (objekti) e procedurës penale
- Palët proceduralo penale
- Masat për sigurimin e të pandehurve në procedurën penale
- Procesi i të provuarit në procedurën penale
- Procedura parapenale dhe Procedura paraprake
- Procedurat Alternative
- Procedura penale kryesore dhe akuzimi
- Procedura me mjete juridike

**Metodat mësimore**

- Ligjërata, Ushtrime, demonstrime
- Diskutime debatuese
- Punimet seminarike
- Vetë hulumtim dhe hartime krijuese
- Puna në grup

**Metodat e vlerësimit**

- Prezantime individuale dhe grupore
- Punim seminari
- Test mes‟semestral
- Provimi përfundimtar

**Literatura**


- Ejup Sahit, Rexhep Murati. “E Drejta e Procedurës Penale” Prishtinë, 2016.
- Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale te Kosoves.
- Ligji për Gjykatat i Kosovës.
- Kodi i Drejtësisë për të mitur – Kosove.
- Ligji për Gjykatën Kushtetuese te Kosoves.
- Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës.
- Ligji për Prokurorin e Shtetit – Kosove.
- Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës.
- Ligji për Avokatinë – Kosove.

## D32. Lehtësirat doganore

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 70 |
| Periudha: | Semestri 5 |
| Lloji i lëndës: | Zgjedhor |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Përjashtimi nga detyrimi/taksa jepet vetëm për lëndë të parë/pjesë të makinerisë/pajisje të përdorura drejtpërdrejtë në procesin e prodhimit të kompanisë duke u bazuar në kodin doganor dhe të akcizës ose ligjet e tjera të miratuara nga agjencionet ose ministritë qeveritare.
Mallrat e importuara ose të blera nga misionet diplomatike, konsullatat dhe personeli i tyre mund të përjashtohen nga akciza dhe taksat doganore, duke iu nënshtruar kushteve të caktuara.

**Mësimnxënia**

Studenti është në gjendje të:

- Zbatojë trajtimin përkatës të përdorimit të miratuara doganor për dispozitat e dhëna në anekset A, B, C dhe D të kodit doganor të akcizës.
- Dijë ligjet, rregulloret dhe udhëzimet administrative të publikuara nga Kuvendi i Kosovës (Gazeta Zyrtare).

**Përmbajtja**

- Përjashtimet prej dispozitave të kodit doganor dhe të akcizës si dhe udhëzimet administrative për zbatimin e ligjet
- Përjashtimet prej dispozitave të ligjeve dhe rregulloreve të tjera (nga administrata tatimore, ministritë e caktuara dhe agjencionet e tjera qeveritare ose diplomatike)
- Njohuri lidhur me kodet procedurale të zbatuara në veçanti për secilin rast të përjashtimit

**Metodat mësimore**

- Ligjërata
- Studime-rasti
- Punë ekipore

**Metodat e vlerësimit**

- Testi me shkrim
- Punime seminarike

**Literatura bazike:**

- Kodi doganor dhe i akcizave Dhe:
- Udhëzimi administrativ nr. 09/2011
- Ligjet, rregulloret, politikat e tjera qeveritare

## D20. Magazinimi doganor

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 70 |
| Periudha: | Semestri 6 |
| Lloji i lëndës: | Obligativ |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Nga perspektiva financiare, procedurat doganore me ndikim ekonomik luajnë një rol të rëndësishëm për importin dhe eksportin e prodhimeve. Kur të lëshohen autorizimet paraprake për mallrat nën Procedurën Doganore me Ndikim Ekonomik – magazinimin (deponimin doganor) ju mundeni t‟i shmangeni taksave doganore në tërësi ose së paku t‟i shtyni deri sa malli në fjalë të hyjë në qarkullim tregtar të vendit tuaj. Prandaj edhe qëllimi i kësaj lënde është të shpjegohet roli i Procedurave Doganore me Ndikim Ekonomik me fokus në ate tregtar që ka të bëjë me deponimin doganor.

**Mësimnxënia**

Studenti është në gjendje të:

- Zbatojë të gjitha trajtimet dhe praktikat e miratuara lidhur me procedurat me ndikim ekonomik (PMNE).
- Dijë si ta zbatojë PMNE – deponimin doganor në punën praktike duke nënkuptuar me këtë se është në gjendje të përzgjedh trajtimet ose përdorimet e sakta të miratuara doganore.
- Përvetësojë njohurinë e kërkesave dhe masave lidhur me importin e mallrave sipas Kodit Doganor dhe të Akcizave.
- Të njoh autorizimet dhe arsyet e lëshimit të autorizimeve për magazinim doganor
- Të njohet me riskun i cili përcjell monitorimin dhe mbikëqyrjen e operatorëve ekonomik nën autorizimet e lëshuara.
- Te kuptojnë njohurit themelore për magazinim doganore
- Te fitojnë njohurit e duhura për llojet e procedurave doganore me ndikim ekonomik.
- Ti janë te njoftuar kur lejohet transferimi i mallrave nën procedurën e deponimit doganor - llojet e tranfereve dhe kushtet
- Te fitojnë njohurit e duhura për përgjegjësitë e drejtuesit të depos dhe depozitorit, operacionet e trajtimit
- Të jenë në gjendje që njohuritë e fituara t'i aplikojnë në punën praktike

**Përmbajtja**

- Caktimi i mallrave për trajtimet e mallrave doganore të miratuara sipas autorizimit
- Paraqitja e deklaratës doganore sipas autorizimit
- Taksat doganore të mbuluara me garancinë bankare dhe risku i mbikëqyrjes doganore
- Sistemi elektronik i mbikëqyrjes
- Kontrolli dhe monitorimi i mallrave dhe mbrojtja e klientit
- Trajtime dhe përdorime të tjera të miratuara doganore
- Lëshimi në qarkullim të lirë (IM4)

**Metodat mësimore**

- Ligjërata
- Studime-rasti
- Punë ekipore

**Metodat e vlerësimit**

- Testi me shkrim
- Analiza e rasteve
- Punime seminarike

**Literatura bazike:**

- Kodi doganor dhe i akcizave dhe:
- Udhëzimi administrativ nr. 09/2011
- Doracakët për PMNE nga Zyra Ligjore e Doganës së Kosovës
- Doracak mbi shfrytëzimin e ASYCUDA World
- Udhëzimi administrativ nr. 09/2011
- Doracakët për PMNE nga Zyra Ligjore e Doganës së Kosovës
- Doracak mbi shfrytëzimin e ASYCUDA World
- Udhëzim numër 07 i dates27.03.2019, protokolli 7776 mbi zbatimin praktik te regjimit te Magazinimit Doganor

## D23. Kontrabanda dhe informaliteti

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 70 |
| Periudha: | Semestri 6 |
| Lloji i lëndës: | Obligative |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**
Shërbimi doganor ka një mision të gjerë duke filluar prej mbrojtjes së shtetit, ekonomisë dhe qytetarëve. Prandaj, misioni i shërbimit doganor mund të ndahet në dy kategori kryesore:
*1. Kontributi për çështjet ekonomike dhe 2. Luftimi i aktiviteteve ilegale*
Luftimi i aktiviteteve ilegale përfshin: praninë e shtuar të sigurimit në pikë kalimet kufitare, luftimi i krimit në kufi, luftimin e trafikimit me narkotikë, etj. Mbrojtjen e popullsisë dhe mjedisit, parandalimin e kontrabandës me armë dhe substanca eksplozivë. Luftimi i kontrabandës si pjesë e "luftimit të aktiviteteve ilegale" ka rol shumë të rëndësishëm në kontrollin doganor dhe në fushën e sigurisë në punë. Pozita gjeografike e Kosovës e cila ndodhet në mes të Ballkanit dhe mundësia e kalimit nëpër te, të mallrave të ndaluara, e shton rëndësinë e rolit të procedurave dhe personelit mjaft të motivuar dhe profesional në luftimin e kontrabandës. Lënda përbëhet prej dy pjesëve: Aspekti ligjor i operimit të ekipeve në luftimin e kontrabandës, procedurat e punës dhe autorizimet e kontrolleve; aspektet praktike-mjetet dhe metodat e operimit të ekipeve në luftimin e kontrabandës

**Mësimnxënia**
Studenti është në gjendje të:
- Kuptojë kontrabandën dhe ndikimin e saj n në shoqëri.
- Elaborojë dhe demonstrojë rëndësinë e luftimit të kontrabandës në shoqëri.
- Fitojë njohuri të fushave të ndryshme të operimit të ekipeve të luftimit të kontrabandës.
- Kuptojë rëndësinë e bashkëpunimit në luftimin e kontrabandës me grupet e ndryshme të interesit dhe në gjendje të kontribuojë përmes kontributit personal.
- Kuptojë rëndësinë e bashkëpunimit të luftimit të kontrabandës me grupet ndryshme të interesit dhe në gjendje të kontribuojë përmes kontributit personal.
- Fitojë njohurinë dhe kompetencat themelore të çështjeve të luftimit të kontrabandës dhe pajisjeve dhe metodave të përdorura në kontrollin doganor.
- Kuptojë dallimin ndërmjet kontrolleve në kufijtë e jashtëm dhe të brendshëm.
- Fitojë njohurinë themelore të përdorimit përkatës të pajisjeve të ndryshme të sofistikuara siç janë skanerët dhe pajisjet për kontroll të thellë.
- Zhvillojë planin e luftimit të kontrabandës.

**Përmbajtja**
- Përkufizimi i kontrabandës
- Konceptet ligjore dhe praktike të luftimit të kontrabandës
- Parimet dhe metodat e luftimit të kontrabandës
- Kontrollet doganore të zbatuara në luftimin e kontrabandës dhe aktivitetet e zbatuara për menaxhimin e projektit

**Metodat mësimore**
- Ligjërata
- Studime-rasti
- Punë ekipore
- Ushtrime praktike

**Metodat e vlerësimit**
- Testi me shkrim
- Punë seminarike,
- Raste studimi

**Literatura:**
- Kodi doganor dhe i akcizave në fuqi Dhe:
- Udhëzimi administrativ 09/2011
- Ligji kundër shpëlarjes së parasë
- Udhëzimet e tjera administrative
- Kodi doganor i BE-së - Regulation EEC, Nr 2913/92, Pb. KE 1992

## D1. Institucionet globale dhe tregtia ndërkombëtare

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 70 |
| Periudha: | Semestri 6 |
| Lloji i lëndës: | Obligative |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Qëllimi i kësaj lënde është t"iu ofrohet studentëve njohuritë bazike të teorive të tregtisë ndërkombëtare dhe trendëve zhvillimore në tregtinë ndërkombëtare në dekadat e fundit. Vëmendje e posaçme i është dhënë pozicionit të tregtisë ndërkombëtare në Evropën Qendrore dhe Lindore. Kjo lëndë ofron një qasje për pasojat e ndryshimeve të tanishme në tregtinë ( e atëhershme) lindje-perëndim për mundësitë e tregtimit brenda rajonit. Pjesët e rëndësishme të lëndës paraqesin institucionet ndërkombëtare dhe efektet e globalizmit në tregtinë botërore dhe ekonominë botërore.

**Mësimnxënia**

Studenti është në gjendje të:

- Kuptojë trendet bazike në tregtinë ndërkombëtare
- Kuptojë fazat e proceseve integruese
- Shpjegojë bazat e teorive të tregtisë ndërkombëtare
- Analizojë ndikimet e globalizimit në tregtinë ndërkombëtare dhe ekonominë botërore
- Shpjegojë përmbajtjet e marrëveshjeve të tregtisë së lirë

**Përmbajtja**

- Globalizimi i ekonomisë botërore dhe tregtisë ndërkombëtare
- Aspektet makroekonomike të globalizimit
- Organizatat Ekonomike Ndërkombëtare dhe bizneset globale me referim WTO (GATT, GATS, TRIPS), WCO, UNCTAD, IMF dhe Bankën Botërore
- Rajonizimi dhe integrimi ekonomik – EU, EFTA, NAFTA, CEFTA
- Politika tregtare ndërkombëtare, liberalizimi dhe proteksionizmi

**Metodat mësimore**

- Ligjërata
- Studime-rasti
- Punë ekipore
- Mediumet elektronike

**Metodat e vlerësimit**

- Testi me shkrim
- Ese analitike

**Literatura:**


- Ralph Folsom International Trade Law Including the WTO, Technology Transfers, and Import/Export/Customs Law (Concise Hornbook Series) 2017
- Anne O Kruger ,International Trade: What Everyone Needs to Know , Oxford University Press October , 2020
- Marc Melitz,Paul R.Krugman,Maurice Obstfeld, International Trade: Theory and Policy, 2018
- Anne O. Krueger, ed. Chicago: University of Chicago Press, 401-410. Dhe:
- Stephen, B. & Laird, S. (2011): The International Trade Centre: Export Impact for Good (Global Institutions). Kindle Edition.
- Bhagwati, Jagdish (2004): In defense of globalization. New York: Oxford University Press.
- Krugman, P., Obstfeld, M. & Melitz, M. (2011): International Economics, Theory and Policy, 9 edition, USA.
- Krueger, Anne O. (1998): An Agenda for the WTO. In The WTO as an International Organization,
- **James Raymond Vreeland** The International Monetary Fund (IMF): Politics of Conditional Lending (Global Institutions)1st edition (December 6, 2006)

## D14. Vlera doganore e mallrave

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 48 |
| Orët individuale: | 52 |
| Periudha: | Semestri 6 |
| Lloji i lëndës: | Obligativ |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

### Hyrje në lëndën mësimore

Vlerësimi i mallrave për qëllime doganore është një prej faktorëve kryesorë që ndikojnë në të hyrat doganore marrë parasysh që në shumicën e rasteve taksat doganore për mallrat dhe shërbimet janë kalkuluar sipas vlerës "ad valorem". Për të përcaktuar vlerën e mallrave është shumë e nevojshme të dihen kushtet e tregtisë ndërkombëtare Incoterms 2010, lidhur me ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive të shitësve dhe blerësve, cilat elemente janë përshirë në vlerën doganore dhe elementet që mund të përjashtohen. Me qëllim të përcaktimit të vlerës doganore, rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve të importuesve dhe eksportuesve dhe autorizimeve doganore, vlera doganore do të përcaktohet sipas metodologjisë së përshkruar në kodin doganor dhe të akcizave të Republikës së Kosovës , si dhe nenit 7 të marrëveshjes GATT. Qëllimet tona për shpejtimin e procedurave doganore, lehtësimin e tregtisë legjitime dhe shfrytëzimit efikas të potencialeve të ndryshme krijon nevojën për menaxhimin e rrezikut në pikëpamje të vlerës doganore në bazë të informatave preliminare gjyqësore.

### Mësimnxënia

Studenti është në gjendje të:

- Të vlerësoj se drejtë vlerën doganor të mallrave në raport me inkasimin e taksave të ligjshme dhe mbrojtjen nga evazionit fiskal.
- Të zbatojnë metrologjinë e bazuar hap pas hapi lidhur më gjashtë (6) metodat e vlerësimit doganor të mallrave, të përcaktuar nga dispozita e Kodit Doganor dhe nenit 7 i GATT.
- Të zbatojnë drejtë faktorët ndikues, Incotermet dhe elementet tjera të rëndësishme në përcaktimin e drejtë të vlerës doganore,
- Të zbatojnë menaxhimin e rrezikut për vlerën doganore, në funksion të përshpejtimit të procedurave doganore, mbrojtjen e te hyrave, lehtësimin e tregtisë legjitime duke krijuar raporte të barabarta mes subjekteve të përfshira në procedurën e importit dhe eksportit.

### Përmbajtja

- Baza ligjore për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore
- Vlera e mallrave për qëllime doganore
- Gjashtë metodat e vlerësimit të mallrave
- Elementet e vlerës doganore, çmimeve, rabateve, zbritjeve dhe elementeve të tjera
- Incoterms 2010, katër grupet kryesore dhe 11 kushtet e tregtisë ndërkombëtare
- Menaxhimi i rrezikut në pikëpamje të vlerës doganore.

### Metodat mësimore

- Ligjërata
- Studime-rasti
- Punë ekipore

### Metodat e vlerësimit

- Testi me shkrim
- Punime seminarike
- Raste studimi

### Literatura bazike

- Kodi doganor dhe i akcizave në fuqi dhe Marrëveshja „GATT „„ neni 7 Dhe:
- Udhëzimi administrativ për vlerësimin doganor
- Rregullat Incoterms 2010
- Marrëveshjet ndërkombëtare/Memorandumet
- Përmbledhja TAXUD 2008 për vlerësimin e mallrave
- Kodi Doganor dhe i Akcizave , Ligji 03/L-109,
- Udhëzim nr. 3, datë 23.1.2018 për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore
- U.A. që implementon KDAK-se 11/2009,
- Marrëveshja për zbatimin e nenit VII- të GATT,
- Udhëzues mbi vlerësimin e mallrave të importuara për qëllime doganore, TVSh-ë dhe informata statistikore.
- BAZAT E SISTEMIT DOGANOR - – Ylber Rraci - 2010
- EU Customs Code (Kodi Doganor i BE-së),
- Marrëveshja GATT dhe OBT,
- Unioni Doganor në BE – Broshurë,
- Dokumenti Blueprint,
- Rregullat e Incotermesve,
- Marrëveshjet dhe memorandumet ndërkombëtare
- Marrëveshjet e Organizatës botërore për tregti,
- Blueprintet (projektet) Doganore

## D19. Përpunimi i brendshëm doganor dhe përpunimi nën kontrollin doganor

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 70 |
| Periudha: | Semestri 6 |
| Lloji i lëndës: | Zgjedhore |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

### Hyrje në lëndën mësimore

Dy nga Procedurat doganore me ndikim ekonomik të luajnë një rol të rëndësishëm dhe kanë fokus më të madh tek prodhuesi janë Përpunimi i Brendshëm dhe Përpunimi nën Kontroll Doganore. Qëllimi i këtyre regjimeve pezulluese është favorizimi i prodhimit vendor duke mundësuar importin e lëndës së parë dhe materialeve tjera përcjellëse nën regjimin e pezullimit të taksave deri në momentin e lëshimit në qarkullim të lirë të produktit kompensues (produktit të përfituar pas përpunimit).

### Mësimnxënia

Studenti është në gjendje të:

- Dalloj regjimin pezullues të përpunimit të brendshëm dhe atij nën kontroll doganore
- Të dijë kur lëshohen autorizimet për Përpunim të brendshëm dhe kur për atë nën kontroll doganore
- Të njoh autorizimet dhe kriteret të cilat duhen plotësuar për lëshimit e tyre për këto dy regjime pezulluese.
- Të njohet me riskun i cili përcjell monitorimin dhe mbikëqyrjen e operatorëve ekonomik nën autorizimet e lëshuara për këto dy regjime

### Përmbajtja

- Hyrje në regjimet pezulluese të përpunimit të brendshëm dhe Përpunimit nën kontroll Doganore
- Procedura e Përpunimit te Brendshëm nën RP si dhe funksionimi e kësaj procedure.
- Procedura e Përpunimit nën kontroll doganore
- Paraqitja e deklaratës doganore sipas autorizimit
- Taksat doganore për Produktet kompensuese
- Beneficionet nga Përpunimi i Brendshëm

### Metodat mësimore

- Ligjërata
- Studime-rasti
- Punë ekipore

### Metodat e vlerësimit

- Testi me shkrim
- Analiza e rasteve
- Punime seminarike

### Literatura:


- Kodit Doganor dhe të akcizave në Kosovë ( Ligji Nr.03/L-109 të datës 11 Nëntor 2008) Dhe:
- Udhëzimi Administrativ 11/2009 për implementimin e Kodit Doganor dhe te Akcizave te Kosovës
- Doracakët për PMNE nga Zyra Ligjore e Doganës së Kosovës
- Doracak mbi shfrytëzimin e ASYCUDA World

## D18. Kontrolli i trafikut ajror dhe pasagjerëve

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 70 |
| Periudha: | Semestri 6 |
| Lloji i lëndës: | Zgjedhore |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

### Hyrje në lëndën mësimore

Kontrolli doganor i trafikut ajror si pjesë e kontrollit doganor është një procedurë komplekse e cila kërkon profesionalizëm të lartë dhe mjete moderne të kontrollit. Lënda përfshin sigurinë në punë si temë e kontrollit ajror.

### Mësimnxënia

Studenti është në gjendje të:

- Elaborojë dhe demonstrojë rëndësinë e rolit të sigurisë në punë në kontrollin ajror.
- Fitojë njohurinë e metodave të ndryshme të kontrollit doganor të aeroplanëve dhe pasagjerëve.
- Fitojë njohurinë themelore dhe kompetencat ligjore në kontrollin doganor të aeroplanëve
- Fitojë kontrollin themelor të përdorimit përkatës të pajisjeve dhe metodave të përdoruara në kontrollin doganor (aeroplanë dhe aeroporte)
- Zhvillojë planin e veprimit lidhur me mallrat dhe pasagjerët e profilizuar me rrezik të lartë

### Përmbajtja

- Kontrolli i aeroplanëve
- Kontrolli i pasagjerëve dhe bagazhit
  Përdorimi përkatës i skanerëve
- Përdorimi përkatës i mjeteve të kontrollit në aeroporte
- Kontrolli i mallrave të arritura me aeroplan
- Kontrolli përkatës i të gjitha dokumenteve lidhur me trafikun ajror
  Përdorimi i profileve moderne të rrezikut
  Aspektet ligjore – bazat e përdorimit ë autorizimeve
- Përkufizimi i sigurisë në punë në kontrollin e aeroplanëve
- Parimet dhe metodat e sigurisë në punë dhe kontrolli doganor i pasagjerëve
- Roli i sigurisë në punë në të gjitha procedurat e kontrollit
- Aspektet praktike- mjete dhe metodat e kontrollit të trafikut ajror
- Konceptet ligjore dhe praktike të aeroplanëve dhe kontrollit të pasagjereve

### Metodat mësimore

- Ligjërata
- Studime-rasti
- Punë ekipore
- Ushtrime praktike

### Metodat e vlerësimit

- Testime
- Analiza e rasteve

### Literatura

## D8. Menaxhimi i krizave

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 70 |
| Periudha: | Semestri 7 |
| Lloji i lëndës: | Obligative |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Qëllimi kryesor është t‟i njoftojë studentët me menaxhimin e krizës si proces, menaxhimin e ngjarjeve të mëdha që kërcënojnë apo dëmtojë organizimin e sistemit, apo publikun e gjerë.

**Mësimnxënia**

Studenti është në gjendje të:

- Përcaktojë kuptimin dhe lëndën e menaxhimit të krizave.
- Zbatojë njohurinë e fituar në menaxhimin e krizës duke përfshirë kërcënimet dhe shmangien e kërcënimeve
- Menaxhojë situatat e krizës sipas rolit
- Identifikojë rolet e institucioneve të sigurisë të përfshira në menaxhimin e krizës
- Njohë modelet dhe teoritë lidhur me menaxhimin e krizave në Kosovë

**Përmbajtja**

- Kuptimi i krizave
- Veçoritë e krizave
- Llojet e krizave-burimet shkaqet dhe pasojat
- Tipologjia e krizave-llojet dhe ndikimet e mundshme
- Modelet dhe teoritë lidhur me menaxhimin e krizës
- Parashikimi i krizave dhe planifikimi i menaxhimit të krizave
- Planifikimi i emergjencave
- Korniza institucionale e menaxhimit të krizave-struktura kombëtare e menaxhimit
- Roli dhe përgjegjësit e institucioneve në menaxhimin e krizave
- Izolimi i krizave
- Komunikimi gjatë krizave
- Shkollat e menaxhimit të krizave
- Roli i lidershipit në menaxhimin e krizave

**Metodat mësimore**

- Ushtrimet, demonstrimet, interpretimet, praktikat,
- Diskutime debatuese
- Punimet seminarike
- Vetë hulumtim dhe hartime krijuese
- Puna në grup

**Metodat e vlerësimit**

- Teste me shkrim
- Vlerësime seminarike
- Detyrë shtëpie
- Vlerësim klase
- Provimi përfundimtar

**Literatura bazë**


- Gashi,B., Jusufi, Xh. (2012): Menaxhimi i Krizave, Dukagjini, Pejë
- Faggiano, V. (2011): Critical Incident Management: A Complete response Guide. 2 Edition. CRC
- United Nations Foundation, OCHA, Harvard Humanitarian Initiative and Vodafone foundation. 2011..http://www.unfoundation.org/news-and-media/publications-and-speeches/disaster-relief-2report.html
- Fink, S. (2002): Crisis Management, planning for Inevitable, SHBA
- Mitroff, I., Anagnos, G. (2001): Managing Crises Before They Happen New York
- Hillyard, M. (2000): Public Crisis Management, SHBA
- Boin, A., Hart, P.l, Stern, E., Sundelius, B. (2005): The Politics of Crisis Management, Britani e Madhe,
- Sistemi i Integruar i Menaxhimit te Emergjencave dhe Plani i Reagimit Kombëtar- I miratuar nga Qeveria e Republikes se Kosoves, Prishtinë 2011

## D21. Inteligjenca dhe hetimi

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 70 |
| Periudha: | Semestri 7 |
| Lloji i lëndës: | Obligativ |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Përmbushja e misionit doganor duke filluar nga mbrojtja e shtetit, ekonomisë dhe qytetarë, kërkon përkushtimin e plotë e të gjitha burimeve doganore, si të hyrave dhe po ashtu edhe zbatimit të ligjit. Inteligjenca dhe hetimi janë dy aktivitete vendimtare brenda vet doganave si zbatues i ligjit të cilat i mbështesin doganat në mbledhjen e tatimeve për ekonominë e Kosovës. Këto aktivitete janë të nevojshme në përmbushjen e që të dyja misioneve të shërbimit doganor të cilat janë (1) kontributi për çështjet ekonomike ( mbledhja e taksave doganore, kontrolli import/eksport, mbrojtja e ekonomisë, mbrojtja e markës tregtare dhe marrja e përgjegjësisë për të dhënat statistikore të tregtisë) dhe (2) kontributi për sigurinë (luftimi i aktiviteteve ilegale, luftimi i krimit kufitar, luftimi i trafikimit me narkotikë, mbrojtja e popullsisë dhe mjedisit, parandalimi i kontrabandës me armë dhe eksplozivë). Lënda përbëhet prej dy pjesëve: Baza ligjore e inteligjencës dhe hetimit, procedurat e punës dhe autorizimet e zyrtarëve dhe Aspektet praktiket – mjetet dhe metodat e inteligjencës dhe hetimit

**Mësimnxënia**

Studenti është në gjendje të:

- Kuptojë inteligjencës doganore rolin dhe kompetencat.
- Kuptojë rolin hetimor dhe kompetencat e doganave .
- Ketë kuptim të qartë lidhur me ndikimin e inteligjencës në rritjen e efikasitetit të aktiviteteve të tjera doganore.
- Kuptojë rolin e hetimit dhe inteligjencës në luftimin e shpëlarjes së parasë, luftimin e ekonomisë joformale dhe evazionin tatimor , luftimin e tregtisë ilegale dhe mallrave të ndaluara
- Elaborojë dhe demonstrojë rëndësinë e inteligjencës dhe hetimit për doganat.
- Fitoj njohuri të fushave të ndryshme të operimit nga ekipet e inteligjencës.
- Kuptojë rëndësinë e bashkëpunimit të inteligjencës për luftimin e grupeve të kontrabandës dhe grupeve të tjera të interesit dhe në gjendje të kontribuojë përmes kontributit personal .
- Fitojë njohurinë dhe kompetencat themelore të pajisjeve dhe metodave të shfrytëzuara.
- Kuptojë bazën ligjore të Kodit Penal të Kosovës dhe procedurës Penale të Kosovës.
- Zhvillojë planin e veprimit të inteligjencës.

**Përmbajtja**

- Përkufizimi i inteligjencës dhe hetimit
- Konceptet ligjore dhe praktike të inteligjencës
- Konceptet ligjore dhe praktike të hetimit
- Parimet dhe metodat e inteligjencës dhe hetimit

**Metodat mësimore**

- Ligjërata
- Studime-rasti
- Punë ekipore
- Ushtrime praktike

**Metodat e vlerësimit**

- Test me shkrim
- Prezantime seminarike

**Literatura**

- Kodi Penal i Republikës së Kosovës dhe Kodi i procedurës penale i Republikës së Kosovës Dhe
- Kodi doganor dhe i akcizave (KDA) në fuqi
- UA 11/2009 mbi zbatimin e KDA

## D22. Analiza e rrezikut dhe kontrolli post-doganor

| | |
|---|---|
| Vëllimi: | 4 ECTS |
| Orët në klasë: | 30 |
| Orët individuale: | 70 |
| Periudha: | Semestri 7 |
| Lloji i lëndës: | Obligativ |
| Lloji i vlerësimit: | Diferencuar |

**Hyrje në lëndën mësimore**

Një prej pjesëve më të rëndësishme të zbatimit të ligjit doganor e cila e ruan baraspeshën ndërmjet lehtësimit tregtar dhe mbrojtjes së shoqërisë është sektori i analizës së rrezikut. Profilizimi përkatës dhe profesional i kompanive importuese dhe subjekteve të tjera do ta mbështesnin mjaft shumë pjesën e atyre zyrtarëve doganor të cilët punojnë në kufi. Meqë gabimi mund të ndodh në çdo kohë ekziston sektori i kontrollit post-doganor.Detyrat e raportit të analizës së rrezikut dhe auditimit post-doganor përbëhet prej dy pjesëve:

- *aspekti ligjor i operimit të analizës së rrezikut dhe post-auditimit, procedurat vijuese dhe autorizimi i zyrtarëve*
- *aspektet praktike – mjetet dhe metodat e operimit të analizave të rrezikut dhe post –auditimit.*

**Mësimnxënia**

Studenti është në gjendje të:

- Kuptojë analizat e rrezikut, profilet e rrezikut dhe profilizimin, rolin dhe kompetencat.
- Kuptojë kontrollin post doganor, rolet dhe kompetencat.
- Ketë një pasqyrë të qartë lidhur me ndikimin e analizave të rrezikut në rritjen e efikasitete të sektorëve të tjerë doganor.
- Ketë një pasqyrë të qartë të kompetencave dhe rolit të sektorit post-aedit në shtimin e efikasitetit të hyrave doganore.
- Të marrin njohurit lidhur më kompetencat dhe rolin e Sektorit të Analizës se Riskut dhe Sektorin Post –doganor në rritjen e efikasitetin të hyrave doganore;
- Të demonstrojnë rendësin e bashkëpunimit të njësiteve te analizës së riskut dhe kontrollit post-doganor dhë të zhvillojnë plane të përbashkëta të veprimit
- Elaborojë dhe demonstrojë rëndësinë e analizave të rrezikut dhe post-auditimit për doganat.
- Fitojë njohuri të fushave të ndryshme të operimit të analizave të rrezikut dhe post-auditimit.
- Kuptojë rëndësinë e bashkëpunimit të ekipeve të analizave të rrezikut me ato të post-auditimit dhe grupeve të tjera dhe në gjendje të kontribuojë përmes kontributit personal.
- Kuptojë bazën ligjore të pjesës së Kodit doganor të Kosovës lidhur me analizën e rrezikut dhe post- auditimit
- Zhvillimin e planit të veprimit të kontrollit post- doganor.

**Përmbajtja**

- Përkufizimi i analizave të rrezikut dhe post-auditimit
- Konceptet ligjore dhe praktike të analizës së rrezikut
- Konceptet ligjore dhe praktike të post-auditimit
- Parimet dhe metodat e analizës së rrezikut dhe post-auditimit

**Metodat mësimore**

- Ligjërata
- Studime-rasti
- Punë ekipore
- Ushtrime praktike

**Metodat e vlerësimit**

- Testi me shkrim
- Punë seminarike
- Raste studimi

**Literatura:**


- Kodi doganor dhe i akcizave në fuqi dhe Udhëzimi administrativ 09/2011
- Ligji kundër shpëlarjes së parasë, Udhëzimet e tjera administrative
- Kodi doganor i BE-së - Regulation EEC, Nr 2913/92, Pb. KE 1992
- Konventa ndërkombëtare lidhur me thjeshtësimin dhe harmonizimin e procedurave doganore (Konventa e rishikuar e Kjotos 1999)
- Revizioni Financiar dhe Kontrolli i proceseve Afariste në Ndërmarrje, Shefket Jakupi, Hidajet Shehu, Prishtinë, 2011
- Auditimi, Vjollca Karapici, 2010, Tiranë;

**Metodat e vlerësimit:**

- Portofoli i punës praktike
- Raporti i punës praktike
- Raporti i Vetvlersimit
- Prezantimi i raportit të punës praktike në seminar

**Analiza SWOT për përmbajtjen e procesit arsimor:**

**A. Pikat e forta**

- Programi është i harmonizuar me nevojat dhe kërkesat që kanë agjencitë e sigurisë publike.
- Programi është përkrahur dhe mbështetur me ekspertizë ndërkombëtare nga dy projektet e binjakëzimit.
- Programi bachelor është i krahasueshëm me programet e institucioneve të njohura evropiane (Finlandë dhe Estoni) dhe kjo bën që të diplomuarit në këtë program të jenë të përgatitur të japin kontributin e tyre në agjencitë ligj-zbatuese.
- Gërshetim i shkëlqyeshëm i teorisë dhe praktikës profesionale të studentëve, në funksion të avancimit të shkathtësive dhe kompetencave profesionale.

**B. Dobësitë**

- Mungesa e hapjes së programit për kandidatë edhe nga publiku, krahas studentëve të punësuar në agjencitë e sigurisë publike.
- Mungesa e literaturës shkencore në gjuhën shqipe dhe qasja e kufizuar në literaturën ndërkombëtare nëpërmjet data-bazave shkencore të rëndësishme ndërkombëtare.

**C. Mundësitë**

- Rritja e konkurueshmërisë dhe cilësisë përmes hapjes së mundësisë së regjistrimit të studentëve nga publiku.
- Zhvillimi i programit master për t'i ndërlidhur studimet themelore bachelor, me qëllim të ngritjes së shkathtësive dhe kompetencës profesionale.
- Zgjerimi i ofertës programore për t'i përfshirë edhe agjencitë tjera të sigurisë.

**D. Sfidat**

- Ndërlidhja e programit studimor bachelor me trajnimin themelor profesional.

## 2.5. Studentët

Kërkesat e pranimit janë të specifikuara qartë dhe të përshtatshme për institucionin dhe programet e tij; kërkesat e pranimit aplikohen vazhdimisht dhe në mënyrë të drejtë.
Pranimi i studentëve realizohet përmes konkursit publik, i cili shpallet në ueb faqen e Agjencive të Sigurisë Publike, në afatin e parë në muajin korrik, ndërsa për ato drejtime që ka vende të lira, konkursi publik hapet edhe në muajin shtator.

Kushtet e pranimit të studentëve janë të përcaktuara me Rregullorën (QRK) nr.05/2019 për arsimin e lartë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike si dhe Rregullorën (AKSP) Nr.01 për studimet themelore Bachelor në Fakultetin e Sigurisë Publike.

Në studimet Bachelor, të drejtë pranimi në Fakultet kanë të gjithë kandidatët kosovarë të punësuar në Agjencionet e Sigurisë Publike, të cilët e kanë përfunduar me sukses shkollën e mesme në Kosovë apo jashtë Kosovës dhe e kanë diplomën për shkollimin e kryer.
Fakulteti regjistron deri 65 student për vit akademik.

**Doracaku i studentit** është i disponueshëm gjerësisht brenda institucionit, duke mbuluar të gjitha informacionet e kërkuara për të gjitha fazat e ciklit të jetës së studentit-pranimi, përparimi, njohja dhe certifikimi - përfshirë të gjitha rregulloret, të drejtat dhe përgjegjësitë e studentëve, veprimet që duhen ndërmarrë për shkelje të disiplinës, përgjegjësitë e nëpunësve dhe komisioneve përkatëse, si dhe ndëshkimet që mund të vendosen.

Në vitin 2020 është botuar Doracaku për studentë, i cili është në dispozicion të studentëve. Në këtë Doracak janë përfshirë shumë informata relevante, duke përfshirë Fakultetin dhe programet e studimit, kohëzgjatjen e studimeve, titujt e fituar, ECTS kreditë, kalendarin akademik, kush ka të drejtë të studioj në fakultet, kushtet e pranimit dhe të transferimit të studentëve, të drejtat dhe përgjegjësitë e studentëve, përgjegjësitë e nëpunësve dhe komisioneve, masat ndëshkuese, SMU, etj.
Doracaku është shpërndarë tek studentët përmes përfaqësuesve të tyre dhe janë organizuar seanca diskutimi rreth informacioneve që mban ky doracak. Doracaku njihet mirë edhe nga zyrtarët e shërbimit të studentëve në fakultet të cilët gjate punës me studentë, ju ofrojnë informacion sqarues në raste specifike. I njëjti doracak përdoret edhe gjatë prezantimi të programeve të Fakultetit në Agjencive të Sigurisë Publike dhe është i publikuar edhe në ueb faqe të Fakultetit.

### 2.5.1. Numri aktual i studentëve

Drejtori i Përgjithshëm pas konsultimeve me KPF -në vendos lidhur me numrin e përgjithshëm të studentëve për vitin akademik. Bordi i Akademisë vendosë për kuotat e studentëve në fakultet - FSP/AKSP.

Paraqitja tabelore për vitin akademik 2020/2021

| Programi | Institucioni | Kuota e studentëve | | Studentët aktual | |
|---|---|---|---|---|---|
| Policor | PK | 27 | 29 | 15 | 15 |
| | IPK | 2 | | / | |
| Korrektues sprovues | SHKK | 21 | 23 | 4 | 4 |
| | SHSK | 2 | | / | |
| Menaxhimi emergjent | AME | 8 | 8 | 5 | 5 |
| Doganor | DK | 5 | 5 | / | / |
| **GJITHSEJT** | | **65** | | **24** | |

Paraqitja tabelore për vitin akademik 2019/2020

| Programi | Institucioni | Kuota e studentëve | | Studentët aktual | |
|---|---|---|---|---|---|
| Policor | PK | 27 | 27 | 21 | 21 |
| | IPK | / | | / | |
| Korrektues sprovues | SHKK | 21 | 23 | 14 | 14 |
| | SHSK | 2 | | / | |
| Menaxhimi emergjent | AME | / | / | / | / |
| Doganor | DK | 5 | 5 | 3 | 3 |
| **GJITHSEJT** | | **55** | | **38** | |

Paraqitja tabelore për vitin akademik 2018/2019

| Programi | Institucioni | Kuota e studentëve | | Studentët aktual | |
|---|---|---|---|---|---|
| Policor | PK | 27 | 28 | 28 | 28 |
| | IPK | 1 | | / | |
| Korrektues sprovues | SHKK | 21 | 21 | 19 | 19 |
| | SHSK | / | | / | |
| Menaxhimi emergjent | AME | 11 | 11 | 4 | 4 |
| Doganor | DK | 5 | 5 | 1 | 1 |
| **GJITHSEJT** | | **65** | | **52** | |

Përcaktimi i kuotave dhe numrit të studenteve në vitet në vijim do të jetë në përputhje me vizionin e AKSP-së dhe rrjedhimisht analizat dhe nevojat e agjencive për siguri publike.

Numri i studenteve të diplomuar në tri vitet e fundit në institucion dhe program veç e veç, raporti gjinor. Programi Bachelor në sigurinë publike në AKSP i cili zgjat katër vite ka filluar në vitin akademik 2014/2015 dhe aktualisht në procesin mësimor në FSP janë duke e vijuar katër gjenerata

Paraqitja tabelore e të diplomuarve

| Programi | Institucioni | Studentët e Diplomuar | |
|---|---|---|---|
| Policor | PK | 26 | 27 |
| | IPK | 1 | |
| Korrektues Sprovues | SHKK | 27 | 27 |
| | SHSK | / | |
| Menaxhimi Emergjent | AME | 9 | 9 |
| Doganor | DK | 4 | 4 |
| **GJITHSEJT** | | **67** | |

Paraqitja në formë tabelore e kalueshmërisë së studentëve

| INSTITUCIONI AKSP<br><br>PROGRAMI – Bachelor- Siguri Publike | KALUESHMËRIA E STUDENTËVE | | |
|---|---|---|---|
| | Viti Akademik 2018/2019 | Viti Akademik 2019/2020 | Viti Akademik 2020/2021 |
| | Viti i I-rë | Viti i I - rë | Viti i I - të |
| | 100% | 98 % | / |

Kalueshmëria e studenteve në provime për tri vitet e fundit në institucion dhe program veç e veç

Numri i studentëve që i braktisin studimet për tri vitet e fundit në institucion

| Programi | Institucioni | Braktisja e studimeve | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | 2018-2019 | | 2019-2020 | |
| Policor | PK | / | 1 | 1 | 1 |
| | IPK | / | | / | |
| Korrektues sprovues | SHKK | 1 | 1 | / | / |
| | SHSK | / | | / | |
| Menaxhimi emergjent | AME | / | / | / | / |
| Doganor | DK | / | / | / | / |
| GJITHSEJT | | 1 | 1 | 1 | 1 |

Në bazë të intervistave të realizuara me studentë një ndër arsyet kryesore për braktisjen e studimeve është përgatitja e pamjaftueshme e studentëve për shkollim të mëtutjeshëm akademik.

### 2.5.2. Punësueshmëria e të diplomuarve në tri vitet e fundit

Kriter bazë për regjistrimin e studentëve në FSP është që kandidati të jetë në marrëdhënie të punës me ndonjë nga agjencitë e sigurisë publike që marrin shërbime sipas ligjit në AKSP, përkatësisht të ketë përvojë profesionale prej së paku 3 viteve në agjencinë përkatëse të sigurisë.

Synimi i programit konsiston që pas diplomimit studenti t'i kthehet agjencisë së tij punëdhënëse, me shkathtësi dhe kompetenca të zhvilluara dhe të avancuara, që do të ofrohen në shërbim të ngritjes së profesionalizmit në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive në kuadër të detyrave të punës.

Në AKSP neve tashmë kemi student të diplomuar dhe ashtu siq është e precizuar edhe në vetë misionin, objektivat dhe qëllimin e programit studimor për zyrtarët e sigurisë publike, ata janë të tashmë të punësuar bazuar në kriteret e konkursit për të qenë student në Fakultetin e Sigurisë Publike, që rrjedhmisht nënkupton që studentët janë të gjithë janë në marrëdhënije pune.

### 2.5.3. Raporti personel akademik i rregullt / student për njësi dhe institucion në përgjithësi

Në vitin akademik 2020 -2021 AKSP ka 171 studentë në Programin Bachelor si dhe 8 profesorë të rregullt për programin Bachelor.Raporti Profesor i rregullt / Studentë është 22,12 studentë për një profesor të rregullt. Për të ushtruar veprimtarinë mësimore, shkencore dhe profesionale në Fakultet dhe realizimit sa më cilësor të programit studimor, përveç personelit akademik me orar të plotë (të rregullt), AKSP ka angazhuar 35 mësimdhënës me orar jo të plotë.

### 2.5.4. Ndarja përkatësisht ndërmjetësimi i bursave nga institucioni arsimor

AKSP nuk ofron bursa studimi për studentët e FSP-së por mbështet studentët në koordinim me agjencitë respektive duke ua mundësuar marrëdhënien e tyre të rregullt të punës dhe moscënimin e pagës se tyre të cilët gjatë tre ditëve të punës vijojnë studimet në AKSP ndërsa në dy ditët e mbetura vazhdojnë punën në pozitat e tyre në axhencitë respektive.
Po ashtu AKSP-ja studentëve të FSP-së ua ka mundësuar edhe mbulimin e shpenzimeve buxhetore të ushqimit , akomodimin në konvikte, mbështetjen me transportin e rregullt të AKSP-së si dhe shërbime tjera përkatëse.

### 2.5.5. Organizimi i studentëve brenda institucionit/njësisë

Duke u bazuar në nenin 60 dhe 61 të Rregullores (QRK) - Nr. 05/2019 për Arsimin e Lartë në AKSP (SHM 7.6) shprehin qartë që interesat e studentëve do të përfaqësohen nëpërmes Këshillit të Studentëve. Anëtarët e Këshillit të studentëve zgjedhen në bazë të rezultateve të zgjedhjeve të cilat organizohen sipas rregullores mbi zgjedhjet studentore të miratuar nga Këshilli i Fakultetit. Kryesuesi i Këshillit të Studentëve është anëtar ex-officio i Këshillit të Fakultetit.

Aktet normative që rregullojnë organizimin e studentëve Brenda institucionit janë:

- Rregullore (AKSP) - Nr. 01/2016-KF për Zgjedhjet e Studentëve në FSP (SHM 7.16)
- Rregullore (AKSP) - Nr. 02/2016-KF mbi Punën e Këshillit të Studentëve në FSP (SHM 7.17)
- Rregullore (AKSP) - Nr. 01/2020-KF e punës së Këshillit të Fakultetit të Sigurisë Publike. (SHM 7.18)

KPF në mbledhjen e 25-të të dt. 29.04.2016 ka nxjerr vendimin nr.2/25 të datës 29.04.2016 për shpalljen e zgjedhjeve të studentëve për Këshillin e Studentëve të FSP(SHM 7.19) dhe vendimin nr.3/25 të datës 29.04.2016 për themelimin e Komisionit zgjedhor për përgatitjen, udhëheqjen dhe organizimin e zgjedhjeve studentore në FSP. (SHM 7.20)

Pas përfundimit të procesit zgjedhor, me datën 31.05.2016 është mbajtur mbledhja konstituive e KS-së të FSP -së ku njëkohësisht është zgjedhur edhe kryesuesi i këtij Këshilli i cili është anëtar ex-officio KPF- së.

### 2.5.6. Shërbimi Studentor

DTPA si dhe FSP janë përgjegjës për shërbimet ndaj studentëve, përkatësisht DSHS/Administrata Studentore ofron shërbimet administrative për FSP-në, ashtu siç parashihet edhe me Rregulloren e organizimin dhe sistematimizimin e vendeve të punës QRK 05/2014 të AKSP-së (SHM 7.21),si;

- Hartimin i statistikave të studentëve,
- Vendosjen e notave,
- Hartimin i raportit të vijueshmërisë për stafin e angazhuar akademik,
- Aplikimi i Sistemit Informativ të Studentëve - SIS si dhe shërbime tjera.

DSHS/Administrata Studentore ofron shërbimet përkatëse për procesin e aplikimit, pranimit dhe regjistrimit të studentëve të ASP- ve në FSP duke i njoftuar studentët dhe njëkohësisht publikimin e afateve përkatëse kohore në mënyrë elektronike si dhe shërbime tjera përkatëse. Shërbimet poashtu ofrohen edhe përmes web-faqes së AKSP (http://aksp.rks-gov.net;) përfshirë konsultime dhe udhëzime përkatëse nga DSHS/Administrata Studentore në AKSP çdo ditë pune në zyret e AKSP-së prej 08:00-16:00.

### 2.5.7. Shërbimi për udhëzim në karrierë dhe kryerjen e praktikës (internship) për student

Praktika profesionale është e integruar në programin studimor. Programi studimor ka paraparë që 1/3 e programit është e rezervuar si pjesë praktike, përkatësisht 80 ECTS, të cilat janë të shpërndara në 4 vite të studimit.

Qëllimi i programit të Intershipit është që studentet të arrijnë kompetencë të caktuar profesionale, e cila është e ndërlidhur ndërmjet pjesës teorike dhe praktikës profesionale. Krahas ndjekjes së aktiviteteve profesionale në agjencitë e sigurisë publike, studentët përgatisin edhe një punim hulumtues për tema të caktuara, varësisht nga viti i studimit.

Synimi i punës praktike është familjarizimi i studentit me praktikat kryesore profesionale dhe me aplikimin e njohurive dhe aftësive të tilla. Nga perspektiva e studimeve profesionale, studentët mësojnë që të vlerësojnë punën e tyre, ta bëjnë zhvillimin e detyrave në fushën e tij dhe ta vejnë atë në raport me punën në komunitet.

Përveç ndërlidhjes së lëndëve teorike dhe intershipit, me ndjekjen e aktiviteteve të praktikës profesionale arrihet edhe efekti i njohjes së drejtpërdrejt të agjencive, e sidomos të agjencive ku student nuk është i punësuar dhe në vitin e parë të studimeve ai ka mundësi të zgjedh të ndjekë prkatikën profesionale në ndonjë nga agjencitë tjera.

Për pjesën e shërbimit për udhëzim në karrierë do të diskutojmë tek rubrika pasuese, përkatësisht tek pjesa e shërbimit për studentët e diplomuar e të punësuar (Alumni).

### 2.5.8. Oferta tjera arsimimi të institucionit (nëse ekzistojnë)

AKSP si institucion përgjegjës për ofrimin e trajnimeve dhe arsimit të lartë, zbatimin e politikave dhe strategjive të trajnimit, arsimimit të lartë si dhe zhvillimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë publike, ofron këto shërbime për të gjitha institucionet e sigurisë publike, sikurse: Policia; Shërbimi Korrektues; Shërbimi Sprovues; Dogana, Agjencia e Menaxhimit Emergjent, Inspektoratin Policor. Në nivelin e trajnimeve, AKSP ofron trajnime bazike, të avancuara dhe të specializuara. Trajnimet bazike për të gjitha agjencitë e sigurisë janë të validuara / akredituara nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve.

Përveç programit studimor "*Siguria Publike*" me specializimet përkatëse, AKSP nuk ka ofertë tjetër studimore që zhvillohet në arsimin e lartë.

Në synimet e saja strategjike të parapara në Strategjinë Zhvillimore 2019-2022, është paraparë krijimi dhe zhvillimi i programit master. Ky synim mbështetet në një punë konkrete dhe relevante, pasi për zhvillimin e programit master tanimë ekziston një studim fizibiliteti. Në vitin 2016, është realizuar *"Studimi i Fizibilitetit - Themelimi i studimeve pasuniversitare në sigurinë publike dhe*

*në sektorin e sigurisë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike"*, nga eksperti i Misionit të OSBE-së në Kosovë, Klaus Welter. Mbi këtë studim të rëndësishëm është duke u punuar edhe programi studimor master dhe synohet të fillohet të zbatohet në vitin 2022.

### 2.5.9. Shërbimi për studentët e diplomuar e të punësuar (Alumni)

Programi studimor "Siguria Publike" është program specifik dhe unik në hapësirën e arsimit të lartë në Kosovë. Programi i dedikohet ekskluzivisht nevojave që kanë agjencive të sigurisë me qëllim rritjen e kompetencës dhe shkathtësive profesionale të personelit të tyre për ushtrimin e përgjegjësive të tyre ligjore në sigurinë publike, përkatësisht aftësimin e tyre për t'iu përshtatur sfidave të ndryshueshme në praktikë.

Kriter bazë për regjistrimin e studentëve në FSP është që kandidati të jetë në marrëdhënie të punës me ndonjë nga agjencitë e sigurisë publike që marrin shërbime sipas ligjit në AKSP, përkatësisht të ketë përvojë profesionale prej së paku 3 viteve në agjencinë përkatëse të sigurisë. Me hyrjen në fuqi të Rregullores 01/2020 për studimet bachelor në FSP është përcaktuar që përzgjedhja e studentëve do të bëhet nga vet agjencitë e sigurisë publike, duke u bazuar në nevojat që kanë në raport me avancimin e kompetencave dhe shkathtësive profesionale të personelit të tyre, si dhe bazuar në kriteret dhe kushtet që parashihen në këtë rregullore që duhet t'i plotësojë një kandidat për ta marrë statusin e studentit në FSP.

Pas përfundimit të studimeve, përkatësisht diplomimit të studentit, FSP njofton agjencinë përkatëse për përfundimin e studimeve, duke mbajtur evidencën përkatëse për secilin të diplomuar edhe pas përfundimit të studimeve. Menaxhmenti i FSP-së, së bashku me Divizionin e Shërbimeve Studentore përcjellin zhvillimin e karrierës të të diplomuarit në agjencinë përkatëse.

Me Strategjinë Zhvillimore dhe Planin e Veprimit 2019 - 2022 të AKSP, është paraparë krijimi i rrjetit Alumni, si dhe është paraparë të caktohet një zyrtarë që do të merret vetëm me këtë fushë specifike.

Përfitimet e funksionalizimit të rrjetit të alumnit janë të konsiderueshme. Si të diplomuar të suksesshëm, alumni përfaqëson ambasadorët më të mirë të institucionit. Ata mund të ofrojnë njohuri të rëndësishme në boshllëqet e shkathtësive dhe kompetencave në kurrikulat tona aktuale, si dhe rekomandimet e dobishme për zhvillimin e ardhshëm të kurrikulave. Alumni gjithashtu mund të shërbejë potencialisht si bashkëpunëtor i dobishëm për punën praktike/intership dhe angazhimin në aktivitetet e AKSP/FSP.

**Analiza SWOT për studentët**

**A. Pikat e forta**

- Studentë të motivuar për t'i ndjekur aktivitetet akademike dhe për të arritur rezultate të larta në studime.
- Ndërlidhje e drejtpërdrejt e pjesës teorike dhe asaj praktike, pasi studentët janë të punësuar në agjenci dhe drejtpërdrejt zbatojnë mësimet e marra në fakultet.

**B. Dobësitë**

- Qasje jo e bollshme në materiale që lidhen me studimet e tyre në lëndët përkatëse.

**C. Mundësitë**

- Rritja e numrit të studentëve për drejtimet e caktuara.
- Përfshirja e studentëve nga publiku dhe nga agjencitë tjera të sigurisë.

**D. Sfidat**

- Kohë jo e bollshme për t'iu përgjigjur studimeve me kapacitet të plotë, pasi krahas vijimit të studimeve janë të punësuar në agjencitë e sigurisë publike.

## 2.6. Hulumtimi

Akademia e Kosovës për Siguri Publike ka mandat ligjor për të kryer hulumtime dhe zhvillime në fushën e sigurisë publike.

Në strukturën organizative të FSP-së është paraparë edhe funksionalizimi i Institutit për Hulumtim dhe Zhvillim. Me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të AKSP-së është themeluar grupi punues në përbërje të stafit akademik dhe administrativ për të hartuar draft-rregullore për përcaktimin e parimeve, procedurave dhe standardeve për funksionalizim të institutit. Gjithashtu ekziston një grup punues për hartimin e Strategjisë për Institutin për Hulumtim dhe Zhvillim.

Pra, Fakulteti për Siguri Publike (AKSP) është në fazën e zhvillimit të aktiviteteve qe i shërbejnë funksionalizimit të Institutit për Hulumtim dhe Zhvillim. Brenda strategjisë së Institutit janë paraparë mënyrat e realizimit të projekteve të ndryshme, ku pjesë e këtyre projekteve do të jenë edhe studentët nga Fakulteti i Sigurisë Publike.

Lidhur me mbështetjen e drejtpërdrejta të punës hulumtuese ende nuk është krijuar një linjë e veçantë buxhetore që i përgjigjet ekskluzivisht nevojave të hulumtimeve, por deri më tani stafi akademik ka përfituar nga mbështetja financiare e ofruar nga institucioni, pasi AKSP ka përkrahur vizita studimore në institucione ndërkombëtare shkencore, ka mbështetur disa projekte hulumtuese shkencore, si dhe janë mbështetur në pjesëmarrje në konferenca shkencore ndërkombëtare, duke subvencionuar materialisht aktivitetet e pjesëmarrjes në konferenca.

AKSP ka organizuar dhe mbështetur organizimin e konferencave shkencore me pjesëmarrje ndërkombëtare që janë mbajtur në kampusin e institucionit sikurse në vijim:

- *Konferenca e parë shkencore, me temën "Sfidat e sigurisë në Kosovë", 29 maj 2017.*
- *Konferenca e dytë shkencore ndërkombëtare me temën "Institucionet arsimore të sigurisë publike, faktor kyç në forcimin e rendit dhe sigurisë", 7 nëntor 2018.*
- *Konferenca shkencore ndërkombëtare me temën "Sfidat e mobilitetit të transportit dhe siguria publike"*, e organizuar nga Kolegji "Tempulli" në bashkëpunim më Akademinë, 24 janar 2020.

Stafi akademik vit për vit është pjesë aktive e angazhimeve në publikimet shkencore dhe këto publikime bëhen nën emrin e institucionit, përkatësisht AKSP/FSP (për më tepër shiko listën e publikimeve në CV-të e mësimdhënësve).

Publikimet shkencore të stafit akademik janë në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr. 01/2018 për parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension të nxjerrë nga Ministria e Arsimit të Republikës së Kosovës.
Publikimet shkencore të mësimdhënësve janë të indeksuara në platforma të njohura shkencore, sikurse: Scopus, EBSCO, DOAJ, WorldCat etj.

Një zhvillimi i rëndësishëm për mbështetjen e punës shkencore në AKSP/FSP, është edhe nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit më 9 tetor 2020 me Bibliotekën Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani" dhe Asociacionin e Bibliotekave Elektronike të Kosovës (ABEK).

Në kuadër të marrëveshjes së nënshkruar në mes të AKSP-së dhe BKK-së, ndër të tjerash bashkëpunimi do të fokusohet në mbështetjen dhe përkrahjen reciproke në kuadër të: forcimit të marrëdhënieve institucionale, shfrytëzimit të resurseve të institucioneve me interes të përbashkët, hulumtimit/kërkimit, bashkëpunimit në organizimin e konferencave, seminareve, ekspozitave, panaireve, promovimeve të botimeve të rëndësishme të autorëve, përfshirjes në projekte të mundshme të përbashkëta, zbatimit të shërbimeve të specializuara për të drejtën e autorit, qasjes dhe ofrimit të shërbimeve të referencave për studentët, stafin akademik dhe stafin profesional të Akademisë, duke përfshirë këtu informacionin për koleksionet Bibliotekës (qasje në mbi 700 mijë tituj), mbi katalogun elektronik dhe manual, mënyrat e hulumtimit, etj.

Përderisa në kuadër të marrëveshjes së nënshkruar në mes të AKSP-së dhe ABEK-ut, qëllimi i kësaj marrëveshje është anëtarësimi i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike në Asociacionin e Bibliotekave Elektronike të Kosovës dhe shfrytëzimi i burimeve dhe materialeve elektronike të nevojshme për nevojat e Akademisë. Anëtarësimi i AKSP-së në ABEK ofron mundësinë e shfrytëzimit të burimeve elektronike të cilat sigurohen nga ABEK përmes EIFL ("Electronic Information for Libraries", apo në përkthim "Informatat Elektronike për Bibliotekat"). Më këtë marrëveshje do të bëhët e mundur që duke filluar nga viti 2021, studentët dhe mësimdhënësit e FSP-së të kenë qasje në 8 (tetë) burime elektronike për literaturë dhe referenca, si në: ASTM International, Cambridge University Press Jounals, Duke University Press Journals, Edëard Elgar Publishing, European Respiratory Society (ERS) Journals, IOP Science, MSP Journals dhe Openedition Freemium for Journals.

### 2.6.1. Listimi i publikimeve nga stafi akademik dhe i studentëve

Informata lidhur me publikimet dhe pjesëmarrjen e personelit akademik në konferencat shkencore janë të prezantuara në CV-të e personelit akademik (SHM 7.14)

Në lidhje me publikimet e studentëve në revista ndërkombëtare dhe kombëtare nuk ka të realizuara deri më tani.

### 2.6.2. Projektet për bashkëpunim ndërkombetar në hulumtim dhe mësimdhënie

Pjesëmarrja e stafit akademik të rregullt, stafit administrativ – studentëve ne konferenca, simpoziume dhe seminare shkencore ne tri vitet e fundit.

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1 | Erasmus+ Mobiliteti Ndërkombëtar i Kredive | a) 4 (katër) anëtarë të stafit akademik nga FSP i AKSP-së kanë ndjekur trajnim secili për 1 (një) javë, 24 - 28.06.2019;<br>b) 9 (nëntë) studentë nga FSP i AKSP- së kanë ndjekur trajnim secili për një semestër për javë, 28.05 - 01.06.2018;<br>c) 2 (dy) anëtarë të stafit administrativ nga AKSP kanë ndjekur trajnim secili për 1 (një) javë, 24 - 28.06.2019;<br>d) 19 (nëntëmbëdhjetë) zyrtarë të Policisë së Kosovës (PK) kanë ndjekur trajnim secili për 1 (një) javë, dhe atë 3 (tre) nga 04 - 08.12.2017, 8 (tetë) nga 28.05 - 01.06.2018 dhe 8 (tetë) të tjerë nga 24 - 28.06.2019;<br>e) 1 (një) trajnues nga Universiteti në fjalë i Brandenburgut ka mbajtur një trajnim dhe ka qëndruar në Kosovë nga 01 - 07.10.2017. | Universiteti i Shkencave të Aplikuara të Policisë të Brandenburgut, Oranienburg, Gjermani |
| 2 | Erasmus+ Mobiliteti Ndërkombëtar i Kredive | a) 4 (katër) anëtarë të stafit akademik nga FSP i AKSP-së kanë qëndruar për nga 1 (një) javë në Estoni, dhe atë: 1 (një) nga 14 - 20.03.2018 dhe 3 (tre) të tjerë nga 04 - 08.11.2019;<br>b) 4 (katër) studentë nga FSP i AKSP-së kanë ndjekur secili nga një semestër për 5 (pesë) muaj, dhe atë: 2 (dy) nga 01.09.2019 - 31.01.2018 dhe 2 (dy) të tjerë nga 01.09.2019 - 31.01.2020;<br>c) 1 (një) mësimdhënës nga Estonia ka qëndruar për mësimdhënie në AKSP/Kosovë nga 17 - 21.02.2018;<br>d) 6 (gjashtë) anëtarë të stafit administrativ nga AKSP kanë qëndruar secili nga 1 (një) javë në Estoni, dhe atë: 2 (dy) nga 11 - 17.02.2018, 3 (tre) nga 20 - 24.05.2019 dhe 1 (një) tjetër nga 04 - 08.11.2019;<br>e) 5 (pesë) anëtarë të stafit administrativ nga Estonia kanë qëndruar secili nga 1 (një) javë në Kosovë, dhe atë: 2 (dy) nga 06 - 12.04.2019, 1 (një) nga 27.05 - 02.06.2019 dhe 2 9dy) të tjerë nga 24 - 29.11.2019. | Akademia e Estonisë e Shkencave të Sigurisë Tallinn, Estoni |
| 3 | Erasmus+ Mobiliteti Ndërkombëtar i Kredive | a) 1 (një) anëtar i stafit akademik nga FSP i AKSP-së ka qëndruar për 1 (një) javë në Poloni nga 14 - 18.05.2018;<br>b) 2 (dy) anëtarë të stafit administrativ nga AKSP kanë qëndruar secili për 1 (një) javë në Poloni dhe atë: njëri nga 14 - 18.05.2018 dhe tjetri nga 22 - 26.10.2018. | Shkolla Kryesore e Shërbimit të Zjarrfikjes, Varshavë, Poloni |

Një nga faktorët për zbatimin e suksesshëm të misionit dhe vizionit të AKSP-së është bashkëpunimi dhe fizibiliteti në nivel ndërkombëtar. Aftësia për të mësuar nga praktikat më të mira në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe mundësia për të kontribuar në cilësinë e arsimit të lartë në sigurinë publike, do të rrisë ndërgjegjësimin e AKSP-së në aspektin ndërkombetar dhe do të promovoj vlerat dhe cilësinë në të gjitha nivelet e studimeve. Gjithashtu, procesi i Bolonjës kërkon plotësimin e një grupi të caktuar të kritereve për të ndërkombetarizuar arsimin e lartë ne AKSP,bazuar në këtë, AKSP ka prioritet aktivitetet në vijim në bazë të Strategjisë së Zhvillimit të AKSP-së dhe Planit të Veprimit 2019-2020 (SHM 7.3)
AKSP ka krijuar partneritet dhe është bashkuar me rrjetet ndërkombëtare që janë të rëndësishme dhe efektive për arritjen e objektivave të institucionit për ndërkombëtarizimin e tij (**Tabela nr.10.4-verifikim me nr te tabelave**) me këtë rast është zbatuar edhe procesi i monitorimit dhe i vlerësimit.Një ndër pengesat kryesore për ndërkombëtarizimin e institucionit tonë janë çështje politike dhe niveli i pamjaftueshëm i aftësive të njohjes të gjuhëve të huaja., me këtë rast janë ndërrmarrë veprime për eliminimin e këtyre vështirësive.

### 2.6.3. Ndërlidhja e hulumtimit me mësimdhënien në nivel të institucionit dhe të programit

Publikimet shkencore të mësimdhënësve pothuajse i përgjigjen mësimdhënies në nivel të institucionit dhe të programit studimor. Publikimet shkencore të mësimdhënësve janë të indeksuara në platforma të njohura shkencore, sikurse: Scopus, EBSCO, DOAJ, WorldCat etj.

**Analiza SWOT për hulumtim:**
**A. Pikat e forta**

- Pjesëmarrja aktive në konferencat akademike kombëtare dhe ndërkombëtare të stafit akademik;
- Publikimi i punimeve shkencore në revista ndërkombëtare të indeksuara në platforma elektronike sipas Udhëzimit Administrativ të MASHT-it;
- Organizmi i konferencave shkencore me pjesëmarrje ndërkombëtare.
- Qasja në data-baza elektronike të rëndësishme shkencore ndërkombëtare.
- Me nënshkrimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet AKSP-së dhe Asociacionit të Bibliotekave Elektronike të Kosovës (ABEK), do të bëhët e mundshme që, duke filluar nga viti 2021, studentët dhe mësimdhënësit e FSP-së të kenë qasje në 8 (tetë) burime elektronike për literaturë dhe referenca, si në: ASTM International, Cambridge University Press Jounals, Duke University Press Journals, Edward Elgar Publishing, European Respiratory Society (ERS) Journals, IOP Science, MSP Journals dhe Openedition Freemium for Journals.

**B. Dobësitë**

- Mos-përfshirja e studentëve në hulumtime dhe publikime shkencore;
- Mos-alokimi i buxhetit nga institucioni që do t'i shërbente vetëm nevojave të hulumtimeve, publikimeve dhe pjesëmarrjes në konferenca shkencore;
- Mungesa e fondeve për financimin e hulumtimeve të pavarura shkencore;

**C. Mundësitë**

- Funksionalizmi i Institutit për Hulumtim dhe Zhvillim;
- Themelimi i revistave shkencore që i përgjigjen fushave të hulumtimit në fushën e sigurisë publike, përkatësisht specializimeve përkatëse.
- Financimi nga fondet apo burimet e jashtme të projekteve kërkimore-shkencore.

**D. Sfidat**

- Numër i kufizuar - i vogël i stafit akademik dhe studentëve për përfshirje në projekte hulumtuese.

## 2.7. Infrastruktura dhe burimet

AKSP ka selinë e saj në qytetin e Vushtrrisë ku edhe gjendet kampusi i saj në adresën : Rr. "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" P.n. 42000 Vushtrri, Republika e Kosovës. Informatat kontaktuese të AKSP-së janë: Telefoni +381 (0)28 590 070; www..aksp-ks.net

AKSP në fushën e infrastrukturës dhe burimeve kryeson me një shembull në ofrimin e kushteve dhe sigurimin e tyre për zbatimin e programit studimor duke e veqar nga Insititucionet tjera të Arsimit të lartë. AKSP në kuadër të organogramit të saj posedon departamentet gjegjëse me divizionet përbëresë të cilat sigurojnë avancimin, ngritjen, mirëmbajtjen, mbështetjen dhe ofrimin e shërbimeve të natyrës logjistike, mjekësore si dhe të shërbimeve të teknologjisë informative. Të gjitha këto të prezantuara dhe të mbështetura në aspektin financiar buxhetor.

### 2.7.1.Infrastruktura fizike, teknologjisë informative dhe logjistike

**Infrastrukura fizike** -AKSP-ja për zhvillimin dhe realizimin sa më të mirë të programit studimor dhe realizimin e misionit te saj institucional posedon, hapësira, salla , kabinete dhe amfiteatro si vijon:

| Hapësira | Numër | Sipërfaqja në m2 |
|---|---|---|
| Salla e mësimit | 20 | 1522.63 |
| Laboratorët | 2 | 140 |
| Kabinete | 10 | 150 |
| Amfiteatrot | 1 | 850 |

AKSP-ja përveç hapësirave të cekura në tabelën 9.1 posedon edhe objekte tjera përcjellese si vijon:

- Ndërtesa kryesore, me sipërfaqe prej 4953.07 m2.
- Konvikti I (i dedikuar për akomodim të studentëve) me sipërfaqe prej 2706.35 m2
- Konvikti II (i dedikuar për akomodim të femrave, instruktorëve, me sipërfaqe prej 1293.07 m2
- Konvikti III (i dedikuar për (VIP) – PRV) me sipërfaqe prej 3803 m2 – Ndërtesa 4
- Palestra sportive me dy salla, me sipërfaqe prej 1222.68 m2
- Mensa / objekti për ngrënie, me sipërfaqe prej 548.75 m2
- Ambulanca, me sipërfaqe prej 131.8 m2
- Logjistika, me sipërfaqe prej 1111 m2
- Ngrohtorja me sipërfaqe prej 168.16 m2
- Arkiva, me sipërfaqe prej 78.84 m2
- Ndërtesa përballë gjeneratorëve, me sipërfaqe prej 684.85 m2
- Qendra mësimore Steve Bennett, me sipërfaqe prej 1753.39 m2
- Depoja, me sipërfaqe prej 1418.87 m2
- Ndërtesa e kopshtarisë, me sipërfaqe prej 29.50m2
- Ndërtesa për pajisje të kopshtarisë, me sipërfaqe prej 29.30m2
- Ndërtesa Administrative, me sipërfaqe prej 621.2 m2
- Ndërtesa e poligonit të mbyllur, për trajnim me armë të shkurtra me sipërfaqe prej 400 m2
- Ndërtesa e Sigurimit, me sipërfaqe prej 108.7 m2
- Stacioni i pompave, me sipërfaqe prej 20 m2
- Lavanderia, me sipërfaqe prej 288.09 m2
- Fakulteti i Sigurisë Publike 7000 m² (*Në ndërtim e sipër, funksionalizimi i të njëjtit pritet të bëhet në pjesën e dytë të vitit 2021 ose pjesa e parë e vitit 2022)*

**Infrastruktura e TI-së –** AKSP-ja posedon Divizionit e Teknologjisë Informative si dhe njësinë e Multimedias në kuadër të strukturës organizative të cilat përjashtimisht mirëmbajtës së pajisjeve të teknologjisë informative dhe atyre mediale, siguron edhe shërbime Profesionale të cilat sigurojnë aplikimin e programit studimor edhe në formatin online përmes platformës "Moodle".

| Pajisjet | Numër |
|---|---|
| Projektorë | 40 |
| Mjete të konkretizimit | 20 tabletë të mençur, 20 flip charts dhe gjithashtu 20 tabela të bardha. |
| Mjetet laboratorike | Mjete për laborator bazë forenzikës |
| Internet | Në tërë kampusin e AKSP |
| WI FI | Në tërë kampusin e AKSP |
| Numri i kompjuterëve për stafin akademik, dhe administratën | 300 |
| Numri i kompjuterëve për studentët | 25 |
| Numri i kompjuterëve për administratën | 100% mbulim |

**Infrastruktura logjistike** – në kuadër të infrastruktës logjistike hyjnë të gjitha objektet, mjete dhe pajisjet e konkretizimit të programit studimor në AKSP.

Akademia me qëllim të realizimit të programit studimor posedon edhe mjete dhe aparatura si në vijim :

| Pajisjet | Numër |
|---|---|
| Projektorë | 40 |
| Mjete të konkretizimit | 20 tabletë të mençura, 20 flip charts dhe gjithashtu 20 tabela të bardha. |
| Mjetet laboratorike | Mjete për laborator bazë forenzikës |
| Internet | Në tërë kampusin e AKSP |
| WI FI | Në tërë kampusin e AKSP |
| Numri i kompjuterëve për stafin akademik, dhe administratën | 300 |
| Numri i kompjuterëve për studentët | 25 |
| Numri i kompjuterëve për administratën | 100% mbulim |

Për shfrytëzimin e hapësirave për trajnime / ligjërata/ seminare, janë në dispozicion gjithsej 27 klasë:

*• 21 klasë të pajisura me mjete të nevojshme; gjysma prej tyre gjithashtu të pajisura me tabela elektronike dhe projektorë.*

*• 6 klasë të tipit kontejner, shfrytëzohen vetëm në rast të mungesës së hapësirave të tjera.*

Përveç kësaj, kati i epërm i qendrës mësimore Steve Bennett, është plotësisht i pajisur me infrastrukturë të nevojshme për takime dhe seminare, si për shembull, pajisjet e përkthimit simultant,tabela të mençura. Kapaciteti maksimal i këtyre hapësirave është **775 persona**.

### 2.7.2.Burimet njerëzore dhe financiare

**Burimet njerëzore** – në kuadër të AKSP-së përjashtimisht proceseve të rekrutimit të stafit akademik, poashtu sigurohet edhe një infrastrukturë e burimeve njërzore e cila korrespondon me nevojat administrative të FSP në zbatueshmërinë e programit studimor. AKSP posedon një strukture tashmë të dëshmuar në aspektin përmbajtësor qoftë atij akademik, menaxherial dhe të stafit professional, administrative-teknik mbështetës.

Struktura etnike dhe gjinore e të punësuarëve

| Kombësia | Gjinia | | | | Total | % |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Meshkuj | % | Femra | % | | |
| **Shqiptarë** | **110** | **67.49%** | **48** | **29.45%** | **158** | **96.94%** |
| **Serbë** | **2** | **1.23%** | **1** | **0.61%** | **3** | **1.84%** |
| **Turq** | **1** | **0.61%** | **1** | **0.61%** | **2** | **1.22%** |
| **TOTAL** | **113** | **69.33%** | **50** | **30.67%** | **163** | |







**Burimet financiare** – AKSP-ja përmes Divizionit për Buxhet dhe Financa koordinon çështjet buxhetore për të gjitha strukturat organizative të Akademisë, njëheresh siguron që shpenzimet financiare janë bërë në përputhje me rregullat dhe procedurat buxhetore përfshirë dhe në mënyrë të veqant aplikimin e programit studimor.

Paraqitja tabelore e buxhetit të AKSP 2020-2022

| **Buxheti i AKSP 2020-2022 sipas Ligjit të Buxhetit 2020** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Kategorit** | **viti 2020** | **Rishikuar** | **Reduktime** | **viti 2021** | **viti 2022** |
| Paga&Mëditje | 1,211,383.00 | 1,211,383.00 | 0.00 | 1,217,440.00 | 1,217,440.00 |
| Mallra&Sherbime | 1,470,091.00 | 1,270,091.00 | 200,000.00 | 1,547,232.00 | 1,547,232.00 |
| Shpen.Komunalive | 144,030.00 | 95,007.00 | 49,023.00 | 144,030.00 | 144,030.00 |
| Shpe.Kapitale | 1,000,000.00 | 536,036.00 | 463,964.00 | 1,100,000.00 | 1,100,000.00 |
| **Total** | **3,825,504.00** | **3,112,517.00** | **712,987.00** | **4,008,702.00** | **4,008,702.00** |

**Shërbimet mbështetëse -** Në kuadër të shërbimeve mbështetëse në AKSP pothuajes veprojnë një mori njësish dhe divizionesh të cilat sigurojnë një mbështetje të aspektit të ndryshëm të shërbimeve, si biblioteka, sigurimi i kampusit, pastaj shërbimet mjekësore, gjuhësore dhe atyre të përbashkëta, të cilat në fakt përbërjnë një numër të angazhimeve që sigurojnë një kampus të sigurt dhe me shërbimet më unike në vend.

**Analiza SWOT për infrastrukturën dhe burimet:**

**A. Pikat e forta**

- Kampus unik me një strukturë të vendosur në aspektin e ofrimit të sigurisë, burimeve njerëzore dhe pajisjeve të avancuara të cilat garantojnë një aplikim cilësor të programit studimor.
- Planifikim të pasqyruar financiar në implementimin e programit studimor të cilat garantojnë një qëndrueshmëri financiare për tri vitet e ardhshme.
- Shërbime dhe pasjise përcjellëse të teknologjisë informative të cilat ofrojnë qasje dhe aplikim të sistemit online të mësimit, vlerësimit dhe programit në përgjithësi.
- Biblioteka me hapësirat e leximit të mjaftueshme si dhe me një numër të konsideruar titujsh në aspektin profesional dhe atë të përgjithshëm.
- Infrastrukturë të knaqshme dhe të dëshmuar në aspektin e avancimit të burimeve dhe modifikimit të tyre sipas përshtatshmërisë së aplikimit të programit studimor.
- Shërbime mbështetëse të cilat sigurojnë një mbarëvajtje të programit studimor dhe ofrojnë një ambient relaksues për student.

**B. Dobësitë**

- Shkurtimet buxhetore me impakt në projektet kapitale.

**C. Mundësitë**

- Avancimi i infrastrukturës dhe ngritja e nivelit të shërbimeve të përbashkëta dhe të atyre mbështetëse.
- Sigurimi i donacioneve.

**D. Sfidat**

- Përmbushja në tërësi e planifikimit infrastrukturor.

## 3. EVOLUCIONI DHE ZHVILLIMI I KOHËVE TË FUNDIT I REGJISTRUAR QË NGA VLERËSIMI I MËPARSHËM

| Rekomandimi i Ekipit të Ekspertëve në Raportin e mëparshëm të Rishikimit të Jashtëm | Zgjidhja që ofruesi ka zbatuar në adresimin e rekomandimit | Komentet e tjera relevante |
|---|---|---|
| Rekomandim: AKSP-të duhet të ndryshojnë organogramin në përputhje me rrethanat në kohën e duhur. | AKSP në përputhje me zhvillimet dhe rrethanat e krijuara në formë konstante ka plotësuar mungesat në burimet njerëzore | AKSP në kuadër të strategjisë zhvillimore 2019-2022, ka paraparë në Objektivi Specifik: 5.2. Zhvillimi dhe avancimi i mëtejmë i burimeve njerëzore, Aktiviteti 5.2.6 Ngritjen e strukturës së përshtatshme organizative të AKSP-së |
| Rekomandim: një precizitet të planit të Zhvillimit të Stafit duke përshkruar në mënyrë transparente kompetencat vendimmarrëse të organeve të ndryshme të AKSP-së të përfshira, procedurën e aplikimit për mbështetje zhvillimore e cila duhet të ndiqet nga një individ ose grupe individësh, dhe kriteret në bazë prej të cilit do të merret një vendim pozitiv ose negativ. | Zhvillimi i personelit kademik është parashikuar në detaje me planin e zhvillimit të personelit akademik për periudhën 2017-2022<br>Në plan janë parashikuar tre objektiva:<br>1. Mbështetja e stafit akademik në kërkimin shkencor;<br>2. Zhvillimi dhe promovimi i personelit akademik dhe<br>3. Mbështetje në botimin e botimeve. | AKSP në kuadër të strategjisë zhvillimore 2019-2022, përmes Objektivit Strategjik: 5. Ngritja dhe përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore, kapaciteteve infrastrukturore dhe proceseve të punës, ka parparë planin e zhvillimit të stafit |
| Rekomandim: AKSP duhet të shikojë mundësinë për të mbështetur dhe inkurajuar stafin akademik me tituj Master për të punuar dhe për të fituar një PhD në një periudhë afatmesme.<br>A ka një përqindje të barabartë të grave në mesin e stafit akademik? | Ne jemi dakord me rekomandimet dhe në lidhje me politikën e mundësive të barabarta, AKSP do të ndjekë procedurat gjatë rekrutimit të stafit të ri akademik, duke mundësuar mundësinë e rritjes së pjesëmarrjes së grave në përbërjen e stafit akademik. Do të krijohen kushte dhe mbështetje institucionale për avancimin dhe kualifikimin e stafit të ri akademik për kërkime dhe mësimdhënie cilësore. Do të sigurohet mbështetje cilësore dhe efektive administrative. | AKSP në kuadër të strategjisë zhvillimore 2019-2022, përmes Objektivi Specifik: 5.2. Zhvillimi dhe avancimi i mëtejmë i burimeve njerëzore, aktiviteti 5.2.3. Hartimi i planit zhvillimor të personelit akademik, si dhe Objektivi Specifik: 5.1. Rekrutimi i numrit të nevojshëm të personelit mësimdhënës, hulumtues, trajnues dhe mbështetës, aktiviteti 5.1.2 Hartimi i planit të rekrutimit |
| Më shumë strategji duhet të zhvillohen për rekrutimin dhe / ose zhvillimi i stafit të ri akademik dhe veçanërisht i grave. Ne do të rekomandonim seminare të rregullta të llojit | | AKSP në kuadër të strategjisë zhvillimore 2019-2022, përmes Objektivit Specifik: 5.1. Rekrutimi i numrit të nevojshëm të personelit mësimdhënës, hulumtues, trajnues dhe mbështetës, aktiviteti 5.1.1. |

| | | |
|---|---|---|
| "trajnimi i trajnerëve" për anëtarët e rinj të stafit akademik. Një version i konsoliduar, i azhurnuar vazhdimisht dhe i pasur empirikisht i Politikës së Zhvillimit të Stafit duhet të shoqërojë çdo RVV si një aneks për të dhënë shumën e përgjithshme të informacionit mbi zhvillimin e stafit, në mënyrë që ekspertët të fitojnë një pamje më të plotë të situatës së stafit kur vlerësojnë RVV. | | Identifikimi i nevojave për personel 5.1.2 Hartimi i planit të rekrutimit si dhe aktiviteti 5.1.3. Plotësimi i vendeve të lira të punës në pajtim me Planin e Rekrutimit, 5.1.4 Plotësimi i pozitave menaxheriale në FSP |
| AKSP-ja gjithashtu mund të dëshirojë të publikojë, në një periudhë afatmesme, një broshurë të vogël mbi strukturën, funksionet, opsionet kërkimore, arritjet e hulumtimit dhe botimet e Institutit dhe stafit të tij bashkëpunues në mënyrë që të sigurojë disa informacione për donatorët e ardhshëm dhe dhënësit e kontratave | Në formë të vazhdueshme në kuadër të web-faqes së AKSP, ka të ndarë dhe lehtë të qasur pjesën e FSP. Gjerë më tani janë duke u konsultuar mbi formatin e broshurave dhe pasqyrimit të tyre | AKSP në kuadër të strategjisë zhvillimore 2019-2022, përmes Objektivit Specifik: 6.3. Rritja e kredibilitetit përmes transparencës dhe besueshmërisë , synon të arrij shpërndarjen dhe ofrimin e informacionit. |
| Paneli do të shtonte rekomandime për blerjet e mëtejshme të bibliotekës kur diskutonte strukturën dhe përmbajtjen e moduleve individuale të kursit.<br>Për më tepër, studentët dhe personeli akademik duhet të kenë qasje në bazat e të dhënave elektronike dhe burimet falas në mënyrë që të mbajnë azhurnimin e kërkimeve më të fundit në fushat e tyre. | | AKSP në kuadër të strategjisë zhvillimore 2019-2022, përmes Objektivit Specifik: 3.3. Ngritja e kapaciteteve hulumtuese përmes publikimeve dhe konferencave, ka të planfikuar në baza vjetore aktivitetin 3.3.7. Blerja e librave me interes në fushën e sigurisë publike si dhe avancimin e sistemit elektronik duke ofruar qasje dhe mundësi të organizmieve nga më të ndryshmet konferenca, botime, revista shkencore etj. |
| Prandaj, ekipi i ekspertëve do të rekomandonte titujt vijues për përfshirje në fondet e Bibliotekës dhe zgjedhjen si literaturë të caktuar të kursit:<br>¬ Alan Collins (ed.): Contemporary Security Studies. 4th ed. Oxford UP December 2015<br>¬ M. D. Cavelty et al. (eds.): Routledge Handbook of Security Studies. 2nd . ed. Routledge 2017 | AKSP ka marrë për bazë rekomandimet e ekipit të ekspertëve dhe ka reflektuar në pasurimin e bibliotekës. Në kuadër të planifikimit buxhetor si dhe atij strategjik, blerja e librave dhe pasurimi i bibliotekës së AKSP është prioritet. | AKSP në kuadër të strategjisë zhvillimore 2019-2022, përmes Objektivit Specifik: 3.3. Ngritja e kapaciteteve hulumtuese përmes publikimeve dhe konferencave, ka të planfikuar në baza vjetore aktivitetin 3.3.7. Blerja e librave me interes në fushën e sigurisë publike.<br><br>Në baza vjetore lista e konsultuar me stafin akademik përpilohet |

| | | |
|---|---|---|
